



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Degën Doganore Tiranë

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”

Tiranë, Dhjetor 2024

NR.	PËRMBAJTJA	FAQE
I	PËRMbledhja Ekzekutive	2-12
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	2-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-13
II	HYRJA	13-18
1.	Objektivat dhe qëllimi	13
2.	Identifikimi i çështjes	13
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14-15
4.	Përgjegjësitë e audituesve	16
5.	Kriteret e vlerësimit	16
6.	Standardet e auditimit	17
7.	Metodat e auditimit	17
8.	Dokumentimi i auditimit	17-18
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	18-200
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	18-23
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	23-200
2.1	1. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.	23-30
2.2	Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori i magazinimit të përkohshëm dhe sektorit të pikës së hyrje-dalje (<i>afati kohor dhe mbyllja e tranziteve</i>) për periudhën nën auditim.	30-54
2.3	Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori i mbikëqyrjes doganore në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike për periudhën nën auditim. <i>3.1. Regjimin e Përpunimit Aktiv.</i> <i>3.2. Regjimin e Lejimit të Përkohshëm.</i> <i>3.3 Magazinat Doganore.</i>	54-89
2.4	Auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklarimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim.	89-151
2.5	Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor për periudhën nën auditim	151-177
2.6	Auditimi i veprimtarisë doganore për procedurat doganore të ndjekura sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për “ <i>Akcizat në RSH</i> ” për periudhën nën auditim.	177-192
2.7	Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.	192-200
2.8	Auditimi i problemeve të tjera që mund të rezultojnë gjatë procesit të auditimit për periudhën nën auditim.	200
IV	REKOMANDIME	200-229

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Dega Doganore Tiranë është një njësi funksionale (zone doganore) e miratuar që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave . Kjo degë doganore mbulon operacione të deklarimit doganor të mallrave dhe zhdoganimit të tyre duke mundësuar lehtësimin e procedurave doganore për hedhjen e mallrave në territorin doganor si dhe kryerjen e procedurave të tjera doganore, tranzitim, magazinim, eksportim etj.

Misioni i Degës Doganore Tirane, është ;

- mbledhja e të ardhurave doganore, garantimi i interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar,
- mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;
- garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera.

Nëpërmjet zbatimit të ;

- -Parimit të mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë.
- -Parimit të mbështetjes së konkurrueshmërinë së kompanive shqiptare përmes:
- -Parimit të lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme përmes
- -Parimit të kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave përmes
- -Parimi të bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit përmes:

Kuadri rregullator nga e cila udhëhiqet administrata e Degës Doganore Tiranë, është legjislacioni doganor ku respektivisht detyrat funksionale sipas funksionit organik janë sanksionuar në Rregulloret e Brendshme të miratuara nga Ministria e Financave Gjithashtu Dega Doganore Tirane ka si objektiva kryesore:

- Sigurimin e mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve dhe taksave nëpërmjet rritjes së efikasitetit në punë të stafit doganor, zbatimin korrekt të legjislacionit, uljen e kohës së përpunimit të deklaratës doganore, duke ulur njëkohësisht dhe kostot shtesë të operatorëve ekonomikë që kryejnë veprime doganore në këtë pikë doganore;
- Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtarëve dhe subjekteve që operojnë nëpër Degë Doganore duke krijuar lehtësi në lëvizje, e kontroll eficient duke synuar uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore sipas legjislacionit në fuqi.

Për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, kryerja e këtij auditimi, ka rëndësi lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, nga mangësitë në aplikimin e kritereve të duhura ligjore gjatë procesit të vlerësimit doganor.

Drejtoria Doganore Tiranë është një institucion buxhetor në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e ngarkuar për administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave doganore në formën e takses doganore, taksave kombëtare të ngarkuara me ligj për tu

mbletdhur, te ardhurave nga taksat kombetare te akcizes, detyrime doganore ne formen e tvsh, detyrime doganore të taksës së rentes minerare, dhe te tjera detyrime per tu paguar në Buxhetin e Shtetit që ja ngarkon legjislacioni fiskal ne RSH si dhe përgjegjëse për përgatitjen e planeve dhe objektivave institucional, në funksion të promovimit të transparencës së duhur në marrëdhëniet me subjektet dhe operatorët deklarues, duke siguruar sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë riskun e korrupsionit, dhe trajtimin e paanshem dhe të babartë për të gjithë importuesit dhe deklaruesit e mallrave. Financimi i institucionit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) sipas programit buxhetor “*Menaxhimi i të ardhurave Doganore*”, pjesë e programeve buxhetore të administruara nga Ministria e Financave.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1112/1 prot., datë 26.12.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua auditim në këtë Degë Doganore lidhur me programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së kryer gjate procedurave te deklarimit, vlerësimin e përputhshmërisë të procedurave të brendshme tranzite, magazinim i perkohshem, vlerësimin dhe klasifikimit tarifor të mallrave, të procedurave ligjore gjatë marrjes së vendimeve administrative etj periudhën 01.01.2022-31.12.2023.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Dega Doganore Tiranë është një njësi administrative e krijuar në mbështetje të ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Organigrama e Degës Doganore Tiranë është miratuar me urdhër të Ministrit të Financave sipas Urdherit per Rregulloren e Brendshme “*Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD*”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.146, datë 07.05.2018. bazuar në Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 921 datë 29.2 “Për personelin e administrates doganore” te ndryshuar me VKM nr 355 datë 26.05.2022

Auditimi i këtij institucioni lidhur me realizimin e të ardhurave kundrejt planit, buxhetit, dhe vlerësimin të përputhshmërisë së veprimtarisë së sektorëve të Degës Doganore Tiranë ka një rëndësi të veçantë, lidhur me transparencën e veprimtarisë në këtë fushë, impaktin financiar në buxhetin e shtetit si dhe zbatimin e parimeve të tregëtisë së lirë

Dega Doganore Tiranë është dega doganore më e madhe referuar nivelit të mbledhjes doganore kundrejt gjithë totalit të sistemit doganor, duke u renditur e para, konkretisht me një realizim prej rreth 35% të totalit të të ardhurave totale doganore.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhshmërisë së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, të cilësuar si kritere vlerësimi, në lidhje me vlerësimin doganor. Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimin në lidhje me përputhshmërinë.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.

2. Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori i magazinimit të përkohshëm dhe sektorit të pikës së hyrje-dalje (afati kohor dhe mbyllja e tranziteve) për periudhën nën auditim.

3. Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori i mbikëqyrjes doganore në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike për periudhën nën auditim, Regjimin e Përpunimit Aktiv, Regjimin e Lejimit të Përkohshëm, Magazinat Doganore.

4. Auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklarimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim.

5. Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor për periudhën nën auditim

6. Auditimi i veprimtarisë doganore për procedurat doganore të ndjekura sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për "Akcizat në RSH" për periudhën nën auditim.

7. Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.

8. Auditimi i problemeve të tjera që mund të rezultojnë gjatë procesit të auditimit për periudhën nën auditim.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut. Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

- Teknika të ndryshme të ekzaminimeve nëpërmjet sistemit të raporteve të përpunuara në sistemin ORACLE, si dhe drejtpërdrejtë në sistemin elektronik Assycuda Word duke përdorur metodat e ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumenteve justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik (*auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet*).

- Teknikat me ndihmën e kompjuterit - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;

- Verifikime transaksionesh me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në lidhje me informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit

- Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera alternative deklarimi në sistemin Asicuda Eörd.

- Intervistimi i personelit që ka patur role specifike në subjektin që u auditua

- Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 26 gjetje të përmbledhura sipas drejtimeve të auditimit dhe ka dhënë **23 rekomandime**, nga të cilat **1 Masë për Përmirësim ligjor, 13 Masa Organizative, 6 Masa** për te ardhura te munguara doganore të rillogaritur, **1 Mase për Eleminim Efektesh Negative** ne të ardhurat doganore të rillogaritur dhe **2 Masa te tjera** të rillogaritur si efekte penalitete administrative të cilat duhet të ndiqen nga subjekti audituar Dega Doganore Tirane.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet kryesore që janë konstatuar gjatë procesit të auditimit kanë konsistuar në :

- ◆ ne konstatimin se artikujt “*Tub Plastik një përdorim për përdorim venoz*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim ne trajte përdorimi përfundimtar ambalazh*” janë ambalazhe plastike dhe kane si përdorim ne destinacion përfundimtar ambalazhimin e solucionit mjekësor dhe se nga pikëpamja e pikës 3 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, këto shërbejnë për mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim ose përdorim. Konstatohet se ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, vendos kufizime duke mos u shtrire efektin e tij në te gjithë mallrat e deklaruar ne Nomenklaturën e Mallrave ne RSH , dhe artikuj e mësipërm nuk përfshihen ne listën e artikujve plastike ambalazhues njëpërdorimshme që duhet të paguajnë taksë plastike TAM ne RSH
- ◆ në rillogaritje të të ardhurave doganore të munguara si pasojë e moszbatimit të kërkesave te pikës 6, 7, 8, 10 dhe 11 të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*”, klasifikime të gabuara tariforë, rillogaritje të detyrimeve doganore që duhen paguar për taksën kombëtare TAM të ambalazhit plastik sipas ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*” i ndryshuar, rillogaritje të detyrimeve doganore për taksën kombëtare të hirrës, kemit të qumështit, qumështit pluhur sipas ligjit nr. 112/2021 date 25.11.2021 “*Taksa e hirrës, kemit të qumështit, qumështit pluhur*”, rillogaritje të detyrimeve doganore si pasojë e mos pagesës së taksave kombëtare te akcizës sipas ligjit 61/2012 “*Për Akcizat ne RSH*”,
- ◆ në rillogaritje të detyrimeve doganore gjatë procedurave doganore të daljes së mallrave nga rregjimi ekonomik i tipit RPA me procedurë 4051 dhe moszbatim të detyrimit ligjor sipas pikës 4 dhe 5 “*Mbikëqyrja e Rregjimit dhe kontrolli*” te Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “*Mbi zbatimin Praktik te Rregjimit te Përpunimit Aktiv*” qe lidhet me raportin dhe kontrollin për verifikimin e koeficientit te shfrytëzimit të mallrave të ndryshëm,
- ◆ në rillogaritje të shumave si masa për eliminim dëmi të efekteve financiare negative për artikujt të ndryshëm për problematika që lidhen me raste dhe gjetje të cilat mbartin efekte negative në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit në lidhje me shkallën e tarifës doganore që mund të jetë shmangur, problematika që lidhen për mos pagesën e taksës QPL për probleme që lidhen me rillogaritje detyrime doganore të taksave kombëtare të akcizës etj.

- ◆ në rekomandime për pagesa të gjobave doganore në lidhje me regjimin e tranzitit (T1), pasi nuk është respektuar afati i caktuar kohor për mbërritje në doganën e destinacionit dhe nga personeli përpunues doganor i pikës së kontrollit kontrollit nuk është vepruar në përmbushje të detyrave funksionale në përputhje me kërkesat e nenit 273.3 të KD pasi nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, ku të aplikohet edhe sanksioni për kundërvajtjen administrative.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e situatës, janë dhënë disa rekomandime si kryesore si vijon:

- Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të rekomandimeve të trajtuara gjatë auditimit të procesit të vlerësimit doganor në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rilogaritur në shumën 418,004,313 lekë.
- Dega Doganore Tiranë, të shqyrtojë rastet e evidentuara dhe të pasqyruara trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulëta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruar sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 31,400.097 lekë
- Dega Doganore Tiranë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi me qëllim rinxjerrjen e vendimeve administrative për, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e vlerës së rekomanduar në shumën 3,121,527 lekë për rastet e trajtuar më hollësisht në anekset respektive dhe materialin e Raportit të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023.
- Drejtoria e Përgjithshme të Doganave nëpërmjet strukturave të specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-se, Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria së Riskut, dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës si dhe Drejtoria e Laboratorit Kimik të ndërtojë menjëherë Programe Kontrolli bazuar në gjetjet dhe konstatimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit trajtuar sa më sipër për artikujt “qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe” “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohte” për probleme që lidhen me rekomandime për rilogaritje detyrime doganore për mallin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire” për pagesën e taksës QPL dhe për probleme që lidhen me rekomandime për rilogaritje detyrime doganore për mallin “Spraj (vajra të lehte), Praimer, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”, për pagesën e detyrimeve të akcizës dhe të kryejë menjëherë veprime konkrete verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe të regjistrave të kontabilitetit financiar të subjekteve të trajtuar sa më sipër të trajtuara në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim ndjekjen e kontabilizimin e të ardhurave doganore të munguara të llogaritura në shumën 173,484,666 leke të cilat duhet të shoqërohen me gjoba dhe penalitete si pasoje e keq deklarimit dhe shmangies se pagesës së detyrimeve doganor nga deklaruesit e drejtpërdrejtë apo të tërthortë agjencitë doganore respektive rezultojnë bazuar në kërkesat e nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD. Mbetet në diskrecion të plotë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që të vlerësojë impaktin e çdo gjetje të auditimit, duke vlerësuar risqet, por edhe duke marra masa për çështje që kanë prekur të ardhurat e Buxhetit të

Shtetit duke e kombinuar në rastin konkret me procedura verifikimi, të dhënat të kontabilitetit të aktivitetit tregtar dhe financiar të operatorëve të trajtuar në këto anekse

- Dega Doganore Tiranë të marrë masa që për rastet e tranziteve të evidentuara si të mbërritur me vonesë, të reflektojnë shënimet përkatëse në dokumentin e tranzitit, si dhe të procedojë me penalizimin e subjekteve për mosrespektim të afatit kohor të mbërritjes në doganën e destinacionit dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në 13,045 raste në shumën 260,900,000 lekë
- Dega Doganore Tiranë bazuar në nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 të ligjit nr. 9863 date 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar në për 125 raste të deklarimeve të mallrave ku janë konstatuar deklarime mallrash të natyrës “Produkte Shtazore” dhe “Mallra Ushqimore të Gatshëm” të cilat nuk kanë bashkëlidhur në sistemin Asicuda Eörd dokumentacion ligjor të tipit “Certifikate Veterinare “për produktet shtazore të importuara, dhe dokumenti shoqërues i tipit “Raport Analize”, “Certifikate Fitosanitare” “Certifikate Shëndeti”, “Certifikate Origjine” për produkte ushqimore të gatshme të aplikojë një gjobë bazuar në nenin 259 pika 1 germa (b), 266c/d të ligjit nr. 102/2014” Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” për subjektet deklarues të mallit në masën 20,000 leke për çdo rast kundërvajtje administrative doganore në shumën totale 2,500,000 lekë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë (i kualifikuar)

Nga auditimi mbi përputhshmërinë¹, për sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Degën Doganore Tiranë në të cilën kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së saj për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2023, bazuar në Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, akteve të tjera ligjore e nënligjore mbi bazën e të cilave e ushtron veprimtarinë subjekti i audituar, në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH, në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), bazuar në dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga ky institucion u konstatuan problematika në lidhje me mbledhjen e të ardhurave doganore, gjatë veprimtarisë së procesit të vlerësimit doganor, gjatë veprimtarisë doganore të regjimeve ekonomike të tipit RPA dhe RLP, problematika që lidhen me rekomandime për rilogaritje detyrime doganore në lidhje me shkallën e tarifës doganore, problematika në lidhje me dokumentacionin e detyrueshëm ligjor të lëshuar nga Agjencia e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (*dokumentit të Akt Kontrollit të përpiluar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në pikat kufitare hyrëse*), problematika në lidhje me afatet kohore administrative të mbërritjes së mjeteve pranë Degës Doganore Tiranë, mospërputhje të treguesve të DEMP-it (ngjyrës) në sistem me statusin doganor aktual të mallrave dhe të tjera. Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e

procedurave doganore, referuar dosjeve përkatëse, si dhe të dhënave, informacionit, evidencave dhe çdo dokumenti të ndodhur në sistemin Asycuda World, mbështetur në analizë risku, duke përzgjedhur kampionin përfaqësues mbi të cilin u kryen testet analitike.

Opinion i modifikuar/kualifikuar¹

Nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI, në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit i kryer në Degën Doganore Tiranë, rezultoi se, në opinionin tonë, nga aktiviteti i tij është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, të cilat justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar/kualifikuar i përputhshmërisë, adresuar për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes.

Baza për opinionin e modifikuar (kualifikuar/i cilësuar)

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e projekt raportit tonë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në dhënien e opinionit kemi marrë në konsideratë:

Faktin se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionit. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të më poshtëm

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

-kanë rezultuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit sipas marrëveshjeve në fuqi që lidhen me tarifën doganore të reduktuar, mos aplikim të saktë të elementëve të vlerës së mallit për qëllime të vlerësimit doganor, procedura vlerësimi të transportit për qëllime të vlerësimit doganor jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, klasifikime tariforë jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave në RSH, raste ku për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar janë deklaruar dhe trajtuar me transaksion edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar artikulli për raste të tjera jo, deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë, duke kryer veprime jo në përputhje të kërkesave me kërkesat e pikës 6, 7, 8, 10 dhe 11 të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, dhe për mallra të importuar nga vende jashtë Komunitetit Evropian trajtimi i tyre është bërë me transaksion në momentin e hedhjes për qarkullim të lirë, keq klasifikime mallra me pasojë, rilloaritje

¹ *Opinionin i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura*

të detyrimeve doganore që duhen paguar për taksën kombëtare TAM të ambalazhit plastik, rillogaritje të detyrimeve doganore për taksën kombëtare të hirrës, kremi të qumështit, rillogaritje të detyrimeve doganore si pasojë e mos pagesës së taksave kombëtare të akcizës me pasojë rillogaritjen e të ardhurave të munguara në shumën totale 417,679,279 lekë detyrime doganore dhe gjoha doganore. (*shuma prej 233,900,296 lekë për vitin 2022 dhe shuma prej 183,778,882 lekë për vitin 2023*)

- kanë rezultuar veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi gjatë veprimtarisë doganore të regjimeve ekonomike të tipit RPA të cilët kanë kryer sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrave të ndryshme ku është konstatuar se vlera e mallrave dhe vlera e shpenzimeve të transportit të deklaruara rezultojnë shumë e ulët për të cilat janë llogaritur rivlerësime të detyrimeve doganore për vlerën e mallit dhe të shpenzimeve të transportit me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit. Gjithashtu nuk rezultoi i kryer dhe i zbatuar detyrimi ligjor sipas pikës 4 dhe 5 “Mbikëqyrja e Rregjimit dhe kontrolli” të Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin Praktik të Rregjimit të Përpunimit Aktiv” që lidhet me raportin dhe kontrollin për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit të mallrave të ndryshëm dhe në veçanti për një subjekt që operon në fushën e përpunimit të alkoolit për të cilin është llogaritur dhe një gjohë doganore dhe një detyrim doganor sipas nivelit të taksimit përkatës karta teknologjike e të cilit nuk rezultojnë e akredituar nga një institucion/laborator/përgjegjës i akredituar në RSH, dhe janë konstatuar raste gjatë auditimit të regjimeve ekonomike të tipit RLP me pasojë shkelje të afateve të eksportuese dhe autorizuese të shtyrjeve të afateve të veprimtarisë së këtyre aktiviteteve, në shumën totale 31,550,097 lekë.

-është konstatuar se dosjet e magazinave doganore nuk janë të inventarizuara veprime këto që bien në kundërshtim me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të mbajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve, nuk japin të dhëna të qarta të gjurmës së kontrolleve të ushtruara, administrimin në to jo vetëm të dokumentacionit të sjellë nga subjektet por edhe dokumentacionin vërtetues të gjithë punës së kryer nga doganierët mbikëqyrës të regjimit të magazinimit doganor. Gjithashtu konstatohet mosrespektim të kryerjes së kontrolleve të paktën një herë në tre muaj veprime në kundërshtim me përcaktimet e nenet 44-46 të Urdhrit nr.146, datë 07.05.2018 të DPD-së kreu 8, “Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve”, dhe përcaktimet e pikës VII “Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikëqyrës” të Udhëzimit nr. 07, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Magazinimit Doganor” të DPD-së me pasojë dhe efekte në formën e gjohës doganore në shumën 100.000 lekë.

-Nga auditimi i kryer rezultoi se në magazinën e mallrave të sekuestruara evidentohen 497 kode artikuj të ndryshëm të sekuestruar në vlerën 11,892,923 lekë për vitin 2022 dhe në përfundim të vitit 2023 vlera totale e artikujve paraqitet në shumën 24,340,919 lekë. Për këto mallra të bllokuara me dyshimin e cënimit të pronësisë intelektuale, Drejtoria përkatëse për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (*si drejtori konstatuese*) nuk ka në të gjitha rastet vendimmarrje për vazhdim procedurash asgjësimi, por vetëm procesverbal bllokimi dhe në mungesë të procesverbaleve të sekuestrimit, nga ana e sektorit juridik nuk janë përgatitur vendime për vijimin e procedurës së konfiskimit ndërsa për mallrat me natyrë akcize të destinuar për shkatërrim nga dega doganore është hartuar Urdhri nr. 09 datë 05.07.2023 i DD Tirane “Për ngritje komisioni për inventarizim të mallrave të konfiskuara me destinacionin shkatërrimin” dhe i është dërguar relacion përmblendhës Drejtorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e mallrave.

- Nga auditimi rezultoi se në shume praktika doganore të artikujve ushqimorë kryesisht kapitujt 1, 2 3 dhe 4, 7, 8 ,9, 10, 11, 12, deri 24 të NM në RSH dokumentacioni i detyrueshëm ligjor i lëshuar nga Agjencia e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

(dokumentit te Akt Kontrollit te përpiluar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ne pikat kufitare hyrëse) nuk kishte bashkëlidhur dokumentacionin shoqëruës ligjor për deklarime doganore të produkteve shtazore deklaruar në kapitujt 1, 2 3 dhe 4, për të cilat nuk rezultonte e bashkëlidhur dokumenti “*Certifikatë Veterinare*” dhe dokumentin “*Certifikata Origjine*” dhe për mallrat ushqimore te gatshëm të deklaruar nuk rezultonte në disa raste bashkëlidhur dokumenti “*Raport Analize*” dhe dokumenti “*Certifikate Fito sanitarë*” “*Certifikate Shëndeti*”, dhe “*Certifikate Origjine*” duke kryer veprime në kundërshtim me nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr. 9863 date 28.01.2008 “*Për Ushqimin*” i ndryshuar, pasi këto mallra duhet te kishin dokumentacion ligjor të trajtuar sa më sipër me efekte administrative në shumën 2,500,000 lekë për 125 raste deklarimi.

- Gjatë auditimit u konstatua se për artikujt “*qumësht Uht me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe*” “*Doreza Kirurgjikale*” dhe “*Hudhër e ftohte*” “*Spraj (vajra te lehte), Pramer, dhe Solvent*” dhe “*Vaj Lubrifikant*” janë konstatuar problematika që lidhen me shkallën e tarifës doganore, pagesën e taksës QPL (*taksa kombëtare e hirrës dhe qumësht pluhur dhe krem qumështi*) taksave kombëtare të akcizës për mallin “*S’praj (vajra te lehte), Pramer, dhe Solvent*” dhe “*Vaj Lubrifikant*”, për të cilat është rekomanduar që nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave nëpërmjet strukturave te specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-se, Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria e Riskut, dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës si dhe Drejtoria e Laboratorit Kimik të ndërtohen menjëherë Programe bazuar në gjetjet dhe konstatimet e Kontrollit te Larte të Shtetit trajtuar për artikujt sa më sipër me qëllim kryerjen e veprime kontrolluese pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe të regjistrave të kontabilitetit financiar të subjekteve të trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar te Auditimit bazuar në përcaktimet e nenit 47, 48 dhe 49, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. nr.102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” me qëllim ndjekjen e kontabilizimin e të ardhurave doganore të munguara të llogaritura në shumën 173,484,666 lekë (*shuma prej 90,212,026 lekë për vitin 2022 dhe shuma prej 83,272,639 lekë viti 2023*)

-Nga auditimi janë evidentuar raste me diference peshe ndërmjet sasisë së gjendjes faktike të mallit në transit (*fletë peshës*) dhe deklarimit. Për këto raste rezulton se nuk ka veprime të mëtejshme në lidhje me parregullsitë dokumentare të konstatuara të cilat duhet të ndiqen nga zyra operacion ale me qëllim ndjekjen e të gjitha procedurave për verifikimin e mallrave dhe ngarkesës si dhe nuk është rianalizuar praktika doganore në kanal të kuq, nuk janë zbatuar procedurat në rastet e parregullsive për mbylljen e DEMP nuk janë pasqyruar masat e marra në “*aktin e kontrollit*” në deklaratë si dhe nuk ka dokumentacion të shtuar për të faktuar se këto mallra nuk janë gjendje duke mos aplikuar një penalitete në shumën 440,000 lekë (20,0000 lekë për çdo rast) .

-Nga auditimi i kontroleve të realizuara nga Zyra Akcizës është konstatuar se në dosjet e kontrollit nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, ku rezultatet e kontrollit nuk janë pasqyruar në raport sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021 ‘*Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës*’ kapitulli 8,2 ‘*Përmbajtja e raportit përfundimtar të kontrollit*’, pika 5. Në përfundim të veprimeve përgatitore nuk janë hapur dosje kontrolli për çdo operator, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “*Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës*”, pika 8.4 ‘*Administrimi i dokumentacionit*’ dhe pika 6.4.2, duke shkaktuar një dokumentim jo të plotë të gjurmëve të auditimit për këto procedura dhe gjithashtu nga auditimi është konstatuar se mungon një analizë risku në nivel zyre apo dege për evidentimin e operatorëve me risk, si dhe dokumentimi i kësaj analize në përzgjedhjen e secilit operator për kontroll sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021, pika 6.3.

-Nga auditimi i borxhit doganor në DDT për vitin 2022 dhe 2023 konstatohet se për vitin 2022 ka qenë në vlerat 18,368 milion lekë me 1,407 debitorë dhe viti 2023 me 18,620 milion lekë me 1,252 debitorë, dhe gjatë vitit 2023 janë pakësuar 652 debitorë për vlerën 177 milion lekë. Nga auditimi i evidencës së borxhit vendosur në dispozicion është konstatuar se për një pjesë të vendimeve të shpalljes së debitorëve gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 nuk janë zbatuar përcaktimet e Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 ‘mbi masat për rikuperimin e borxhit të evidentuar dhe konkretisht për 184 subjekte janë bërë njoftimet por rezultojnë jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 24h/5ditë/10ditë, për 34 subjekte me vlerë borxhi 812,086 lekë janë nxjerre vendime administrative por nuk janë shoqëruar me rikuperim me forcë të borxhit, dhe për 111 subjekte të tjera, këto vendime janë nxjerrë jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 10/30 ditësh, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, kap. VII ‘Ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor’, për 71 subjekte me vlerë borxhi 3,686,949 lekë nuk është dërguar në gjykatë kërkesa për nxjerrjen e urdhër ekzekutimeve

- Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të nxjerra për shkeljet në fushën doganore për periudhën 01.01.2022 deri 01.01.2023 rezultuan vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” për raste marrje vendimi për diferenca sasiore të konstatuara në sasi malli rezultuar më tepër dhe të padeklaruara në deklaratat doganore respektive nga operatorët ekonomikë, për të cilat nuk është aplikuar një gjobë doganore sa 2 (dy) fish i detyrimeve doganore të papaguara dhe shkelja doganore nuk është trajtuar si “Kundërvajtje doganore të kryera në neglizhencë” Janë konstatuar vendime administrative për shkelje në fushën e akcizës për të cilat janë vendosur masa konstatuese nga struktura kontrolluese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave por nuk është propozuar masë për konfiskimin e mallit objekt shkelje doganore në fushën e akcizës dhe më pas riblerjen e tij para hedhjes dhe çlirimit të mallit, sipas përcaktimeve të pikës “d” të nenit 87 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH” i ndryshuar. Gjithashtu u konstatuan marrje të vendimeve të tjera në mosrespektim të legjislacionit doganor në fuqi, që lidhen me në mosrespektim të afatit kohor për regjime doganore ekonomike të tipit RLP duke konsumuar veprime në kundërshtim me nenet 273- 276 të Kodit Doganor dhe nenet 98-100 të Kodit të Procedurës Administrative të RSH në shumën totale 3,121,527 lekë.

- nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore të operatorëve që kanë operuar nën mbikëqyrjen doganore në regjimin e transitit (T1), rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 126.1/a pasi nuk është respektuar afati i caktuar kohor për mbërritje në doganën e destinacionit. Nga personeli i pikës së hyrjes nuk janë bërë shënime përkatëse në kutinë 56-1 të deklaratës “Kontrolli nga zyra e destinacionit: rubrika data e ardhjes, kontrolli i plumbçeve, shënime etj. Është plotësuar data e ardhjes dhe kontrolli i plumbçeve, por nuk është plotësuar fusha shënime për vonesa të konstatuara. Nga personeli përpunues doganor të pikës së kontrollit nuk është vepruar në përmbushje të detyrave funksionale në përputhje me kërkesat e nenit 273.3 të KD pasi nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, ku të aplikohet edhe sanksioni për kundërvajtjen sipas përcaktimeve të nenit 256.1/b të KD në 13045 raste në shumën 260,900,000 lekë për vitin 2022 dhe vitin 2023.

Vlen të theksohet se gjatë auditimit konstatohet se nga ana e Sektorit të Vlerësimit Doganor në Qendër (SQV), si dhe nga ana e Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ (SKAO) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për importet e mallrave të kryer nga një numër i madh subjektësh, veprimet e transaksionit për rastet e trajtuara nuk ka qenë plotësisht i justifikuar dhe është evident fakti që nga strukturat e vlerësimit doganor në sektorin e vlerësimit doganor (SVQ) dhe sektorit të kontrollit aposterior operativ

(SKAO) në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për këto raste nuk janë ndjekur metoda dhe hapa të unifikuara dhe efektive të vlerësimit doganor lidhur me mallrat e importuar në Republikën e Shqipërisë sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi lidhur me vlerësimin e mallrave në zbatim të neneve 65-71 të Kodit të ri Doganor.

HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1113/1 datë 26.12.2023 i (i ndyshuar) miratuar nga Kryetari i KLSH, me periudhe auditimi në terren nga data 26.12.2023 deri në datë 31.05.2024, në subjektin Dega e Doganës Tiranë për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi auditimin e përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. D, Përgjegjës Grupi,
2. Xh. Xh, Audituese,
3. F. D, Auditues,
4. M. V, Audituese,

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi “Auditim të Përputhshmërisë” në Degën e Doganës, Tiranë (këtu e në vazhdim DDT), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me realizimin e të ardhurave dhe zbatimin e legjislacionit doganor. Auditimi u krye me zgjedhje dhe në bazë rrishtu, për vlerësimin e saktësisë së procedurave të ndjekura dhe transaksioneve financiare, si dhe çështjeve që lidhen me organizimin dhe vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë DDD.

1. Objektivat e auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga DDT gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi janë:

-Evidentimi i shmangieve në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së DDT me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator për periudhën objekt i auditimit;

-Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (këtu e në vazhdim DPD);

-Vlerësimi ekonomik e financiar i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë dëm ekonomik, mungesë të ardhurash dhe ato të shkeljeve në fushën doganore.

-Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

-Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.

-Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.

-Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

2. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është: vlerësimi objektiv dhe i pavarur i sistemeve të ngritura, vlerësimi profesional i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative,

ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimi objektiv dhe i pavarur i parimeve, normave, rregullave dhe përcaktimeve në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor të Republikës së Shqipërisë (këtu e në vazhdim RSH); evidentimi i shkëlqeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënia e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e punës të kësaj Dege Doganore (këtu e në vazhdim DDT), gjatë veprimtarisë së saj.

3. Identifikimi i çështjes

Veprimtaria e personelit doganor të DDT, realizohet në përputhje me: Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* (këtu e në vazhdim KD); Ligjin nr. 8474 datë 14.04.1999 *“Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”*, i ndryshuar; Ligjin nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *“Për Akcizat në RSH”*, i ndryshuar;; VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 *“Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 ‘Kodi i Republikës së Shqipërisë’”*, i ndryshuar; Urdhërave dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave (këtu e në vazhdim MF) dhe DPD, si dhe detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018. Veprimtaria e DDT realizon kontrollin dhe përputhshmërinë e deklarimeve dhe procedurave të kryera nga operatorë ekonomikë sipas legjislacionit të fushës. Gjithashtu përgatitja dhe miratimi i pasqyrave financiare në DDT, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”* i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara të shoqëruara me relacion shpjegues (si lista e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera për sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive)

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Degës Doganore Tirane, janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave doganore, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullor në fushën e kontrollit dhe vlerësimit të subjekteve importues dhe deklarues, shërbimin ndaj operatorëve ekonomikë, nxjerrjen e vendimeve etj. Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë

-Kryetari i DDT (*Nëpunësi Autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale si dhe të tjera detyra të sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

-Përgjegjëset e sektorëve operacional të kontrollit fizik, të sektorit të mbikëqyrjes doganore të regjimeve doganore ekonomike dhe akcizës, të pikës së hyrje dalje (tranzit) dhe të magazinimit të përkohshëm mbikëqyrin veprimtarinë dhe organizojnë mbarëvajtjen e punës në këta sektorë si dhe janë persona që autorizojnë çlirimin e praktikave doganore në përpunim sipas profilit të kanalizimit të riskut qëndror dhe lokal si dhe kryejnë të tjera detyra sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit

nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor

-Specialistet e sektorit të mbikëqyrjes dhe analizës së rrishtit dhe kontrollit aposterior (*Nëpunësi Zbatues*) është personi përgjegjës për rishikimin e deklaratave doganore lidhur me saktësinë e deklarimeve e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

-Specialisti jurist (*Nëpunësi Zbatues*) është personi përgjegjës për konceptimin e akteve administrative, e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

-Specialisti i borxhit (*Nëpunësi Zbatues*) është personi përgjegjës për konceptimin e akteve administrative si dhe me procedurat e vjeljes së borxhit doganor, e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

-Specialisti i Financës (*Nëpunësi Zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

- *Personeli përpunues i sektorit operacional (Nëpunës Zbatues)*, janë personat përgjegjës për kryerjen e procedurave doganore gjatë procesit të deklarimeve dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet gjatë ushtrimit të detyrave funksionale e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

- Personeli përpunues i sektorit regjimeve doganore ekonomike (*Nëpunës Zbatues*), janë personat përgjegjës për kryerjen e procedurave doganore gjatë procesit të deklarimeve dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet gjatë ushtrimit të detyrave funksionale e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

- Personeli përpunues i sektorit të pikës hyrje dalje tranzit dhe magazinimit të përkohshëm (*Nëpunës Zbatues*), janë personat përgjegjës për kryerjen e procedurave doganore gjatë procesit të deklarimeve dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet gjatë ushtrimit të detyrave funksionale e sanksionuar kjo në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor.

- Sektori i Vlerësimit Qendër (këtu e në vazhdim SVQ) dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ (këtu e në vazhdim SKAO), (*Nëpunës Zbatues*), janë personat përgjegjës për përpunimin dokumentar të deklarimeve doganore dhe çlirimin e mallrave për ne territorin doganor në RSH dhe për veprimet apo mosveprimet gjatë ushtrimit të detyrave funksionale e sanksionuar kjo me Udhëzimin nr. 05, datë 26.01.2018, të DPD, “*Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO*”

- Strukturat drejtuese të DDT janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e realizimit të të ardhurave doganore, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara

(kriteret e vlerësimit). Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në përputhje me legjislacionin doganor. Kryetari i cili përfaqëson DDTiranë vepron si pikë e parë e kontaktit midis DPD dhe institucionit është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave doganore, si dhe zbatimin e detyrave të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi. Strukturat drejtuese dhe zbatuese të DDTiranë kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar të bëjmë të mundur që:

- Të evidentojmë dhe vlerësojmë nëse informacioni mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në çfarë mase subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4100);
- Të krijojmë bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne si auditues t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimeve të ndjekura nga subjekti i audituar, për faktin nëse pasqyrat financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi;
- Të kryejmë në mënyrë efektive auditimin sipas standardeve (ISSAI 1300);
- Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe, nëse bazuar në këtë evidencë, nga ana jonë mund të arrijmë në konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).
- Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

6. Kriteret e vlerësimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 200; 400 etj.;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë-KLSH;
- Manuali i Zbatimit të Rekomandimeve etj.
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",
- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 "Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore", i ndryshuar;

- Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Ligji nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9720 datë 23. 04. 2007, i ndryshuar nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar
- VKM nr. 651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të KD”;
- Udhëzimi nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme”;
- Marrëveshjet e Republikës së Shqipërisë me vendet tjera EU apo NEU lidhur me trajtimin preferencial të mallrave.
- Urdhër nr.146 date 07.05.2018 “Për Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore”
- Të Tjera.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; ISSAI 4200; ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”, ISSAI 130 “Kodin Etik”, ISSAI 2315 “Risku”, ISSAI 2320-2450 “Materialiteti” , ISSAI 2500 “Dokumentimi”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t; INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

8. Metodat e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1.1. Kontrolli aritmetik që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhenë paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (ditari i

kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

1.2. Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

2. Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese

3. Intervistimi i personelit që ka pasë role specifike në subjektin që u auditua.

4. Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/informacioneve që lidhen direkt me objektivat auditimit.

5. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në lidhje me informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit

6. Pyetësorët sipas teknikës së grumbullimit të të dhënave në rastet kur veprime të caktuara kanë karakteristika të ngjashme dhe janë të përsëritura në struktura të ndryshme të organizatës.

7. Teknika të ndryshme të ekzaminimeve nëpërmjet sistemit të raporteve të përpunuara në sistemin Oracle, Assycuda Ëord, testime konkrete të dokumentacionit fizik të praktikave doganore si dhe duke përdorur metodat e ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet).

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon:(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimin përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshime. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i

rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë dorëzuar në zyrën e protokollit DDTirane 12 akte konstatimi nr 10738/3 deri 10738/14 prot Dega Doganore Tirane date 31.05.2024 të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizim nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion, u përgatit dhe u dërgua në subjekt Projekt raporti i Auditimit me shkresën nr. 1113/5 prot KLSH datë 26.06.2024 derguar Degës Doganore Tiranë për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive rreth gjetjeve të tij.

Në përfundim të afatit 30 ditorë, nga subjekti i audituar (DDT), me shkresën nr. 10738/25 prot DDTirane datw 01.08.2024 per nevoja objektive te citauara ne shkrese eshte kerkuar shtyrja e afatit te paraqitjes se observacioneve mbi Projekt Raportin e Auditimit nisur edhe nga volumi shum i madh i materialit te Projekt Raportit te Auditimit si dhe me shkresën nr. 10738/26 prot KLSH datë 30/08/2024 pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit subjekti i audituar ka bërë komente dhe shpjegime dhe janë paraqitur kundërshtitë mbi Projektraport Auditmin, të cilat pasi u analizuan me kujdes, profesionalizëm dhe paanshmëri nga grupi i auditimit

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Dega e Doganës Tiranë (DDD), është një njësi funksionale që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), dhe ka në varësi të saj sektorët operacional që operojnë brenda zonës doganore të miratuar dhe gjendet e pozicionuara në zonën midis qytetit Vorës dhe aeroportit të Rinasit. Nga pikëpamja doganore kryen funksione në mbledhjen e të ardhurave doganore sipas legjislacioni doganor në fuqi të RSH. Kuadri rregullator nga e cila udhëhiqet administrata e DDTiranë, të cilat ndahen në sektorë, ku çdo strukturë mbulon një funksion të caktuar në përputhje me aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj, është legjislacioni doganor ku respektivisht detyrat funksionale sipas funksionit organik janë sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore sipas Urdhërit nr. 146 prot DPD datë.07.15.2018 dhe Udhëzimin nr. 05, datë 26.01.2018, të DPD, “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

Dega Doganore Tiranë ka si objektiva kryesore:

- *Rritjen e nivelit të të ardhurave doganore nëpërmjet rritjes së efikasitetit në punë të stafit doganor, zbatimin korrekt të legjislacionit, uljen e kohës së përpunimit të deklaratës doganore, duke ulur njëkohësisht dhe kostot shtesë të operatorëve ekonomikë që kryejnë veprime doganore në këtë pikë doganore;*
- *Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtareve dhe subjekteve që operojnë në këtë degë doganore duke krijuar lehtësi në lëvizje, e kontroll eficient duke synuar uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore sipas legjislacionit në fuqi.*
- *Rritja e cilësisë së kontrolleve;*
- *-Ulje të borxhit doganor, mbajtjen nën kontroll të borxhit të ri të krijuar;*
- *-Vlerësimi i punës së nëpunësve;*
- *-Vlerësimi i rezultateve të kontrolleve;*
- *-Informimi dhe këshillimi i vazhdueshëm i subjekteve deklarues në zbatim të një procesi të drejtë për te gjithë dhe të paanshëm.*

Për institucionin tonë, kryerja e këtij auditimi, ka rëndësi lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale me pasojë të ardhura të munguara në

Buxhetin e Shtetit, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Për vitin ushtritor 2022 dhe 2023 Dega Doganore Tirane ka arkëtuar ne Buxhetin e Shtetit te ardhura doganore sa me poshtë vijon

Realizimi

Plan/Fakt për vitin 2022 dhe 2023 ne 000/leke

Periudha	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
2022	86,090,698	87,517,424	1,426,690	102
2023	84,230,163	81,613,636	-2,616,528	97

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Realizimi


Plan/Fakt për vitet 2022 dhe 2023 sipas muajve në 000/lekë

Muaji	Plan 2022	Fakt 2022	Në %	Plan 2023	Fakt 2023	Në %	Dif plan/fakt 2023	Dif me fakt 2022	Në % 2022
Janar	4,578,799	4,578,799	100.00%	5,588,042	5,588,042	100.00%	0	1,009,243	22.04%
Shkurt	6,156,976	6,175,205	100.30%	5,946,925	5,946,925	100.00%	0	-228,280	-3.70%
Mars	7,388,112	7,390,960	100.04%	6,343,108	6,343,108	100.00%	0	-1,047,852	-14.18%
Prill	6,559,220	6,570,482	100.17%	6,034,388	6,034,388	100.00%	0	-536,094	-8.16%
Maj	6,782,866	6,783,075	100.00%	7,598,408	7,598,408	100.00%	0	815,333	12.02%
Qershor	7,471,959	7,483,888	100.16%	7,008,795	7,008,795	100.00%	0	-475,093	-6.35%
Korrik	7,479,458	7,479,641	100.00%	6,833,556	6,833,556	100.00%	0	-646,085	-8.64%
Gusht	8,110,608	8,300,918	102.35%	7,444,286	7,444,286	100.00%	0	-856,632	-10.32%
Shtator	7,000,000	7,603,779	108.63%	6,817,569	6,817,569	100.00%	0	-786,210	-10.34%
Tetor	7,500,000	7,539,163	100.52%	7,485,086	7,353,109	98.24%	-131,977	-186,054	-2.47%
Nëntor	7,162,700	7,149,057	99.81%	7,930,000	7,319,374	92.30%	-610,626	170,317	2.38%
Dhjetor	9,900,000	10,462,421	105.68%	9,200,000	7,326,075	79.63%	-1,873,925	-3,136,346	-29.98%
TOTALI	86,090,698	87,517,388	101.66%	84,230,163	81,613,636	97.00%	-2,616,528	-5,903,753	-6.75%

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Grafiku nr. 1


Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave DDT sipas muajve viti 2022 në mijë lekë



Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Grafiku nr. 2

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave DDT sipas muajve viti 2023 në mijë lekë



Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 3

Të ardhurat doganore viti 2022-2023 (sipas llojit të taksave) në 000 lekë

Llojet e taksave	Plani		Realizimi/Fakt		Diferenca në vlerë		Realizimi në %	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Taksë doganore	4,632,214	4,719,495	4,576,912	4,886,321	-55,302	166,826	99	104
Akcizë	17,810,905	19,263,091	17,274,980	18,792,071	-535,925	- 471,020	97	98
TVSH	63,647,340	60,246,951	65,665,313	57,934,447	2,017,973	-2,312,504	103	96
Renta minerare	238	628	219	796	-19	168	92	127
Totali	86,090,697	84,230,164	87,517,424	81,613,636	1,426,690	-2,616,528	102	97

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për vitin ushtrimor rezultojnë të përpunuara pranë Degës Doganore Tirane praktika doganore të llojit IMP (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9), EXP(1, 2 dhe 3), dhe Individë sa me poshtë vijon

Për vitin 2022 rezultojnë në numër praktikash doganore sipas procedurave import dhe eksport si me poshtë vijon ;

Lloji	EXPORT	IMPORT	IND	TOTAL
1	94,196			94,196
2	3,388			3,388
3	84,900			84,900
4		339,812	404	340,216
5		61,119		61,119
6		6,744		6,744
7		24,301		24,301
9		4,673		4,673
Total	182,484	436,649	404	619,537 deklarata doganore

Burimi "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" përpunoi grupi KLSH

Për vitin 2023 rezultojnë në numër praktikash doganore sipas procedurave import dhe eksport si me poshtë vijon ;

Lloji	EX	IM	IND	TOTALI
1	96,862			96,862
2	3,501			3,501
3	83,305			83,305
4		387,689	305	387,994
5		57,542		57,542
6		6,389		6,389
7		27,277		27,277
9		5,109		5,109
Total	183,668	484,006	305	667,979 deklarata doganore

Burimi "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" përpunoi grupi KLSH

2- Gjatë periudhës së auditor rezultoi se janë rreth 665 autorizime të dhënë për operatorët ekonomikë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Dega Doganore Tiranë që kanë vendosur mallra në Regjimin e Lejimit të Përkohshëm dhe janë mbikëqyrur njëkohësisht nga kjo DDTiranë për këtë periudhë auditimi

3-Gjatë periudhës së audituar rezultoi se kanë kryer veprimtari ekonomike dhe kanë qenë të pajisur rreth 326 operatore ekonomikë me autorizime të tipit RPA nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këtë periudhë auditimi

2- Gjatë periudhës së audituar rezultoi se janë rreth 45 autorizime të dhënë për operatorët ekonomikë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Dega Doganore Tiranë që për Magazina Doganore qe stokoj ne mallra dhe janë mbikëqyrur njëkohësisht nga DDTiranë për këtë periudhë auditimi

3- Gjatë periudhës së audituar rezultoi se janë nxjerrë rreth 2500 Vendime Administrative për shkelje te ndryshme doganore me konstates Degën Doganore Tirane dhe struktura te tjera te Drejtorisë se Përgjithshme te Doganave dhe te tjera Institucione

4-Gjate Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Dega Doganore Tirane për vitin 2022 numri total i Dokumentit Elektronik të Magazinimit të Përkohshëm (DEMP) të

gjeneruar është 79,616 dhe për vitin 2023 numri total i DEMP-eve të gjeneruar është 80,992. Operatorët ekonomikë të pajisur me autorizim për magazinim të përkohshëm nga DPD me doganë mbikqyrëse DDT

Nr.	Operatori ekonomik, Numri identifikues i magazinës	NIPT	Autorizimi Numër/datë	Afati i garancisë
1	"M" SHPK MPR	L.....B	Nr. 22303/1, datë 23.09.2015	31.12.2024
2	"I.F.T.M." SHPK MP25	K.....D	Nr. 3462/2, datë 19.04.2019	13.01.2025
3	"D." SHPK MP33	K.....U	Nr. 1229/1, datë 29.01.2021	26.01.2025
4	"S. N. L." SHPK MP16	K.....M	Nr. 17135/1, datë 7.07.2019	21.04.2025
5	"Z. T." SHPK MP30	K.....T	Nr. 20148/1, datë 07.12.2022	18.11.2024
6	"U. E." SHPK MP21	K.....B	Nr. 22533/4, datë 19.11.2019	03.09.2024
7	"S. A." SHPK MP29	K.....N	Nr. 19976/2, datë 07.12.2022	12.07.2024

Burimi: Të dhëna nga ZMP e DDT-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

3- Gjatë periudhës së audituar rezultoi se janë kryer rreth procedura tranzit nga Dege te tjera doganore drejt DDTirane

Tabela nr. 1- Numri i tranziteve të vitit 2022 të ndara sipas sektorëve doganorë

Sektori doganor	Kodi	Numri i tranziteve të mbyllura 2022
Tirana	AL110000	47,063
Tiranë DPS	AL111000	585
Tirana Autopasion	AL110007	207
Tirana IN	AL110002	108
Tirana INT	AL110005	263
Tirana ITD	AL110006	344
Tirana MD	AL110001	1,353
Tirana MS	AL110003	1,092
Tirana PO	AL110004	138
Tirana THG	AL110008	709
Tiranë	321	1
Totali		51,863

Burimi: Të dhëna DPD-ja, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 7- Numri i tranziteve të vitit 2023 të ndara sipas sektorit doganor

Sektori doganor	Kodi	Numri i tranziteve të mbyllura
Tirana	AL110000	47,932
Tirane DPS	AL111000	1,620
Tirana Autopasion	AL110007	311
Tirana IN	AL110002	126
Tirana INT	AL110005	251
Tirana ITD	AL110006	355
Tirana MD	AL110001	1,174
Tirana MS	AL110003	1,114
Tirana PO	AL110004	152
Tirana THG	AL110008	804
Tiranë	321	5
Totali		53,844

Burimi: Të dhëna DPD-ja, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

3- Gjatë periudhës së audituar rezultoi se gjendja e borxhit doganor për vitin 2022 dhe 2023 ka qënë si më poshtë

Borxhi sipas zërave (leke)	Raste	Detyrime	Penalitet	Kamatvonesa	Total
Borxhi 31.12.2022	1,982	5,136,754,633	10,269,412,763	2,962,493,626	18,368,661,021
Borxhi 31.12.2023	1,642	5,137,243,392	10,276,316,231	3,207,375,130	18,620,934,752

Borxhi doganor për vitin ushtrimor 2022 dhe 2023 të dhëna nga DDTirane.

Konkretisht për vitin 2023

Gjendja debitore			Debitorë të shtuar			Debitor të shlyer			Gjendja debitore		
01.01.2023			gjatë 2023 përfshirë kamatvonesat e llogaritura para 2023			gjatë 2023			31.12.2023		
Raste	Debitore	Vlerë	Raste	Debitore	Vlerë	Raste	Debitore	Vlerë	Raste	Debitore	Vlerë

1,98	1,407	18,368,661,0	995	497	430,085,5	1,33	652	177,811,7	1,64	1,252	18,620,934,7
2		21			28	5		98	2		51

Borxhi doganor për vitin ushtrimor 2023 te dhëna nga DDTirane

Gjendja e borxhit doganor sipas llojit te shkeljes deri me datën 31.12.2023

Borxh Total 31.12.2023 (sipas llojit te shkeljeve)			
	Numër Raste	Vlerë	% Ndaj Totalit
TVSH e shtyrë	32	326,649,387	1.75%
Auto Veturë	122	51,070,014	0.27%
Akcize Dogana	139	290,649,762	1.56%
Akcize Tatime	4	12,847,560,363	69.00%
Rivlerësim	417	92,074,073	0.49%
Kontrabandë	230	2,126,424,610	11.42%
Kundërvajtje	698	2,886,506,542	15.50%
Totali	1,642	18,620,934,751	100.00%

Borxhi doganor për vitin ushtrimor 2023 te dhëna nga DDTirane

Te dhëna të marra nga DDTirane për vjetërsinë e borxhit dhe strukturën kohore te lindjes se tij deri me date 31.12.2023

Emërtimi	Raste	Vlerë (mijë lekë)	Në %
1 vit	173	59,975,220	0.32%
2 vjet	97	94,119,896	0.51%
3 vjet	59	10,525,750	0.06%
4 vjet	129	326,538,929	1.75%
Mbi 5vjet	1,184	18,129,774,956	97.36%
Gjithsej	1,642	18,620,934,751	100%

Borxhi doganor për vitin ushtrimor 2023 te dhëna nga DDTirane

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në programin e auditimit, ky auditim ka përfshirë realizimin e të ardhurave doganore si dhe auditimin e procedurave doganore që lidhen me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike, veprimtarinë e kryer gjate procesit te vlerësimit dhe klasifikimit tarifor te mallrave, procesin e nxjerrjes se vendimeve administrative, te veprimtarisë se ndjekur për reduktimin e borxhit doganor, veprimtarin e sektorit te pikës hyrje dalje, magazinimit te përkohshëm, etj.

Në përfundim të auditimit, grupi i auditimit hartoi Projekt Raportin e Auditimit, bazuar në evidencat, dokumentacionin, të dhënat e sistemit, Letrat e punës, diskutimet me zyrtarët e subjektit, Akt Konstatimet, vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga DDTirane sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit, trajtuar më hollësisht si më poshtë.

❖ 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

🚩 2.1 Auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën nen auditim.

Në zbatim të pikës së mësipërme, u shqyrtua informacioni dhe dokumentacioni si vijon:

-Të dhëna statistikore mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave doganore (AD), sipas strukturës së tyre për vitet 2022 dhe 2023;

-Të dhëna mbi realizimin e të AD, për vitet 2022 dhe 2023;

-Të dhëna mbi realizimin e të ardhurave dytësore;

-Të dhëna mbi gjendjen e mallrave të sekuestruara.

nga ku u konstatua se:

Tabela nr. 1 - Realizimi Plan/Fakt në 000/lekë

Periudha	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
2022	86,090,698	87,517,424	1,426,690	102
2023	84,230,163	81,613,636	-2,616,528	97

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sic shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, për vitin 2022, të ardhurat doganore paraqiten me tejkalim në masën 2% ose në vlerën 1,426,690 mijë lekë. Ky tejkalim vjen kryesisht nga realizimi i të ardhurave nga TVSH, në masën 103%, ose me 2,017,972 mijë lekë më shumë se plani. Ndërsa të ardhurat doganore për vitin 2023 paraqiten me mosrealizim në masën 3% ose në vlerën 2,616,528 mijë lekë më pak se plani. Gjithashtu theksojmë se plani i të ardhurave të vitit 2023 në raport me vitin 2022 është ulur me 2,16%, ose në vitin 2023 u planifikuan 1,860,535 mijë lekë më pak të ardhura se në vitin 2022.

Tabela nr. 2- Realizimi Plan/Fakt për vitet 2022 dhe 2023 sipas muajve (në 000/lekë)

Muaji	Plan 2022	Fakt 2022	Në %	Plan 2023	Fakt 2023	Në %	Dif plan/fakt 2023	Dif me fakt 2022	Në % 2022
Janar	4,578,799	4,578,799	100.00%	5,588,042	5,588,042	100.00%	0	1,009,243	22.04%
Shkurt	6,156,976	6,175,205	100.30%	5,946,925	5,946,925	100.00%	0	-228,280	-3.70%
Mars	7,388,112	7,390,960	100.04%	6,343,108	6,343,108	100.00%	0	-1,047,852	-14.18%
Prill	6,559,220	6,570,482	100.17%	6,034,388	6,034,388	100.00%	0	-536,094	-8.16%
Maj	6,782,866	6,783,075	100.00%	7,598,408	7,598,408	100.00%	0	815,333	12.02%
Qershor	7,471,959	7,483,888	100.16%	7,008,795	7,008,795	100.00%	0	-475,093	-6.35%
Korrik	7,479,458	7,479,641	100.00%	6,833,556	6,833,556	100.00%	0	-646,085	-8.64%
Gusht	8,110,608	8,300,918	102.35%	7,444,286	7,444,286	100.00%	0	-856,632	-10.32%
Shtator	7,000,000	7,603,779	108.63%	6,817,569	6,817,569	100.00%	0	-786,210	-10.34%
Tetor	7,500,000	7,539,163	100.52%	7,485,086	7,353,109	98.24%	-131,977	-186,054	-2.47%
Nëntor	7,162,700	7,149,057	99.81%	7,930,000	7,319,374	92.30%	-610,626	170,317	2.38%
Dhjetor	9,900,000	10,462,421	105.68%	9,200,000	7,326,075	79.63%	1,873,925	-3,136,346	-29.98%
TOTALI	86,090,698	87,517,388	101.66%	84,230,163	81,613,636	97.00%	2,616,528	-5,903,753	-6.75%

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela e mësipërme paraqet planin dhe faktin e të ardhurave doganore sipas muajve për vitet 2022 dhe 2023. Për vitin 2022 evidentohet se përgjatë muajve plani është realizuar, ka pasur dhe tejkalim, përveç muajit nëntor, muaj gjatë të cilit realizimi konsiston në masën 99.81%. Për vitin 2023 evidentohet se deri në Shtator 2023 të ardhurat janë realizuar në masën 100% të planit, ndërsa për 3-mujorin e fundit kanë pasur mosrealizim, ku muaji dhjetor shënon mosrealizimin më të lartë në masën 20.37%.

Tabela nr. 3- Të ardhurat doganore viti 2022-2023 (sipas llojit të taksave) në 000 lekë

Llojet e taksave	Plani		Realizimi/Fakt		Diferenca në vlerë		Realizimi në %	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Taksë doganore	4,632,214	4,719,495	4,576,912	4,886,321	-55,302	166,826	99	104
Akcizë	17,810,905	19,263,091	17,274,980	18,792,071	-535,925	- 471,020	97	98
TVSH	63,647,340	60,246,951	65,665,313	57,934,447	2,017,973	-2,312,504	103	96
Renta minerare	238	628	219	796	-19	168	92	127
Totali	86,090,697	84,230,164	87,517,424	81,613,636	1,426,690	-2,616,528	102	97

Sikurse evidentohet nga tabela, të ardhurat më të larta gjenerohen përkatësisht nga TVSH-ja, ndjekur më pas nga të ardhurat nga akciza. Për vitin 2022, taksat doganore paraqiten me mosrealizim në masën 1%, apo 55,302 mijë lekë më pak, akciza me mosrealizim në masën 3%, apo 535,925 mijë lekë më pak, TVSH me tejkalim në masën 3%, apo 2,017,973 mijë lekë më shumë, renta me mosrealizim në masën 8%, apo 19 mijë lekë më pak. Për vitin 2023 TVSH është planifikuar më e ulët se plani i vitit 2022, në vlerë 3,400,389 mijë lekë më pak dhe pavarësisht kësaj ka pasur mosrealizim në masën 4% ose në vlerën 2,312,504 mijë lekë më pak se plani. Gjithashtu akciza rezulton me mosrealizim në masën 2% apo 471,020 mijë lekë më pak se plani. Realizimi i taksës doganore për vitin 2023 rezulton 166,826 mijë lekë më tepër se plani ose 104%. Gjithashtu krahasuar me vitin 2022 rezulton 309,409 mijë lekë më tepër. Realizimi i akcizës për vitin 2023 rezulton 471,020 mijë lekë më pak se plani ose realizim 98%. Ndërsa krahasuar me vitin 2022 rezulton në vlerën 1,517,091 mijë lekë më tepër.

Realizimi i rentës minerare për vitin 2023 rezulton 168 mijë lekë më tepër se plani ose realizim 127%. Gjithashtu krahasuar me vitin 2022 ka pasur rritje në vlerën 577 mijë lekë më tepër. Lidhur me realizimet/mosrealizimet përkatëse u kërkua informacion për faktorët që kanë ndikuar në secilin rast. Nga subjekti na u komunikua se dega doganore nuk realizon një analizë të tillë. Analiza kryhet nga Drejtoria e Statistikave në DPD dhe është gjithëpërfshirëse për të ardhurat doganore në global, jo sipas degëve. Sipas kësaj analize të përgjithshme taksat doganore kanë pasur rritje krahasuar me vitin 2022 si rrjedhojë e rritjes së importeve kryesisht në produkte si konstruksionet metalike, produktet e shportës, veshjet. Rritja e akcizës ka ardhur përgjithësisht nga rritja e importit të karburantit, gazit, cigareve dhe birrës. Rënia e TVSH-së është ndikuar kryesisht nga rënia e importit të energjisë elektrike, rënia e çmimit të karburanteve, rënia e çmimit të gazit, mungesa e importit të metaleve bazë, rënia e çmimeve të vajrave vegjetale dhe yndyrave. Efekt pozitiv kanë dhënë autoveturat e përdorura. Gjithashtu një efekt të lartë në rënie e TVSH-së ka pasur efekti i kursit të këmbimit si dhe rënia e çmimeve të bursave ndërkombëtare.

Mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin e të ardhurave doganore.

- **Të ardhura nga TVSH**

Të ardhurat nga TVSH rezultojnë zëri më performues gjatë viteve 2022 dhe 2023 me një kontribut përkatësisht 75% dhe 70.9% ndaj totalit të të ardhurave të arkëtuara. Për vitin 2022 të ardhurat nga TVSH, paraqiten me realizim në vlerën 2,017,973 mijë lekë më tepër ose realizim në masën 103% kundrejt planit. Në përgjithësi është ruajtur i njëjti trend i realizimit të tyre gjatë periudhave mujore. Me nivelin më të ulët të realizimit paraqitet muaji nëntor në masën 96%. Për vitin 2023 të ardhurat nga TVSH, paraqiten me mosrealizim në vlerën 2,312,503 mijë lekë më pak ose realizim në masën 96% kundrejt planit. Me nivelin më të ulët të realizimit paraqitet muaji dhjetor në masën 73%.

Tabela nr. 4- Të ardhura nga TVSH 000 lekë

Muaji	TVSH 2022			TVSH 2023		
	Plan	Fakt	Në %	Plan	Fakt	Në %
Janar	3,356,264	3,401,143	101	3,917,232	3,916.606	100
Shkurt	4,638,204	4,639,194	100	4,232,583	4,366.188	103
Mars	5,699,522	5,698,635	100	4,584,209	4,950.543	108

Prill	5,099,282	5,099,419	100	4,202,657	4,515.382	107
Maj	5,010,060	5,009,874	100	5,452,853	5,512.870	101
Qershor	5,339,452	5,339,639	100	5,062,533	4,883.529	96
Korrik	5,462,993	5,463,107	100	4,602,963	4,703.143	102
Gusht	5,729,552	5,976,607	104	5,088,375	4,798.982	94
Shtator	4,902,246	5,754,071	117	4,734,814	4,841.608	102
Tetor	5,510,202	5,746,547	104	5,558,642	5,176.020	93
Nëntor	5,309,000	5,075,756	96	5,870,406	5,182.923	88
Dhjetor	7,590,564	8,461,321	111	6,939,684	5,086.654	73
Totali	63,647,341	65,665,313	103	60,246,951	57,934,448	96

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- **Të ardhurat nga Akciza**

Të ardhurat nga akciza janë zëri i dytë më i rëndësishëm në drejtim të kontributit total të të ardhurave përkatësisht në masën 22,9% dhe 23% të totalit të të ardhurave të arkëtuara për vitet 2022 dhe 2023. Për vitin 2022 të ardhurat nga akciza, rezultojnë me mosrealizim në vlerën 535,924 mijë lekë, ose me mosrealizim në masën 3% kundrejt planit. Gjithashtu për vitin 2023 të ardhurat nga akciza rezultojnë me mosrealizim në vlerën 468,021 mijë lekë ose me mosrealizim në masën 2% kundrejt planit. Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme. Planifikimi mujor i të ardhurave nga akciza për vitin 2022, varion nga 965,936 mijë lekë në muajin janar deri në 1,863,609 mijë lekë në muajin dhjetor, ose sa dyfishi i muajit janar.

Tabela nr. 5- Të ardhura nga Akciza për vitet 2022 dhe 2023 (në 000 lekë)

Viti 2022	Akciza 2022			Akciza 2023		
	Plan	Fakt	Në %	Plan	Fakt	Në %
Janar	965,936	920,413	95	1,354,359	1,365,255	101
Shkurt	1,195,179	1,212,232	101	1,361,760	1,201,043	88
Mars	1,278,904	1,282,573	100	1,365,126	1,017,764	75
Prill	1,102,357	1,113,480	101	1,464,727	1,152,054	79
Maj	1,351,798	1,352,373	100	1,702,328	1,652,918	97
Qershor	1,721,307	1,733,259	101	1,541,137	1,713,272	111
Korrik	1,591,611	1,591,502	100	1,783,784	1,679,661	94
Gusht	1,995,682	1,930,330	97	1,919,747	2,213,516	115
Shtator	1,696,093	1,464,381	86	1,647,706	1,564,990	95
Tetor	1,589,056	1,418,006	89	1,579,980	1,717,303	109
Nëntor	1,459,373	1,679,753	115	1,698,174	1,690,813	100
Dhjetor	1,863,609	1,576,679	85	1,844,263	1,826,481	99
Totali	17,810,905	17,274,981	97	19,263,091	18,795,070	98

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 6- Rimbursimi i akcizës për vitet 2022 dhe 2023 në lekë

Viti	Akciza e rimbursuar
2022	16,424,582
2023	23,194,794
Totali	39,619,376

Burimi: DPD

Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, akciza e rimbursuar nga Dega e Doganës Tiranë rezulton në vlerën 16,424,582 lekë për vitin 2022 dhe 23,194,794 lekë në vitin 2023.

- **Taksa Doganore**

Për vitin 2022 të ardhurat nga “Taksa doganore”, rezultojnë me mosrealizim në vlerën 55,303 mijë lekë, ose në masën 99% kundrejt planit. Ndërsa për vitin 2023 rezultojnë me tejkalim në vlerën 166,826 mijë lekë ose në masën 104% kundrejt planit. Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme, ku sipas të dhënave për vitin 2022 rezultojnë me mosrealizim muajt shtator, tetor dhe dhjetor, ndërsa përgjatë vitit 2023 realizimi ka pasur luhatje në secilin muaj me mosrealizim ose tejkalim.

Tabela nr. 7- Të ardhurat nga Taksat Doganore 000 lekë

Viti 2022	Taksa Doganore 2022			Taksa Doganore 2023		
	Plan	Fakt	Në %	Plan	Fakt	Në %
Janar	256,561	257,209	100	316,438	306,172	97
Shkurt	323,580	323,766	100	352,573	379,678	108
Mars	409,679	409,745	100	393,739	374,737	95
Prill	357,573	357,575	100	366,980	366,871	100
Maj	420,965	420,784	100	443,186	432,474	98
Qershor	411,175	410,966	100	405,091	411,910	102
Korrik	424,838	425,017	100	446,733	450,590	101
Gusht	385,367	393,973	102	436,101	431,777	99
Shtator	401,642	385,313	96	434,979	410,895	94
Tetor	400,723	374,596	93	346,392	462,765	134
Nëntor	394,307	393,515	100	361,343	445,517	123
Dhjetor	445,805	424,453	95	415,940	412,935	99
Totali	4,632,215	4,576,912	99	4,719,495	4,886,321	104

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- **Të ardhura nga renta minerare:**

Të ardhurat nga Renta minerare, për vitin 2022 rezultojnë me një realizim në masën 92%, ku me një nivel tepër të ulët rezulton muaji dhjetor me 13%. Për vitin 2023 të ardhurat nga renta minerare, rezultojnë me një realizim në masën 127%, ku me një nivel të lartë realizimi paraqiten muajt prill-maj.

Tabela nr. 8- Të ardhura nga renta minerare në 000 lekë

Muaji	Renta Minerare 2022			Renta Minerare 2023		
	Plan	Fakt	Në %	Plan	Fakt	Në %
Janar	39	34	88	13	9	71
Shkurt	13	13	100	8	15	184
Mars	7	7	100	35	65	189
Prill	9	9	100	25	80	325
Maj	44	44	100	42	146	347
Qershor	24	24	100	34	84	246
Korrik	16	16	100	77	161	210
Gusht	7	8	118	63	12	18
Shtator	19	13	71	69	75	109
Tetor	19	14	75	72	22	30
Nëntor	20	34	168	77	121	158
Dhjetor	22	3	13	113	5	5
Totali	238	219	92	628	796	127

Burimi: DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizim janë:

Sipas arsyetimit të subjektit, referuar tejkalimit të planit për vitin 2022 në vlerën 1.4 milion lekë ose në masën 102% kundrejt planit edhe planifikimi i vitit 2023 lidhur me të ardhurat doganore ishte i lartë. Për vitin 2023 Dega e Doganës Tiranë kishte ritëm të lartë në realizimin e të ardhurave ku deri në muajin Tetor pati një realizim të të ardhurave në masën 100%. Faktorët kryesorë negativë që ndikuan në mosrealizimin e planit kanë qenë kursi i këmbimit të Euros dhe Usd me Lekun që pësuan një rënie të ndjeshme si dhe rënia e importit e artikullit energji elektrike krahasuar me vitet 2021 dhe 2022. Kjo rënie e importeve të këtij artikulli shpjegohet me situatën e mirë hidrike që kishte viti 2023 si dhe me stabilizimin e çmimit të këtij sektori gjatë këtij viti. Nga artikulli energji elektrike ka pasur një efekt ekonomik në rënie në të ardhura në shumën 8.7 miliardë lekë, po kaq afërsisht në shumën 8.6 miliardë lekë ka pasur efekt të përlogaritur dhe nga kursi i këmbimit. Sipas analizave të subjektit nga krahasimet e të ardhurave me kurs të njëjtë këmbimi rezulton se të ardhurat e vitit 2023 do ishin dukshëm më të larta se ato të vitit 2022. Nga përlogaritja me kurs këmbimi të njëjtë do të kishte një tejkalim në të ardhura në shumën 2.7 milion lekë ose 3.2%.

Të ardhurat dytësore

Gjithashtu përgjatë viteve 2022 dhe 2023 Dega Doganore Tiranë ka realizuar të ardhura të tjera dytësore, për zërat si peshore, të ardhurat nga plumbçet, nga kamatëvonesat, gjoba subjektësh etj., për të cilat nuk ka një plan të përcaktuar paraprakisht, por dega kryen vetëm ndjekjen e arkëtimit të tyre. Për vitin 2022 totali i të ardhurave dytësore rezulton 64,156,595 lekë dhe për vitin 2023 49,469,405 lekë, pra kanë pësuar rënie në vlerën 14,687,190 lekë.

-Të ardhurat nga peshorja përfshijnë të ardhurat nga peshimi i mjeteve, për të cilat zyra e financës bën rakordimin sipas mandat arkëtimeve të lëshuara për pikën e peshores. Lidhur

me këto të ardhura u verifikuan me përzgjedhje rastësore disa blloqe mandatesh dhe nuk u konstatuan problematika.

Gjendja e mallrave të sekuestruara

Lidhur me magazinën e mallrave të sekuestruara, nga zyra e financës u vendos në dispozicion informacioni si më poshtë:

Tabela nr. 9- Gjendja e magazinave të sekuestruara për vitet 2022 dhe 2023 në lekë

Viti	Kod artikuj	Gjendja në fund
2022	497	11,892,923
2023	526	24,340,919

Burimi: Zyra e Financës në DDT, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sikurse evidentohet nga tabela për vitin 2022 rezultojnë 497 kode artikuj të ndryshëm të sekuestruar me vlerë 11,892,923 lekë. Për vitin 2023 është rritur numri i artikujve të sekuestruar dhe vlera totale e artikujve rezulton 24,340,919 lekë. Pra me rritje në vlerën 12,447,996 lekë krahasuar me një vit më parë. Këto mallra nga zyra e financës regjistrohen në bazë të procesverbalit shoqërues të mbajtur nga struktura që i ka bllokuar. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, shumica e artikujve të bërë hyrje në vitet 2022 dhe 2023 janë mallra për të cilat dyshohet se çënohet e drejta e pronësisë intelektuale. Përgjithësisht, mallrat me indicie dyshimi çënimin e të drejtës së pronësisë intelektuale pezullohen nga doganieri fizik pranë Degës së Doganës Tiranë dhe në vijim të “Procesverbalit për pezullimin e mallrave çënuese për të cilat është mbajtur një aplikim” të mbajtur në prani të doganierit fizik të Degës së Doganës Tiranë, përfaqësuesit të subjektit dhe përfaqësuesit të hetimit, bëhen hyrje në magazinën e doganës Tiranë. Ka raste kur në mungesë të përfaqësuesve të drejtorisë së Hetimit, akt-bllokimi mbahet vetëm nga doganieri fizik i degës Tiranë, pasi ky i fundit ka njoftuar me email (duke i bashkangjitur dhe foto të mallrave të dyshuara) strukturës përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, pjesë përbërëse e Departamentit Operativ-Hetimor pranë DPD-se është ajo që verifikon çënueshmërinë e pronësisë intelektuale në bashkëpunim me avokatin ligjor për mbrojtjen e markave dhe patentave. Konkretisht për mallrat e fletë-hyrjes të vitit 2021, procesi i shkatërrimit është bërë në maj të vitit 2023, sepse shkatërrimi i mallit që konfirmohet se ka çënuar të drejtën e pronësisë intelektuale bëhet gjithmonë në prezencë të avokatit ligjor të mbrojtjes së kësaj të fundit. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë bërë çlirime dhe shkatërrime për mallra që kanë qënë gjendje në magazinë, sipas shkresave përkatëse të Drejtorisë për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, në bashkëpunim dhe prezencë të avokatit ligjor të markave dhe patentave. Për këto mallra të bllokuara me dyshimin e çënimin të pronësisë intelektuale, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale e ka informacionin rast pas rasti, por rezulton se jo në të gjitha rastet ka vendimmarrje për vazhdim procedurash. Nga zyra e Financës me shkresën nr. 6253 prot., datë 17.07.2023 është njoftuar kryetari për mallrat sekuestro gjendje në magazinë për të cilat nuk janë marrë vendime administrative dhe nuk është përcaktuar destinacioni. Në përgjigje të kësaj shkresë me shkresën nr. 6253/1 prot., datë 08.02.2024 nga zyra juridike është kthyer përgjigje pa veprim që për këto mallra nuk mund të merret vendim pasi nuk shoqërohen me procesverbal sekuestrimi sipas nenit 274 të ligjit nr. 102/2014 dhe nenit 720 të VKM-së 651 datë 10.11.2017 si dhe i kanë kaluar afatet ligjore për vendimmarrje. Sa më sipër rezulton se nga strukturat verifikuese (Sektori i Verifikimit Fizik, Antikontrabanda etj)

nuk është mbajtur procesverbal verifikimi apo sekuestrimi për të gjitha rastet siç parashikon neni 274 “Forma e procesverbalit të verifikimit e të sekuestrimi” i ligjit 102/2014, por vetëm procesverbal bllokimi. Në mungesë të procesverbaleve të sekuestrimit, nga ana e sektorit juridik nuk janë përgatitur vendime për vijimin e procedurës së konfiskimit, si rrjedhojë nga Dega e Doganës Tiranë nuk ka vendimmarrje për mallrat e sekuestruara me procesverbalet përkatës. Ky element procedural nuk është trajtuar edhe pse mallrat gjendje në magazinë datojnë prej vitit 2018, problematika ka zgjatur ndër vite dhe mallrat gjendje në magazine vazhdojnë të shtohen nga viti në vit. Për rastet që kanë pasur procesverbal verifikimi apo sekuestrimi është vijuar me marrjen e vendimeve të konfiskimit. Gjithashtu në bazë të udhëzimit të drejtorit të përgjithshëm të DPD nr. 07 datë 17.12.2020 “Për procedurat e shkatërrimit të mallrave të akcizës të destinuar për shkatërrim” nga kryetari i degës është hartuar urdhri nr. 09 datë 05.07.2023 “Për ngritje komisioni për inventarizim të mallrave të konfiskuara me destinacion shkatërrimin”. Nga grupi i punës është kryer procedura për identifikimin dhe inventarizimin e mallrave të akcizës dhe i është dërguar relacion përmbledhës kryetarit të degës me shkresën nr. 5614/2 prot., datë 12.07.2023 për kryerjen e inventarizimit për mallrat me vendim konfiskimi të destinuar për asgjësim. Me shkresën nr. 5619/3 prot., datë 15.08.2023 kryetari i degës i ka dërguar relacion përmbledhës drejtorit të përgjithshëm të doganës por procedura nuk ka vijuar me ngritjen e grupit të shkatërrimit. Këto mallra janë gjendje në magazinën e DDT-së.

(Mbajtur ne terren Akt Konstatimi nr. 6 date 31.05.2024)

2.2 Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori i magazinimit të përkohshëm dhe sektorit të pikës së hyrje-dalje (afati kohor dhe mbyllja e tranziteve) për periudhën nën auditim.

2.2.1. Në zbatim të pikës së mësipërme (sektori i magazinimit të përkohshëm), u shqyrtua informacioni dhe dokumentacioni si vijon:

- Të dhëna nga sistemi Asycuda lidhur me Dokumentet Elektronik të Magazinimit të Përkohshëm (DEMP) të trajtuara nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm (ZMP);
- Informacion lidhur me DEMP-et e pambyllura në sistem;
- Informacion nga ZMP për aktivitetin e viteve 2022-2023;
- Informacion lidhur me 40 rastet analitike të evidentuara nga ZMP për vitin 2022 me diferenca në peshë;
- Informacion lidhur me 35 rastet analitike të evidentuara nga ZMP për vitin 2023 me diferenca në peshë;
- Informacion lidhur me subjektet të cilat kanë autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të operuar si magazina të përkohshme dhe vepronë me manifeste doganore;
- Urdhrat e kontrollit dhe kontrollet e ushtruara nga ZMP ndaj operatorëve ekonomike me status magazinimin e përkohshëm.

Zyra e magazinimit të përkohshëm (ZMP) mbulon kryesisht detyrat funksionale lidhur me regjistrimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së hyrje-daljes në magazinat e përkohshme me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit doganor. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2022 numri total i Dokumentit Elektronik të Magazinimit të Përkohshëm (DEMP) të gjeneruar është 79,616. Nga ZMP bazuar në Urdhrin nr. 146 (7786/1), datë 07.05.2018 “Rregullore e brendshme e degëve doganore” dhe Udhëzimin nr. 17, datë 31.12.2018, pika 3.2 dhe pika 4.2 e Manualit “Për

deklarimin elektronik të mallrave në Magazinimin e Përkohshëm-DEMP”, janë mbikëqyrur procedurat e gjenerimit dhe mbylljes së DEMP-eve, si edhe procedurat e kontrollit të mallrave të vendosura në ambientet e magazinimit të përkohshëm të miratuara për disa subjekte (që procedojnë me manifest doganor), me qëllim verifikimin e lëvizjes së mallrave nga momenti i hyrjes në territorin shqiptar, deri në momentin e vendosjes në një regjim doganor ose ri-eksportimin.

a. Mospërputhshmëri e treguesve së DEMP-it (ngjyrës) në sistem me statusin doganor të mallrave

Referuar udhëzimit nr. 17 datë 31.12.2018 “Mbi zbatimin praktik të deklarimit elektronik të magazinimit të përkohshëm të mallrave”, pika 4.3 “DEMP kryen lidhjen automatike të deklaratës T1/T2 me DAV. Sipas Manualit “Për deklarimin elektronik të mallrave në magazinim të përkohshëm” bashkëlidhur udhëzimit nr. 17, pika 3 “Veprimet në DAV: Pasi pranohet DAV bëhet shkarkimi i DEMP, në të cilin shfaqet dhe numri i DAV dhe të dhënat e mallrave të shkarkuara nga ai. Sistemi paraqet DEMP në dritaren me të dhënat kryesore të tyre me ngjyra të ndryshme sipas statusit që ajo ndodhet në sistem. Kur DEMP është në statusin e gjeneruar (nuk është miratuar hyrja, vetëm është mbyllur T1/T2) ka ngjyrë gri, kur është në statusin “miratuar hyrja” ka ngjyrë të bardhë dhe kur është në statusin “e shkarkuar” ka ngjyrë të kuqe.

Sipas verifikimeve në sistemin Asycuda evidentohen raste të DEMP-ve me ngjyrë të bardhë dhe gri (të pa validuara), që nuk përputhet me statusin doganor të mallrave.

Nga auditimi evidentohen raste në ngjyrë gri të cilat sipas informacionit të sjellë nga subjekti i përkasin deklaratave të tranzitit të viteve të kaluara (para vitit 2019), për të cilat janë kryer procedurat e deklarimit për vendosjen e mallrave në një regjim doganor që në momentin e paraqitjes së mjetit në destinacion, por për arsye teknike nuk është kryer procedura e plotë e mbylljes në sistem. Pra nuk është kryer kanalizimi i DEMP nga ngjyra gri në ngjyrë të kuqe pas marrjes së regjimit sipas manualit.

Evidentohen mangësi në sistemin elektronik, ku problematike është qëndrimi i DEMP-eve me ngjyrë të bardhë në sistem, pavarësisht se janë të mbyllura në rastet kur ka tranzit të brendshëm/tranzit ndërkombëtar/mospërputhje të cituara më sipër.

Grupi i auditimit për të bërë testime ose për të nxjerrë të dhëna për testime ka kryer verifikime të mëtejshme në mënyrë që të përftohet një panoramë e azhornuar e organizimit të sistemit të programuar, pasi nuk jep të dhëna të sakta për këtë pikë të proceseve dhe procedurave.

Duke vërejtur këto mangësi grupi i auditimit shqyrtoi rast pas rasti 70 DEMP që rezultojnë me ngjyrë të bardhë në sistem për vitin 2022 dhe nga verifikimi i ushtruar për këto DEMP-e, si dhe nga arsyetimi i ZMP-së rezulton se:

- 16 raste janë tranzit ndërkombëtar
- 21 raste janë tranzit i brendshëm
- 8 raste janë shkarkim i pjesshëm i ngarkesës
- 4 raste janë në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor
- 2 raste janë dërgesa postare, tranzituar gabimisht në Zyrën Doganore Tiranë me Kod AL110000, duhet të tranzitohej në Zyrën Doganore Tiranë me Kod AL111000 (Tirana DPS)

- 14 raste të pambyllura për probleme teknike (mangësi të sistemit)/ Raste ku nuk ka përrputhje midis DAV dhe DEMP, apo nuk është shkarkuar DEMP pavarësisht se DAV është me peshën e plotë

- 5 raste të tjerë (anullim/kthim produkti, vendosje gabim Nipt)

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2023 numri total i DEMP-eve të gjeneruar është 80,992.

Për vitin 2023 në sistemin Asycuda rezultojnë me ngjyrë të bardhë 15 DEMP nga verifikimi i të cilave rezulton se janë raste në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor. (Kalim i afatit 90 ditor të qëndrimit në magazinim të përkohshëm)

Gjithashtu evidentohen 20 raste me ngjyrë gri, për të cilat u kryen verifikimet si dhe nga arsyetimi i ZMP rezultoi se:

- 5 raste i përkasin deklaratave të tranzitit të viteve të kaluara (para vitit 2019), për të cilat janë kryer procedurat e deklarimit për vendosjen e mallrave në një regjim doganor që në momentin e paraqitjes së mjetit në destinacion, por për arsye teknike nuk është kryer procedura e plotë e mbylljes në sistem;

-13 raste nuk gjenerohet dokumenti i mëparshëm (tranziti T1/T2);

-1 rast është vendosur gabimisht dogana destinacion dogana DPS;

-1 rast subjekti bën vetëdeklarim.

Lidhur me projekt raportin e grupit të auditimit, nga ana e DDT është dërguar observacioni me shkresën nr. 10738/26 datë 30.08.2024 nga përfaqësuesit e subjektit, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1113/20 datë 03.09.2024.

Prezëndimi i subjektit: Në lidhje me konstataimin për Dokumentat Elektronikë të Magazinimit të Përkohshëm (DEMP)-et e rezultuara në ngjyrën e “bardhë”, për të cilat është dhënë destinacioni doganor mallrave nëpërmjet deklaratave të tranzitit, deklaratave të ri-importeve, deklaratave të eksporteve, por nuk janë të mbyllura në sistem, sqarojmë se nga verifikimi këto raste konstatohen më tepër për vitin 2022. Për vitin 2023 e në vijim pas hapjes së akseseve për të gjitha rastet kur është vërtetuar dhënia e destinacionit me një deklaratë doganore, është kryer procedura e “shkarkimit manual”, me ngjyrë të bardhë rezultojnë vetëm rastet e DEMP-eve që iu përkasin mallrave për të cilat nuk janë kryer procedurat për vendosjen në një regjim të posaçëm doganor. Rastet e DEMP-eve të rezultuar me ngjyrë “gri” janë të gjitha që iu përkasin tranziteve me destinacion Zyrën Doganore Tiranë me Kod AL111000 (Tirana DPS), për të cilat nuk kryhet procedura e validimit të DEMP.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i paraqitur nga ana e subjektit është i njëjtë me observimin e akt konstataimit, nuk paraqet fakte dhe prova të reja, si rrjedhojë nuk merret në konsideratë.

b. Procedurat e ndjekura nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm mbi tejkalimin e afatit 90 ditor për qëndrimin e mallrave në këtë regjim dhe kontrollet e ushtruara ndaj operatorëve ekonomikë me status magazinimin e përkohshëm

U audituan procedurat e kryera nga ZMP për kontrollin e respektimit të afatit kohor 90 ditë të qëndrimit në magazinim të përkohshëm si dhe kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve të miratuara për magazinim të përkohshëm.

Duke u nisur nga DEMP me ngjyrë të bardhë në sistem (për të cilat nuk është krijuar ende DAV) rezultuan subjekte të cilat kanë tejkaluar afatin e qëndrimit në magazinim të përkohshëm.

Tabela nr. 10. Subjektet që kanë tejkaluar afatin e magazinimit të përkohshëm për vitet 2022 dhe 2023 në lekë

Nr.	Data	Nr. i DEMP	Importuesi	Eksportuesi	Arsyetimi	Vlera e faturës në euro	Kursi i këmbimit	Vlera në lekë
1	05.05.2022	0025547	A. R	F. R	në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor	500	120.57	60,285
2	27.10.2022	0064713	I T W T	S E S	në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor	404,800	118.27	47,875,696
3	02.02.2023	0005192	I T S	R T D	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	30,019	116.29	3,490,909.5
4	19.02.2023	0008591	I T S	S C T	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	10,000	115.72	1,157,200
5	19.02.2023	0008593	I T S	S C T	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	10,000	115.72	1,157,200
6	19.02.2023	0008595	I T S	S C T	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	7,600	115.72	879,472
7	23.02.2023	0009665	I T S	S C T	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	9,000	115.16	1,036,440
8	08.04.2023	0019319	A. H	B E D	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	7,670	112.83	865,406
9	08.06.2023	0033012	I T S	R E O	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	180,200	106.39	19,171,478
10	10.06.2023	0002679	P . M . G	B2	malli gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklaratës për	170	106.26	18,064

					vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.			
11	25.10.2023	0064606	S. D	N M A C	mali gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklarates për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	1,739	105.81	184,003.59
12	30.10.2023	0065891	E. S	G I	mali gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklarates për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	4,063	105.63	429,174.69
13	21.11.2023	0071320	A. T	N C R S	mali gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklarates për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.	1,350	103.82	140,157
14	22.12.2023	0078852	A. U	S. O. U	mali gjendje në parkimin doganor, në pritje të depozitimit të deklarates për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm doganor.			
					Totali	667,111		76,465,487

Burimi: Të dhëna nga ZMP e DDT-së si dhe nga sistemi Asycuda, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Mallrat që ndodhen në parkimin doganor, për të cilat ka kaluar afati 90 ditë sipas faturave dhe dokumenteve bashkëngjitur kanë vlerën 76,465,487 lekë. (faturat në vlerë 667,111 euro konvertuar me kursin e këmbimit të datës së DEMP). Sipas informacionit të subjektit dhe sipas tabelës, për vitin 2023 7 raste DEMP të pambyllura rezultojnë me subjektet I T S dhe I T W T, subjekte të cilat janë nën hetim për inceneratorët.

Tabela nr. 12. Subjektet që kanë tejkaluar afatin e magazinimit të përkohshëm në lekë

Nr.	Subjekti	Magazina e OE	Sasia (kg)	Malli	Dt e hyrjes në magazinë	Vlera në euro	Kursi i këmbimit	Vlera në lekë
1	G B M	S A	1 copë	Skuter elektrik	23.08.2019	500	121.09	60,545
2	G 2	S A	111	Kripë	02.09.2019			
3	BC	F X U E	3,719	Pajisje gjimnastike	08.01.2022	27,431	121.58	3,335,061
4	C M	C G	2,486	Pllaka qeramike	31.10.2022	7,741	118.07	913,980
					Totali	35,672		4,309,586

Burimi: Të dhëna nga ZMP e DDT-së si dhe nga sistemi Asycuda, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Mallrat që ndodhen në magazinat e përkohshme të subjekteve të autorizuara, për të cilat ka kaluar afati 90 ditë sipas faturave dhe dokumenteve bashkëngjitur kanë vlerën 4,309,586 lekë. (35,672 euro konvertuar me kursin e këmbimit të datës së DEMP) Nga ZMP me shkresën nr. 631 prot., datë 24.01.2024 është njoftuar shoqëria “U E” ShPK që për mallrat me numër reference 01964, 01969 pasqyruar në manifestin doganor me numër regjistrimi R19 datë 08.01.2022 si dhe mallin me nr. reference 0064 pasqyruar në manifestin doganor R1367, datë 10.06.2023, janë tejkaluar afatet e përcaktuara në nenin

139 të Ligjit nr. 102/2014. Gjithashtu me shkresën nr. 645 prot., datë 24.01.2024 është njoftuar shoqëria “C G” ShPK që për mallin me numër reference 1 pasqyruar në manifestin doganor me numër regjistrimi R 2486 datë 31.10.2022 është tejkaluar afati i përcaktuar në nenin 139 të Ligjit nr. 102/2014.

Konstatohet se subjektet e paraqitura në tabelat më sipër kanë tejkaluar afatin 90 ditë të qëndrimit në magazinimin e përkohshëm, në kundërshtim me nenin 139 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i RSH” të ndryshuar.

Për sa më sipër, përveç 2 rasteve të njoftimeve, konstatohet se për këto subjekte që kanë mallra në magazinim të përkohshëm përtej afateve kohore, të cilat ndodhen në parkimin doganor apo në ambientet e magazinimit të përkohshëm të operatorëve të autorizuar, doganierët mbikëqyrës të ZMP nuk kanë marrë masat e nevojshme për të rregulluar situatën si njoftimin, çlirimin, sanksionimin, shkatërrimin, braktisjen, konfiskimin deri në shitjen e mallrave referuar legjislacionit doganor.

Për këto raste legjislacioni doganor parashikon:

-Neni 179 “Masat që duhet të merren nga autoritetet doganore”

1. Autoritetet doganore marrin çdo masë të nevojshme, përfshirë konfiskimin dhe shitjen ose shkatërrimin e mallrave, për të rregulluar situatën për këto mallra, në rastet e mëposhtme:

b) kur mallrat nuk mund të çlirohen për një nga arsyt e mëposhtme:

ii) nuk janë depozituar dokumentet që kushtëzojnë vendosjen e mallrave në një regjim doganor të kërkuar apo çlirimin prej tij;

- Sipas nenit 360 të DZKD “Mallrat e pa çliruara” autoritetet doganore duhet t’i japin deklaruesit një afat kohor të arsyeshëm për të korrigjuar situatën e mallrave.

- Sipas nenit 361 të DZKD “Shkatërrimi i mallrave” Autoritetet doganore vendosin llojin dhe sasinë e çdo mbetjeje ose hedhurine, që rezulton nga shkatërrimi i mallrave me qëllim të përcaktimit të ndonjë detyrimi doganor dhe pagesave të tjera të zbatueshme për atë mbeturinë apo hedhurinë, kur vendosen nën një regjim doganor ose rieksporohen.

- Sipas nenit 362, pika 2 të DZKD “Braktisja e mallrave” Një kërkesë për braktisje në favor të shtetit do të konsiderohet se është bërë në përputhje me nenin 180, të Kodit, kur autoritetet doganore kanë bërë një njoftim publik për pronarin e mallrave që të paraqitet dhe pronari nuk është paraqitur brenda 90 ditësh.

- Sipas nenit 363, pika 2 të DZKD “Shitja e mallrave dhe masa të tjera të marra nga autoritetet doganore” Autoritetet doganore mund t’i shesin mallrat e braktisura ose të konfiskuara, vetëm me kusht që blerësi të kryejë menjëherë formalitetet për të vendosur mallrat nën një regjim doganor ose t’i rieksportojë ato. Mallrat e braktisura apo të konfiskuara shiten nga dega doganore kompetente që ka bërë konfiskimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankandin publik, me përjashtim të rastit kur Kodi Doganor apo akte të tjera ligjore parashikojnë ndryshe. Zyra e Magazinimit të Përkohshëm bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara ka mbikëqyruar procedurat e gjenerimit dhe mbylljes së DEMP, si edhe procedurat e kontrollit të mallrave të vendosura në ambientet e magazinimit të përkohshëm të miratuara për shtatë subjekte që kanë proceduar me manifest doganor për vitin 2022. Këto subjekte paraqiten si vijon:

Tabela nr. 13. Operatorët ekonomik të pajisur me autorizim për magazinim të përkohshëm nga DPD me doganë mbikëqyrëse DDT

Nr.	Operatori ekonomik, Numri identifikues i magazinës	NIPT	Autorizimi Numër/datë	Afati i garancisë
-----	--	------	-----------------------	-------------------

1	M	L.....B	Nr. 22303/1, datë 23.09.2015	31.12.2024
2	IM	K.....D	Nr. 3462/2, datë 19.04.2019	13. 01.2025
3	D	K.....U	Nr. 1229/1, datë 29.01.2021	26.01.2025
4	SNL	K.....M	Nr.17135/1, datë 7.07.2019	21.04.2025
5	ZT	K.....T	Nr. 20148/1, datë 07.12.2022	18.11.2024
6	UE	K.....B	Nr. 22533/4, datë 19.11.2019	03.09.2024
7	S	K.....N	Nr.19976/2, datë 07.12.2022	12.07.2024

Burimi: Të dhëna nga ZMP e DDT-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2022 janë gjeneruar në sistem në Zyrën Doganore me Kod AL110000 gjithsej 3,006 manifeste doganore. Për vitin 2022 kontrollet e kryera nga ZMP pranë DDT-së me qëllim verifikimin e zbatimit të kërkesave të neneve 134-141 të Kodit Doganor, mbajtja dhe plotësimi i regjistrit të miratuar nga dega doganore Tiranë, verifikimin fizik të mallrave që ndodhen në ambientet e magazinimit dhe zbatimi i afateve të nenit 139 të Ligjit nr. 102/2014 i ndryshuar, për kohën e qëndrimit të mallit në magazinë sipas operatorëve janë:

1. Operatori ekonomik “S N” ShPK me kod MP16

Për operatorin ekonomik “S N” është ushtruar kontroll nga znj. Z H dhe z. G U datë 16.02.2022. Sipas informacionit për kontrollin e ushtruar në magazinë për dërgesat e dy subjekteve “D V” ShPK dhe “P E” janë tejkalkuar afatet e qëndrimit në magazinim të përkohshëm dhe për këto subjekte janë ndjekur procedurat e përcaktuara në legjislacionin doganor. Informacionet e tjera rezultojnë se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, regjistrat e miratuara nga DDT janë mbajtur në mënyrën e duhur dhe është kryer dhe rakordimi me të dhënat nga sistemi nga ka rezultuar përputhje mes gjendjes fizike të mallrave dhe të dhënave të pasqyruara në systemin Asycuda World. Subjekti D V ShPK sipas DEMP të datës 30.01.2020 ka vendosur në regjimin e magazinimit të përkohshëm mallrat me afat deri në 30.04.2020. Rezulton se nga importuesi nuk janë respektuar afatet e nenit 139 të Kodit Doganor për qëndrim në magazinim të përkohshëm dhe ka kryer shkelje sipas neni 251/f . Për këtë arsye nga autoritetet doganore është vendosur sanksion sipas nenit 256/1/b të Kodit Doganor, me vendimin nr. 481, datë 28.03.2022 të DDT-së. Për subjektin “P E” me vendimin nr. 408 datë 28.06.2021 është vendosur dënimi me gjobë për mos respektim të afatit të përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor. Në datën 16.02.2022 kur është mbajtur akt kontrolli për këtë subjekt, në të cilin është evidentuar malli që ka kaluar afatet, po në këtë datë është hartuar deklarata IM 4 R 2052 për këto mallra. Në vijim janë kryer kontrollet periodike. Konkretisht:

Kontrolli nga znj. Z H dhe z. B N datë 16.05.2022;

Kontrolli nga znj. Z H dhe z. B N datë 17.08.2022;

Kontrolli nga z. B N dhe z. G U datë 17.11.2022.

Për kontrollet e mësipërme nga informacioni rezulton se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, regjistrat e miratuara nga DDT janë mbajtur në mënyrën e duhur dhe është kryer dhe rakordimi me të dhënat nga sistemi nga ka rezultuar përputhje mes gjendjes fizike të mallrave dhe të dhënave të pasqyruara në systemin Asycuda World.

2. Operatori ekonomik “S” ShPK me kod MP29

Për këtë operator ekonomik janë kryer 4 kontrole gjatë vitit 2022. Konkretisht:

Kontrolli nga znj. Z H dhe z. B N datë 24.02.2022;

Kontrolli nga znj. Z H dhe z. B N datë 27.05.2022;

Kontrolli nga znj. Z H dhe z. G U datë 27.08.2022;

Kontrolli nga z. B N dhe z. G U datë 29.12.2022.

Nga kontrollet e kryera dhe informacionet shoqëruar këtyre kontrolleve rezultoi se për dy subjekte mallrat e të cilëve gjenden në magazinën e përkohshme e kanë tejkaluar afatin e lejuar prej 90 ditë sipas nenit 139 të KD. Konkretisht:

Nr.	Subjekti	Magazina e OE	Pesha kg/ Sasi	Dt. e hyrjes në magazine	CMR	Vlera në euro
1	G B	S A	1 cope	23.08.2019	3903	500
2	G 2	S A	111	02.09.2019	2959	

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për këto dy subjekte nga ana e doganierëve nuk është kryer procedura doganore për rregullimin e situatës sipas legjislacionit doganor.

Ndërsa për subjektet e tjera nga informacioni ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, gjendja fizike e mallrave të gjendura në ambientet e magazinimit të përkohshëm ka qënë në përputhje me deklaratimet e kryera në systemin Asycuda World.

3. Operatori ekonomik “U E” ShPK me kod MP21

Operatori ekonomik “U E” është kontrolluar nga znj. Z H dhe z. G U më datë 01.04.2022. Sipas informacionit të këtij kontrolli ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor. Por është evidentuar subjekti V, i cili ka kaluar afatin 90 ditë në magazinim të përkohshëm. Për këtë subjekt është hartuar deklarata IM 9 me R 50778 datë 24.05.2022 për abandonimin e mallrave.

Nga kontrolli i kryer ka rezultuar një sasi mallrash të gjendura në magazinë, të cilat janë të abandonuara nga pritësit. Në informacion ka shënimin se për këto mallra do të procedohet sipas legjislacionit në fuqi për mallrat e abandonuara. *Kontrolli i kryer nuk është shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e artikujve, sasive, vlerës dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në magazinim të përkohshëm.*

Kontrolli periodik i radhës është kryer nga znj. Z H dhe z. B N datë 06.07.2022. Për këtë kontroll nga informacionet rezultojnë se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, regjistrat e miratuara nga DDT janë mbajtur në mënyrën e duhur dhe është kryer dhe rakordimi me të dhënat nga sistemi nga ka rezultuar në përputhje mes gjendjes fizike të mallrave dhe të dhënave të pasqyruara në systemin Asycuda World. Kontrolli nga z. B N dhe z. G U datë 14.10.2022. Nga informacioni rezultoi se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, me përjashtim të subjektit “B ShPK” i cili ka kaluar afatet e magazinimit të përkohshëm dhe do të zbatohet legjislacioni në fuqi. *Nga ZMP nuk është kryer procedura për rregullimin e situatës.*

Nr.	Subjekti	Pesha kg	Dt e hyrjes në magazine	Natyra e mallit	Vlera në euro
1	BC	3,719	08.01.2022	Pajisje gjimnastike	27,431

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

4. Operatori ekonomik “D”shpk me kod MP33

Operatori ekonomik “D. ShPK” është kontrolluar nga znj. Z H dhe z. G U datë 15.03.2022 dhe nga znj. Z H dhe z. B N datë 21.06.2022.

Për këto dy kontrolle ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, gjendja fizike e mallrave të gjendura në ambjentet e magazinimit të përkohshëm ka qënë në përputhje me deklaratimet e kryera në systemin Assucuda World. regjistrat e miratuara nga DDT janë mbajtur në mënyrën e duhur. Në kontrollin periodik të kryer nga z. B N dhe z. G U datë 28.09.2022, ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, me përjashtim të subjektit S C ShPK, i cili ka kaluar afatin tre mujor të qëndrimit në magazinim të përkohshëm. Nga auditimi dhe verifikimet e kryera konstatohet se ky subjekt ka bërë kërkesë për dhënie destinacion mallrave dhe është sanksionuar me vendimin nr. 96 datë 13.02.2023. Lidhur me kontrollin nga z. B N dhe z. G U datë 28.12.2022, ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor.

5. Operatorët ekonomikë “Z T” ShPK me kod MP30, “I M” ShPK me kod MP25 dhe “M A”shpk me kod MP15

Janë kryer kontrollet periodike gjatë vitit 2022. Nga informacionet për kontrollet e mësipërme ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, gjendja fizike e mallrave të gjendura në ambjentet e magazinimit të përkohshëm ka qënë në përputhje me deklaratimet e kryera në systemin Asycuda World. Gjatë vitit 2022 nga ZMP janë konstatuar 12 raste të tejkalimit të afatit të përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, për 9 raste kur nga subjektet është kryer procedura e vendosjes në një regjim doganor janë aplikuar penaltete në masën 180,000 mijë lekë. Këto veprime janë klasifikuar kundërvajtje administrative parashikuar në nenin 251/f të Kodit Doganor dhe janë sanksionuar sipas nenit 256/1/b të këtij KD në shumën 20,000 Lekë. Ndërsa në 3 raste të tjera nga të cilat 1 rast është autoveturë, për të cilat nuk është paraqitur kërkesë për dhënien e destinacionit doganor nuk janë marrë masa për rregullim situatë.

Më poshtë paraqiten procesverbalet e kundërvajtjeve të mbajtura përgjatë vitit 2022:

Tabela nr. 14. Procesverbalet e kundërvajtjeve të mbajtura në vitin 2022 në lekë

Nr.	Deklarata		Subjekti		Artikulli		Procesverbali		Penaliteti
	Nr.	Datë	Emri i shoqërisë	NIPT-i	Përshkrimi	Kodi Tarif	Nr. serial	Datë	
1	136157	06.11.2021	S A	K.....C	Veshje të përdorura	63090000	20276	17.02.2022	20,000
2	D 3690	30.01.2020	D V	L.....T	Vitrina frigoriferike	84185019	20277	18.03.2022	20,000
3	67908	28.03.2021	A SH	L.....R	Bimë Medicinale	1211	20278	28.03.2022	20,000
4	50229	67810	A T	K.....T	AUTOBUS	8702	20279	05.04.2022	80,000

5	6809	28.05.2022	U E	K.....B	Veshje të ndryshme	61091000	20280	01.06.2022	20,000
6	29853	24.05.2022	R T	L.....D	Autobus i përdorur	8702	20284	13.09.2022	20,000

Burimi: Të dhëna nga ZMP e DDT-së

Për vitin 2023 në listën e subjekteve me autorizim si magazinë e përkohshme është shtuar subjekti C G. Kontrollat e kryera nga ZMP pranë DDT-së me qëllim verifikimin e zbatimit të kërkesave të neneve 134-141 të Kodit Doganor, mbajtja dhe plotësimi i regjistrit të miratuar nga dega doganore Tiranë, verifikimin fizik të mallrave që ndodhen në ambientet e magazinimit dhe zbatimi i afateve të nenit 139 të Ligjit nr. 102/2014 i ndryshuar, për kohën e qëndrimit të mallit në magazinë sipas operatorëve janë:

1. Operatori ekonomik “S N” ShPK me kod MP16

Për operatorin ekonomik “S. N” është ushtruar kontroll nga znj. Z H dhe z. G. U datë 01.03.2023, sipas urdhërit nr. 1774 prot., datë 28.02.2023. Sipas informacionit për kontrollin e ushtruar në magazinë rezultoi se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, regjistrat e miratuar nga DDT janë mbajtur në mënyrën e duhur dhe është kryer dhe rakordimi me të dhënat nga sistemi nga ka rezultuar përputhje mes gjendjes fizike të mallrave dhe të dhënave të pasqyruara në systemin Asycuda World.

Në vijim janë kryer kontrollat periodike. Konkretisht:

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 31.05.2023;

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 06.09.2023;

Kontrolli nga z. B N dhe z. G U datë 06.12.2023. Gjatë këtij kontrolli u evidentua se 1 subjekt ka kaluar afatin tre mujor.

Subjekti	Natyra e mallit	Kg	Data e hyrjes në magazinë	Nr. i manifestit
P G	Kozmetike etj	36	28.07.2023	1887

Burimi: Të dhëna nga kontrollat e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi dhe verifikimet e kryera konstatojmë se ky subjekt ka bërë kërkesë për dhënie destinacion mallrave dhe është sanksionuar sipas procesverbalit me nr. serial 0020763 datë 09.04.2024. Për kontrollat e tjera informacionet e tjera rezultojnë se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, regjistrat e miratuar nga DDT janë mbajtur në mënyrën e duhur dhe është kryer dhe rakordimi me të dhënat nga sistemi nga ka rezultuar përputhje mes gjendjes fizike të mallrave dhe të dhënave të pasqyruara në systemin Asycuda World.

2. Operatori ekonomik “Z T” ShPK me kod MP30

Për këtë operator ekonomik janë kryer 4 kontrolle gjatë vitit 2023. Konkretisht:

Kontrolli nga z. Z H dhe z. B N datë 09.03.2023;

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 31.05.2023;

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 05.09.2023;

Nga informacionet për kontrollat e mësipërme ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, gjendja fizike e mallrave të gjendura në ambientet e

magazinimit të përkohshëm ka qënë në përputhje me deklaratimet e kryera në systemin Asycuda World. Kontrolli nga z. B N dhe z. G U datë 06.12.2023.

Gjatë këtij kontrolli u evidentua se 1 subjekt ka kaluar afatin tre mujor të qëndrimit në magazinim të përkohshëm, për të cilin do të zbatohet procedura e parashikuar në legjisllacionin në fuqi.

Subjekti	Natyra e mallit	Kg	Nr. i manifestit
A K	Njësi kondicionimi	135	2021
A K	Njësi kondicionimi	120	204

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi dhe verifikimet e kryera konstatojmë se ky subjekt ka bërë kërkesë për dhënie destinacion mallrave dhe është sanksionuar me vendimin nr. 25 datë 30.01.2024.

3. Operatori ekonomik “S” ShPK me kod MP29

Për këtë operator ekonomik janë kryer 3 kontrolle gjatë vitit 2022. Konkretisht:

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 30.03.2023;

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 30.06.2023;

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 03.10.2023.

Nga kontrollet e kryera dhe informacionet shoqëruar këtyre kontrolleve rezultoi se për dy subjekte mallrat e të cilëve gjenden në magazinën e përkohshme e kanë kaluar afatin e lejuar prej 90 ditë sipas nenit 139 të KD. Konkretisht:

Nr.	Subjekti	Sasia	Dt e hyrjes në magazine	Natyra e mallit	CMR	Vlera në euro
1	G M	1 cope	23.08.2019	Skuter elektrik	3903	500
2	G S	110.9 kg	02.09.2019	Kripë	2959	
				Totali		27,931

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për këto dy subjekte nga ana e doganierëve nuk është kryer procedura doganore për rregullimin e situatës sipas legjisllacionit doganor. Ndërsa për subjektet e tjera nga informacionet nga kontrollet e mësipërme ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, gjendja fizike e mallrave të gjendura në ambientet e magazinimit të përkohshëm ka qënë në përputhje me deklaratimet e kryera në systemin Asycuda World.

4. Operatori ekonomik “U E” ShPK me kod MP21

Për këtë operator ekonomik janë kryer 4 kontrolle gjatë vitit 2022. Konkretisht:

Kontrolli nga z. B N dhe z. G U datë 13.01.2023 dhe 20.04.2023;

Kontrolli nga z. Z H dhe z. B N datë 25.07.2023;

Kontrolli nga z. G U dhe z. B N datë 25.10.2023. Sipas informacionit të këtyre kontrolleve ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor me përjashtim të subjektit B ShPK.

Nr.	Subjekti	Pesha kg	Dt e hyrjes në magazine	Natyra e mallit	Vlera në euro
1	B	3,719	08.01.2022	Pajisje gjimnastike	27,431

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kontrolli periodik i rradhës është kryer nga z. G U dhe z. B N datë 25.10.2023. Nga informacioni rezultoi se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, me përjashtim të dy subjekteve, të cilët kanë kaluar afatet e magazinimit të përkohshëm dhe do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

Nga auditimi dhe verifikimet e kryera konstatohet se mallrat e këtij subjekti rezultojnë ende gjendje në MP dhe nuk janë kryer procedurat për rregullim sipas legjislacionit doganor.

Nr.	Subjekti	Pesha kg	Dt e hyrjes në magazine	Natyra e mallit	Vlera në euro
1	B	3,719	08.01.2022	Pajisje gjimnastike	27,431
2	V	2,500	R1367 10.06.2023	Kafe	9,857.98
				Totali	37,288.98

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

5. Operatorët ekonomikë “D” ShPK me kod MP33, “I M” ShPK me kod MP25 dhe “M A”shpk me kod MP15

Janë kryer kontrollet periodike gjatë vitit 2023. Nga informacionet për kontrollet e mësipërme ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, gjendja fizike e mallrave të gjendura në ambjentet e magazinimit të përkohshëm ka qënë në përputhje me deklaratimet e kryera në systemin Asycuda World.

6. Operatori ekonomik “C G” ShPK me kod MP15

Operatori ekonomik “C G” është kontrolluar nga z. B N dhe z. G U çdo tre muaj përkatësisht datë 29.03.2023, datë 30.06.2023, datë 30.09.2023 dhe datë 05.12.2023. Sipas informacionit të këtyre kontrolleve ka rezultuar se mallrat e gjetura në magazinën e përkohshme ishin të magazinuara në një kohëzgjatje të lejuar, përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor me përjashtim të subjektit C M ShPK.

Nr.	Subjekti	Nr i manifestit	Dt e hyrjes në magazine	Natyra e mallit	Vlera në euro
1	C M	2486	31.10.2022	Pllaka qeramike	7,741

Burimi: Të dhëna nga kontrollet e ZMP-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi dhe verifikimet e kryera konstatohet se mallrat e këtij subjekti rezultojnë ende gjendje në MP dhe nuk janë kryer procedurat për rregullim sipas legjislacionit doganor.

Përgjatë vitit 2023 nga ZMP janë konstatuar 19 raste të tejkalimit të afatit të përcaktuar në nenin 139 të Kodit Doganor, për 3 raste kur nga subjektet është kryer procedura e vendosjes në një regjim doganor janë aplikuar penalitete në masën 60,000 mijë lekë. Këto veprime janë klasifikuar kundërvajtje administrative parashikuar në nenin 251/f të Kodit Doganor dhe janë sanksionuar sipas nenit 256/1/b të këtij KD në shumën 20,000 Lekë. Ndërsa për rastet e tjera, për të cilat nuk është paraqitur kërkesë për dhënien e destinacionit doganor nuk janë marrë masa për rregullim sipas. (Sqarojmë se 6 raste i përkasin Subjektit “I T S”, NIPT L.....C, që janë makineri të ndryshme të përpunimit të mbetjeve

urbane-inceneratorët.) Më poshtë paraqiten procesverbalet e kundërvajtjeve të mbajtura përgjatë vitit 2023:

Tabela nr. 15. Procesverbalet e kundërvajtjeve të mbajtura në vitin 2023 në lekë

Nr	Deklarata		Subjekti		Artikulli		Procesverbali	
	Nr	Datë	Emri i shoqërisë	NIPT-i	Përshkrimi	Kodi Tarif	Nr	Datë
1	D 0002110	20.01.2022	S C	L.....S	Paisje të nryshme	8525	20285	27.01.2023
2	D 0009586	23.02.2023	R P	L.....N	Furgon i perdorur	8703	20300	14.07.2023
3	D 0018288	04.04.2023	Sh A	L.....V	Autoveturë e përdorur	8703	20303	22.08.2023

Burimi: Të dhëna nga ZMP e DDT-së

Veprimet ose mosveprimet e mësipërme janë përgjegjësi e përgjegjësit të ZMP z. A Q dhe doganierëve të kësaj zyre znj. Z H, z. G U, z. B N sipas nenit 12, pikat 6.1 dhe 10 të Urdhrit nr.146, datë 07.05.2018 të DPD-së “Rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e degëve doganore.”

1-Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1113/5 prot KLSH datë 26.06.2024 derguar Degës Doganore Tiranë kanë ardhë observacionet dhe dokumentacioni justifikues me shkresën nr. 10738/26 datë 30/08/2024 pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë dhe subjekti i audituar ka bërë komente dhe shpjegime.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me procedurat e ndjekura për kontrollet e ushtruara për mallrat e vendosura në regjimin e magazinimit të përkohshëm, bazuar në programet e kontrollit të hartuara janë kryer verifikime rregullisht në çdo tre muaj, në përfundim janë përgatitur informacionet mbi rezultatet e verifikimeve, janë evidentuar dërgesat për të cilat është tejkualuar afati 90 ditor i përcaktuar në nenin 139 të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, për qëndrimin në regjim, në informacion është evidentuar numri i manifestit, numri i referues i dërgesës (aëb), lloji i mallit dhe pesha përkatëse, data e vendosjes në regjim, të dhënat që përmban dhe manifesti pasi të dhënat për kodin tarifor dhe vlerat janë në dokumentacionin shoqëruar të mallrave, për rastet kur Subjektet kanë kryer procedurat e deklarimit të mallrave në një regjim të posaçëm doganor përtej afatit 90 ditor, janë aplikuar penalitetet përkatëse për shkeljen e konstatuar. Nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm janë evidentuar të gjitha rastet kur mallrat e vendosura në regjimin e magazinimit të përkohshëm, nëpërmjet dokumentit të DEMP apo manifestit doganor është tejkualuar afati i qëndrimit në këtë regjim, janë të evidentuara DEMP-et dhe manifestet doganore që i përkasin këtyre mallrave me të dhëna për subjektet, llojet e mallrave, sasi të dhe vlerat përkatëse, në përputhje me dokumentacionin që shoqëron mallrat në deklarimin për vendosjen në regjim. Për të gjitha rastet është përcaktuar vendndodhja e mallrave dhe vazhdojnë procedurat e mbikqyrjes, për subjektet që kanë një kohë të gjatë qëndrimi është bërë njoftimi për marrjen e masave për dhënie të destinacionit doganor. Për rastet e tjera gjatë kryerjes së verifikimeve periodike iu është komunikuar subjekteve mbajtës të autorizimit të MP, të bëhet njoftimi dhe të merren masat e nevojshme për të mundësuar kryerjen e procedurave për vendosjen në një regjim doganor. Si rezultat i mbikqyrjes së vazhdueshme për 4 raste, pas aplikimit të penaliteteve nga subjektet janë kryer procedurat e deklarimit për qarkullim të lirë. Këto raste i përkasin subjektit “P G” për DEMP 44896, manifest R1887 datë 28.07.2023 dhe DEMP 69673 datë 14.11.2023, Subjekti “V” për DEMP 3343, manifest R1367 datë 10.06.2023, subjekti “I E” për DEMP 71383, manifest

R2984, datë 22.11.2023. Me përjashtim të një rasti që i përket subjektit "G B" (1 copë scooter me vlerë 500 euro), të gjitha rastet e tjera janë brenda afateve të përcaktuara në nenin 97/1, të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas informacioneve të mbajtësve të autorizimeve të MP, subjektet importues të mallrave që ka kaluar afati i magazinimit të përkohshëm janë në procese gjyqësore ose debitorë pranë organeve tatimore, në asnjë rast nuk është depozituar kërkesë për braktisjen e mallrave. Me qëllim që penalitetet të jenë sa më efektive dhe të mundësohet arkëtimi për të mos krijuar borxh doganor, aplikimi është kryer në momentin e paraqitjes së subjekteve për të vendosur mallrat në një regjim doganor. Në bashkëpunim me subjektete e autorizuar për MP do të vazhdojnë procedurat e mbikqyrjes së mallrave në MP për të cilat ka kaluar afati i qëndrimit në këtë regjim, brenda afateve të përcaktuara në nenin 97/1 të ligjit 102/2014, i ndryshuar do të ndërmerren të gjitha hapat proceduriale për rregullimin e situatës siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për informacionin mbi DEMP 3343, observacion është marrë në konsideratë dhe janë realizuar reflektimet përkatëse. Pjesa tjetër e observacionit të paraqitur nga ana e subjektit është i njëjtë me observimin e akt konstatimit, nuk paraqet fakte dhe prova të reja, si rrjedhojë nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me procedurat e ndjekura nga përgjegjësit operacional lidhur me trajtimin e rasteve të diferencave në peshë ndërmjet gjendjes faktike dhe deklarimit në deklaratën e tranzitit

Nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm për vitin 2022 janë konstatuar 40 raste ku janë evidentuar diferenca në peshë nga krahasimi i të dhënave të deklaruara, me të dhënat e rezultuara nga peshimi i mjeteve grupazh. Gjithashtu gjatë vitit 2023 nga ZMP janë konstatuar 35 raste ku janë evidentuar diferenca në peshë. ZMP i ka dërguar rastet përgjegjësit operacional sipas Udhëzimit nr.17, datë 31.12.2018. (Të pasqyruara në tabelën nr. 1 në Aneks) Për këto tranzite në "aktin e inspektimit" ka shënime të cilat informojnë se ka diferenca në peshë, ndryshime ndërmjet të dhënave në deklarim (të dhënat në dokumentat shoqëruese të mallrave) me ato faktike mbi mallrat (fletë pesha). Nga ana e sektorit operacional janë kryer kontrole, nuk janë bërë rregullime në DEMP dhe nuk ka ndryshime deklarimi ndërmjet deklaratës së Tranzitit, DEMP-it dhe DAV-it. Subjekti komunikon se mbas njoftimit mbi këto problematika, nga ana e Sektorit Operacional janë bërë verifikimet përkatëse në mjetet e transportit si dhe në mallrat e importuara. Në të gjitha rastet e përmendura nga verifikimi i mallrave si në natyrën e tyre ashtu dhe nga verifikimi fizik nuk janë konstatuar parregullsi në lidhje me këto mallra, pra nuk kemi të bëjmë me mallra të padeklaruara apo shmangie nga detyrimet doganore. Arsyeja e diferencave të peshës në pjesën më të madhe të rasteve kanë qenë lëvizjet në peshën e vetë mjeteve, duke u nisur nga modifikime të ndryshme që mund t'i jenë bërë, ose nga fakti që disa mjete lëvizin me mbi një gomë rezerve, të cilat kanë peshë të konsiderueshme. Arsye tjetër është dhe fakti që duke u nisur nga lloji i ngarkesave që pjesa më e madhe janë grupazhe, vetë transportuesit janë të detyruar që të përdorin paleta shtesë në mënyrë që të bëjnë të mundur fiksimin sa më të saktë të ngarkesave gjatë transportit. Duke u gjendur përpara faktit që nga kontrollet e ushtruara nuk janë konstatuar parregullsi nga ana fizike e mallrave nuk është proceduar më tej dhe me penalitete.

Në auditim nga 75 rastet të evidentuara me diferencë në peshë në tranzitet grupazh, janë përzgjedhur për t'u audituar 19 raste me diferencën më të lartë në peshë (mbi 1000 kg) ndërmjet sasisë së gjendjes faktike të mallit në tranzit (fletë peshës) dhe deklarimit. (Të pasqyruara në tabelën nr. 2 në Aneks)

Për këto raste konstatohet se nuk ka procesverbale dhe vendime mbi parregullsitë e konstatuara sipas rastit që realizohen nga përgjegjësi i zyrës operacionale në bazë të pikës 3.4 të Udhëzimit nr. 17/2018. Kur ka ndryshime ndërmjet të dhënave në deklaram dhe se kur sasia faktike e ngarkesës ka qenë më e madhe se ajo e deklaruar nuk janë kryer, sipas problematikës së paraqitur nga zyra doganore e destinacionit të gjitha procedurat e nevojshme për kontrollin e ngarkesës konkretisht:

-Nuk është rikanalizuar DAV; (pika 3.3 e udhëzimit)

-Nuk janë zbatuar procedurat në rastet e parregullsive për mbylljen e DEMP, (pika 5 e Manualit)

-Nuk janë pasqyruar masat e marra në “aktin e kontrollit” në DAV,

-Nuk ka dokumentacion të shtuar për të faktuar se këto mallra nuk sjellin pasoja financiare.

Këto kontrole nuk janë shoqëruar me procesverbal si dhe vendime mbi parregullsitë e konstatuara, bazuar në Titullin IX “Shkeljet në fushën doganore, sanksionet dhe ankimet”, nenet 250 deri 281 të KD.

Për këto raste operatorët ekonomikë, mbajtës të regjimit të tranzitit kanë kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 259 “Sanksione për raste të tjera kundërvajtjesh”, pika 1, për kundërvajtje të tjera nga ato të përcaktuara në mënyrë specifike në nenet 251 deri në 254 zbatohen sanksionet e mëposhtme:

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë.

Sa më sipër, mosveprimet e strukturave përgjegjëse, kanë sjellë pasoja financiare për buxhetin e shtetit dhe vlera 380,000 lekë (19 raste X 20,000 lekë) përbën të ardhura të munguara në formën e gjobave për Doganën Tiranë dhe buxhetin e shtetit.

Në 1 rast të evidentuar për pasaktësi në deklaratën e tranzitit, nga Dega e Doganës Tiranë është marrë vendimi nr. 392 datë 15.03.2022. Në këtë rast nga agjencia doganore është plotësuar gabim pesha në deklaramin për vendosjen nën regjimin e tranzitit. Për këtë rast veprimi i kryer nga agjencia doganore është klasifikuar kundërvajtje administrative në fushën e doganave sipas nenit 251/2/a dhe është sanksionuar sipas nenit 256/1/b të Kodit Doganor.

Për rastet e mëposhtme të tranzitit, janë bërë ndryshime në peshën në DAV, sipas dokumenteve shoqëruese (faturë, CMR ose packing list) dhe ky saktësim nuk është shoqëruar me procesverbal kontrolli dhe sanksionim. Në këto raste agjenti doganor përkatës ka kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 251, pika 2, përma a dhe nuk është sanksionuar sipas nenit 256, pika 1, përma b në vlerën 20,000 lekë.

-Për tranzitin 22AL0200000012180 datë 06.02.2022 për subjektin L ShPK është hartuar deklarata e tranzitit me peshën bruto 456 kg, ndërsa në DAV R10276 datë 07.02.2022 është reflektuar pesha 2,216 kg sipas faturës nr. 220176 datë 02.02.2022. Në këtë rast agjenti doganor “E A” me NIPT L.....E dhe Kod J104 ka kryer kundërvajtje administrative sipas gjermës a, pikës 2 nenit 251 ku citohet “Mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaramin doganore, deklaramin e magazinimit të përkohshëm, deklaramin përmbledhëse të hyrjes, deklaramin përmbledhëse të daljes dhe deklaramin e rieksportit ose njoftimin e rieksportit, i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaramin, njoftim apo aplikim, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 23”; dhe nuk është sanksionuar për pasaktësi sipas gjermës b, pika 1, neni 256.

-Për tranzitin grupazh 23AL14000000132460 datë 31.10.2023 për subjektin A ka ndryshime në peshë, ku sipas tranzitit pesha rezulton 9839.29kg, ndërsa sipas DAV R114916 datë 31.10.2023 rezulton pesha 10189 kg (në përputhje me CMR). Në këtë rast agjenti doganor “M” me NIPT J.....W dhe Kod J009 ka kryer kundërvajtje

administrative sipas gërmës a, pikës 2 nenit 251 dhe nuk është sanksionuar për pasaktësi sipas gërmës b, pika 1, neni 256.

-Për tranzitin 22ALAL14000000103022 datë 12.08.2022 për subjektin P ShPK konstatohet se ka diferencë në peshë sipas aktit të inspektimit nga dogana nisëse në sasinë 1,190 kg më tepër. Nga verifikimi i grupit të auditimit sipas Tranzitit dhe DEMP sasia rezulton 12,342.33 kg ndërsa sipas DAV me R83729 datë 12.08.2022 rezulton 12,810.43 kg duke përfshirë dhe peshën e paletave 468 kg. (sipas packing list).

Në këtë rast agjenti doganor "B C" me NIPT L.....A dhe Kod J100 ka kryer kundërvajtje administrative sipas gërmës a, pikës 2 nenit 251 dhe nuk është sanksionuar për pasaktësi sipas gërmës b, pika 1, neni 256. Evidentohet se për këto raste ka mospërputhje në peshë ndërmjet Tranzitit, DEMP dhe DAV. Sa më sipër, mosveprimet e strukturave përgjegjëse, kanë sjellë pasojë financiare për buxhetin e shtetit dhe **vlera 60,000 lekë (3 raste X 20,000 lekë) përbën të ardhura të munguara në formën e gjobave** për Doganën Tiranë dhe buxhetin e shtetit. Veprimet ose mosveprimet e mësipërme janë përgjegjësi e përgjegjësit operacional, veprime në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së Degëve Doganore, pikat 2.2; 3.3; 3.4; 3.5; 5 të Udhëzimit nr.17, datë 31.12.2018 "Mbi zbatimin praktik të deklarimit elektronik të magazinimit të përkohshëm të mallrave" dhe neneve 250, 256, 259, 273, 276 të Kodit Doganor. Kanë qenë përgjegjës operacional për këtë periudhë si në vijim: 01.01.2022-08.08.2022 z. E Sh; 08.08.2022-06.07.2023 z. E C; 06.07.2023-31.12.2023 znj. E R.

1-Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1113/5 prot KLSH datë 26.06.2024 derguar Degës Doganore Tiranë kanë ardhë observacionet dhe dokumentacioni justifikues me shkresën nr. 10738/26 datë 30/08/2024 pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë dhe subjekti i audituar ka bërë komente dhe shpjegime.

Prezantimi i subjektit: Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Zyra Operacionale për trajtimin e rasteve të diferencave të peshës së mjeteve grupazh, të rezultuara nga krahasimi i peshës së deklaruar në deklaratën e tranzitit, me peshën e rezultuar nga peshimi i mjetit, bazuar në informacionin e dërguar nga ZMP janë evidentuar mjetet, pas depozitimit të të gjitha deklarimeve për mallrat që transportoheshin në një mjet, është përzgjedhur punonjësi që do të kryejë procedurat e verifikimit fizik, më pas kanë vazhduar procedurat e verifikimeve dhe në rubrikën "akt inspektimi" të deklaratave janë plotësuar shënimet mbi rezultatet e verifikimeve, përgjithësisht si shkak i diferencave në peshë kanë qënë pasaktësisë së peshës së mjetit bosh që jepet në lejën e qarkullimit, mjetet për të cilët është konstatuar kjo parregullsi kanë qënë të huaja dhe të paregjstruara në Shqipëri, fakt që nuk mundëson aplikimin e penalteteve. Në disa raste diferencat kanë rezultuar në mallra, pagesa e detyrimit të të cilave përlllogaritet për copë dhe jo për kg dhe diferenca nuk ndikonte në pagesën e detyrimit. Diferenca në peshë është vlerësuar si një indikator për mënyrën se si të kryhen kontrollet dhe verifikimet fizike të mallrave dhe jo si një arsye për të aplikuar penaltitet, në rastet kur nga verifikimet e kryera është vërtetuar se diferenca ndikon në pagesën e detyrimit doganor, janë mbajtur aktet përkatëse dhe për shkeljen e konstatuar janë aplikuar penaltete sipas legjislacionit doganor.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me procedurat e ndjekura nga Zyra Operacionale pavarësisht efekteve financiare, mbajtësit e regjimeve në rastet e evidentuara me diferencë në peshë kanë kryer kundërvajtje administrative dhe nuk janë sanksionuar. Observacioni i paraqitur nga ana e subjektit është i njëjtë me observimin e akt konstatimit, nuk paraqet fakte dhe prova të reja, si rrjedhojë nuk merret në konsideratë.

Në zbatim të pikës së mësipërme (sektori i pikës Hyrje Dalje), u shqyrtua informacioni dhe dokumentacioni si vijon:

Në zbatim të pikës së mësipërme u auditua dokumentacioni dhe informacioni si vijon:

- Të dhëna elektronike të eksportuara në formatin excel për regjistrin e tranziteve me destinacion Degën Doganore Tiranë për vitet 2022 dhe 2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Regjistri i Pikës së Hyrjes;
- Të dhëna nga sistemi Asycuda;
- Dosje fizike të deklaratave në kanal të kuq.

Nga ku u konstatua se: Për vitin 2022 Dogana Tiranë ka qenë si destinacion tranziti për 51,863 raste, nga të cilat të ndara sipas sektorëve doganorë paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 16- Numri i tranziteve të vitit 2022 të ndara sipas sektorëve doganorë

Sektori doganor	Kodi	Numri i tranziteve të mbyllura 2022
Tirana	AL110000	47,063
Tiranë DPS	AL111000	585
Tirana Autopasion	AL110007	207
Tirana IN	AL110002	108
Tirana INT	AL110005	263
Tirana ITD	AL110006	344
Tirana MD	AL110001	1,353
Tirana MS	AL110003	1,092
Tirana PO	AL110004	138
Tirana THG	AL110008	709
Tiranë	321	1
Totali		51,863

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit

Rastet e evidentuara me vonesë të ndara sipas sektorëve doganorë paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 17- Numri i tranziteve me vonesë sipas sektorëve doganorë për vitin 2022

Sektori doganor	Kodi	Numri i tranziteve të mbyllura me vonesë
Tirana	AL110000	8739
Tirana MD	AL110001	909
Tirana MS	AL110003	657
Tiranë DPS	AL111000	564
Tirana THG	AL110008	333
Tirana INT	AL110005	95
Tirana IN	AL110002	89
Tirana ITD	AL110006	74
Tirana Autopasion	AL110007	29
Totali		11,489

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit

Dega doganore e nisjes e përcakton kohën e mbërritjes në doganën destinacion sipas tabelës së afateve të tranzitit të udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e tranzitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit”. Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion, u konstatua se në 11489 raste janë shkelur dispozitat ligjore, për shkak të tejkalimit të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacion. Nga këto 11489 tranzite evidentohet se 564 raste janë mbërritje në sektorin doganor Tiranë DPS, i cili nuk monitorohet nga pika e hyrje-daljes dhe nuk është marrë në analizë. Gjithashtu rezultojnë 2186 raste të cilat shkojnë direkt në magazinat e subjekteve që kanë statusin e pritësit të autorizuar.

Analiza është bazuar në 8739 raste të cilat kanë si mbërritje Degën e Doganës Tiranë me Kod AL110000. Duke marrë në konsideratë edhe arsye objektive, grupi i auditimit ka evidentuar vetëm rastet të cilat kanë vonesë më të lartë se 2 (dy) orë nga koha limit e vendosur. Ky kriter tolerance u vendos duke marrë në konsideratë mundësinë e ndodhive

si trafiku, aksidentet, pritja në radhë apo dhe manuali i pandryshuar i distancave dhe afateve kohore. Gjithashtu edhe për të qënë në një linjë vlerësimi me auditimet e tjera të zhvilluara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Referuar kriterit të tolerancës rezultuan në total 5,974 raste për të cilat nuk janë zbatuar dispozitat ligjore.

Për efekt analize, nga grupi i auditimit këto raste janë ndarë sipas intervaleve kohore: 2-3 orë, 3-5 orë, 5-7 orë dhe mbi 7 orë.

Gjatë auditimit u kërkua të verifikohen rastet si vijon:

- Mbi 3 ditë vonesë janë 32 raste që kanë si destinacion pikën e hyrjes me Kod AL110000;
- Mbi 7 orë vonesë janë 3564 raste që kanë si destinacion pikën e hyrjes me Kod AL110000;
- si dhe 3% e popullatës të ndarë sipas intervaleve kohore për tranzitet e mbërritura në pikën e hyrjes me Kod AL110000 (205 raste).

Informacioni dhe dokumentacioni i mësipërm u kërkua, por nuk u vendos në dispozicion të grupit të auditimit.

Për të audituar procedurat e ndjekura nga kjo degë doganore për mbylljen e tranziteve për evidentimin, dokumentimin, masat e marra nga dogana e destinacionit për vonesat e justifikuar dhe incidentet u audituan të dhëna të përzgjedhura nga sistemi Asycuda dhe dosje nga praktikave të kanalizuar me kanal të kuq e të kontrolluara nga kjo degë doganore. Nga grupi i auditimit u audituan në sistemin Asycuda 205 rastet e përzgjedhura sipas intervaleve kohore dhe u konstatua se megjithëse tranzitet kanë mbërritur me vonesë në doganën e destinacionit, nga ana e doganierëve të pikës së hyrjes nuk janë bërë shënime përkatëse në kutinë 56-I të deklaratës “Kontrolli nga zyra e destinacionit: Data e ardhjes, kontrolli i plumçeve, shënime)”. Është plotësuar data e ardhjes dhe kontrolli i plumçeve, por nuk është plotësuar fusha shënime për vonesat të konstatuara.

U auditua dokumentacioni i 9 dosjeve të përzgjedhura të praktikave kanalizuar në kanal të kuq për vitin 2022 të dorëzuara në arkivë në datat 21.01.2022, 04.03.2022, 27.06.2022, 12.07.2022, 05.08.2022, 02.09.2022, 03.11.2022, 01.12.2022, 28.12.2022.

U audituan në total 563 praktika për të verifikuar konkretisht kryerjen e kontrollit nga dogana e destinacionit, plotësimin e kutive (kutia 56) - masat nga dogana nisëse dhe kontrollin në mbërritje (kutia 56- I) masat e marra nga dogana e destinacionit për mbikqyrjen doganore. Nga auditimi i dokumentacionit të këtyre dosjeve rezultoi se 10 tranzitet e mëposhtme kanë shënim nga dogana nisëse për orarin e daljes nga kjo doganë dhe nuk kanë shënim në kontrollin në mbërritje nga dogana e destinacionit në sistem, konkretisht:

Tabela nr. 18- Rastet e evidentuara me shënim nga dogana nisëse për vitin 2022

Deklaratë	Datë	Nr tranziti	Datë	Nr reference
IM 4 R73257	16.07.2022	22ALAL14000000090976	16.07.2022	#330
IM4 R501	16.01.2022	22ALAL15000000001084	05.01.2022	#3
IM4 R2891	17.01.2022	22ALAL02000000003531	17.01.2022	#13
IM4 R124	04.01.2022	21ALAL15000000177540	30.12.2021	#425
IM4 R129729	13.12.2022	22ALAL14000000153776	12.12.2022	#828
IM4 R116773	09.12.2022	22ALAL15000000146020	08.11.2022	#1648
IM4 R117452	11.11.2022	22ALAL19000000100684	10.11.2022	#716
IM4 R83344	12.08.2022	22ALAL19000000070125	11.08.2022	#600
IM4 R83775	13.08.2022	22ALAL19000000070708	12.08.2022	#525
IM4 R86227	22.08.2022	22ALAL14000000104779	20.08.2022	#440

Burimi: Nga dosjet fizike në kanal të kuq, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga 10 rastet e tranziteve të evidentuara me shënim nga dogana nisëse, 7 prej tyre që rezultojnë te lista në aneksin 3 janë marrë në konsideratë dhe i janë hequr listës.

Nga 5,974 rastet me vonesë janë hequr 7 rastet e mësipërme, të cilat kanë pasur shënim nga dogana nisëse. Gjithashtu nuk janë vendosur si objekt sanksionimi rastet e tranzitit të automjeteve të importuara për individë. Në total për vitin 2022 rezultojnë 155 raste automjete. Në konsideratë për vitin 2022 janë marrë 5812 raste të mosrespektimit të afatit kohor. Më sipër u konstatua mungesa e shënimeve, vërejtjeve të kontrollit në mbërritje nga pika e hyrjes së doganës së destinacionit. U konstatua mos evidentimi, mos dokumentimi i vonesave të justifikuara/ incidenteve dhe masat e marra për mbikqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 128 të Kodit Doganor.

Sipas subjekteve që kanë mbërritur në pikën e hyrjes, duke i grupuar sipas Niptit rezultojnë me më shumë vonesa të pa sanksionuara si më poshtë:

Tabela nr. 19- Nipte me numrin më të lartë të rasteve të tranziteve me vonesë

Nipti	Numri i rasteve
J.....P	129
J.....L	110
K.....A	79
K.....E	72
L.....B	69
K.....V	53
J.....S	50
K.....T	48
K.....U	46
K.....M	46
L.....H	45
K.....H	42
M.....K	42
K.....N	36
J.....F	35
J.....L	34
J.....H	31
K.....E	31
K.....O	31

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit

U konstatuan mangësi në procedurat e ndjekura nga zyra e pikës së hyrje -daljes (afati kohor dhe mbyllja e tranziteve) konkretisht:

- Mos evidentimi dhe mos dokumentimi i vonesave të justifikuara /incidenteve dhe masat e marra për mbikqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 128 të Kodit Doganor.
- Mos penalizimi i subjekteve për mos respektimin e afatit kohor të mbërritjes në doganën e destinacionit në kundërshtim me nenin 126 të Kodit Doganor;

Nga verifikimet e kryera në total rezultojnë **5812 raste** me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacion të pa sanksionuara nga Dega Doganore Tiranë dhe zyra e pikës së hyrjes. Lista analitike e tranziteve është pasqyruar në tabelën 3 në Aneks. Konstatohet se për këto raste nuk janë marrë masat ligjore për shkeljet e afateve kohore lidhur me mbylljen e tranziteve (T1/T2) në kundërshtim me nenin 126, pika 1 dhe nenet 128 pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

Personi, i cili fut mallra në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i transporton ato pa vonesë në rrugën e përcaktuar nga autoritetet doganore dhe në përputhje me udhëzimet e tyre, nëse ka të tilla, drejt zyrës doganore të caktuar ose në një vend tjetër të përcaktuar nga këto autoritete apo në një zonë të lirë

Neni 128 “Transporti nën rrethana të veçanta”

1. Kur, për arsye të rrethanave të paparashikuara ose të një force madhore, detyrimi i përcaktuar në pikën 1, të nenit 126, nuk mund të përmbushet, personi përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi ose çdo person tjetër që vepron në emër dhe për llogari të atij personi duhet të informojë pa vonesë autoritetet doganore për situatën...

3. Autoritetet doganore përcaktojnë masat që duhen marrë për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave të përmendura në pikën 1 ose të mjetit të lundrimit apo atij ajror dhe të çdo malli në të rrethanat e specifikuar në pikën 2 dhe të sigurojë, kur është me vend, që ato janë transportuar më pas në një zyrë doganore ose në çdo vend tjetër të caktuar apo miratuar nga autoritetet.

Neni 207 “Detyrimet e mbajtësit të regjimit të tranzitit kombëtar dhe të transportuesit e të marrësit të mallrave që lëvizin sipas regjimit të tranzitit kombëtar”

1. Mbajtësi i regjimit të tranzitit kombëtar është përgjegjës për të gjitha veprimet e mëposhtme:
a) paraqitjen e mallrave të paprekura dhe të informacionit të kërkuar në zyrën doganore të destinacionit brenda afatit kohor të përcaktuar dhe në përputhje me masat e ndërmarra nga autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e tyre;

b) respektimin e dispozitave doganore për regjimin;

c) përveçse kur është parashikuar ndryshe në legjislacionin doganor, depozitimin e një garancie për të siguruar pagesën e shumës së detyrimit të importit apo eksportit, që i korrespondon çdo borxhi doganor apo pagesave të tjera, që mund të lindin, sipas dispozitave përkatëse në fuqi për mallrat.

3. Transportuesi ose marrësi i mallrave, i cili pranon mallrat, duke e ditur që ato po lëvizin sipas një regjimi të tranzitit kombëtar, është gjithashtu përgjegjës për paraqitjen e mallrave të paprekura në zyrën doganore të destinacionit, brenda afateve kohore të përcaktuara dhe në përputhje me masat e ndërmarra nga autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e tyre.

Si dhe këto veprime janë në kundërshtim me Manualin për deklarimin elektronik të mallrave në doganat destinacion, bashkëlidhur Udhëzmit nr.17, datë 31.12.2018 të DPD - së pikave 2, 4/2 të tij.

Nga ana e doganierëve nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuar /incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 128 të Kodit Doganor. Nuk janë dokumentuar si informimet për vonesën ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklaratës tranzit dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

Doganierët e pikës së kontrollit nuk kanë vepruar sipas Rregullores së degëve doganore-Kompetencat e përgjegjës pikë kontrolli, neni 12 pika 5 dhe 11.

Për këto raste operatorët ekonomik mbajtës të regjimit të tranzitit kanë kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe duhet të zbatohet sanksion sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë.

Referuar nenit 251, pika 2, shkronja “e”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 përcaktohet:

“e) mosrespektimi nga një person, që fut mallrat në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i detyrimit që lidhet me transportin e mallrave drejt vendit të përcaktuar, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 126...”

Referuar nenit 256, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet:

“b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë”.

Referuar nenit neni 273, pika 3, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet:

“Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, nga ana e strukturave doganore që kanë konstatuar shkeljen mbahet një procesverbal me shkrim, i

cili duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë që kryejnë verifikimin e kontrollin, si dhe shkelësi, kur shkelja është evidentuar në prani të tij”.

Sa më sipër, mosveprimet e strukturave përgjegjëse për tranzitin, kanë sjellë efekt financiar negativ për Doganën Tiranë dhe buxhetin e shtetit në vlerën 116.240,000 lekë (5812 raste dhe trajtuar me gjobe doganore 20,000 lekë/rast).dhe trajtuar më hollesisht në aneksin 2.4 të këtij Raportit Përfundimtar te Auditimit

Veprimet e mësipërme janë përgjegjësi e përgjegjësitet të pikës së hyrjes dhe doganierëve të pikës së hyrjes dhe janë në kundërshtim me: Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 126, nenet 203-209, nenet 251, 256, 273; VKM-në nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar (nenet 566-630), neni 623, pika 3 dhe sipas Urdhrit nr.146, datë 07.05.2018 të DPD-së Rregullores së degëve doganore neni 12 pika 5 dhe pika 11.

Për vitin 2023 nga auditimi u konstatuan të njëjtat mangësi procedurale si në vitin 2022 lidhur me tranzitet. Për këtë vit Dega e Doganës Tiranë ka qenë si destinacion tranziti për 53,844 raste, nga të cilat të ndara sipas sektorëve paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 20- Numri i tranziteve të vitit 2023 të ndara sipas sektorit doganor

Sektor i doganor	Kodi	Numri i tranziteve të mbyllura
Tirana	AL110000	47,932
Tirane DPS	AL111000	1,620
Tirana Autopasion	AL110007	311
Tirana IN	AL110002	126
Tirana INT	AL110005	251
Tirana ITD	AL110006	355
Tirana MD	AL110001	1,174
Tirana MS	AL110003	1,114
Tirana PO	AL110004	152
Tirana THG	AL110008	804
Tiranë	321	5
Totali		53,844

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit

Rastet e evidentuara me vonesë të ndara sipas sektorëve doganorë paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 21- Numri i tranziteve me vonesë sipas sektorëve doganorë për vitin 2023

Sektor i doganor	Kodi	Numri i tranziteve të mbyllura me vonesë
Tirana	AL110000	10400
Tiranë DPS	AL111000	1320
Tirana MD	AL110001	835
Tirana MS	AL110003	667
Tirana THG	AL110008	400
Tirana IN	AL110002	105
Tirana INT	AL110005	87
Tirana ITD	AL110006	69
Tirana Autopasion	AL110007	44
Tirana PO	AL110004	1
Totali		13,928

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion, u konstatua se në 13928 raste janë shkelur dispozitat ligjore, për shkak të tejkalimit të afatit limit të vendosur nga dega doganore e nisjes për mbërritjen në destinacion. Evidentohet se 1320 raste janë mbërritje në sektorin doganor Tiranë DPS, i cili nuk monitorohet nga pika e hyrje-daljes dhe nuk është marrë në analizë. Gjithashtu rezultojnë 2208 raste të cilat shkojnë direkt në magazinat e subjekteve që kanë statusin e pritësit të autorizuar, 4 raste janë raste të vjetra (mbërritje në doganën me kod 321).

Analiza është bazuar në 10396 raste të cilat kanë si mbërritje Degën e Doganës Tiranë me Kod AL110000. Lista analitike e tranziteve është pasqyruar në tabelën 4 në Aneks.

Duke marrë në konsideratë edhe arsye objektive, grupi i auditimit ka evidentuar vetëm rastet të cilat kanë vonesë më të lartë se 2 (dy) orë nga koha limit e vendosur. Ky kriter tolerance u vendos duke marrë në konsideratë mundësinë e ndodhive si trafiku, aksidentet, apo pritja në radhë. Gjithashtu edhe për të qënë në një linjë vlerësimi me auditimet e tjera të zhvilluara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Referuar kriterit të tolerancës, rezultuan në total 7,435 raste për të cilat nuk janë zbatuar dispozitat ligjore.

Për efekt analize, nga grupi i auditimit këto raste janë ndarë sipas intervaleve kohore: 2-3 orë, 3-5 orë, 5-7 orë dhe mbi 7 orë.

Gjatë auditimit u kërkua të verifikohen rastet si vijon:

- Mbi 3 ditë vonesë janë 45 raste kanë si destinacion pikën e hyrjes me Kod AL110000;
- Mbi 7 orë vonesë janë kërkuar për verifikim 4412 raste që kanë si destinacion pikën e hyrjes me Kod AL110000;
- si dhe 3% e popullatës të ndarë sipas intervaleve kohore për tranzitet e mbërritura në pikën e hyrjes me Kod AL110000. (253 raste)

Informacioni dhe dokumentacioni i mësipërm u kërkua, por nuk u vendos në dispozicion të grupit të auditimit.

Për të audituar procedurat e ndjekura nga kjo degë doganore për mbylljen e tranziteve për evidentimin, dokumentimin, masat e marra nga dogana e destinacionit për vonesat e justifikuar dhe incidentet u audituan të dhëna të përzgjedhura nga sistemi Asycuda dhe dosje nga praktikat e kanalizuar me kanal të kuq e të kontrolluara nga kjo degë doganore. Nga grupi i auditimit u audituan në sistemin Asycuda 253 rastet e përzgjedhura sipas interevele kohore dhe u konstatua se megjithëse tranzitet kanë mbërritur me vonesë në doganën e destinacionit, nga ana e doganierëve të pikës së hyrjes nuk janë bërë shënime përkatëse në kutinë 56-I të deklaratës “Kontrolli nga zyra e destinacionit: Data e ardhjes, kontrolli i plumceve, shënime)”. Është plotësuar data e ardhjes dhe kontrolli i plumçeve, por nuk është plotësuar fusha shënime për vonesa të konstatuara.

U auditua dokumentacioni i dosjeve të përzgjedhura të praktikave kanalizuar në kanal të kuq për vitin 2023 të dorëzuara në arkivë në datat 27.03.2023, 04.04.2023, 10.05.2023, 11.07.2023, 19.07.2023, 21.10.2023, 31.10.2023, 16.11.2023, 29.12.2023.

U audituan në total 895 praktika për të verifikuar konkretisht kryerjen e kontrollit nga dogana e destinacionit, plotësimin e kutive (kutia 56) - masat nga dogana nisëse dhe kontrollin në mbërritje (kutia 56- I) masat e marra nga dogana e destinacionit për mbikqyrjen doganore.

Nga auditimi i dokumentacionit të këtyre dosjeve rezultoi se 18 tranzitet e mëposhtme kanë shënim nga dogana nisëse për orarin e daljes nga kjo doganë dhe nuk kanë shënim në kontrollin në mbërritje nga dogana e destinacionit, konkretisht

Tabela nr. 22- Rastet e evidentuara me shënim nga dogana nisëse për vitin 2023

Deklaratë	Datë	Nr tranziti	Datë	Nr reference
IM4 R862	09.01.2023	23ALAL24000000000348	06.01.2023	#7
IM4 R13633	14.02.2023	23ALAL14000000015286	14.02.2023	#14
IM4 R23857	15.03.2023	23ALAL19000000019521	14.03.2023	#161
IM4 R24098	15.03.2023	23ALAL14000000028206	13.03.2023	#115
IM4 R22307	10.03.2023	23ALAL19000000018280	09.03.2023	#105
IM4 R37277	19.04.2023	23ALAL19000000030310	16.04.2023	#139
IM4 R72461	15.07.2023	23ALAL19000000058925	14.07.2023	#191
IM4 R73427	18.07.2023	23ALAL15000000088316	17.07.2023	#382
IM4 R58173	10.06.2023	23ALAL14000000069457	09.06.2023	#9
IM4 R94398	11.09.2023	23ALAL02000000112499	10.09.2023	#211
IM4 R 94611	11.09.2023	23ALAL19000000075604	09.09.2023	#925

IM4 R97284	18.09.2023	23ALAL02000000116001	17.09.2023	#1186
IM4 R112977	27.10.2023	23ALAL19000000090437	26.10.2023	#808
IM4 R115195	01.11.2023	23ALAL19000000092418	31.10.2023	#491
IM4 R116438	04.11.2023	23ALAL14000000134113	03.11.2023	#266
IM4 R109171	18.10.2023	23ALAL15000000138900	17.10.2023	#580
IM4 R110577	21.10.2023	23ALAL19000000088487	20.10.2023	#1076
IM4 R115241	01.11.2023	23ALAL02000000140053	31.10.2023	#482

Burimi: Nga dosjet fizike në kanal të kuq, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga 18 rastet e tranziteve të evidentuara me shënim nga dogana nisëse, 10 prej tyre që rezultojnë te lista në aneksin 14 janë marrë në konsideratë dhe i janë hequr listës.

Nga 7,435 rastet me vonesë janë hequr 15 rastet e mësipërme, të cilat kanë pasur shënim nga dogana nisëse. Gjithashtu nuk janë vendosur si objekt sanksionimi rastet e automjeteve të importuara për individë. Në total për vitin 2023 rezultojnë 187 raste automjete. Në konsideratë për vitin 2023 janë marrë 7233 raste tranzitesh të mosrespektimit të afatit kohor.

Sa më sipër u konstatua mungesa e shënimeve, vërejtjeve të kontrollit në mbërritje nga pika e hyrjes së doganës së destinacionit. U konstatua mos evidentimi, mos dokumentimi i vonesave të justifikuar/ incidenteve dhe masat e marra për mbikqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 128 të Kodit Doganor.

Sipas subjekteve që kanë mbërritur në pikën e hyrjes, duke i grupuar sipas Niptit rezultojnë me më shumë vonesa të pa sanksionuara si më poshtë:

Tabela nr. 23- Nipte me numrin më të lartë të rasteve të tranziteve me vonesë për vitin 2023

Nipti	Numri i rasteve
J.....P	171
J.....L	105
K.....H	93
K.....V	77
K.....T	75
L.....B	75
M.....K	72
J.....H	59
L.....Q	56
L.....C	53
J.....F	52
K.....E	52
K.....U	50
K.....G	49
K.....Q	49
J.....L	48
M.....D	48
L.....H	47
J.....S	46
K.....L	45
J.....P	43

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër konstatohet se për këto raste nuk janë marrë masat ligjore për shkeljet e afateve kohore lidhur me mbylljen e tranziteve (T1/T2) në kundërshtim me nenin 126, pika 1, nenin 251, pika 2, shkronja “e”, nenin 256, pika 1, shkronja “b”, nenin 273, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, mosveprimet e strukturave përgjegjëse për tranzitin, kanë sjellë efekt financiar negativ për Doganën Tiranë dhe buxhetin e shtetit në vlerën 144,660,000 lekë (7233 raste dhe trajtuar me gjobe doganore 20,000 lekë/rast).dhe trajtuar më hollesisht në aneksin 2.3 të këtij Raportit Përfundimtar te Auditimit

Veprimet e mësipërme janë përgjegjësi e përgjegjësit të pikës së hyrjes dhe doganierëve të pikës së hyrjes dhe janë në kundërshtim me: Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 126, nenet 203-209, nenet 251, 256, 273; VKM-në nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar (nenet 566-630), neni 623, pika 3 dhe sipas Urdhrit nr.146, datë 07.05.2018 të DPD-së Rregullores së degëve doganore neni 12 pika 5 dhe pika 11.

Konkretisht mbajnë përgjegjësi: z. A N, z. Y V, z. E D, z. G H, z. E B, z. G P, z.E H, z. E M, z. E M, z. K B.

(Mbajtur ne terren Akt Konstatimi nr 7 dhe 8 date 31.05.2024)

Trajtim Obervcione

1-Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1113/5 prot KLSH datë 26.06.2024 derguar Degës Doganore Tiranë kanë ardhë observacionet dhe dokumentacioni justifikues me shkresën nr. 10738/26 datë 30/08/2024 pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë dhe subjekti i audituar ka bërë komente dhe shpjegime.

Pretendimi i subjektit: Puna në sektorin e Pikës së Hyrje-Dalje është 365 ditët e vitit pa pushime, në ditë festash, fundjavash dhe të dielave. Detyra funksionale të doganierëve C3 në sektorin e pikës së hyrje-dalje është 24 orëshe dhe janë të pranojnë, të kontrollojnë dhe të rregjistrojnë të gjithë mjetet tranzite të ardhura nga të gjitha degët doganore që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, mjetet që janë për eksport si dhe mjetet e tjera që marrin mallra apo dorëzojnë në magazinat që janë atashuar brenda territorit doganor në Doganën e Tiranës. Pas kontrollit dokumentar dhe përputhmërisë së dokumentave me mjetin fizik të ardhur, bëhet kontrolli fizik i të gjitha elementëve të sigurimit të mjetit si: Tenda e jashtme nuk duhet të ketë dëmtime. Litarët lidhës që përfundojnë tek plumcja, të jenë të lidhur mirë dhe pa këputje. Kontrolli i plumces së sigurisë dhe përputhshmëria e saj me dokumentin e paraqitur. Kur të gjithë këto elementë të sigurisë janë në rregull kalohet në rregjistrim. Bëhet rregjistrimi i tranziteve në Librin e Hyrjes. Në rast se ka dëmtime në pjesën e jashtme të mjetit bëhet shënimi dhe raportohet tek eprori. Po kështu bëhet dhe për të gjitha mjetet që do të bëhen eksport, bëhet kontrolli i plumces dhe formës së jashtme të jenë në rregull, rregjistrohet mjeti në librin e hyrjes me të gjitha të dhënat dhe kalohet në parkimin doganor për veprimtarinë e mëtejshme. Në pikën e hyrje-daljes kontrollohen të gjitha mjetet që hyjnë në territorin doganor, për tërheqjen e mallrave të zhdoganuara nga magazinat doganore, të cilat janë atashuar në territorin e Doganës së Tiranës, si dhe mjetet e tjera që janë në shërbim të disa subjekteve të tjera që nuk ushtrojnë veprimtari për llogari të Doganës së Tiranës. Këto tranzite të ardhura kërkojnë kohën e tyre për kontrollin fizik të jashtëm, regjistrimin në regjistrin e hyrjes dhe mbylljen e tyre me të gjitha hapat e duhura në programin Asycuda. Puna në Pikën e Hyrje-Dalje është shumë intensive dhe me përgjegjësi, pasi kemi të bëjmë me mallrat e ardhura nga degët e tjera doganore, të cilat do të zhdoganohen apo do të shkojnë në eksport. Detyra kryesore e Pikës së Hyrje-Dalje në Doganën e Tiranës është që të gjitha mallrat e tranziteve të ardhura dhe eksportet e kryera nga kjo doganë, të jenë të pa cënuara nga elementet e sigurisë, si dhe ti shërbehet subjekteve sa më shpejt dhe të mos ketë vonesa në zhdoganimin apo eksportin e mallrave. Për sa i përket vonesave në ardhje të tranziteve ato kanë qenë të justifikuar me shënime nga doganat nisëse për arsyet që i dinë ato. Këto shënime justifikuese janë të shkruara në pjesën e pasme të deklaratës së

parë të tranzitit dhe janë të vulosura ose me vulën personale të doganierit ose me vulën datore të doganës përkatëse. Këto shënime duhej të ishin hedhur edhe në sistem, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe jemi mjaftuar vetëm me justifikimin e shkruar në deklaratën e tranzitit kur i kemi pranuar. Në disa tranzite të ardhura, kanë pasur vonesa pasi kanë ardhur nga faktorë të tjerë, që nuk varen nga dogana siç janë: Nga 15 Qershori deri në 15 shtator është sezoni turistik në Shqipëri dhe mjetet e transportit që kryejnë tranzitet nuk lejohen të qarkullojnë normalisht, por vetëm në bazë të udhëzimit nr. 7967 dt 30.05.2018; Mjetet e transportit të pajisura me "Tahograf" që qarkullojnë në territorin e Shqipërisë, duhet të zbatohen periudhat e pauzës, brenda kufijve të përcaktuar nga rregullorja (Ligji nr. 9808, dt. 24.09.2007, neni 172, pika 2) ose periudhat e pushimit të përcaktuara, në të kundërt ndëshkohet me masë administrative nga autoritete e policisë rrugore; Trafiku rrugor shumë i rënduar në të gjithë periudhën e vitit; Kushtet atmosferike, ku disa nga pikat doganore gjatë dimrit mund të bllokohen nga ngricat në rrugë; Disa tranzite të ardhura nga Kosova dhe kryesisht tranzitet T2 kanë ardhur pa kryer krosbordin e duhur (CTS) në Doganën e Morinës. Për këto arsye nuk bëhet mbyllja e tranzitit deri në kryerjen e krosbordin nga kjo Doganë, e cila bëhet pasi kemi njoftuar Doganën e Morinës dhe Helpdeskun për tranzitin përkatës, megjithëse mjeti ka mbërritur në Doganën e Tiranës dhe mbyllja e tranzitit është bërë në kohën që është bërë kalimi i krosbordin, jo të mbërritje në Doganën e Tiranës; Gjatë dimrit dhe verës së nxehtë kemi pasur shumë ndërprerje të energjisë elektrike dhe sistemit, për periudha jo të shkurtra kjo ka sjellë mbylljen me vonesë të tranziteve megjithëse mjetet kanë qenë parkuar në Doganën e Tiranës.

Edhe kur ka pasur ndonjë mjet në tranzit me vonesë, e kemi pyetur për vonesën dhe shoferët na janë justifikuar me shprehjet si "e kemi për herë të parë nuk e dinim", nuk na është thënë nga agjenti doganor për orarin e mbërritjes etj. Për këto raste të padijes nga ana e transportuesit ne kemi bërë informimin e duhur të tyre, që ata transportues të mos e përsërisin më vonesën dhe nuk i kemi gjorbitur.

Në punën tonë të përditshme në Pikën e Hyrje-Dalje në Doganën e Tiranës ne mbajmë parasysh porosinë e vazhdueshme që jepen nga eprorët tanë dhe Drejtori ynë i përgjithshëm, që kontrollet dhe përpunimi i deklaratës së tranzitit, të jenë të shpejta dhe të përpikta, në mënyrë që subjektet të mos vonohen në momentin e parë sapo futen në territorin doganor të Tiranës, pra përpunimi i deklaratave të zhdoganimit të kryhet sa më shpejt.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i paraqitur nga ana e subjektit është i njëjtë me observimin e akt konstatimit, nuk paraqet fakte dhe prova të reja, si rrjedhojë nuk merret në konsideratë. Ashtu sikurse e kemi trajtuar dhe më parë problematikat e trajtuara në material lidhen me mangësitë në dokumentimin e vonesave në tranzit dhe sanksionimeve sipas ligjeve dhe akteve ligjore. Këto observacione nuk kundërshtojnë faktin se nga ana e doganës së destinacionit nuk ka qëndrim në lidhje me justifikimin ose jo të vonesave nga mbajtësit e regjimeve, si dhe në lidhje me mos sanksionimin e tyre.

2.3 Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori i mbikëqyrjes doganore në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike për periudhën nën auditim.

2.3.1. Auditimi i Rregjimit RLP që operojnë nën Regjimin e Lejimit të Përkohshëm".

Auditimi u krye referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:

-Ligjit nr. 102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Titulli VII Regjimet e posaçme, Kreu I Dispozita të përgjithshme, nenet 191-200; Kreu IV Përdorim i veçantë, Seksioni 1, Lejimi i përkohshëm nenet 223-226; VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” nenet 533-534; nenet 649-685;

-Udhëzimit nr. 146, datë 07.05.2018 të DPD “Rregullore e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e degëve doganore”.

Nga auditimi rezultoi se operatorët ekonomik që kanë vendosur mallra në Regjimin e Lejimit të Përkohshëm dhe janë mbikëqyrur nga kjo Degë Doganore për periudhën nën auditim janë pajisur me 656 autorizime. Nën Regjimin e Lejimit të Përkohshëm (RLP) mallrat joshqiptare, të destinuara për riekспорт, mund të jenë objekt i përdorimit të veçantë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi i importit dhe pa iu nënshtruar: a) pagesave të tjera, të parashikuara sipas dispozitave përkatëse në fuqi; b) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 223 të Kodit Doganor. “Mbikëqyrje doganore” është veprimi i ndërmarrë në përgjithësi nga autoritetet doganore për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor dhe kur është e nevojshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen këtij veprimi, sipas nenit 6 të Kodit Doganor. U shqyrtuan të dhënat nga Zyra e Mbikëqyrjes së RLP të DDT, të dhëna nga sistemi Asycuda dhe nga 88 raste (14%) të përzgjedhura lidhur me procedurat e ndjekura nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore për subjektet që operojnë në regjimin e RLP-së u konstatua:

a. *Zyra e Mbikëqyrjes Doganore për Regjimin e Lejimit të Përkohshëm nuk ka mbajtur regjistra dhe nuk ka kryer kontrolle fizike të mallrave të vendosura në këtë regjim gjatë kësaj periudhe për të mbikëqyrur regjimet, në veçanti lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre.*

Doganierët mbikëqyrës të regjimeve nuk kanë zbatuar nenin 194 “Regjistrimet” të Kodit Doganor; nuk kanë zbatuar nenin 557 Regjistrimet (nenet 192, pika 1, dhe 194, pika 1, të Kodit) të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor dhe Udhëzimit nr. 146, date 07.05.2018 të DPD, “Rregullore e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e degëve doganore” nenin 4 “Mbajtja dhe përdorimi i regjistrave”, nenin 15 Sektori Zyra e Mbikëqyrjes Doganore të këtij udhëzimi. Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore të regjimit të lejimit të përkohshëm u konstatua se:

Për këto veprime janë përgjegjës doganierët e zyrës së mbikëqyrjes doganore të regjimit RLP në DDT: z. A M, znj. S P, znj. S S, znj. T L, znj. S C, znj. A M, znj. E N, znj. L A, znj. R R, z. D A dhe përgjegjësi i zyrës z. V I.

Procedurat e mbikëqyrjes së operatorëve që veprojnë në regjimin e RLP-së nga Zyra e Mbikëqyrjes se këtij regjimi janë në kundërshtim me nenet 10, pika 2 “Përgjegjësitë e autoriteteve doganore”, nenin 194 “Mbyllja e regjimeve të posaçme” të Kodit Doganor. Në kundërshtim me Udhëzimit nr. 146, datë 07.05.2018 të DPD, “Rregullore e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e degëve doganore”. Neni 4 “Mbajtja dhe përdorimi i regjistrave”, Neni 15 “Sektori Zyra e Mbikëqyrjes Doganore”, Kompetencat e përgjegjësit të zyrës dhe përgjegjësitë kryesore të doganierit mbikëqyrës, ku citohet:

Kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në lidhje me aplikimet, regjimet, akcizën, përjashtimet, klasifikimin, origjinën, vlerësimin doganor dhe kontrollin fizik të mallrave, mjeteve të transportit dhe të udhëtarëve; Zbaton urdhëra dhe udhëzime dhe kryen kontrolle mbi

bazën e informacioneve dhe analizës së rriskut; Zbaton planin e punës, grafikët e shërbimit, regjistron në sistem dhe në regjistrat e duhur dhe të sekretuar të gjitha të dhënat dhe informacionet e duhura dhe të sakta sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën doganore.

Trajtime observacione

Lidhur me akt konstatimin nr. 9, datë 31.05.2023, nga ana e DDT është dërguar observacioni me shkresën nr. 10738/21 prot datë 07.06.2024 nga përfaqësuesit e subjektit z. V I, znj. S C, znj. S S, znj. A M, znj. S P, znj. T L, znj. E N, znj. R R protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1113/3 datë 12.06.2024.

Pretendimi i subjektit:

Subjekti 'R' SHPK me NUIS L.....G, për Autorizimin P20211223/6951, me afat 365 ditë, deri më 23.12.2022, subjekti ka bërë kërkesë për shtyrje afati me Nr DPD-2022-00016857 datë 16.12.2022, afati i shtyrjes ka qenë deri më 15.11.2023. Subjekti ka bërë exportin e fundit R 30731 datë 01.04.2023. Bashkëlidhur keni dhe dokumentin e shtyrjes së afatit gjithashtu dhe Autorizimin e RLP. Subjekti 'GI' PF me NUIS M.....U, për Autorizimin P20231115/26719, me afat 5 ditë, deri më 20.11.2023, subjekti ka bërë kërkesë për shtyrje afati me Nr DPD-2023-00027232 datë 24.11.2023, afati i shtyrjes ka qenë deri më 15.12.2023. Subjekti ka bërë Exportin e fundit R 129643 datë 06.12.2023. Bashkëlidhur keni dhe dokumentin e shtyrjes së afatit gjithashtu dhe Autorizimin e RLP. Subjekti "S E" Degë e Shoqërisë, me NUIS K.....K, për Regjimin e Lejimit të Përkohshëm me Përrjashtim të pjesshëm Nr. L20220810/12985/1 ka kryer import DAV me nr. 84104 dt 15.08.2022 dhe eksport DAV me nr. 120991 dt. 21.11.2022; autorizimi rezultoi me shtyrje afati nr. 00015710 dt. 10.11.2022 deri 10/12/2022. Bashkëlidhur gjeni shtyrjen e afatit dhe autorizimin e RLP.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i sjellë nga subjekti me faktet dhe provat bashkëlidhur, në lidhje me mosverifikimin dhe mos sanksionimin e shkeljes së afatit të RLP, për këto tre raste, merret në konsideratë dhe reflektohet në projekt raport dhe reflektohet në shumën 150,000 lekë për tre raste.

2.3.2 Magazinat Doganore.

Gjatë periudhës 2022-2023 nën mbikëqyrjen e Degës së Doganës Tiranë kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre 48 magazina doganore, nga të cilat 12 të Tipit (A) dhe 36 të Tipit (C). Nën një regjim magazinimi, mallrat joshqiptare mund të magazinohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pa iu nënshtuar: a) detyrimeve të importit; b) pagesave të tjera të parashikuara në dispozitat e tjera përkatëse në fuqi; c) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 210.1 të Kodit Doganor. Nën regjimin e magazinimit doganor, mallrat joshqiptare mund të magazinohen në ambiente ose vende të tjera të autorizuara nga autoritetet doganore për këtë regjim dhe janë objekt i mbikëqyrjes doganore ("magazinat doganore"), sipas nenit 213.1 të Kodit Doganor. "Mbikëqyrje doganore" është veprimi i ndërmarrë në përgjithësi nga autoritetet doganore për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor dhe, kur është e nevojshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen këtij veprimi, sipas nenit 6 të Kodit Doganor. Tabela nr. 8- Tabela përmbledhëse e operatorëve ekonomikë nën regjimin e magazinimit doganor 2022-2023

Nr.	Operatori ekonomik	Nipt	Tipi i magazinës	Autorizimi
1	C	K.....B	A19	AL 14438/3 DT.18.09.2013
2	N	K.....B	A21	AL.12412/3/2849/1 DT.05.12.2014
3	M	L.....B	A22	AL 14784/1/1583/1 DT.29.01.2015
4	M	K.....U	A25	AL.12832/3/3166/1 DT.15.02.2017
5	M D	J.....N	A31	AL.9004/2 DT.04.09.2018
6	S N	K.....M	A35	AL 10685 DT.29.07.2019
7	U T	K.....V	A36	AL 241/1 DT.27.01.2021
8	D	K.....U	A37	AL.226/1 DT.22.01.2020
9	E	J.....L	A42	AL 4265/3 DT.02.206.2022
10	P Sh	J.....N	A44	AL.9998/1 DT.30.05.2022
11	T D	L.....I	A45	AL 12290/1 DT 04.07.2022
12	GT	J.....B	A53	AL 18752/2 DT.19.04.2023
13	AS	J.....G	C09	AL 23053/2 DT.03.03.2022
14	P	K.....P	C10	AL.4310/11829 DT.16.10.2006
15	KS	L.....A	C100	AL 5955/1 DT.29.03.2022
16	Ex	L.....Q	C104	AL 2238/1 DT.16.02.2023
17	Zo	L.....E	C107	AL 8085/1 DT.23.05.2023
18	I D	K.....E	C109	AL 8916/2 DT.07.06.2022
19	V H	L.....Q	C110	AL.21028/2 DT.11.12.2023
20	A S P	L.....N	C115	AL 17121/2 DT.06.02.2023
21	E G S	L.....G	C116	AL 17901/2 DT.22.02.2023
22	S G	K.....L	C117	AL19928/2 DT.20.04.2023
23	Sh	J.....V	C118 (A56)	AL.19345/2 DT.24.04.2023
24	B	K.....T	C120	AL22860/2 DT.27.07.2023
25	A E	L.....Q	C124	AL.22669/2 DT.03.11.2023
26	A M	K.....I	C17	AL 3339 DT.14.04.2009
27	Z	K.....M	C21	AL 9709/2725 DT.13.03.2007
28	H	K.....M	C22	AL 4021/4517 DT.30.04.2007
29	F F	J.....C	C25	AL 3052/13187 DT.17.06.2007
30	SHI	K.....R	C38	AL 12826/2 DT.18.08.2020
31	BT	K.....P	C40	AL.7281/853 DT.22.01.2010
32	ME	K.....Q	C42	AL 9172/2353 DT01.03.2010
33	Au	K.....H	C44	AL 13020/8443 DT.29.06.2010
34	R F	J.....U	C47	AL 5097 DT.30.09.2010
35	E	K.....N	C51	AL.14914/10337/1 DT.15.06.2011
36	P	J.....A	C57	AL 17366/27503/1 DT.15.05.2012
37	Te	L.....J	C61	AL 13778/3/6691/1 DT.22.04.2013
38	Av	K.....A	C65	AL 2633/2/16192/1 DT.01.10.2013
39	EV	J.....L	C69	AL 16193/2/11249 DT.12.05.2014
40	F	K.....M	C78	AL 9716/2 DT.03.07.2020
41	Agr	J.....D	C79	AL.18958/1 DT.26.10.2020
42	A	K.....D	C80	AL.13671/1/30212/1 dt.28.12.2016
43	Gl	L.....G	C81	AL 16560/1/1308/1 DT.01.02.2017
44	Eu	K.....E	C82	AL 26310/1 DT.13.12.2018
45	Ar	J.....U	C85	AL 2577/4 DT.11.03.2019
46	AL	J.....N	C95	AL 1955/4 DT.19.04.2019

47	Fo	L.....E	C97	AL 13558/1 DT.27.07.2020
48	Al	L.....Q	C99	AL 21689/1 DT.31.12.2021

Burimi: Zyra e Mbikqyrjes së Regjimit të Magazinimit Doganor, DDT, përnuar nga grupi i auditimit të KLSH

Për auditimin e procedurave të ndjekura nga doganierët mbikëqyrës së këtij regjimi pranë Degës së Doganës Tiranë në zbatim të Kodit Doganor nenet 192-202 dhe nenet 210-215, VKM nr. 651 datë 10.11.2017, Kreu 3 “Magazinimi doganor” nenet 631-633, Urdhërit Nr.146 (7786/1), datë 07.05.2018: “Rregullore e brendshme e degëve doganore”; Udhëzimit nr. 7 datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” u përzgjedhën dosjet e mbajtura nga doganierët mbikëqyrës së këtij regjimi, dokumentacioni i dorëzuar prej operatorëve ekonomik, të dhëna nga sistemi Asyccuda për nëntë (19%) operatorë që kanë operuar të pajisur me Autorizim për Regjimin e Magazinimit Doganor. Gjatë auditimit u shqyrtuan dokumentacioni dhe procedurat e ndjekura për: shqyrtimin dhe miratimin e aplikimit për të përfituar autorizim për funksionimin e ambienteve të magazinimit doganor, mbikëqyrjen e autorizimeve, mbikëqyrjen e regjimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikëqyrës, kontrollet dokumentare dhe fizike të ushtruara, shkeljet dhe kundravajtjet doganore të zbuluara së bashku me penalitetet përkatëse që janë vënë gjatë kontrolleve të ushtruara. Nga auditimi u konstatua:

1. Magazina doganore C95, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C95, shoqëria “A” SHPK me NUIS J.....N.

Në dosjen e vënë në dispozicion u paraqitën: kopje të autorizimit e garancitë e afatet e vlefshmërisë së tyre, për vitin 2023 katër kontrolle të kryera, deklarimi i gjendjes së stokut cdo muaj të këtij viti, për vitin 2022 dy kontrolle të kryera, gjendja e stokut deklaruar cdo muaj të këtij viti.

Konstatohet: Dosja e painventarizuar, Procesverbalet e kontrolleve të ushtruara nuk janë protokolluar, nuk u janë bashkeëlidhur fletë nga regjistri i magazinës e kopjet e deklaratave doganore, kontrollet për vitin 2022 janë kryer cdo tre muaj. Veprime në kundërshtim me pikën VII “Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikëqyrës” të Udhëzimit nr. 07, datë 27.03.2019 “Mbi Zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” të DPD-së. Përgjegjës doganier mbikëqyrës znj. S S.

2. Magazina doganore C97, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C97, shoqëria “F” SHPK me NUIS L.....E.

Në dosjen e vënë në dispozicion u paraqitën: kopje të autorizimit e garancitë e afatet e vlefshmërisë së tyre, për vitin 2023 katër kontrolle të kryera, deklarimi i gjendjes së stokut cdo muaj të këtij viti, për vitin 2022 kontrolle të kryera, gjendja e stokut deklaruar cdo muaj të këtij viti. Konstatohet: Dosja e painventarizuar, Procesverbalet e kontrolleve të ushtruara nuk janë protokolluar, janë firmosur vetëm nga një doganiere mbikëqyrëse, nuk u janë bashkëlidhur fletë nga regjistri i magazinës e kopjet e deklaratave doganore, kontrollet për vitin 2022 janë kryer cdo tre muaj. Veprime në kundërshtim me pikën VII “Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikëqyrës” të Udhëzimit nr. 07, datë 27.03.2019 “Mbi Zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” të DPD-së. Përgjegjës doganier mbikëqyrës znj. T L.

3. Magazina doganore C57, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C57, shoqëria “Ps” SHPK me NUIS J.....A.

Në dosjen e vënë në dispozicion u paraqitën: kopje të autorizimit e garancitë e afatet e vlefshmërisë së tyre, për vitin 2023 katër kontrolle të kryera, deklarami i gjendjes së stokut cdo muaj të këtij viti, për vitin 2022 kontrolle të kryera, Proces verbal kontrolli për magazinim doganor datë 04.04.2022 shoqëruar me fletë inventarin e produkteve; pa numër protokolli, firmosur vetem nga një doganiere kontrollit, pa firmë subjekti, gjendja e stokut deklaruar cdo muaj të këtij viti. Konstatohet: Dosja e painventarizuar, Procesverbalet e kontrolleve të ushtruara nuk janë protokolluar, janë firmosur vetëm nga një doganiere mbikqyrëse, nuk u janë bashkelidhur fletë nga regjistri i magazinës e kopjet e deklaratave doganore, kontrollet për vitin 2022 janë kryer cdo tre muaj. Veprime në kundërshtim me pikën VII. Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikqyrës të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 “Mbi Zbatimin praktik të rregjimit të magazinimit doganor” të DPD-së. Përgjegjës doganier mbikqyrës znj. T L.

4. Magazinë Doganore e pajisur me regjim gjatë vitit 2023. Magazina doganore C118, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C118, shoqëria “Sh” SHPK me NUIS J.....V.

Në dosjen e vënë në dispozicion u paraqitën: Kopje autorizimi nr.19345/2prot., datë 24.04.2023 periudha kohore e vlefshmërisë 12 muaj; Shtesë autorizimi nr.7133prot., datë 26.04.2023, në pikën 11 të autorizimit – zyrat doganore të vendosjes nën regjim shtohet zura doganore e vendosjes nën regjim zyra doganore Durrës, me ndryshim nr.15481/1, datë 03.10.2023 në autorizim për ndryshimin e statusit nga Magazinë Doganore Tipi C, private C118 administruar nga kjo shoqëri bëhet Magazinë Doganore Publike Tip I, për efekt identifikimi dhe monitorimi kodi magazinës doganore nga C118 bëhet A56. Kopje të garancive e afatet e vlefshmërisë së tyre; Proces verbal kontrolli për magazinim doganor datë 20.12.2023 shoqëruar me deklarami gjendje në magazinë nga operatori datë 20.12.2023; pa numër protokolli. Proces verbal kontrolli për magazinim doganor datë 02.10.2023 shoqëruar me gjendjen e magazinës datë 02.10.2023 numrin e deklaratave import llojin, sasinë, kodin tarifor të artikullit; pa numër prot. Nuk është poroces verbali përfundimtar i kontrollit ku të jenë të përfshira konkluzionet e kontrollit kontabël e material. Gjendja e stokut në magazinë datë 30.11.2023(nr.10259prot., datë 06.12.2023); datë 31.10.2023(nr.9467prot., datë 07.11.2023); datë 30.09.2023(nr.8496prot., datë 05.10.2023); datë 31.08.2023(nr.7642prot., datë 06.09.2023); datë 31.07.2023(nr.6834prot., datë 04.08.2023); datë 30.06.2023(nr.5852prot., datë 05.07.2023); datë 30.04.2023(nr.3930prot., datë 05.05.2023); Plan kontrolli për verifikimin e plotësimit të kriterëve të parashikuara për përfitimin e autorizimit të magazinës doganore së bashku me dokumentacionin bashkelidhur aplikimit. Konstatohet: Dosje të painventarizuar, Procesverbalet e kontrolleve të ushtruara nuk janë protokolluar, nuk u janë bashkelidhur fletë nga regjistri i magazinës e kopjet e deklaratave doganore. Konstatohet se Autorizimi për një periudhë një vjecare nuk është mbikqyrur rreptësisht nga dega doganore, në kundërshtim me pika V.1 e udhëzimit. Nr.07, datë 27.03.2019 Magazinimi Doganor: Autorizimi për një periudhë një vjecare mbikqyret rreptësisht nga dega doganore e vendosjes nën rregjim për të parë nëse përmbushen detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim si dhe justifikimin ekonomik të këtij rregjimi. Përgjegjës doganier mbikqyrës znj. E N.

5. Magazina doganore C78, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C78, shoqëria “FM” SHPK me NUIS K.....M.

Në dosjen e vënë në dispozicion u paraqitën: kopje të autorizimit e garancitë e afatet e vlefshmërisë së tyre, për vitin 2023 katër kontrolle të kryera Proces verbalet janë firmosur me një firmë nga një doganiere kontrolli, deklarami i gjendjes së stokut cdo muaj të këtij viti, për vitin 2022 kontrollet të kryera, Proces verbali kontrollit i datës 28.03.2022 i

firmosur vetëm nga një doganiere kontrolli, gjendja e stokut deklaruar cdo muaj të këtij viti. Konstatohet: Dosja e painventarizuar, Procesverbalet e kontrolleve të ushtruara nuk janë protokolluar nuk u janë bashkelidhur fletë nga regjistri i magazinës e kopjet e deklaratave doganore, kontrollet për vitin 2022 janë kryer cdo tre muaj. Nga doganierët mbikqyrës janë kryer veprime në kundërshtim me pikën VII. Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikqyrës të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 “Mbi Zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” të DPD-së.

- Konstatohet se në proces verbalin e kontrolit date 28.03.2022 gjendja e stokut datë 05.07.2022 ka artikuj të kodit 9032 pra artikuj, mallra që janë vendosur nën regjimin doganor jo në përputhje me pikën 7 të autorizimit kodi NK, Përshkrimi. Konstatohet se: Nga ana e subjektit janë kryer veprime në kundërshtim me detyrimet e neneve 28, 215 të Kodit Doganor:

Neni 28 Mbikëqyrja e vendimeve të favorshme të marra në bazë të aplikimeve 1. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga ky vendim. 2. Pasi vendimi është marrë, personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, informon autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor të krijuar, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e vendimit.

Neni 215 Përgjegjësitë e mbajtësit të autorizimit ose të regjimit 1. Mbajtësi i autorizimit dhe mbajtësi i regjimit janë përgjegjës: a) për të siguruar që mallrat nën regjimin e magazinimit doganor të mos nxirren/të dalin nga mbikëqyrja doganore; b) për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i mallrave të mbuluara nga regjimi i magazinimit doganor. 2. Duke anashkaluar pikën 1, kur autorizimi ka të bëjë me një magazinë doganore publike, në autorizim mund të parashikohet që përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjën “a” ose “b”, të pikës 1, t’i kalojnë ekskluzivisht mbajtësit të regjimit. 3. Mbajtësi i regjimit është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga vendosja e mallrave nën regjimin e magazinimit doganor.

Veprime në kundërshtim me pikën V.3 të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 të DPD -së “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor”: për cdo ndryshim në autorizim emri i shoqërisë, kapacitetet, artikujt/mallrat pika 7 e autorizimit, ndiqet e njëjta procedurë sikur të ishte autorizimi i ri.

Subjekti nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i mallrave, kushteve të autorizimit, ka kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 252 shkronja g) të Kodit Doganor dhe nuk është penalizuar me 50,000 Lekë sipas nenit 257/1/b të Kodit Doganor. Neni 252 Kundërvajtje të kryera në neglizhencë Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: g) mosrespektimi nga mbajtësi i autorizimit apo mbajtësi i një regjimi i detyrimeve që rrjedhin nga magazinimi i mallrave që mbulohen nga regjimi i magazinimit doganor, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 215.

Neni 257 Sanksionet për kundërvajtjet e kryera në neglizhencë 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

Për mos verifikimin e shkeljes mos sanksionimin e saj me 50.000 lekë sipas neneve 252 shkronja g) dhe 257/1/b të Kodit Doganor ka të ardhur të munguar në shumën 50,000 lekë. Në këtë rast janë përgjegjës doganierët mbikqyrës znj. T L, znj. S P.

6. Magazinë doganore e pajisur me autorizim në vitin 2023. Magazina doganore C117, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C85, shoqëria “S G” SHPK me NUIS K.....L.

Në dosjen e vënë në dispozicion u paraqitën: Kopje autorizimi Nr.19928/2, datë 20.04.2023 periudha kohore e vlefshmërisë 12 muaj; Plan kontrolli për verifikimin e plotësimit të kriterëve të parashikuara për përfitimin e autorizimit të Magazinës Doganore (urdhër nr.3381prot., datë 14.04.2023 i DDT në zbatim të kërkesës së DPD për mendim për ndjekjen e procedurës së përfitimit të një magazine doganore shoqëruar me dokumentacionin për magazinën doganore);

- Dërgim opinion në lidhje me plotësimin e kushteve teknike të operatorit për pajisjen me autorizim për Magazinë Doganore, nr.3381prot., datë 20.04.2023 shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe aneksin 3 plotësimi i kushteve dhe opinion i degës doganore. Garancitë e afatet e vlefshmërisë së tyre. Konstatohet: Dosja e painventarizuar, Procesverbalet e kontrolleve të ushtruara nuk janë protokolluar Proces verbal kontrolli për magazinim doganor datë 11.09.2023, datë 06.06.2023 shoqëruar me fletë inventarin e produkteve. Gjëndja e stokut në magazinë datë 31.05.2023(nr.5736prot., datë 03.07.2023), datë 30.06.2023 (nr.5737prot., datë 03.07.2023), datë 31.07.2023(nr.6649prot., datë 01.08.2023), datë 31.08.2023(nr.7502prot., datë 31.09.2023), datë 30.09.2023(nr.8361prot., datë 02.10.2023), datë 31.10.2023(nr.9318prot., datë 02.11.2023), datë 30.11.2023(nr.10114prot., datë 04.12.2023), datë 31.12.2023(nr.39prot., datë 04.01.2023), shoqëruar me deklarinimin e hyrje – daljeve sipas anekseve 5 dhe 5/1 të udhëzimit;

Nga auditimi konstatohet: -Dosja nuk është e inventarizuar. Proces verbalet e kontrolleve doganore nuk janë të protokolluara, nuk kanë bashkëngjitur dokumentacionin e vënë në dispozicion për kryerjen e kontrollit, kopje të deklaratave doganore; Kontrollat fizike për vitin 2023 janë kryer cdo tre muaj. Proces verbal kontrolli për magazinim doganor muajt qershor, shtator 2023 shoqëruar nga plan kontrolli- urdhëri i Kryetarit të Doganës dhe inventari i produkteve. Veprime në kundërshtim me pikën VII. Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikqyrës të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 “Mbi Zbatimin praktik të rregjimit të magazinimit doganor” të DPD-së. -Mangësi kryerjen e procedurave sipas pika VI/2 të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 – mbikqyrja e autorizimit. Autorizimi për një periudhë një vjecare mbikqyret rreptësisht nga dega doganore sipas pikës V.1 e udhëzimit. Mangësi në plotësimin e të gjithë rubrikave të proces verbal kontrollit dhe dokumentave bashkëngjitur tij – kopje të deklaratave doganore dhe regjistrit të magazinës.

- Mangësi në procedurën e dokumentacionin bashkëngjitur dhënies së opinionit për plotësimin e kushteve të operatorit për pajisjen me autorizim- sipas pikës III/4 të udhëzimit; mos plotësim në Aneksi 3 – verifikimin e kushteve për ambiente pune për doganën, kuadrati - përshtatshmëria e ambientit për të ruajtur mallra, kuadrati- ekzistencës së mundësisë për regjime të posacme brenda ambienteve të magazinimit. Dokumentacioni për dhënien e mendimit nuk është plotësuar në të gjithë rubrikat e tij për verifikimin e kushteve përshtatshmërinë e ambjentëve, aneksi 3 dhe nuk është shoqëruar me aneksin 4. Mosplotësim i aneksit 7 nga mbikqyrja doganore i ndryshimit të pronësisë së mallit të vendosur në magazinën doganore. Nga doganierët e mbikqyrjes doganore këto veprime janë në kundërshtim me pikën III/4 të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 të DPD-së që parashikon procedurën që ndiqet nga zyra doganore e vendosjes nën regjim e vizita në ambientet e planifikuara për magazinim doganor e që konsiston në verifikimin dhe plotësimin e të gjitha kërkesave që janë paraqitur në urdhër dhe me mbarimin e vizitës aneksi nr.3 firmoset dhe i përcillet kryetarit të degës doganore.

Nga ana e subjektit kemi veprime në kundërshtim me detyrimet e neneve 28, 215 të Kodit Doganor. Subjekti nuk është penalizuar me 50,000 lekë sipas neneve 252 shkronja g) dhe 257/1/b të Kodit Doganor.

Dega doganore nuk ka vepruar për këtë rast sipas pikës III.5 të udhëzimit për problematika që çenojnë funksionimin korrekt të rregjimit dhe mbikqyrjen e tij dhe subjekti nuk është

penalizuar me 50,000 Lekë për këtë kundërvajtje sipas neneve 252/g dhe 257/1b të Kodit Doganor. Kemi të ardhur të munguar në shumën 50,000 Lekë. Përgjegjës doganier mbikqyrës znj. T L.

7. Magazina doganore C85, tipi magazinë doganore private, numri identifikues i magazinës C85, shoqëria "A" SHPK me NUIS J.....U.

- Sistemi elektronik ORACLE i të dhënave për deklaratat doganore Import 4 (IM4) të përpunuara në DDD në bazë të përzgjedhjes si kriter vlerësimi: vlerat më të larta; mallrat që importohen më shpesh dhe me ndikim në të ardhurat; mallrat që kuotohen në bursë; mallrat e trajtuar me origjinë preferenciale; artikujt e importuar nga NEU (kryesisht Kina); mallrat e përdorur; praktika doganore; auditimin e metodave të vlerësimit doganor nisur nga vlera e lëndëve të para të futura ose të trupëzuara në produktin përfundimtar; deklarime mallrash në praktika doganore për të cilat mund të paguhet taksë doganore akcize, taksë kombëtare TAM (takse ambalazhi), mallrat e zhdoganuar nga magazina doganore të hedhur për qarkullim të lirë, mallra të deklaruar në praktika doganore me origjinë MSABE të cilat duhet të paguajnë tarifë bazë, deklarime në praktika doganore në të cilat janë kryer klasifikime të gabuara tariforë, praktika doganore në të cilat nuk është respektuar kushti material në faturat shoqëruese të mallit i përfitimit të mos pagesës së tarifës bazë të NM, duke synuar që të mbulohej e gjithë periudha e programuar, pa krijuar mbivendosje me strukturat e tjera kontrolluese;
- Dokumentacioni tregtar elektronik i praktikave doganore me artikuj të njëjtë nga e njëjta origjinë deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme, të përpunuara në këtë degë doganore, për të cilët nga SVQ apo SKAO nuk është ndjekur i njëjti kriter apo standard vlerësimi, të cilat janë përzgjedhur dhe vlerësuar me risk.
- Sistemi elektronik ORACLE i të dhënave për deklaratat doganore IM4 të përpunuara në DDD ku si kriter vlerësimi u përzgjedhën praktikatat doganore ku: mallrat janë lëvruar në inkotermin FOB & EXW; vlerat të deklaruar dhe transaktuara; mallrat e importuar nga NEU;
- Dosjet e subjekteve të cilët operojnë me transaksion pranë kësaj dege doganore, si dhe Dosje të subjekteve për të cilat ka verifikime doganore nga Autoritetet Doganore Homologe dhe Vendime Gjyqësore të formës së prerë për artikuj identik me periudhën për të cilën u krye auditimi.

Per vitin 2022 rezultojne nr praktikash doganore sipas procedurave import dhe eksport si me poshte vijon

Lloji	EXPORT	IMPORT	IND	Total
1	94,196			94,196
2	3,388			3,388
3	84,900			84,900
4		339,812	404	340,216
5		61,119		61,119
6		6,744		6,744
7		24,301		24,301
9		4,673		4,673
Total	182,484	436,649	404	619,537

Burimi “Drejtoria e Pergjithshme e Doganave”

Per vitin 2023 rezultojne nr. praktikash doganore sipas procedurave import dhe eksport si me poshte vijon

Lloji	EX	IM	IND	TOTALI
1	96,862			96,862

2	3,501			3,501
3	83,305			83,305
4		387,689	305	387,994
5		57,542		57,542
6		6,389		6,389
7		27,277		27,277
9		5,109		5,109
Total	183,668	484,006	305	667,979

Burimi “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”

Shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, gjatë procedurave të zhdoganimit të cilat janë vlerësuar me risk u krye në bazë të metodave të ekzaminimit të kryqëzuar, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, shqyrtimit të të dhënave të internetit nëpërmjet kodit dhe përshkrimit të artikullit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese, krahasimi me dokumentat bazë dhe ekzaminimi analitik (*auditimi ivërtetësisë, rakordimet, krahasimet*),

1-procedura të vlerësimit doganor të mallrave.

2-procedura klasifikimit tarifor të mallrave.

3-procedura të deklarimeve për pagesën e taksave kombëtare të ambalazhit TAM,

4-procedura të deklarimeve për pagesën e detyrimeve doganore të akcizës .

5-procedura të deklarimeve për cilat nuk përmbushet kushti preferencial MSABE,

6-procedura të deklarimeve për rilogaritje detyrimesh doganore të shpenzimeve të transportit,

7-procedura të deklarimeve për të tjera detyrime doganore.

Gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni tregtar me fusha risku për kapituj të Nomenklaturës së Mallrave lidhur me procedurat e vlerësimit doganor në përputhje me legjislacionin e fushës, auditimi i procedurave doganore të klasifikimit tarifor të mallrave, auditimi i procedurave doganore në lidhje me përmbushjen e kushtit preferencial MSABE , auditimi i procedurave doganore në lidhje me detyrimet doganore të shpenzimeve të transportit , auditimi i procedurave doganore në lidhje me pagesën e taksave kombëtare TAM dhe të tjera, auditimi i pagesave të akcizës në përputhje me shtojcat dhe tabelat e publikura të njësive të pagesave të akcizës sipas ligjit nr 61 “Per Akcizat në RSH” , duke rakorduar me të dhënat elektronike të zhdoganimeve të kryera të siguruara nga sistemi elektronik Asycuda Ëord, me praktika doganore dhe dokumentacioni bashkelidhur tyre të administruara pranë sistemit Asicuda Ëord. U auditua veprimtaria e kryer nga personeli përpunues doganor për përputhshmërinë e veprimeve të kryera në lidhje me përcaktimet ligjore të shprehura në legjislacionin doganor lidhur me vlerësimin doganor të mallrave referuar Ligjeve të fushës dhe Udhezimit të Ministrit të Financave Gjate auditimi u konstatuan gjetje dhe konstatime në referim të nenit

Nenit 67, pika 1, gërma “d/i”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

1. Në përcaktimin e vlerës së transaksionit sipas nenit 66, çmimit realisht të paguar ose për t’upaguar për mallrat e importuara i duhen shtuar:

d) kostot e mëposhtme, deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si

Referuar nenit 171, pika 2, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

Për qëllime të pikës 1, kur një deklaratë doganore mbulon dy ose më shumë artikuj, të dhënat për secilin artikull konsiderohen sikur përbëjnë deklaratat e veçanta doganore.

Referuar nenit 70, pika 2, shkronja “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

*Vlera doganore, sipas pikës 1, është:
vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;
vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen*

Referuar nenit 70, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i m e Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

*Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1, të këtij neni, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
Referuar pikës 7, të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, në të përcaktohet qartë që:
Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor Indikatorët që mund të evidentojnë një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, mund të jenë:*

-Ekziston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimeve të Database-it Kombëtar të Vlerësimit apo të të dhënave të disponueshme për artikujt që përditësohen nga bursat apo agjenci ndërkombëtare.

-Ka çmime të ndryshme të deklaruar për të njëjtin produkt, nga furnizues/origjina të njëjta/ngjashme.

-Vendi i origjinës/lëvrimit me risk: Azisë, Lindjes së Largët, vendeve arabe, zonave të lira (zona off- shore), Amerika Latine.

-Vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet/lëvrohet malli.

-Përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme.

-Përfshihen shitjet e njëpasnjëshme (zinxhir shitjesh).

-Ekziston një tregtar ose një kompani e tretë (agjenti blerës) i përfshirë në transaksione.

-Mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje të asistencës reciproke me vendin tonë ose nga ku është e vështirë për të marrë informacion.

-Vendi i ngarkimit nuk korrespondon me vendin e adresën e eksportuesit.

-Ekziston një ndryshim i dukshëm midis çmimit të deklaruar me çmimet nga publikime në tregje të ndryshme.

-Vlera e produktit nuk mund të jetë më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar.

Referuar pikës 10, shkronja “h” të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, në të përcaktohet qartë që:

Kur importohen mallra të përdorura dhe transaksioni i paraqitur nuk justifikon gjendjen e tyre, nga dega doganore apo strukturat e posaçme, ngrihet “grup vlerësimi”, që merr në konsideratë sipas rasti, vitin e prodhimit, shkallën e amortizimit, gjendjen reale të tyre etj., por jo më pak se 40% të vlerës të mallit të ri

Referuar Urdhërit nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD “Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, në të përcaktohet qartë që:

Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.

Për kryerjen e auditimit u përdorën teknika të ndryshme të ekzaminimeve nëpërmjet raporteve të përpunuara në sistemin ORACLE, si dhe Asycuda WORLD. Nga auditimi u konstatua që është pranuar transaksioni dhe për raste kur vlerat e artikujve kanë qenë nën referencë, por dokumentacioni bashkëngjitur praktikave doganore nuk justifikonte metodën e përdorur. U konstatua që është bërë ndërhyrje duke mos e pranuar transaksionin por masa e ndërhyrjes nuk ka qenë në nivelet e operatorëve të tjerë për të njëjtin artikull

nga e njëjta origjinë. Gjatë auditimit janë përdorur metodat e ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet).

Nga auditimi i kryer ne ***Degen Doganore Tiranë*** rezultojnë rivlerësime mallrash për deklarime doganore për të cilat dokumentacioni justifikues nuk përmbush kriteret e trajtimit të këtyre deklarimeve sipas deklarimit të transaksionit dhe për të cilat nga administrata doganore duhej të ishin marrë në konsideratë aplikimi i metodave të tjera alternative të vlerësimit doganor me impakt negativ në të ardhurat doganore dhe të ardhurat në Buxhetin e Shtetit.

Më konkretisht

Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimindoganor të mallrave, përpunuar nga sektori i vlerës pranë DDD, Sektorit të Vlerësimit Doganor në Qendër -SVQ dhe sektorit të kontrollit aposterior operativ SKAO, pranë DPD.

Nga auditimi me përzgjedhje dhe me risk i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me procedurat e kryera nga personeli përpunues doganor në lidhje me vlerësimindoganor të mallrave, përpunuar nga sektori i vlerës pranë DDD, Sektorit të Vlerësimit Doganor në Qendër -SVQ dhe sektorit të kontrollit aposterior operativ SKAO, pranë DPD gjatë procesit të vlerësimit të sistemit të vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor të mallrave të kryera nga Autoriteti Doganor Durrës për periudhën nën juridiksion auditimi rezultuan gjetje dhe konstatime

sa më poshtë vijon :

Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar pranë Degës Doganore Durrës për vitin 2021 sipas Kapitujve nga 1-97 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 **Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë** dhe shpjegimeve, janë evidentuar trajtime dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Sesionit të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 *“Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”*. Konkretisht trajtime jo të bazuara sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 4.2 sipas metodës 2 shprehur sipas *“Vleres se transaksionit e mallrave identike”* dhe pikën 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të *“Dhënat e Disponueshme ne RSH”* dhe pikës 5 *“Rregullimet”* dhe pikës 6 *“Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vleren doganore”* sipas shpjegimeve të pikës 6/b/c/d dhe pikës 7 *“Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor”* sipas indikatorëve bazuar në çmime të ndryshme të deklaruar për të njëjtin produkt nga furnizues ose origjina të ngjashme, zona ofshore, përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme, mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje reciproke me Autoritet Doganore Shqiptare, pagesat nuk bëhen direkt me furnizuesin; si dhe sipas pikës 8 *“Dokumentacioni Shtese”* sipas pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f dhe pikës 11 *“Përdorimi i Databasit të Vlerësimit”* bazuar në pikën 10/c.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave doganore IM4, kryesisht me origjinë NEU, por edhe EU për mallra të deklaruar, çmimi për njësi i të cilave rezulton dukshëm më i ulët krahasuar me çmimin: e mallrave të njëjtë apo identik të importuar të deklaruar dhe transaktuar; e publikuar në tregje; të publikuar në bursë; si dhe të dhënat e miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të publikuara në faqen zyrtare të DPD, rezulton se nga ana e sektorit operacional pranë degeve doganore, Sektorit të Vlerësimit Doganor në Qendër (SQV), si dhe nga ana e sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), për importet e mallrave nga disa subjekte, pranimi i transaksionit nuk ka qënë i justifikuar pasi referuar *“Indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të*

Ministrit te të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afate publikimit me të dhënat e disponueshme...”, ndryshuar me pikën 7 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*”, me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, nuk është bërë një **analizë** e thelluar, sepse:

së pari, “*Vlerat e mallrave identike apo të ngjashme të pranuar me transaksionin në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit*”, ku nga verifikimi në sistemin **ORACLE**, rezulton se çmimi për të njëjtin artikull, nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues paraqitet i ndryshëm;

së dyti, “*Vlerat e mallrave te derguara zyrtarisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave si te dhena te disponueshrne etj*”, ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin **ORACLE**, krahasuar me çmimet e publikuara në faqen zyrtare të DPD dhe të miratuara nga komisioni Add-Hoc pranë Ministrisë së Financave, janë shumë të ulëta;

së treti, “*Vlera e produktit nuk mund te jete me e ulet se vlera e lendes se pare me te cilen eshte prodhuar*”, ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin **ORACLE**, në disa raste janë nën çmimin e lëndës së parë;

së katërti, “*Vendi i origjines me risk: Azise, Lindjes se Larget, Vendeve Arabe, Zonave te Lira (zona off-shore), Amerika Latine*”, ku nga verifikimi rezulton se janë trajtuar me transaksion mallrat e importuar nga këto vende, të cilat përcaktohen me rrisht të lartë me të cilat administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi;

së pesti, “*fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi, pra vend ii origjinës ndryshon nga vendiku lëvrohet malli*”, rezulton se nga verifikimi, transaksioni është kryer nga kompani me seli të ndryshme nga vendi i origjinës dhe dërgues i mallit;

së gjashti, “*Kontrata me firmën shitëse, përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme në vlerë*”, rezulton se, nga verifikimi, për importet **nuk rezulton** kontratë bashkëngjitur praktikave doganore me firmën shitëse;

së shtati, në asnjë rast nuk është bërë asnjë investigim lidhur me verifikimin e faturave të deklaruara apo verifikim aposterior nga grup i përbashkët lidhur me çmimin e produkteve në treg;

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me procedurat e kryera nga personeli përpunues doganor gjatë procesit të vlerësimit të sistemit të vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor të mallrave të kryera nga Autoriteti Doganor Tirane për periudhën nën juridiksion auditimi rezultoi:

♦. **Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruara në Kapitullin *02*** të Nomeklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ***Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*** dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*” që lidhen me vlerësimin doganor te mallrave ku ne vecanti u audituan transaksionet nga kompani me vende te lëvrimit te Marrëveshjes CEFTA. Konstatohet se bazuar ne marreveshjen preferenciale te zones CEFTA keto deklarime gezojne edhe reduktim te tarifes baze kur deklarohen nen kete kushtin preferencial dhe paraqesin risk te mundshem edhe hedhjen e mallrave në qarkullim të lirë me kosto më të ulëta se ato që duhej të rezultonin. Gjithashtu u moren ne konsiderate edhe opinione dhe fakte te te dhenave eeb per shitje malli me origjine malli jo te rregullta drejt territorit doganor te RSH. Trajtuar ne tabelat e anekseve bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe rastet e rivleresimeve të mallrave te Kapitullit 2 per mallra

te natyres “mish gjedhesh pa/kocka, me kocka, mish gjedhi tremiks, fileto pule, mish pule, kofshe derri ,kofshe/derri/kocke, mish koke pa kocke/derri, mish/gjedhi/muskul, mish/gjedhi/tremiks, mish/koke/gjedh/pa kocke, paste pule MDM, mish pule, shpatull derri etj” te trajtuara sipas disa vendeve dhe kompanive eksportuese te origjinave te ndryshme te perzgjedhura per shqyrtim.

Efekti financiar i perllogaritur ne praktikat doganore te mesiperme per deklarime te mallrave ne Kapitullin 02 te NM ne RSH te trajtuara ne tabelen anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit ne shumën 36,639,299 lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar ne Buxhetin e Shtetit.

◆. Ne lidhje me vleresimin doganor te mallrave te deklaruar ne Kapitullin *05* te Nomenklaturës së Mallrave ne RSH konstatohet se nga personeli perpunues doganor nuk është marrë ne konsideratë per trajtim vleresimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 te ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë* dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave te Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vleresimin e mallrave per qellime doganore” qe lidhen me vleresimin doganor te mallrave. Trajtuar ne tabelat e anekseve bashkelidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe rastet e rivleresimeve te mallrave te Kapitullit 2 per mallra te natyres te natyres te brendshme “stomak pule” te cilat duhet te ishin trajtuar me nivel vleresimi doganor prej 0.45 Euro/kg me efekte te ardhurash te munguara ne Buxhetin e Shtetit.

Efekti financiar i perllogaritur ne praktikat doganore te mesiperme per deklarime te mallrave ne Kapitullin 05 te NM ne RSH te trajtuara ne tabelen tabelen anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit ne shumën 68,592 lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar ne Buxhetin e Shtetit.

◆. Ne lidhje me vleresimin doganor te mallrave te deklaruar ne Kapitullin *24* te Nomenklaturës së Mallrave ne RSH konstatohet se nga personeli perpunues doganor nuk është marrë ne konsideratë per trajtim vleresimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 te ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë* dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave te Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vleresimin e mallrave per qellime doganore” qe lidhen me vleresimin doganor te mallrave. Trajtuar ne anekset bashkelidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë ne konsideratë per caktimi ligjor i mesiperme per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 24 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH per mallra (cigare) te deklaruar me nivel vleresimi doganor prej 11.2 Euro/1000 fije nderkohe qe duhet te ishin vleresuar me vleren e mallit identik te hyre ne RSH ne niveli 19 Euro/1000 fije me efekte te ardhurash ne Buxhetin e Shtetit.

Efekti financiar i perllogaritur ne praktikat doganore te mesiperme per deklarime te mallrave ne Kapitullin 24 te NM ne RSH te trajtuara ne tabelen tabelen anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit ne shumën 3,591,382 lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar ne Buxhetin e Shtetit.

◆. Ne lidhje me vleresimin doganor te mallrave te deklaruar ne Kapitullin *08* te Nomenklaturës së Mallrave ne RSH konstatohet se nga personeli perpunues doganor nuk është marrë ne konsideratë per trajtim vleresimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 te ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë* dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave te Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vleresimin e mallrave per qellime doganore” qe lidhen me vleresimin doganor te mallrave. Trajtuar ne anekset bashkelidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë ne konsideratë per caktimi ligjor i mesiperme per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 8 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH te transaktuar me vlera me te uleta nderkohe qe duhet te ishin vleresuar me “vleren prej 2 usd/eu kg per origjine eu/neu, vleren 4.3 usd/eu/kg per origjine eu/neu , 1.4 usd/euro/kg kg per origjine eu/neu, dhe 1.8 usd/euro/kg

kg per origjine eu/neu” për mallra te natyres “arra ne guacke/paqeruar, hurma arabie, arre kokosi, pistake”

Ne lidhje observacionin e ardhur nga Dega Doganore Tirane per zhdoganimet e subjektit “F. M.” me nipt K.....E per artikullin “*fruta te thata, arra, hurma arabie, kikirike*” te importuara nga subjekti me nipt K.....E pretendohet se këto deklarime janë kryer ne zbatim korrekt te kodit doganor dhe faturat shoqëruese përmbajnë informacion te plote te detajuar me dokumentacion shtese si trasferta bankare, deklarata eksporti te cilat i jane vene ne dispozicion grupit auditues nga Dega Doganore Tirane duke paraqitur edhe deklarata doganore te importeve te kryera per vitin 2022 dhe 2023 te cilat kane bashkëlidhur gjithë dokumentacionin tregetar te nevojshëm por nga Dega Doganore Tirane nuk rezultojnë veprime verifikuese pranë selive te kompanive importuese te këtyre mallrave per te cilët pretenfohet se transaksioni i kryer eshte real, i sakte dhe ligjor. Subjekti ka paraqitur edhe faturat, pagesat bancare, deklarata nga eksportuesi. Dega Doganore Tirane në vijim të procedurave të mëtejshme, të vlerësojë për problematikën e cituar në këtë Raportit Përfundimtar te Auditimit, duke ndjekur dhe respektuar metodat dhe rradhën e procesit ligjor të vlerësimit doganor dhe përputhshmërinë me Udhëzimin nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*” dhe neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. si dhe nenet 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”. Gjithashtu konstatohet se për praktikat doganore nën juridiksion auditimi të rekomanduara për rrillogaritje detyrimi doganor në këtë Raportit Përfundimtar te Auditimit nga Autoriteti Doganor Tirane nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese për importe malli te ketij operatori, bazuar në Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore me Shqipërinë, pranë Autoriteteve Doganore Homologe me qëllim verifikimin e vërtetësisë se transaksionit te kryer nga shtete levruese te mallit si Moldavi dhe Ukraine duke garantuar borxhin doganor që mund të lindë deri në ardhjen e verifikimeve doganore. Rezulton e dërguar kërkesa per verifikim EUR1 sipas shkresës nr 4756 prot date 02.06.2024 e Deges Doganore Tirane per verifikimin e llojit te origjinës se mallit ne shtetin Moldavi me te cilin Administrata Doganore Shqiptare ka Marrveshje Bashkepunimi per te dhënat dokumentare te praktikës nr. 135423 date 09.02.2023. Gjithashtu pretendohet per atikullin hurma arabie ne paketim shumice i vlerësimi prej 1.8 eu/kg i referohet nje produkti te ambalashuar ne sasinë 5 kg per artikullin hurma arabie dhe sasinë 20 kg dhe 10 kg per artikullin arra ne guacke dhe te qëruara dhe jo per shitje te vogla pakice. Gjykojme qe ky konstatim eshte i drejte po nga grupi auditues ne kete moment auditimi nuk mund te jepet opinion ne lidhje me deklarimet alternative te mallit hurma arabie te importuara ne deklarime alternative. Konstatohet se dokumentacioni ardhur ne per zhdoganime te mallit arra me lëvozhge dhe pa levozhge te importuara nga subjekti F.M gjate fazës observuese ka perfshire dokumentimin e importeve te kryera nga ky operator duke vene ne dispozicion te gjitha praktikat doganore te atakuara ne materialin e projekt raportit te auditimit duke pretenduar se dokumentacioni bashkëlidhur eshte origjinal dhe vlera e paraqitur eshte vlera reale e transaktuar por nuk dokumentohet me prova vërtetësia e këtyre faturave te mallit te nisura nga Ukraina dhe Moldavia. Grupi auditues ne mungese edhe te te dhënave orakull per importues te tjerë te këtij malli per te njëjtat orgjina malli ose identike ose te përfaqëta ne afate kohore 3 mujor te përfaqëta, garancive te depozituara per qëllime te verifikimit doganor i cili nuk rezulton i kryer per periudhën 2022 dhe 2023 nuk mund te shprehet ne lidhje me vërtetësinë e ketyre transaksioneve dhe per rrjedhoje e trajton kete fakt ne kete material dhe rekomandon per subjektin e audituar ndjekjen e arkëtimit te te ardhurës doganore te munguar trajtuar sa me siper

Efekte e përlllogaritura në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 08 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 11,966,211 lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *18* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ****Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**** dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 ***“Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”*** që lidhen me vlerësimin doganor te mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 18 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH per mallra te kapitullit 18 deklaruar ***”me nivele te uleta vlersimi doganor nderkohe që duhet te ishin vleresuar me vleren e mallit prej 4.3 Euro/kg ,3.3 Euro/kg, 1.6 Euro/kg dhe 4.8 Euro/kg2”*** per artikujt e poshteshenuar per mallra te ***“natyres kakao, cokollate, cokokrem”*** ” te trajtuara sipas disa vendeve dhe kompanive eksportuese te origjinave të ndryshme të përzgjedhura për shqyrtim.

Efeksi financiar i përlllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 18 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 6,281,240 lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *20* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ****Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**** dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 ***“Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”*** që lidhen me vlerësimin doganor te mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 20 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH deklaruar me nivel vlersimi doganor të ulët nderkohe që duhet te ishin vleresuar me vleren e mallit identik te hyre ne RSH ne nivelin prej ***0.44 Euro/litri, 0.6 Euro/litri, 2.5 Euro/kg*** për artikujt ***“domate e konservuar” “leng fruta”, “Kerpudha te konservuara” dhe “kikirike”***.

Efeksi financiar i përlllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 20 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 1,001,022 lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në praktiken doganore nr R. 84431 viti 2023 te deklaruar nga subjekti importues ***“It”*** me nipt L.....A konstatohet se nuk ka permbushur kushtin e perfitimit te kushtit te origjines preferenciale MSABE ***“Udhërrëfyesit”*** sipas Ligjit Nr. 9590, datë 27.07.2006 për ratifikimin e MSABE. Pasi provohet fakti qe dokumentacioni i bashkelidhur ne systemin asiuda ëord (***fatura***) eshte mbi vleren 6000 euro, e transaktuar ne **nivelin 8100 Euro** dhe e shoqeruar me shenimin e perfitimit kushtit te origjines prefernciale , ndërkohë që ky kusht është i detyrueshme per shuma malli deri ne 6000 Euro. Personeli përpunues doganor ka kryer veprime në kundërshtim me shpjegimet dhe përcaktimet Kodit Doganor për nenet respektive që lidhen me ***“E drejta e Kontrollit”***, për ***“Verifikimi i Deklaratës”***, për ***“Deklarata me Shkrim”***, për ***“Kontrolli i mallrave dhe mjeteve”***, për ***“Dokumentacionin që shoqëron Deklaratën Doganore”*** të për ***“Deklarata Doganore”*** të VKM nr. 657 për ***“Dispozitat Zbatuese të***

Kodit Doganor”. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga operatorët ekonomike deklarues dhe nga agjencitë doganore respektive rezultojnë shmangie të detyrimeve doganore dhe shkelje doganore të kryera me sanksione doganore respektive me një detyrim doganor prej 190,720 leke dhe një penaltet 190,720 leke bazuar në legjislacionin e fushës. veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD. Nga ana e sektorit të vlerës prane DVQse për sa më sipër, duhej mbajtur procesverbal me shkrim referuar nenit 273.3 të KD për praktikën doganore të pasqyruara në material duke sanksionuar për çdo rast deklaruesin drejtpërdrejt ose të terthorë.

Efekti financiar i përllogaritur në praktikën doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 20 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën 381,440 lekë do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *21* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ****Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**** dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesipërme për mallrat e deklaruar në Kapitullin 21 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH deklaruar me nivel vlerësimi doganor shumë të ulët, nderkohe që duhet të ishin vlerësuar me vlerën e mallit identik të hyrë në RSH ***“ne nivelin 0.96 Euro/kg”*** me efekte të ardhurash në Buxhetin e Shtetit. Gjate auditimit u konstatua se kompanitë eksportuese të mallit dhe kompanitë importuese janë persona 100% të lidhur nga pikepamja e ortakerisë me ndikim tërësor të dukshëm në çmimin e ulët të importuar dhe të transaktuar dhe konkretisht janë trajtuar dhe shqyrtuar

Rastet e transaksioneve të kompanisë eksportuese “Gt” e lidhur 100% me kompaninë deklaruese “Gr” ku janë konstatuar deklarime tërësor të uletave për artikullin “Ketchup domateje” të importuar.

2-Rastet e transaksioneve të kompanisë eksportuese “Bu” e lidhur 100% me kompaninë deklaruese “Bu” ku janë konstatuar deklarime tërësor të uletave për artikullin “Akullore” të importuar.

3-Rastet e deklarimeve të uletave të artikullit “Ketchup/Salce” me pasojë mungesën e të ardhurave doganore në Buxhetin e Shtetit të deklaruar në kapitullin 21 të NM në RSH të cilat duhet të ishin rivlerësuar me 0,9 euro/kg sipas kushtit FOB.

Efekti financiar i përllogaritur në praktikën doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 21 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën 1,497,884 lekë do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *22* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ****Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**** dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave.

1-Trajtuar në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesipërme për mallrat e deklaruar në Kapitullin 22 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH deklaruar me nivel vlerësimi doganor të ulët, nderkohe që duhet të ishin vlerësuar me vlerën e mallit identik të

hyre ne RSH ne “***nivelin 0.39 Euro/litri per produkte me ambllazh 1.5 liter dhe 0.83 euro/litri per ambllazh 0.25 euro/litri***” me efekte te ardhurash ne Buxhetin e Shtetit.

2-Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallin Birre/Peroni ne Kanace e deklaruar ne Kapitullin 22 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH deklaruar ”***me nivel vleresimi doganor te ulet, nderkohe që duhet te ishin vleresuar me vleren e mallit identik te hyre ne RSH ne nivelin 0.26 Euro/litri deri 0.47 Euro/litri per artikullin birre ne kanace***” me efekte te ardhurash ne buxhetin e Shtetit eksportuar nga kompania “As” ku nga grupi auditues eshte konstatuar se ne periudha kohore brenda harkut kohor prej 3 muaj jane deklaruar cmime te ndryshem te artikullit birre ne kanace me nje luhatje cmimi **prej 35% me te uleta** se cmime alternative te deklaruar per te njejtin mall identik me efekte te ardhurash ne buxhetin e Shtetit

3-Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallin “***Birre/Car shishe 0.33 liter dhe birre ne fuci***” dhe “***BirreTu ne shishe 0.33 liter dhe birre ne fuci***” e deklaruar ne Kapitullin 22 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH deklaruar ”***me nivel vleresimi doganor te ulet ne vleren 0.63 Euro/litri-0.67 Euro/litri peer birren ne shishe 0.33 litra*** importuar drejperdrejt nga prodhuesi eskuziv ne Rumani nga kompania **UA** me nipt K.....O nderkohe që rezultojne importe te mallrave identike te importuar ne te njejtin kohe nga prodhuesi eskuziv ne SERBI nga kompania “AI” me nipt K.....C **ne nivelin 1.22 Euro/litri dhe 0.88 Euro litri**.

4- Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallin birre ne fuci i llojit Carlsberg dhe Tuborg i importuar ne nivele te ndryshme brenda periudhave kohore te ndryshme dhe me vlere te uleta nga kompania **Un** me nipt K.....O nderkohe qe per te njejta mallra identike jane importuar me vlere 35% deri 40% me te larta nga kompania **AI** me nipt K.....C ne **nivelin 0.8 eu/litri per birren Car ne fuci dhe 0.67 euro/litri per birren Tu ne fuci**

Nga ana e grupit auditues eshte konstatuar se ne periudha kohore brenda harkut kohor prej 3 muaj jane deklaruar cmime te ndryshem te artikullit birre me nje luhatje cmimi **prej 35%-40% me te uleta** nga ana e kompanise “Un” me nipt K.....O se cmimet alternative të mallit identik te deklaruar nga kompania “AI” me nipt K.....C me efekte te ardhurash ne Buxhetin e Shtetit

Efeksi financiar i përllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 22 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 17,072,405 do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *23* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë* dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “***Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore***” që lidhen me vlerësimin doganor te mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 23 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH deklaruar per artikullin “***Frut Molle i Thare***” deklarime te cilat jane kryer ne kundershtim me percaktimet dhe shpjegimet e NM ne RSH pasi artikulli i mesiperm duhej te ishte deklaruar ne kapitullin 8 te NM ne RSH i cili përcakton se :

Si rezultat i ketij keqklasifikimi nga ana e deklaruesit te malli dhe nga ana e personelit perunues doganor nuk eshte kryer vlersimi i sakte i mallit te deklaruar pasi deklarimet alternative ne kapitullin 8 te NM rezultojne me **3.3 Euro/kg** per mallra identike referuar edhe te dhenave te cmimeve referuese sipas Dosjes se te Dhenave te Disponueshme ne RSH.

Efekt i financiar i perllogaritur ne praktikat doganore te mesipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 23 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 2,231,510 do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *23* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ***Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*** dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 **“Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”** që lidhen me vlerësimin doganor te mallrave. Trajtuar ne anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 23 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH deklaruar per artikullin **“ushqim per qen dhe mace”** deklarime te cilat duhet te ishin vleresuar jo me pak se **1.2 Euro/kg** sipas kushtit FOB bazuar edhe ne te dhenat alternative te deklarimeve ne systemin asicuda ëord.

Efekt i financiar i perllogaritur ne praktikat doganore te mesipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 23 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 424,721 do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *32* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ***Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*** dhe procedura te kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 **“Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”** që lidhen me vlerësimin doganor te mallrave. Trajtuar ne anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm per mallrat e deklaruar ne Kapitullin 32 te Nomenklatures se Mallrave ne RSH deklaruar per artikullin **“Boje Hidromat”** deklarime te cilat duhet te ishin vleresuar jo me pak se 0.68 Euro/litri sipas kushtit FOB, **“Ngjites/Mastice”** deklarime te cilat duhet te ishin vleresuar jo me pak se 1.4 USD/kg sipas kushtit FOB, dhe, **“Pigment/Ngjyroses”** deklarime te cilat duhet te ishin vleresuar jo me pak se 8-9 USD/EU/ liter/kg sipas kushtit FOB bazuar edhe ne te dhenat alternative te deklarimeve ne systemin asicuda ëord, per mallra identike referuar edhe te dhenave te cmimeve referuese sipas Dosjes se te Dhenave te Disponueshme ne RSH.

Efekt i financiar i perllogaritur ne praktikat doganore te mesipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 23 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 5,269,261 do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *33* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 ***Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*** dhe procedura te

kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm për mallrat e deklaruar në Kapitullin 33 të Nomenklatures së Mallrave në RSH deklaruar për artikullin “Letra të Lagura” deklarime të cilat duhet të ishin vlerësuar jo me pak se 1.6 Euro/kg, dhe “Detergjent leng”, “Zbutesh rrobash”, “Sapun leng”, “Solucion enesh” sipas kushtit FOB, bazuar edhe në të dhenat alternative të deklarimeve në systemin asicuda ëord, për mallra identike referuar edhe të dhenave të cmimeve referuese sipas Dosjes së të Dhenave të Disponueshme në RSH si dhe cmimeve të transaktuara të mallit lende e pare e perdorur në prodhimin e artikullit detergjent pasi ka luhatje të dukshme të cmimit të importuar nga operatore ekonomikë trajtuar nga grupi auditues në nivelin **36% deri 60%** krahasuar me importet e tjera për artikullin letra të lagura dhe nga niveli **23% deri në nivelin 60%** për artikujt e tjere. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe tabela e e importeve për “Lenden e Pare për Prodhim Detergjenti” me transaksione të kryera në nivelin nga niveli **0.6Eu/kg deri në nivelin 1.5 Eu/kg**

Efekt i financiar i përlogaritur në praktikën doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 33 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën 43,385,177 do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *38* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë* dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm për mallrat e deklaruar në Kapitullin 38 të Nomenklatures së Mallrave në RSH deklaruar për artikullin “Aditiv Betoni” deklarime të cilat duhet të ishin vlerësuar jo me pak se 0.5 Euro/kg, sipas kushtit FOB, bazuar edhe në të dhenat alternative të deklarimeve në systemin asicuda ëord, për mallra identike referuar edhe të dhenave të cmimeve referuese sipas Dosjes së të Dhenave të Disponueshme në RSH

Efekt i financiar i përlogaritur në praktikën doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 38 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën 11,726,000 do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *41* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë* dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave. Trajtuar në anekset bashkëlidhur ketij Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm për mallrat e deklaruar në Kapitullin 38 të Nomenklatures së Mallrave në RSH deklaruar për artikullin “Lekure e Njome” deklarime të cilat duhet të ishin vlerësuar jo me pak se **2.2 Euro/kg**, sipas kushtit FOB, bazuar edhe në të dhenat alternative të deklarimeve në systemin asicuda ëord, për mallra identike referuar edhe të dhenave të cmimeve referuese sipas Dosjes së të Dhenave të Disponueshme në RSH si dhe cmimeve të transaktuara të mallit “lekure e njome”.

Efekti financiar i përllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 41 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 1,791,868 do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

- 4-Nuk jane kryer verprime verifikuese nga personeli doganor i kontrollit fizik prane Deges Doganore Tirane dhe prane DPD-se me qellim pagesen e plote te takses se ambllazhit TAM.

Nga ana e grupit auditues jane llogaritur edhe detyrimet respective shoqeruara me penalitete perkatese trajtuar më konkretisht në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar te Auditimit.

Efekt i financiar i përlogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 15 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumen në shumën 996,912 (detyrim dhe gjobe) lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

4-Në lidhje me pagesen e takes TAM per artikullin “Laminat plastic PVC” dhe artikullin “Membran PVC” konstatohet se operoret ekonomik trajtuar edhe rastet kur gjate deklarimeve te artikulli “Laminat plastic PVC” dhe artikulli “Membran PVC” eshte perfituar perjashtimi nga pagimi i takses se Ambllazhit Plastik ne **nivelin 35 lek/kg** ne kundershtrim me percaktimet ligjore te shpjegimeve te pikes 4 (e) dhe 4 (ë) te ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”.

Pika 4 e Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, percakton se ;

4. Përjashtohen nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe ambllazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4:

v) kutitë e votimit;

viii) paketuesit për serumet, gjakun dhe barnat mjekësore;

dh) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar dhe që klasifikohen në kapitullin 39, të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polysterene), importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS extruder polystyrene), si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, artikujt të cilët përdoren në

**industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë;
ë) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve, si dhe importimi i materialeve/artikujve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, që përdoren në industrinë e prodhimit të mobilieve;**

f) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta apo materialet celuloike, sipas kapitullit 39, të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve. Kodet e detajuara të artikujve në kapitullin 39, të NKM-së, që përjashtohen nga taksa, sipas pikave “dh”, “e”, “ë” dhe

“f” më sipër, përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financa.

Trajtuar në anekset bashkelidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit edhe rastet kur operatorë të ndryshëm ekonomikë nuk kanë paguar taksën TAM për artikullin “Laminat plastik PVC” dhe artikulli “Membran PVC” pasi nuk janë artikuj dhe mallra që kanë destinacion përdorimi në industrinë e prodhimit të mobilerisë, janë produktet të gatshme të prodhuar me përmbajtje të fortë plastike dhe nuk përfshihen në asnjë përshkrim të pikës 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”.

Efekti financiar i përlllogaritur në praktikën doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 68 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkelidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën 37,746,548 lekë (detyrim dhe gjobe) lekë do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

◆ Në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, u konstatua se artikujt “Tub Plastik njeperdorim per perdorim venoz” dhe “Shiringa plastike nje perdorim ne trajte perdorimi perfundimtar ambalazh” kanë si përdorim në destinacion përfundimtar ambalazhimit e solucionit mjeksor si në trajtën e përdorimit të artikullit “Shiringe” dhe në trajtën e përdorimit të artikullit “Tub per leng venoz”.

Konstatohet nga auditimi se

1-Keto janë artikuj teresisht plastike

2-Klasifikohen në kapitullin 91 për arsye të destinacionit të përdorimit mjeksor

3-Përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, përcaktojnë si ambalazh plastik, “**artikujt plastike nje perdorimsh/Ambalazh plastik/qelqi është çdo material pakëtues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.**”

Konstatohet se ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, vendos kufizime duke mos u shtirë në të gjithë mallrat e deklaruara në Nomenklaturën e Mallrave në RSH, duke vecuar plastikën e deklaruar në kapitullin 39 si dhe ambalazhet e tjera plastike për mallra që deklarohen në kapituj të tjera tarifore, jashtë kapitullit 39 të NM në RSH

Konstatohet se artikujt “Tub Plastik njeperdorim per perdorim venoz” dhe “Shiringa plastike nje perdorim ne trajte perdorimi perfundimtar ambalazh” kanë si përdorim në destinacion përfundimtar ambalazhimit e solucionit mjeksor si në trajtën e përdorimit të artikullit “Shiringe plastike” dhe në trajtën e përdorimit të artikullit “Tub plastik per leng venoz” dhe janë 100% material plastik dhe nga pikepamja dhe fryma e ligjit duhet të meritojnë vlerësim për pagesë të takses TAM pasi në përdorim përfundimtar shërbejnë totalisht si ambalazh që ambalazhojnë shtetë mjeksor me qëllim që

“ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim”

Konstatohet se keto artikuj dhe te tjere artikuj nuk jane perfshire ne listen e artikujve plastike amballazhues njeperdorimsh qe paguajne takse kombetare TAM ne nivelin 35 lek/kg dhe trajtohen si mbetje spitalore sipas nje kuadri rregullator qe i neshtrohet nje rregullimi brenda zonave te caktuara spitalore por qe shitja dhe treëgtimi i tyre behët në shitje më pakicë dhe shumicë ne Depo farmaceutike dhe Farmaci publike

Konstatohet se në VKM Nr.798, datë 29.9.2010 për miratimin e rregullores "*Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore*" në VKM Nr. 418, datë 27.05.2020 "*Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020–2035*" dhe Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore percakton rregulla të qarta per mënyrën e trajtimit të pajisjeve mjekësore të perdorura ne njësi spitale përfshirë edhe mallrat *Tub Plastik njeperdorim*" dhe "*Shiringa plastike nje perdorim*" ndërsa për pajisjet mjeklësore të natyrës së mësipërme që nuk trajtohen në njësi spitalore por vetëm në farmaci publike dhe depo farmaceutike në shitje të lirë për publikun nuk ka asnje rregullim ligjor.

Gjatë auditimit u konstatua se artikujt "*Tub Plastik njeperdorim per perdorim venoz*" dhe "*Shiringa plastike nje perdorim ne trajte perdorimi perfundimtar amballazh*" janë amballazhe plastike dhe kane si perdorim ne destinacion perfundimtar amballazhimin e solucionit mjeksor dhe se nga pikepamja e pikës 3 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", , këto shërbjenë për mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim ose përdorim. Konstatohet se ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", vendos kufizime duke mos u shtrire efektin e tij ne te gjithë mallrat e deklaruar ne Nomenklaturen e Mallrave ne RSH , dhe artikuj e mesiperem nuk përfshihen ne listen e artikujve plastike amballazhues njeperdorimsh që duhet të paguajnë taksë plastike ne RSH Konstatohet se artikujt "*Tub Plastik njeperdorim per perdorim venoz*" dhe "*Shiringa plastike nje perdorim ne trajte perdorimi perfundimtar amballazh*" kane si perdorim ne destinacion perfundimtar amballazhimin e solucionit mjeksor si ne trajten e perdorimit te artikullit "*Shiringe plastike*" dhe në trajten e përdorimit te artikullit "*Tub plastik per leng venoz*" dhe jane 100% material plastik dhe ne perdorim perfundimtar sherbejne totalisht si amballazh qe amballazhojn solucione mjeksore. Konstatohet gjatë auditimit se nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka pasë korrespoedence dhe bashkepunim me Ministrine e Financave për kete problematikë. Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë se Kontrollit të Akcizes dhe Pas Zhdoganimit në Departamentin e Analizave Riskut dhe Aposteriorit bazuar në nenin 45 dhe 47 të ligjit, "*Për Akcizat në RSH*" nuk rezultojnë të kryera kontrole doganore me qëllim ekzaminimin e mallrave, vërtetësinë e dokumentacionit dhe destinacionin e mallrave dhe nenit 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*" me qëllim verifikimin e vërtetësisë së pagesës së detyrimeve doganore për mallrat "*Tub Plastik njeperdorim*" dhe "*Shiringa plastike nje perdorim* kur shiten per destinacion jo per "*Njesi spitalore*" por per farmaci ose depo farmaceutike pra shitje e lire publike trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar te Auditimit të cilat do te kishin sjelle efekte pozitive ne të ardhurat doganore nese do te ishin trajtuar me shkalle takse kombetare në nivelin 35 lek/kg.

Në analizë të argumentëve dhe provave të mësipërm janë trajtuar në anekset bashkëlidhur këtij Projekt Raporti Auditimi edhe rastet e kalkuluara në shumën 18,689,857 leke dhe te llogaritura te pagesave doganore qe mund te ishin arkëtuar në Buxhetin e Shtetit nese në përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "*Për Taksat Kombëtare*",do të ishin parashikuar pagesa e Takses Kombëtare te Amballazhit prej **35 leke/kg** per importet e kryera për keto 2 artikuj amballazhues njeperdorimsh.

1-"*Tub Plastik njeperdorim per perdorim venoz*"

2-“*Shiringa plastike nje perdorim ne trajte perdorimi perfundimtar amballazh*”

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet sektorit të Drejtorise se Kontrollit te Akcizes dhe Pas Zhdoganimit në Departamentin e Analizave Riskut dhe Aposteriorit ne vijim të ndërtojë **Programe Kontrolli Specifike Verifikuese** për praktikën doganore që janë përpunuar sipas tabelës trajtuar për këtë ceshtje bashkëlidhur anekseve të Raportit Përfundimtar te Auditimit së mësipërme si dhe te tjerat praktika te me qëllim verifikimin e vertetesise se pageses detyrimeve doganore per mallrat e trajtuar sa me siper me qëllim verifikimin e destinacinit të mallit , me destinacion perfundimtar Mbetje Spitalore ose Shitje ne Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike

Ne perfundim te procedures nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave te gjykoje problematiken e e trajtuar sa me siper duke bashkerenduar me Ministrine e Financave me qellim perfshirjen e artikujve “*Tub Plastik njeperdorim per perdorim venoz*” dhe “*Shiringa plastike nje perdorim ne trajte perdorimi perfundimtar amballazh*” qe kane si destinacion amballazhimin e solucionit mjeksor per perfshirjen ne listen e artikujve plastike amballazhues njeperdorimsh qe paguajne takse kombetare TAM ne nivelin 35 lek/kg.

Në perfundim të procedurës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të informohet Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi rezultatet e kontrollit dhe mbi vërtetësinë e veprimeve të kryera për propozim për pagesë takse të amballazhit plastik për praktika të gjeneruara të trajtuara në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar te Auditimit.

♦ *Ne lidhje me pagesën e takses kombetare per artikujt e deklaruar në kapitullin 04 te NM në RSH të nxjerrë sipas ligjit nr. 112/2021 date 25.11.20121 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Per taksat kombetare” të ndryshuar duke perdorur kodin e takses QPL për procedura IMP 4 ne systemin Asicuda Ëord u konstatua sa me poshte vijon se :*

1- Operatori ekonomik “*In*” me nipt K.....L ka deklaruar artikullin “*Qumesht i Kondensuar*” në kodin 04049083 te NM ne RSH dhe ne kodin tarifor “*0404*” importuar nga kompania “*Jia*”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore konstatohet se

1-Malli deklarohet sipas Certifikates Veterinare si “*qumesht i kondensuar i mbushur me embelsire*”, me origjinë nga Kina vend NEU (me të cilin nuk ka marrëveshje bashkëpunimi midis Administratave Doganore).

2-Malli deklarohet në i amballzhuar në amballazh plastik “*plastic cup*”, për të cilat nuk rezultojnë të paguar taksa amballazhi TAM

3-Nuk rezultojnë verifikime laboratorike nga Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor për klasifikimin tarifor të mallit “*qumesht i kondensuar i mbushur me embelsire*”, të deklaruar paraprakisht në kodin tarifor 04049083 te NM për të cilin nuk rezultojnë të jete paguar Takse Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg

4-Rezultojnë deklarime identike të mallit “*qumesht i kondensuar i mbushur me embelsire*”, të deklaruar në kodin tarifor “*040229910*” për të cilat është paguar Taksa Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg për këtë artikull shoqëruar edhe me deklaratat e faturave dhe mallit ku është percaktuar kodi tarifor nga eksportuesit e mallit.

V.eksportues	Viti	Nr Dekl	Cmp Cod	Con	HS 4	Kodi	Gds Ds3	P Neto	Takse Kombetare e paguar	Paguar
Spanja	2023	66343	J.....L		402	4029910	qumesht kondensuar	13,720	150 lek/litri	150 lek/kg
Spanja	2022	31972	J.....L		402	4029910	qumesht kondensuar	15,245	150 lek/litri	150 lek/kg
Spanja	2023	42279	J.....L		402	4029910	qumesht kondensuar	1,563	150 lek/litri	151 lek/kg

Hollanda	202 2	60638	K.....L	402	402991 0	qumesht kondensuar	20,88 5	150 lek/litri	152 lek/kg
Gjermania	202 2	73473	K.....L	402	402991 0	qumesht kondensuar	7,254	150 lek/litri	153 lek/kg
Italia	202 2	69456	K.....Ë	402	402101 1	qumesht kondensuar	614	150 lek/litri	154 lek/kg

5-Referuar percaktimeve ligjore të Shkreses nr. 66 prot date 05.01.2022 percaktohet se importi dhe prodhimi i kemit të qumeshtit, të përfshirë në kreun 0402 të NM në RSH duhet të paguajë takese kombetare në nivelin 150lek/kg

6-Referuar shenimeve dhe percaktimeve të Nomenklatures së Mallrave në RSH, kreu 0402 përfshin mallrat “**Qumesht dhe krem, i koncentruar apo që përmban sheqer shtesë apo lende të tjera embelsuese**” të cilat klasifikohen tek kodi tarifor “04029910”

Te tjera:

Me përmbajtje yndyre, ndaj peshes, që nuk e kalon 9,5%.

Me përmbajtje yndyre, ndaj peshes, mbi 9,5 % por që nuk e kalon 45 %

Ndërsa në kreun 0404 klasifikohen :

“Hirre, nese është apo jo e koncentruar apo që përmban sheqer shtesë apo lende të tjera embelsuese; produktet që përbehen nga përberes të qumeshtit natyral, nese përmbajne apo jo sheqer shtesë apo lende të tjera embelsuese, të përfshira apo të paspecifik” dhe konkretisht kodi tarifor 04049083 përmban :

Te tjera

Që nuk përmban sheqer apo materiale të tjera embelsuese shtesë, me përmbajtje yndyre, ndaj peshes:

Me tepër se 1,5 % por jo më tepër se 27 %

7- Nuk rezultojnë të administruara në sistemin Asicuda Eëord të dhëna për karakteristikat teknike të mallit “**qumesht i kondensuar i mbushur me embelsire**”, për mallin e importuar nga shoqëria “In” me nipt K.....L në lidhje me elementet “**sheqer dhe materiale embelsuese**” dhe nivelin e % të yndyrës në volumnin e produktit.

8- Artikujt që klasifikohen në kreun “04049083” sipas percaktimeve të NM në RSH përmbajnë peshe yndyre nga 1.5% deri 27% ndërsa artikujt që klasifikohen në kodin tarifor “040229910” për të cilat është paguar Taksa Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg përmbajnë nga 9,5% yndyre deri në 45% yndyre.

9- Artikujt që klasifikohen në kreun “04049083” sipas percaktimeve të NM në RSH nuk përmbajnë sheqer dhe materiale embelsuese shtesë, ndërsa artikujt që klasifikohen në kodin tarifor “040229910” për të cilat është paguar Taksa Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg përmbajnë sheqer dhe lende embelsuese shtesë.

Grupi auditues në analizë të fakteve dhe provave mori në shqyrtim deklaratimet e shoqërisë “In” me nipt K.....L për mallin e deklaruar “**Qumesht i Kondensuar**” në kodin 04049083 të NM në RSH dhe në kodin tarifor “**0404**” për të cilin nuk rezultoi të paguar taksa kombetare **QPL në nivelin 150 lek/kg**, dhe përlogaritë efektin e munguar financiar në buxhetin e Shtetit nëse ky artikull duhet të paguajë Takse Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg në mungesë të veprimeve verifikuese të pakryera nga Administrata Doganore pasi subjekti ka status të privilegjuar dhe operon në kanal jeshil OEA deklarimi pa mbikeqyrje doganore.

Në përfundim nga ana e grupit auditues janë llogaritur edhe rivlerësime të detyrimeve doganore respektive për periudhën e audituar duke llogaritur efektin negativ të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit që mund të kishin lindur si pasojë e mosdeklarimit të mallit “**Qumesht i Kondensuar**” në kodin 04049083 të NM në RSH në kodin tarifor “**0404**” për të cilin nuk rezultoi të paguar Taksa Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg, nga ana “In” me nipt K.....L. Neni 49 i Kodit Doganor në RSH sipas ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “**Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**” përcakton se :

Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën

përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksporimit ose në njoftimin rieksporimit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqëruës”

si dhe paragrafi nr. 2

Ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë”.

Bazuar në konstatimet e mësipërme të kryhen shqyrtime të detajuara me të thelluara nga **Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit** pranë Drejtorise së Përgjithshme të Doganave në bazë të nenit 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Pranë **Drejtorisë së Laboratorit Kimik Doganor** me qëllim analizimin e sakte dhe ligjor të klasifikimit tarifor të artikullit “**Qumesht i Kondesuar**” në kodin 04049083 të NM në RSH dhe në kodin tarifor “**0404**” për të cilin nuk rezultoi e paguar Taksa Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg, nga ana “**In**” me nipt K.....L

Pranë **Drejtorisë së Monitorimit të Riskut** për të analizuar përgjegjësitë dhe shkaqet e mosvënies në profilin e riskut të deklarimeve të mallrave në kapitullin 0402 dhe 0404 me qëllim pagesën e plote të shumës së detyrimeve doganore që lidheshin me pagesën e Takses Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg,

Pranë **Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës** për të analizuar deklarimin doganor të mesipërme dhe kryerjen e analizave dhe verifikimeve tarifore për deklarimin e klasifikimit tarifor të artikullit “**Qumesht i Kondesuar**” në kodin 04049083 të NM në RSH për të cilin nuk rezultoi e paguar Taksa Kombetare QPL në nivelin 150 lek/kg, nga ana “**In**” me nipt K.....L

Në përfundim të analizës, gjykimet si dhe fakteve të mësipërme, nga ana e grupit auditues janë llogaritur efektet negative të krijuara nëse ky artikull do të rezultojë me pagesë detyrimit të Takses QPL në nivelin 150 lek/kg, për deklarime nga ana e shoqërisë “**In**” me nipt K.....L me pasoja të mundshme në të Ardhurat e Buxhetit të Shtetit në **shumen 81,962,208 leke** i cili duhet të shoqërohet me gjoba dhe penalitete respektive në rast se do të rezultojnë pagesa të Takses Kombetare QPL si pasoje e keqdeklarimit dhe shmangies së pagesës së detyrimeve doganor nga deklaruesit e drejtpërdrejtë apo të terthortë subjektet deklarues ose agjencitë doganore respektive rezultojnë shmangie e detyrimeve doganore veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD.

Bazuar në legjislacionin doganor të fushës të cilat duhet të trajtohen rast pas rast nga Drejtoria e Kontroleve Pas Zhdoganimit pranë Drejtorise së Përgjithshme të Doganave duke marrë në konsideratë dhe argumentet e paraqitura nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore të cilat do të rezultojnë si detyrime doganore përfundimtarë të papaguara në Buxhetin e Shtetit.

Në përfundim të procedurave të kryera të informohet menjëherë Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për rezultatet e arritura me qëllim kontabilizimin dhe arkëtimin e menjëhershëm të detyrimeve doganore respektive dhe penaliteteve që do të rrjedhin në zbatim të legjislacionit doganor të fushës.

♦. Në lidhje me pagesën e takses kombetare për artikujt e deklaruar në kapitullin 04 të NM në RSH të nxjerrë sipas ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombetare” të ndryshuar duke përdorur kodin e takses QPL për procedura IMP 4 në sistemin Asicuda Ëord u konstatua se me poshtë vijon se disa operatore ekonomike kanë kryer pagesën e takses kombetare QPL në nivelin 16 lek/kg duke kryer klasifikime të gabuara tarifore me pasoje mospagesën e plote në nivelin 150 lek/kg të takses QPL për artikujt “**Hirre, Protein Hirre dhe Qumesht pluhur**” të cilat trajtohen me nivel taksimi në masën 100 lek/kg dhe 150 lek/kg. Referuar përcaktimeve ligjore të Shkresës nr.66 prot date 05.01.2022 ku përcaktohet se “**Importi dhe prodhimi i**

hirres se qumeshtit dhe qumeshtit pluhur, te perfshire ne kreun 0402 te NM” ne RSH duhet te paguaje takese kombetare ne nivelin 100lek/kg dhe 150 lek/kg. Nga ana e grupit auditues jane llogaritur edhe detyrimet respektive shoqeruara me penalitete perkatese trajtuar me konkretisht ne anekset bashkelidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit.

Viti	DAV	Subjekt	Nipt	Kodi	Malli	Pesha	Taksimi	Takse/hirre	Paguar	Detyrim	Gjobe	Agjensia	Kuq
2023	4684	AL	L.....R	4041014	Lactomin /Protein Hirre	1500	100%	150 lek/kg	150 lek/kg	0	0	Fas	
2022	2324	AL	L.....B	4049021	Lactomin/ Protein Hirre	6000	100%	150 lek/kg	16 lek/kg	804,000	804,000	Fa	
2022	36652	AL	L.....B	4049021	Lactomin/ Protein Hirre	12000	100%	150 lek/kg	16 lek/kg	1,608,000	1,608,000	Fa	1
2022	111885	AL	L.....B	4049021	Prot/hirre /qumes/pluhur	24000	100%	100 lek/kg	16 lek/kg	2,400,000	2,400,000	Fa	
2022	82410	AL	L.....B	4049021	Prot/hirre /qumes/pluhur	24000	100%	100 lek/kg	16 lek/kg	2,400,000	2,400,000	Fa	
2022	116584	BB	J.....S	4049089	Protein hirre 35%	2000	35%	150 lek/kg	0 lek	105,000	105,000	St	1
2023	3674	BB	J.....S	4049089	Protein hirre 35%	5000	35%	150 lek/kg	0 lek	262,500	262,500	St	
2023	62970	BB	J.....S	4049089	Protein hirre 35%	500	35%	150 lek/kg	0 lek	26,250	26,250	St	
					Totali					7,605,750	7,605,750 leke		

Si rezultat i keqdeklarimit dhe shmangies se pageses se detyrimeve doganor nga deklaruesit e drejperdrejtë apo te terthortë subjektet deklarues ose agjencitë doganore respektive rezultojnë shmangie e detyrimeve doganore veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD. Nga ana e sektorit të vlerës prane DVQse, SKAO dhe personeli përpunes doganor prane DDDurrës për sa më sipër, duhej mbajtur procesverbal me shkrim referuar nenit 273.3 të KD për praktikat doganore të pasqyruara në material

Efekti financiar i përlllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 04 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumen në shumën 15,211,500 (detyrim dhe gjobe) lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

V- Auditimi i dokumentacionit bashkelidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave, përpunuar nga sektori i vlerës pranë DDD, SVQ dhe SKAO, pranë DPD

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave, gjatë procedurave të zhdoganimit të vlerësuar me rrisht referuar artikujve të importuar dhe notave spjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM), mbështetur në ekzaminimin kryq, rishikimin analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, shqyrtimit të të dhënave të internetit nëpërmjet kodit dhe përshkrimit të artikullit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese, krahasimi me dokumentat bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet), konstatohet që:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkelidhur praktikave doganore IM4 të artikujve të ndryshëm në kodet përkatëse tarifore të NKM u konstatua se bazuar në të dhënat e sistemit ORACLE; në dokumentacionin bashkelidhur praktikave doganore, në notat spjeguese të NKM, si dhe shfrytëzimit të të dhënave të internetit lidhur me mallrat e deklaruar, disa praktika doganore rezultojnë me keqklasifikim të kodit tarifor të artikujve të importuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore. Nga agjensitë doganore, sektori i vlerës pranë D.D. Durrës, SVQ pranë DPD, por dhe SKAO pranë DPD, artikujt janë keqklasifikuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të nenit 250.1/a, 251.1 dhe 256.1/a të KD.

Referuar nenit 251, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

2. Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive: a) mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaratën doganore, ..., i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratë, ..., në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 23

Referuar nenit 256, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

Kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, **lloj**) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, **zbatohet sanksion në masën sa 1-njefishi i detyrimeve doganore te papaguara**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të artikujve të ndryshëm në kodet përkatëse tarifore të NKM u konstatua se bazuar në të dhënat e sistemit ORACLE; në dokumentacionin bashkëlidhur praktikave doganore, në notat shpjeguese të NKM, si dhe shfrytëzimit të të dhënave të internetit lidhur me mallrat e deklaruara, disa praktika doganore rezultojnë me keqklasifikim të kodit tarifor të artikujve të importuar me pasojë shamngien e detyrimeve doganore.


♦ **Ne lidhje me deklaratime të Artikulli “Diafragme Derri” rezulton i klasifikuar në kodin tarifor “02064900” dhe në kreun “0206”**

Te brendshmet e ngrenshme të gjedheve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomereve, mushkave apo hibridit të gomarices, të fresketa, të ftohta apo të ngrira

sipas kushtit MSABE, duke përfituar tarife doganore të reduktuar në nivelin 0%.

Referuar shpjegimeve dhe përcaktimeve të NM në RSH konstatohet se në të brendshmet e kafsheve hyjnë “melci, shpretke, stomak, zemer, zorre” etj pa u trajtuar edhe pjesa e sipërme e muskulit të difragmes e cila është një muskul/tendine e cila ndan pjesën e poshtme të të brendshme të kafsheve me pjesën e sipërme

Diafragma (lat.: Diaphragma [dia'fragma]) është një pllakë muskulore që ndan zgavrën e krahërorit nga zgavra e barkut (të njeriut dhe të gjitarët). Ka formën e një kupa e cila gjatë kontaktimit mundëson frymëmarrjen.





Referuar Notave dhe Shpjegimeve te NM ne RSH ne kren "020329" klasifikohen

Te tjera

Te derrave shtepiake:

Fundet e perparme dhe prerje prej tyre

Fileto dhe prerje prej tyre, me kocka ne te

Pjesa e barkut (me dhjam ne te) dhe prerje prej tyre

Te tjera

Pa kocka ne te

Te tjera

Te cilat trajtohen **me tarife 10%** pa reduktim tarifor edhe ne rastet kur malli ka origjine preferenciale MSABE.

Trajtuar ne anekset bashkelidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit edhe rastet e deklarimeve ku artikulli "*Diafragm Muskul*" eshte deklaruar si te brendshme duke mos paguar tarifen baze prej 10% si rezultat i klasifikimi tarifor jo te sakte. Nga agjensite doganore, sektori i vlerës pranë D.PD, SVQ pranë DPD, por dhe SKAO pranë DPD, si dhe gjate deklarimeve te operatorit ekonomik, rezulton se artikujt janë keqklasifikuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të nenit 250.1/a, 251.1 dhe 256.1/a të KD.

Nga ana e grupit auditues jane llogaritur edhe detyrimet respektive shoqeruara me penalitete perkatese trajtuar më konkretisht në anekset bashkelidhur ketij Raportit Përfundimtar te Auditimit.

Efekti financiar i përllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 02 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumen në shumën 23,253,721 (detyrim dhe gjobe) lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦ ***Në lidhje me deklarimet doganore të artikullit "Ushqim per qen dhe mace"*** konstatohet sipas Nomenklaturës së Mallrave nxjerrë sipas ligjit nr. 9461 datë 21.12.20022 "*Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifen Doganore*" për vitin ushtrimor 2022 dhe 2023 se në kreun "2309" klasifikohen "*Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafsheve*" dhe në kodin 6 shifror *230910* klasifikohen "*Ushqime të qenit apo të maces, vendosur për shitjen me pakicë*" të cilët trajtohen më tarifë bazë 10%. Konstatohet se disa subjekte kane paraqitur Certifikatën e Origjinës Preferenciale duke përfshirë të gjitha mallrat e deklaruar me cilësinë e mallrave që janë të mbuluara nga Origjina Preferenciale MSABE dhe kane reduktuar pagesen e tarifës doganore 10%. Konstatohet sipas shënimeve të nomenklaturës së Mallrave të kreut 23 se "*Kreu 2309 perfshin produktet e nje lloji te perdorur ne ushqimin e kafsheve, te paperfshira apo te paspecifikuara diku tjeter, fituar nga procesimi i materialeve vegjetale apo te kafsheve ne nje shkalle te tille qe ato te humbin karakteristikat thelbesore te materialit origjinal, pervec kthimeve vegjetale, mbetjet vegjetale dhe nenproduktet e proceseve te tilla*". Konstatohet gjate auditimit te materialit bashkelidhur praktikave doganore se gjithë produktet e përfshira në deklaratat doganore trajtuar sa me poshte vijon janë me pa përmbajtje qumështi" dhe duhet te ishte

deklaruar konkludohet në klasifikimin tarifor në kodin 7 shifror *2309101* ku klasifikohen **“Ushqime të qenit apo të maces, vendosur për shitjen me pakicë”** të cilët trajtohen më tarifë bazë 10%. Në analizë të klasifikimeve të kodit 6 shifror *230910* dhe kodit 7 shifror *2309101* rezulton se kodet tariforë që nuk kanë përmbajtje qumështi brenda kësaj familjeje të kodit 7 shifror *2309101* janë kodet:

- 23091011 tarifë sipas kushtit MSABE 10%
- 23091031 tarifë sipas kushtit MSABE 10%
- 23091051 tarifë sipas kushtit MSABE 10%
- 23091090 tarifë sipas kushtit MSABE 10%

të cilët trajtohen me tarifë doganore bazë 10% edhe në kushtet e përfitimit të Origjinës Preferenciale MSABE. Klasifikimi i mallit **“Ushqime të qenit apo të maces, vendosur për shitjen me pakicë”** duhet të ishte kryer bazuar në përmbushje të përcaktimeve të klasifikimeve tariforë në kodet **“23091011, 23091031, 23091051, 23091090”** Gjithashtu referuar Shënimeve të Seksionit Nr. 1 **“Rregullat e Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar”** klasifikimi në Nomenklaturën e Kombinuar Të Mallrave do të udhëhiqet sipas parimeve që pasojnë dhe sipas Shënimit nr. 3 pika C që përcakton se **“kur mallrat nuk mund të klasifikohen sipas rregullave 3a, apo 3b, ato do të klasifikohen në kreun i cili ndodhet në rendin e fundit numerik midis mallrave që meritojnë të njëjtin vlerësim tarifor”**. Konstatohet se rendi i fundit numerik për kreun tarifor *2309* është kodi tarifor *23091090* me tarifë bazë dhe tarifë të reduktuar sipas kushtit preferencial MSABE në kuotën 10%.

Nga agjensitë doganore, operatorët deklarues sektori i vlerës pranë D.PD, SVQ pranë DPD, por dhe SKAO pranë DPD, rezulton se artikujt janë keqklasifikuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkëlqje të nenit 250.1/a, 251.1 dhe 256.1/a të KD, për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në formën e detyrimit doganor të papaguar Nga ana e grupit auditues janë llogaritur edhe detyrimet respective shoqeruara me penalitete perkatese trajtuar më konkretisht në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 23 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën në shumën 5,780,612 (detyrim dhe gjobe) lekë do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

- ◆ Në lidhje me deklarime të kryera pa origjinë preferenciale MSABE në kapitullin 94 të NM të mallrave në RSH rezulton se janë deklaruar artikujt **“Aksesore për mobilerë”** dhe artikulli **“shezlon/mbeshtetese”** me tarife doganore 0% duke kryer klasifikim të gabuar tarifor Në kreun 8302 të NM në RSH deklarohen **“pajisje prej metali baze për mobilerë”**

Mbajteset, pajisje prej metaleve baze dhe artikuj të ngjashëm të pershtatshme për tu përdorur me mobilerite, dyert, shkallet, dritaret, grilla dritaresh, karrocë, pajisjeve të kalit, bauleve, senduqeve, kutive apo për artikuj të ngjashëm; mbajtese dhe varesë kapelesh dhe fiksues të tjere të ngjashëm prej metali baze; rroteza apo rule për mobilerite me mbajtese për to, prej metali baze; mbyllesit automatike të dyerve prej metali baze:

te cilat trajtohen me tarife doganore baze 15%.

Ne kreun 9404 të NM deklarohen **“Mbeshtetese prej gome ose plastike”**

Mbeshteteset dhe mbajteset e dysheqeve; artikujt e krevateve dhe të ngjashmet (psh, dysheqet, jorganet me pambuk apo me pupla, jasteqet e fjetjes, pufete dhe jasteqet e zburimit), te

pajisura me susta apo te mbushura apo pershtatur nga brenda me cdo material apo prej gome celulare apo plastike, nese jane apo jo te mbuluara

te cilat trajtohen me tarife doganore baze 15%.

Nga agjensitë doganore, operatorët deklarues sektori i vlerës pranë D.PD, SVQ pranë DPD, por dhe SKAO pranë DPD, rezulton se artikujt janë keqklasifikuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të nenit 250.1/a, 251.1 dhe 256.1/a të KD, për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në formën e detyrimit doganor të papaguar. Nga ana e grupit auditues janë llogaritur edhe detyrimet respective shoqeruara me penalitete perkatese trajtuar më konkretisht në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Efekt i financiar i përlllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 94 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën në shumën 3,962,712 lekë (detyrim dhe gjobe) lekë do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦ ***Ne lidhje me deklarime doganore në “Kapitullin 20”*** janë konstatuar raste të keqklasifikimit tarifor të mallrave të cilat janë deklaruar sipas kushtit MSABE me tarife doganore të reduktuar në një kod tarifor me një tarifë me të ulet se ajo që duhej të paguante. Konkretisht sa me poshtë janë konstatuar raste të keqklasifikimeve tarifore me pasojë mospagimin e tarifës doganore prej 15% të mallrave të natyrës “***konserva turshi conserve, kastarvec turshi***” trajtuar me detyrim doganor të munguar dhe gjobe doganore respective. Nga agjensitë doganore, operatorët deklarues sektori i vlerës pranë D.PD, SVQ pranë DPD, por dhe SKAO pranë DPD, rezulton se artikujt janë keqklasifikuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të nenit 250.1/a, 251.1 dhe 256.1/a të KD, për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në formën e detyrimit doganor të papaguar. Nga ana e grupit auditues janë llogaritur edhe detyrimet respective shoqeruara me penalitete perkatese trajtuar më konkretisht në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Efekt i financiar i përlllogaritur në praktikat doganore të mësipërme për deklarime të mallrave në Kapitullin 94 të NM në RSH të trajtuara në tabelën tabelën anekse nr. 4.1 deri nr 4,74 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në shumën në shumën 1,861,713 lekë (detyrim dhe gjobe) lekë do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

♦ ***Në lidhje me deklarime të mallrave me tarifë bazë 2% në kodin tarifor *07* për artikullin “Hudhra”*** me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Konstatohet se artikulli “***Hudhër***” me origjinë nga Kina është deklaruar në kodin tarifor *07032000* me tarifë doganore bazë 2%. Në kreun tarifor *0703* klasifikohen mallrat “***....hudhra ...zarzavate të tjera të freskëta apo të ftohta***”. Konstatohet se në të gjitha aktet e inspektimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit bashkangjitur praktikave doganore ky produkt është cilësuar në gjendje “***Hudhër e paketuar***” në paketime në thasë në masën 10kg dhe 20kg pra “***jo në gjendje të freskët***”. Referuar notave shpjeguese të kreut *0712* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH në këtë kre tarifor klasifikohen “***Zarzavate të thara.....të plota, të prera..... por jo më tej të përgatitura***” dhe konkretisht në kodin tarifor *07129090* me tarifë doganore bazë 10%. Konstatohet se shkresa nr 4030/1 e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave datë 08.03.2011 dhe shkresa nr. 6724 prot DPD date 09.03.2016 përcakton se në kreun *0712* klasifikohet “***Hudhra e Thatë që mund të jetë kokërr dhe që ka kaluar procese të tharjes, dehidratimi***” dhe në kreun *0703* klasifikohet “***hudhra jo tërësisht e thatë me bisht dhe që nuk ka kaluar proces tharjeje***”. Konstatohet se në asnjë rast në praktikat doganore të mëposhtme nuk është kryer **asnjë mostrim laboratorik** për këtë artikull me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor

të artikullit “**Hudhër**” megjithëse praktikat doganore kanë qënë të kanalizuar në profil risku për kontroll të plotë fizik. Në shënimet e Kapitullit 7 pika 3 përcaktohet se në “**kreun 0712 përfshihen të gjitha zrazavatet e thara të llojeve që futen në krerët 0701 deri 0711 përfshirë këtu dhe artikullin hudhër**”. Në pikën 3 të Rregullave të Përgjithshme për Interpretim të Nomenklaturës së Mallrave përcaktohet qartë se “**kur mallrat janë në pamje të parë të klasifikueshme në dy apo më shumë krerë klasifikimi do të kryhet në kreun numerik i cili ndodhet i fundit**”. Kreu numerik i cili ndodhet në fund është kreu *07129090* me **tarifë bazë 10%**. Konstatohet se artikulli hudhër për nga karakteristikat e konstatuara duhet të ishte klasifikuar në kodin tarifor *07129090* me **tarifë bazë 10%** ndërkohë që është klasifikuar në kodin tarifor *07032000* me tarifë doganore **2%** duke shmangur pagesën e detyrimeve doganore nëpërmjet deklaramit në një kod tarifor më tarifë doganore më të ulët se ai që duhej deklaruar sipas Rregullave të Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave sipas ligjit specifik për “**Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore**” i ndryshuar.

Rregulli nr.3 i Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2021 përcakton se

“Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, në pamje të parë, të klasifikueshme në dy apo më shumë krerë, klasifikimi do të ndikohet nga kriteret e mëposhtme:
(a) **kreu i cili jep përshkrimin më specifik do të preferohet nga krerët që japin një përshkrim më të përgjithshëm**. Megjithatë, kur dy apo më shumë krerë secili i referohet vetëm pjesës së materialeve apo substancave që bëjnë pjesë në mallrat e përberë apo të përziera, apo vetëm pjesës së artikujve në një grup të vendosur për shitjen me pakicë, këta krerë do të vlerësohen njëllëj të specifikuar në lidhje me këto mallra, edhe nëse njëri prej tyre jep një përshkrim më të saktë apo më të plotë të mallrave”.

Gjithashtu sipas rregullit nr. 3 të NM përcaktohet se :

3/c-Kur mallrat nuk mund të klasifikohen sipas rregullave 3(a) apo 3(b), ato do të klasifikohen në kreun i cili ndodhet i fundit në **rendin numerik, midis atyre mallrave që meritojnë të njëjtin vlerësim**.

Në përmbushje të përcaktimeve të nenit të nenit 256 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “**Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**” nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Dega Doganore Tirane të ndërmerren veprimet administrative për sanksionet respektive për shkeljet doganore të konsumuara nga subjektet që kanë kryer deklarime të gabuara tariforë të artikullit “**Hudhër**” të deklaruar në kodin tarifor *07032000* me tarifë doganore bazë 2% ndërkohë që duhej të ishte deklaruar në kodin tarifor *07129090* me **tarifë bazë 10%**.

Ilustrim/foto



Nga ana e grupi auditues janë llogaritur edhe rivlerësime të detyrimeve doganore respektive për periudhën e audituar duke llogaritur efektin negativ të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit si pasojë e deklaramit të mallit “**Hudher e Thate**” në kreun “0703” të NM në RSH.

Si rezultat i keq deklaramit dhe keqklasifikimit nga agjencitë doganore respektive rezultojnë shmangie e detyrimeve doganore veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD. Nga ana e sektorit të vlerës pranë

DVQse për sa më sipër, duhej mbajtur procesverbal me shkrim referuar nenit 273.3 të KD për praktikat doganore të pasqyruara në material.

Viti	Dav	Subjekt	Nipt	Malli	Pesha	Duhej deklar	Vlera deklar	Detyrim	Penaliet	Total	Kuq
2023	1E+05	J.	L.....M	Hudhra e ftohte(thare)	13000	10%	973492	97349	97349	194,698	
2022	83	O.	L.....J	Hudhra e ftohte(thare)	28000	10%	1992435	199244	199244	398,487	
2022	115	O.	L.....J	Hudhra e ftohte(thare)	28000	10%	1992434	199243	199243	398,487	1
2022	77336	J.	L.....M	Hudhra e ftohte(thare)	28000	10%	2182744.2	218274	218274	436,549	
								714,111		1,428,221	

Bazuar ne konstatimet e mësipërme të kryhen shqyrtime të detajuara me te thelluara nga **Drejtoria e Kontrolleve Pas Zhdoganimit** pranë Drejtorise se Përgjithshme te Doganave në bazë të nenit 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” për periudhën 01.01.2019-31.12.2021 të ndërtojë programe kontrolli specifike verifikuese për praktikat doganore që janë përpunuar sipas tabelës së mësipërme.

Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përfshijë për këtë problematikë edhe shqyrtime të detajuara pranë;

-pranë **Departamentit Teknik dhe te Akcizës** ku eshte lëshuar dhe udhëzimi specifik sipas shkresës nr. shkresa nr 4030/1 e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave datë 08.03.2011 dhe shkresa nr. 6724 prot DPD date 09.03.2016...datë për mënyrën e mostrimit dhe klasifikimit doganor për artikullin hudhër.

-pranë **Drejtorisë së Monitorimit dhe Riskut** për të analizuar përgjegjësitë dhe shkaqet e mosvënies ne profil risku te deklarimeve te mallrave ne kapitullin “07” per artikullin “Hudhër e Thatë” te deklaruar ne kreun *0703* të cilat duhet te klasifikoheshin ne kreun *0713*

-pranë **Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore** me qëllim rishikimin e çmimit referues i publikuar në nivelin **0.45 Usd /kg** origjinë NEU i cili është një çmimi referues shumë i ulët dhe nuk përputhet me rritjen tatimore që pëson ky artikull ne shitje me pakica edhe shumice si dhe nisur nga kushtet e periudhës së rritjes së çmimeve të gjithë produkteve bazë parësor edhe dytësore.

Në përfundim të analizës, gjykimeve si dhe fakteve të mësipërme, nga ana e grupit auditues janë llogaritur efekteve negative te krijuara nese ky artikull do te rezultojte me pagese detyrimit te me pasoja te mundshme ne të Ardhurat e Buxhetit te Shtetit ne **shumen 1,428,211 leke (detyrim dhe gjobe)** si pasojë e keqdeklarimit dhe shmangies se pageses se detyrimeve doganore nga deklaruesit e drejperdrejtë apo te terthortë subjektet deklarues ose agjencitë doganore respektive rezultojnë shmangie e detyrimeve doganore veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD.

Bazuar ne legjislacionin doganor te fushes te cilat duhet te trajtohen rast pas rast nga Drejtoria e Kontrolleve Pas Zhdoganimit pranë Drejtorise se Përgjithshme te Doganave duke marre ne konsiderate dhe argumentet e paraqitura nga Institucioni i Kontrollit te Larte te Shtetit me qellim arkëtimin e detyrimeve doganore te cilat do te rezultojnë si detyrime doganore përfundimtarë te papaguara ne Buxhetin e Shtetit.

Ne përfundim te procedurave te kryera te informohet menjehere Institucioni i Kontrollit te Larte te Shtetit per rezultatet e arritura me qellim kontabilizimin dhe arkëtimin e menjehershëm te detyrimeve doganore respektive dhe penaliteteve qe do te rrjedhin ne zbatim te legjislacionit doganor te fushes.

♦ **Në lidhje me deklarime të mallrave të kapitullit “39” për artikujt “Artikuj plastike”** u ritrajtuan klasifikime të gabuara tariforë të kapitullit *39* për mallrat e cituar ne tabelen e meposhteme te cilet duhet të ishte klasifikuar me tarifë doganore 6% me efekte në pagesën e tarifës doganore referuar te dhenave dhe shpjegimeve te Nomenklatures se Mallrave ne RSH

3923 – –Kutite, kasat, sendyqet dhe artikuj te ngjashem prej plastike, ne forme te vecante apo te pershtatshme per mbajtjen apo paketimin e vaferrave gjysmercuese, maskave ose grilave 6%
--

3924 Paisjet e tavolines, te kuzhines, artikuj te tjere shtepiake dhe artikuj
te tualetit, prej plastike :
3924 10 00 – Artikuj te tavolines dhe te kuzhines 6%
3924 90 00 – Te tjera..... 6 %

3925 Pajisjet e ndertimit prej plastike, te paperfshira dhe te
paspecificuara diku tjeter -----6%
3925 90 20 – Arkat per kanalizimet, tubacionet dhe kabllot e qarqeve elektrike _____6%
3925 90 80 – Te tjera6%

3926 Artikuj te tjere prej plastike dhe artikuj prej materialeve te tjera te
kreteve 3901 deri 3914:
3926 30 00 – Pershtatjet per mobilerite, karrocet apo te ngjashmet e tyre----- 6%
3926 40 00 – Statujat dhe artikuj te tjere ornamentale6%

3919 Pllaka, fleta, filma, krisafe, shirita dhe forma te tjera te rregullta, vetengjtese, prej plastike, nese jane apo jo ne role:
3919 10 – Ne role
– – Shirita, veshja e te cileve konsiston ne gome natyrore apo sintetike te
pavullkanizuar:
3919 10 12 – – – Prej polivinil kloridi apo prej polietileni 6

3921 Pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita te tjera, prej plastike:
– Celulare:
3921 11 00 – – Prej polimereve te stirenit 6 –
3921 12 00 – – Prej polimereve te vinil kloridit 6
3921 14 00 – – Prej celulozes se rigjeneruar 6 –
3921 19 00 – – Prej plastikave te tjera 6
3921 90 30 – – – Prej rreshirave fenolike 6 –
– – – Prej amino-rezinave:
– – – – Te laminuara:
3921 90 41 – – – – Lamine me presion te larte me siperfaqe dekorative nga te
dyja anet 6 –
3921 90 43 – – – – Te tjera 6 –
3921 90 49 – – – – Te tjera 6 –
3921 90 55 – – – Te tjera 6 –
3921 90 60 – – Produkte te polimerizimit te metejshem 6

Lidhur me akt konstatimin nr. 5, datë 31.05.2023, nga ana e DDT është dërguar observacioni me shkresën nr. 10738/18 prot datë 07.06.2024 nga përfaqësuesit e subjektit znj. L D dhe z. K E protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1113/3 datë 12.06.2024.

Prezantimi i subjektit: *Për vendimet Nr. 584,585,586,587, 588, 589 si dhe 590 datë 01.04.2022, kur nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se procedura e marrjes së vendimit nuk është bërë në zbatim korrekt të kuadrit ligjor i cili mirëregullon daljen me aktin administrativ dhe mundësinë që i jepet operatorit ekonomik të kundërshtojë gjatë procedurës administrative detyrimin dhe sanksionin që lindin nga ky akt administrativ, më lejoni që të kundërshtoj këtë konstatim tuajin, pasi vendimarrjet që ju konstatoni janë marrë mbi bazën e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit (Nr.1006/18 Prot., DDT date 04.10.2021) “Mbi përputhshmërinë dhe Rregullueshmërinë Financiare në Degën e Doganës Tirane per periudhen 01.01.2021-31.12.2022” të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Rekomandime këto të cilat u janë përcjellë me njoftim subjekteve përmes shkresave të komunikimit të cilat gjenden të arkivuara në Zyrën e Arkiv-Protokollit të Degës së Doganës Tiranë, pas ardhjes së observacioneve për rekomandimet e lëna nga struktura audituese, Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin Nr.12 datë 04.11.2021 ka proceduar me procesverbalet përkatëse të kundërvajtjes administrative në zbatim të këtyre rekomandimeve, duke ezauruar në këtë mënyrë procedurën e komunikimit të konsatimit të kundërvajtjes administrative. Gjithashtu duke marrë në konsideratë faktin se ka një afat të caktuar për zbatimin e rekomandimeve dhe faktin se porcesverbalet e konstatimit të kundërvajtjeve janë depozituar në limitet kohore, vlerësoj se duhet të rishikohet ngarkimi me përgjegjësi për juristin lidhur me porcedurën e komunikimit të aktit administrativ. Sjell në vëmendjen tuaj se këto për këto vendimarrje detyrimi doganor i lindur gjithashtu dhe sanksioni janë kontabilizuar me shumat përkatëse për llogari të autoritetit doganor. Lidhur me vendimin nr.676 datë datë*

19.05.2022 me subjekt Al. konstatimi nuk qëndron pasi si formë shkelje futet tek rastet e paparashikuara shprehimisht dhe për pasojë është bazuar në nenin 259 të KD. Vendimi është bazuar në procesverbalin e strukturave konstatuese.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i paraqitur nuk ka fakte e prova të reja nuk shpjegojnë se nuk janë realizuar procedurat për kryerjen e njoftimeve efikase të proces verbaleve të verifikimit të kundërvajtjes administrative, se nuk janë zbatuar afatet kohore të paraqitjes së pretendimeve nga shkelësit; se ka mungesë të arsytimit dhe argumentimit të vendimeve në kundërshtim me nenet 273, 276 të Kodit Doganor nenet 98-100 të Kodit të Procedurës Administrative të RSh. Observacioni nuk merret parasysh.

2. Nga auditimi u konstatua keq klasifikim i shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur për:
a. Thyerjen e afatit kohor të mbylljes së Regjimit të Lejimit të Përkohshëm
b. Mos përfitim të trajtimit tarifor preferencial.

2.a Nga auditimi mbi vendimet administrative të marra nga kjo Degë Doganore konstatohet klasifikim të gabuar të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur për shkeljen e afatit kohor të mbylljes të Regjimit të Lejimit të Përkohshëm, konstatohet në këto vendime mungesë të përshkrimit dhe mënyrës së kryerjes së shkeljes si për automjetet e përdorimit privat dhe mallrat, konkretisht:

- Auditimi i vendimeve të marra gjatë muajve prill, maj, qershor të vitit 2022 për shkeljen e afatit të regjimit të lejimit të përkohshëm, për automjetet e përdorimit privat:

Nga auditimi i vendimeve për shkeljen e afatit të regjimit të lejimit të përkohshëm, për automjetet e përdorimit privat, klasifikimit të shkeljes doganore dhe bazës ligjore të aplikuar në këto raste konstatohet klasifikim të gabuar në nenin 259/1/b të Kodit Doganor dhe sanksion të gabuar në shumën 20,000 lekë. Gjithashtu këto vendime kanë bazë ligjore të ndryshme nga procesverbalet për verifikimin e kundërvajtjes administrative dhe kanë mungesë arsytimi, argumentimi, kanë mangësi të përshkrimit dhe mënyrës së kryerjes së shkeljes. (Në PV ka bazë ligjore nenet 250/1/a;256/1/b të Kodit Doganor dhe Vendimet bazë nenin 259/1/b i Kodit Doganor).

Për këto vendime kemi të bëjmë me një vendim/autorizim të dhënë në bazë të nenit 192 të Kodit Doganor kundërvajtja klasifikohet kundërvajtje në neglizhencë, në përputhje me nenin 252, gërma c) të Kodit Doganor dhe për këtë shkelje aplikohet penaltet minimalisht në masën 50,000 lekë në bazë të nenit 257/1/b të Kodit Doganor;

Nenin 252, gërma c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Neni 257 “Sanksionet për kundërvajtjet e kryera në neglizhencë”, ku citohet:

1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

Konkretisht për muajin prill ka keqklasifikim të shkeljes dhe sanksionit të vendosur në nëntë vendime:

Tabela nr. 9. Vendimet e muajit prill 2022 me keqklasifikim të shkeljes

Nr	Nr dhe datë vendimi	Subjekti/Individi	Nipti/ID	Agjencia doganor	Kodi	Deklarata IMP4	Datë
1	598 datë 04.04.2022	Q W	L.....P	C G	J101	R31572	04.04.2022
2	599 datë 05.04.2022	D S	F.....V	Sa	J023	R32078	05.04.2022
3	602 datë 07.04.2022	H Xh	G.....N	Ce	J024	R32981	07.04.2022
4	604 datë 11.04.2022	K C	I.....J	C G	J101	R34355	11.04.2022
5	607 datë 19.04.2022	S Xh	J.....G	En	J109	R37561	19.04.2022

6	619 datë 22.04.2022	B T	L.....D	Dr	J033	R38722	22.04.2022
7	624 datë 27.04.2022	H K	L.....P	Dr	J033	R40452	27.04.2022
8	625 datë 27.04.2022	B LI	L.....P	C&	J119	R40451	27.04.2022
9	626 datë 29.04.2022	I D	H.....	Dr	J033	R41369	29.04.2022

Burimi: Vendimet e DDT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për këto nëntë vendime për keq klasifikim të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur kemi të ardhura të munguara në shumën 270,000 lekë (9x30,000 lekë). Përgjegjës për këto vendime Juriste znj. L D.

Për muajin maj 2022, për klasifikime të gabuara të thyerjes së afatit të RLP-së për automjete të përdorimit privat ka keqklasifikim për 11 vendime:

Tabela nr. 10. Vendimet e muajit maj 2022 me keqklasifikim të shkeljes

Nr	Nr dhe datë vendimi	Subjekti/Individi	Nipti/ID	Agjencia doganor	Kodi	Deklarata IMP4	Datë
1	629, datë 04.05.2022	I T	L.....D	C7	J119	R41468	29.04.2022
2	647, datë 09.05.2022	M V	J.....N	Le	J123	R43954	06.05.2022
3	656, datë 11.05.2022	D D	L.....Q	Sa	J023	R43142	04.05.2022
4	658, datë 12.05.2022	A K	J.....G	Dr	J033	R41607	29.04.2022
5	665, datë 16.05.2022	G B	L.....E	En	J033	R46568	14.05.2022
6	670, datë 17.05.2022	E S	L.....E	Ce	J024	R47609	17.05.2022
7	677, datë 19.05.2022	F I	J.....K	Ur	J098	R48636	19.05.2022
8	700, datë 26.05.2022	K D	J.....E	Ce	J024	R50975	24.05.2022
9	702, datë 27.05.2022	V G	H.....L	Dr	J033	R52094	27.05.2022
10	703, datë 30.05.2022	E H	H.....L	Ce	J024	R52804	30.05.2022
11	713, datë 31.05.2022	A M	H.....M	En	J109	R53087	30.05.2022

Burimi: Vendimet e DDT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për këto 11 vendime për keq klasifikim të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur kemi të ardhura të munguara në shumën 330,000 Lekë (11x30,000 lekë).

Përgjegjës për 8 vendime juriste znj. L D dhe për 3 vendime jurist z. K E.

Për muajin qershor 2022, për klasifikime të gabuara të thyerjes së afatit të RLP-së për automjete të përdorimit privat ka keqklasifikim për katër vendime:

Tabela nr. 11. Vendimet e muajit qershor 2022 me keqklasifikim të shkeljes

Nr	Nr dhe datë vendimi	Subjekti/Individi	Nipti/ID	Agjencia doganor	Kodi	Deklarata IMP4	Datë
1	759, datë 09.06.2022	A D	H.....L	Dr	J033	R57487	09.06.2022
2	760, datë 09.06.2022	A E	H.....Ë	Lo	J029	R57286	08.06.2022
3	784, datë 21.06.2022	A B	L.....P	Ur	J098	R62262	21.06.2022
4	761, datë 10.06.2022	Z P	J.....T	Dr	J033	R57834	10.06.2022

Burimi: Vendimet e DDT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për këto katër vendime keq klasifikim të shkeljes së kryer dhe keq klasifikim të sanksionit të vendosur ka të ardhura të munguara në shumën 120,000 lekë (4x30,000 lekë).

Përgjegjës për këto vendime Juriste znj. L D.

- Auditimi i vendimeve për shkeljen e afatit të lejimit të përkohshëm për mallrat klasifikimit të shkeljes doganore dhe bazë ligjore të aplikuar në këto raste konstatojmë klasifikim të gabuar në nenin 259/1/b të Kodit Doganor dhe sanksion të gabuar në shumën 20,000 lekë duke qënë se shkelja e kryer është kundërvajtje administrative parashikuar në nenet 250/a, 252/c të Kodit Doganor dhe sanksioni në nenin 2571/b të Kodit Doganor minimalisht në shumën 50,000 lekë.

Konkreisht për muajin prill 2022, dy vendime, vendimi nr. 596, datë 04.04.2022 dhe vendimi nr. 597, datë 04.04.2022 subjekti "I E" SHPK me NUIS K.....U ka klasifikim të gabuar të shkeljes dhe sanksionit të vendosur.

Për këto dy vendime për keq klasifikim të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur kemi të ardhura të munguara në shumën 60,000 lekë (2x30,000lekë). Përgjegjëse për këto dy vendime juriste znj. L D.

Për muajin maj 2022, tre vendime, me klasifikim të gabuar të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur në lidhje me thyerjen e afatit të RLP-së për subjektet e mëposhtme:
-Vendimi nr. 673, datë 18.05.2022, subjekti "T" SHPK me NUIS K.....L ka shkelur afatin e rieksporit dhe bazuar në nenin 2591/b të Kodit doganor është dënuar me gjobë 20,000 lekë. Ky vendim konstatojmë se ka klasifikim të gabur të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur pasi shkelja klasifikohet në nenin 252/2/c dhe sanksioni në nenin 257/1/b në shumën 50,000 Lekë. Përgjegjëse juriste znj. L D.

-Vendimi nr. 674, datë 18.05.2022, subjekti "RO" SHPK me NUIS JV ka shkelur afatin e rieksporit dhe bazuar në nenin 2591/b të Kodit doganor është dënuar me gjobë 20,000 lekë. Ky vendim konstatojmë se ka klasifikim të gabur të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur pasi shkelja klasifikohet në nenin 252/2/c dhe sanksioni në nenin 257/1/b, në shumën 50,000 Lekë. Përgjegjëse juriste znj. L D.

-Vendimi nr. 676, datë 19.05.2022, subjekti "A" SHPK me NUIS L.....M ka shkelur afatin e rieksporit dhe bazuar në nenin 2591/b të Kodit doganor është dënuar me gjobë 20,000 lekë. Ky vendim konstatojmë se ka klasifikim të gabur të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur pasi duhet të klasifikohet në nenin 252/2/c dhe sanksioni në nenin 257/1/b në shumën 50,000 Lekë. Përgjegjës jurist z. K E.

Për këto tre vendime për keq klasifikim të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur kemi të ardhura të munguara në shumën 90,000 lekë (3x30,000 lekë).

Për muajin qershor 2022, me keq klasifikim të shkeljes së afatit të regjimit RLP dhe sanksionit të vendosur për dy vendime:

-Vendimi nr. 714, datë 02.06.2022, subjekti "Ne F" SHPK me NUIS M.....D ka shkelur afatin e rieksporit regjimi RLP dhe bazuar në nenin 2591/b të Kodit doganor është dënuar me gjobë 20,000 lekë. Ky vendim konstatojmë se ka klasifikim të gabur të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur pasi klasifikohet në nenin 252/2/c dhe sanksioni në nenin 257/1/b në shumën 50,000 Lekë. Përgjegjës juriste znj. L D.

-Vendimi nr. 715, datë 02.06.2022, subjekti "AL" SHPK me NUIS J.....T ka shkelur afatin e rieksporit regjimi RLP dhe bazuar në nenin 2591/b të Kodit doganor është dënuar me gjobë 20,000 lekë. Ky vendim konstatojmë se ka klasifikim të gabur të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur pasi shkelja klasifikohet në nenin 252/2/c dhe sanksioni në nenin 257/1/b në shumën 50,000 Lekë. Përgjegjës juriste znj. L D.

Për këto dy vendime ka të ardhura të munguara në shumën 60,000 Lekë.

2.b Për vitin 2022, një vendim me klasifikim të gabuar të shkeljes së kryer dhe sanksionit të vendosur për mallrat në rastet kur pas verifikimit pranë autoriteteve doganore të vendit eksportues rezulton se prova e origjinës preferenciale është autentike por malli i eksportuar drejt Shqipërisë nuk plotëson kushtet për përfitimin e origjinës preferenciale. Operatori ekonomik depozites i kësaj prove origjine pranë autoriteteve doganore shqiptare është kundërvajtës sipas nenit 256, pika 2/a të KD dhe sanksionohet bazuar në nenin 256, pika 1/a e KD, duke paguar shumën e plotë të detyrimeve doganore që duheshin paguar në kushtet e mungesës së preferencës ndaj origjinës dhe një gjobë në masën 1-fish të detyrimit të munguar.

Në vendimin nr. 763, datë 13.06.2022, subjekti "B I" SHPK me NUIS L.....M është vendosur: subjekti të paguajë diferencën e detyrimit të importit të rezultuar në shumën prej 179,751 lekë. Ky vendim është në kundërshtim me Proces Verbalin për Verifikimin

e Kundërvajtjes Administrative me nr. serie 0022850, nr. 3547 prot., datë 11.04.2022 nga Zyra e Aposteriorit në bashkëpunim me Zyrën e Analizës së Riskut për këtë rast është vendosur se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative, megjithëse mallrat e mbuluara nga certifikata lëvizëse Euro1 nr. A-1084988T dt.30.04.2020, lëshuar nga zyra doganore, nënshkrimi dhe vula janë autentike, ato nuk përfitojnë trajtim preferencial. Subjekti të paguajë detyrimin dhe sipas nenit 256 të KD të sanksionohet me 1-fishin e detyrimit. Ky vendim është në kundërshtim edhe me qëndrimin e mbajtur nga kjo degë doganore në vendimet nr. 775, datë 20.06.2022 dhe 776, datë 20.06.2022 në të cilat DDT në të cilët megjithëse deklaratat faturë, certifikatat lëvizëse janë autentike mallrat nuk përfitojnë origjinë preferenciale dhe në bazë të neneve 250,251/2/a/b, 256/1/a, 262, 276 ka vendosur subjektet të paguajnë detyrimin doganor dhe penalizohen me njëfishin e detyrimit.

U konstatua se vendimi nr.763, datë 13.06.2022 subjekti “B I” SHPK me NUIS L.....M është në kundërshtim të nenit 49-64, 251 të Kodit Doganor. Në këtë rast subjekti ka kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 251/2/b të Kodit Doganor: “mosrespektim nga personi, që depoziton deklaratën doganore, i detyrimit për të siguruar vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 2 të nenit 23;”. Për këtë kundërvajtje subjekti nuk është penalizuar sipas nenit 256/1/a të Kodit Doganor, me një fishin e detyrimit, si pasojë kemi të ardhura të munguara në shumën 179,751 lekë. Përgjegjës jurist znj. L D.

Nga auditimi u konstatuan në total të ardhura të munguara në formën e gjobës në shumën 1,109,751 lekë.

Përgjegjës Juristët e Degës Doganore znj. L D, z. K E në bazë të nenit 11 pika 4 “Kompetencat më të rëndësishme të juristit” të Urdhërit nr. 146, datë 07.05.2018 “Rregullore e degëve doganore” të DPD-së sipas të cilës: *juristi përgatit vendime, urdhra të brendshëm, kontrata etj, dhe raporte në vijimësi për Kryetarin e Doganës si dhe analizat e punës në periodicitete për periudhat e kërkuara.*

Përgjegjës ish Kryetari i Degës Doganore z. J. M në bazë të nenit 9 “Kryetari i Degës Doganore dhe kompetencat e tij”, të Urdhërit nr. 146, datë 07.05.2018 “Rregullore e degëve doganore” të DPD-së, pika 4 sipas të cilës: *Kryetari i Degës Doganore është struktura vendimarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e Degës Doganore si dhe në lidhje me gjithë aktivitetin e përditshëm të degës.*

(Mbajtur ne terren Akt Konstatimi nr 5 date 31.05.2024)

1-Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1113/5 prot KLSH datë 26.06.2024 derguar Degës Doganore Tiranë kanë ardhë observacionet dhe dokumentacioni justifikues me shkresën nr. 10738/26 datë 30/08/2024 pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë dhe subjekti i audituar ka bërë komente dhe shpjegime.

Pretendimi i subjektit: Konstatohen vendime per klasifikim te gabuar te shkeljes se kryer dhe sanksionit te vendosur per rastet e marra ne shklje te RLP-se per automjete, si me poshte referoj per keto vendimarrje : Vendimet nr 598 datë 04.04.2022, 599 datë 05.04.2022, 602 datë 07.04.2022, 604 datë 11.04.2022,607 datë 19.04.2022, 619 datë 22.04.2022, 624 datë 27.04.2022, 625 datë 27.04.2022 dhe 626 datë 29.04.2022 ; vendimet nr.629 datë 04.05.2022, 647 datë 09.05.2022, 656 datë 11.05.2022, 658 datë 12.05.2022, 665 datë 14.05.2022, 670 datë 17.05.2022, nr.700 datë 26.05.2022, nr.702 datë 27.05.2022, nr.759 datë 09.06.2022, nr.760 datë 09.06.2022, 761 datë 10.06.2022 dhe 761 datë 10.06.2022. Gjithashtu për të njëjtën natyre të kundërvajtjes administartive përmend dhe vendimet Nr.48 datë 12.01.2023 dhe Nr.89 datë 10.01.2023. Grupi i auditimit vlerëson se shkelja e afatit të mbylljes së RLP-së, duke qënë se kemi të bëjmë me një autorizim/vendim të dhënë në bazë të nenit 192 të Kodit Doganor, kundërvajtja e kryer

duhet të klasifikohet "kundërvajtje në neglizhencë", në përputhje me nenin 252, gërma c) të Kodit Doganor dhe për këtë shkelje duhet të aplikohet një gjobë në mbështetje të nenit 257/1/b të Kodit Doganor. Si më poshtë ju bëj me dije se :

Të gjitha aktet administrative sa më lartë trajtuar në këtë auditim kanë dalë në bazë të nenit 10, 72, 74/1a, 74/2a, 74/3a, 169, 250/1a, 250/2, sanksionuar sipas nenit 259/1b, 262, 273 e vijues, 276 të Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i RSH"), të VKM –së nr. 651, datë 10.11.2017 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014" .

Në mbështetje të legjislacionit doganor shqiptar si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm me nr. 4, datë 04.02.2010 « Për zbatimin e procedurave të miratimit, mbikëqyrjes dhe përmbylljes së rregjimit të lejimit të përkohshëm të automjeteve të huaja për përdorim privat » lidhur me parashikimin e nenit 3 të nenit 650 Vendi për paraqitjen e aplikimit të VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 « Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor » në të cilën citohet se : "Policisë Kufitare dhe Migracionit i delegohet e drejta për vendosjen nën regjimin e lejimit të përkohshëm të automjeteve rrugore për përdorim privat, të cilat plotësojnë kushtet për dhënien e këtij regjimi. Vendosja nën këtë regjim, si rast specifik, bëhet nëpërmjet regjistrimit në rrugë elektronike, në sistemin TIMS. Mbikëqyrja dhe mbyllja e këtij regjimi bëhen nga autoritetet doganore, në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe Migracionit, sipas kompetencave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. ", gjatë përpilimit dhe përpunimit të deklaratës doganore sipas Udhëzimit me nr. 05/2194 Prot., datë 26.01.2018 "Mbi procedurat standarte të SVQ-së dhe SKAO-s" të DPD-së nga ana e doganierit dhe përgjegjësit të Sektorit të Vlerësimit në Qendër pranë DPD-së sipas pikës "e" Konstatimi i shkeljeve doganore kur konstatojnë shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore është hartuar procesverbali i verifikimit të shkeljes doganore, i cili është përcjellur për procedurë pranë autoritetit doganor kompetent.

Akti i konstatimit përpilohet në përputhje me nenin 274 të KD; Autoriteti Doganor Kompetent Vendimarrës merr vendim të arsyetuar në përputhje me nenin 276 të Kodit Doganor, Marrja e vendimit dhe njoftimi; Gjatë marrjes së Vendimeve Administrative nga autoriteti Vendimarrës Kompetent është mbajtur në konsideratë që sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara sipas Kodit Doganor duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe të vendosen brenda kufijve ligjore.

Kjo nisur nga: 1. administrimi i akteve të konstatimit të mbajtur nga Strukturat e Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër/Struktura të Sketorit të Operacioneve pranë Degëve Doganore për të cilën është mbajtur një qëndrim lidhur me cilësimin e shkeljes së kryer me përgjegjësi objektive dhe masa e penaltit është e vendosur në shumën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë sipas përcaktimeve të nenit 256/1b ose 259/1b të Kodit Doganor mbi bazën e të cilit dhe organi kompetent vendimarrës dega doganore ka proceduar me vendime administrative sipas rastit nga ku rezulton që nuk është trajtuar si shkelje, kundërvajtje e kryer në neglizhencë sipas nenit 252 të Kodit Doganor. 2. të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Drejtoria e Hetimit pranë Departmentit Operativ- Hetimor në materialin e tyre dërguar për vendimarrje Degës së Doganës Durrës me nr. 2465 Prot., datë 03.02.2020, akti i konstatimit të shkeljes doganore me nr. 0015306, datë 24.01.2020, duke përcaktuar si bazë ligjore për thyerje të RLP-së të automjetit nenin 250/1a dhe 259/1b dhe masë penalteti 20 000 lekë, në bazë të të cilit Dega e Doganës ka marrë Vendimin Administrativ me nr. 195/3154 Prot., datë 05.03.2020; 3. Rezulton se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me vendimin administrativ me nr. 8196/1 Prot., datë 08.06.2021, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e bërë nga palë kërkuese shtetasi Emiljano Shkira me ID H61005123K me objekt "Kundërshtim i Vendimit nr. 543, datë 08.05.2021

të Degës së Doganës Durrës” që ka të bëjë me thyerje të rregjimit të lejimit të përkohshëm të mallit “autoveturë e përdorur Volksäagen Touran” të deklaruar me Imp. 4 R. 47918, datë 29.04.2021 ka vendosur në bazë të nenit 282 të Kodit Doganor “Lënien në fuqi të Vendimit nr.53, datë 08.05.2021 të DDD dhe rrëzimin e kërkesës ankimore me nr. 8196 Prot., datë 10.05.2021 të shtetasit Emiljano Shkira”

Aktualisht normimi i kësaj shkelje doganore është bërë edhe në Urdhërin nr. 05, datë 12.01.2024 të DPD-së me nr. 814/1 Prot., datë 12.01.2024 “Manual udhëzues mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në RSH-në” që për të gjitha rastet e trajtuara nga ana e Juaj më lartë është shprehur: parashikimit të V. “Cështje Specifike të Lidhura me Shkelje të RLP-së të Automjeteve për Përdorim privat” të Urdhërit nr. 05, datë 12.01.2024 të DPD-së me nr. 814/1 Prot., datë 12.01.2024 “Manual udhëzues mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në RSH-në” në të cilën citohet se: Megjithatë, për efekt të zbatimit të nenit 262 të Kodit dhe në kushtet kur nuk ka një aplikim të mirëfilltë në zbatim të nenit 27 të Kodit por, në zbatim të pikës nenit 3 të nenit 650 Vendi për paraqitjen e aplikimit të VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 « Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor » në të cilën citohet se : “Policisë Kufitare dhe Migracionit i delegohet e drejta për vendosjen nën regjimin e lejimit të përkohshëm të automjeteve rrugore për përdorim privat, të cilat plotësojnë kushtet për dhënien e këtij regjimi. Vendosja nën këtë regjim, si rast specifik, bëhet nëpërmjet regjistrimit në rrugë elektronike, në sistemin TIMS. Mbikëqyrja dhe mbyllja e këtij regjimi bëhen nga autoritetet doganore, në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe Migracionit, sipas kompetencave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. ”, në diskrecion të saj, Dega Doganore Vendimarrëse, kur konstaton se personi përgjegjës nuk është përsëritës dhe është bashkëpunues, mund t’i referohet sanksionit të parashikuar në nenin 259 të Kodit në analogji me shkeljet e referuara për RPA apo RPP në nenin 251 të Kodit. Në trajtim të Nenit 262 : Neni 262 “Caktimi i llojit dhe masës së sanksioneve për kundërvajtjet administrative” i Kodit Doganor ; Mbështetur në parimin e proporcionalitetit, parashikuar në nenin 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit” dhe neni 12 “Parimi i proporcionalitetit “ të Ligjit nr. 44/2015 të “Kodit të Procedurave Administrative”, I ndryshuar ;

Pra, organi doganor ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t’u paguar për hedhjen në qarkullim të lirë të mallrave tip automjete rrugore për përdorim privat. Referuar praktikës së konsoliduar të Gjykatës ashpërsia e penaliteteve nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke patur në konsideratë faktin që shtetasit janë paraqitur pranë autoritetit doganor për të dhënë destinaconin doganor automjetit si dhe kanë paguar shumën e detyrimeve që rrjedhin si rezultat i hedhjes në qarkullim të lirë të automjeteve për përdorim privat.

Rezulton nga administrimi i fakteve dhe rrethanave se: -Nga ana e organit konstatues DVQ-ja mbahet një qëndrim lidhur me cilësimin e shkeljes së kryer me përgjegjësi objektive dhe masa e penaltetit është e vendosur në shumën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë sipas përcaktimeve të nenit 256/1b ose 259/1b të Kodit Doganor mbi bazën e të cilit dhe organi kompetent vendimarrës dega doganore ka proceduar me vendime administrative sipas rastit nga ku rezulton që nuk është trajtuar si shkelje, kundërvajtje e kryer në neglizhencë sipas nenit 252 të KD.

Dega e Doganës Tiranë gjatë marrjes së këtyre vendimarrjeve ka marrë në analizë të gjithë faktorët përcaktues të një shkelje doganore duke konkluduar që në të gjitha rastet deklaruesit janë paraqitur vetë për deklarimin në qarkullim të lirë / eksport mjetet e tyre; nuk janë përsëritës; kanë pranuar pagesën e menjëhershme të penaltetit të vendosur pra

kanë qenë bashkëpunues dhe jo përsëritës dhe në këtë mënyrë kanë respektuar edhe Urdhërin nr. 05, datë 12.01.2024 të DPD-së me nr. 814/1 Prot., datë 12.01.2024 “Manual udhëzues mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në RSH-në” duke procedurë me bazën ligjore për sanksionim nenin 259 të Kodit Doganor. - Në këto kushte mendoj se vendimarrja administrative e Degës së Doganës Tiranë është e mbështetur në ligj dhe në akte dhe si e tillë nuk mund të procedohet me rishikim të tyre apo me saktësim të bazës ligjore. Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë ka parashikuar dhe rastet se e drejta e ankimit ndaj një vendimi të marrë nga autoritetet doganore kompetente në lidhje me një borxh dhe /ose vendosjen e sanksioneve mund të ushtrohet fillimisht pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave e më pas përpara autoriteteve gjyqësore, sipas parashikimeve të nenit 281 E drejta e ankimit “1. Çdo person ka të drejtë të ankohet kundër çdo vendimi të marrë nga autoritetet doganore, në lidhje me një borxh dhe/ose vendosjen e sanksioneve në lidhje me zbatimin e këtij Kodi. 2. E drejta e ankimit mund të ushtrohet fillimisht pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave e, më pas, përpara autoriteteve gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi.”

Ligji nr. 45/2015 “Kodi I Procedurës Administrative”, i ndryshuar ka parashikuar në neni 128 Legjitimimi dhe mjetet e ligjore administrative dhe në nenin 129 të Kodit të Procedurës Administrative Shterimi i mjeteve ligjore administrative Bazuar në qëndrimet e mbajtuara nga Gjykata Kushtetuese nëpërmjet Vendimeve Nr.5/2001, Nr. 24/2002 dhe nr. 11/2014 interpretimi i legjislacionit është e drejtë e organit që merret me zbatimin e tij, referuar këtij qëndrimi të unifikuar në Gjykatën Kushtetuese, Dega e Doganës Tirane ka qenë kompetente dhe ka interpretuar legjislacionin konform ligjit doganor në fuqi në Vendimet objekt të auditimit nga ana e Juaj.

Gjithashtu kjo është e argumentuar dhe me shkresën Nr.15542/1.Prot datë 03.08.2015 të Drejtorisë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në të cilën citohet se: interpretimi i ligjeve është para se gjithash e drejta për çdo Organi që i zbaton ato ... Mbështetur në këtë qëndrim të unifikuar të Gjykatës Kushtetuese, Dega Doganore në kompetencën e organit zbatues bën interpretimin e legjislacionit doganor mbështetur në shqyrtimin e fakteve dhe provave, rast pas rasti në evidentimin e shkeljeve në fushën e doganave.

Përsa më lart, në analizën e thelluar si dhe në arsyetimet përkatëse në trajtimin për çdo rast të Vendimarrjeve Administrative, për zbatimin e legjislacionit doganor për rrethana specifike që lidhen me vendosjen në rregjimin e lejimit të përkohshëm të automjeteve jo nga autoriteti doganor sipas përcaktimeve të neneve 191 deri 202, 223 deri 226 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (në mungesë të një Autorizimi apo Vendimi të favorshëm sipas legjislacionit doganor) dhe neneve 533 deri 534, 649 deri 685 të VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" por delegimit të së drejtës për vendosjen nën regjimin e lejimit të përkohshëm të automjeteve rrugore për përdorim privat, të cilat plotësojnë kushtet për dhënien e këtij regjimi, si rast specifik, që bëhet nëpërmjet regjistrimit në rrugë elektronike, në sistemin TIMS bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Brendshme nr. 4, datë 04.02.2010, “Për zbatimin e procedurave të miratimit, mbikqyrjes dhe përmbylljes së regjimit të lejimit të përkohshëm të automjeteve të huaj për përdorim privat », konstatova se Vendimarrjet objekt auditimi janë të mbështetura në ligj dhe në prova dhe si rrjedhojë rekoandimi për zbatimin e nenit 257 të Kodit Doganor në rastet e konstatimit të shkeljes së afatit të RLP-së të mjeteve për përdorim privat, vjen në kundërshtim të hapur me ligjin material, për shkak se nenin 252 i Kodit Doganor « Kundërvajtje të kryera në neglizhencë » nuk është i parashikuar rasti i sipërcituar.

Pra, organi doganor ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi

doganor i lindur për t'u paguar për hedhjen në qarkullim të lirë të mallrave tip automjete rrugore për përdorim privat.

Referuar praktikës së konsoliduar të Gjykatës ashpërsia e penaliteteve nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke patur në konsideratë faktin që shtetasit janë paraqitur pranë autoritetit doganor për të dhënë destinacionin doganor automjetit si dhe kanë paguar shumën e detyrimeve që rrjedhin si rezultat i hedhjes në qarkullim të lirë të automjeteve për përdorim privat.

Duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme nga e cila duhet të udhëhiqet administrata doganore në kryerjen e funksioneve të saj si parimi i ligjshmërisë, parimi i mbrojtjes së interesit publik por pa çënuar të drejtat e personave privat, parimi i drejtësisë dhe paanësisë, parimi i përgjegjshmërisë, parimi i kontrollit gjyqësor etj..parime këto të sanksionuara në Ligjin nr. 44/2015 « Kodi i Procedurës Administrative në RSH-në » rezulton se nga ana e Autoriteti Vendimarrës Kompetent është vlerësuar në përputhje të plotë me ligjin.

Nëse i referohemi praktikës gjyqësore tashmë të konsoliduar ashpërsia e penalitetit nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke marrë në konsideratë edhe faktin që shtetasit janë paraqitur vullnetarisht pranë autoritetit doganor për të dhënë destinacion automjetit si dhe kanë paguar shumën e detyrimeve që rrjedhin si rezultat i zhdoganimit të automjeteve për përdorim privat.

Konstatohen 6 vendime me parregullsi në klasifikimin e shkeljes për RLP të ndryshme nga makinat.

Në rastin e RLP qendron i njëjti interpretim si për rastin e RLP-se se makinave. Pra baza ligjore që duhet të aplikohet është neni 259 për shkelje të paparashikuara shprehimisht. Sqarojmë se në çdo rast dokumentacioni për nxjerrjen e vendimeve të cituara nga ana Juaj ndodhet në Sekretarinë e Doganës Tirane si edhe gjithashtu është respektuar procedura e nxjerrjes së aktit. Në rast Zyra Juridike ka kërkuar në vazhdimësi nga struktura konsultuese plotësimin e materialit për vendimarrje nga struktura konstatuese, Zyra e Rregjimeve Doganore. Për sa më lart, klasifikimi i shkeljes doganore lidhur me afatin e mbylljes së RLP së është unifikuar në të gjithë sistemin doganor.

Rezulton se vendimet e Degës së Doganës Tirane janë nxjerrë mbi bazën e procesverbaleve të shkeljeve doganore, si rrjedhojë e aplikimit të saktë të dispozitave ligjore që i përgjigjen shkeljes doganore të kryer të konstatuara nga Struktura doganore respektive, pra referenca ligjore është e saktë dhe për pasojë sanksionet e vendosura janë korrekte.

Duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme nga e cila duhet të udhëhiqet administrata në kryerjen e funksioneve të saj si “Parimi i ligjshmërisë; parimi i mbrojtjes së interesit publik por pa çënuar të drejtat e personave privat; parimi i drejtësisë dhe paanësisë; parimi i përgjegjshmërisë; parimi i kontrollit gjyqësor etj”, parime këto të sanksionuara në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, shprehemi se nga ana Jonë është vepruar në përputhje të plotë me ligjin. Gjithashtu, edhe po ti bëjmë një interpretim llogjik të shkeljes, duke e krahasuar edhe me shkelje të ngjashme sic është thyerja e afateve të ndryshme lidhur me mbylljen e rregjimeve si në rastin e RPA apo RLP-se etj, konstatohet se këto shkelje ligjvënasi i ka trajtuar si shkelje me përgjegjësi objektive nën 251, çfarë do të thote që duke patur parasysh natyrën jo aq të rëndë të saj si shkelje sanksionet duhet të jenë të lehta sipas nenit 251 në lidhje me nenin 256 të Kodit Doganor.Po ashtu, çështja duhet të parë edhe në kuadër të parimeve të proporcionalitetit të sanksionit me shkeljen. Në shumë raste duke patur parasysh shumën e detyrimit doganor do të rezultonte një gjobë me e madhe dhe tepër e ashpër po të aplikohet nën 252.

Gjatë marrjes së Vendimeve Administrative nga autoriteti Vendimarrës Kompetent është mbajtur në konsideratë që sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara sipas Kodit Doganor duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe të vendosen brenda kufijve ligjore. Neni 252 dhe 257 nuk janë referenca e sakte ligjore për raste të tilla, keq orientime të tilla sjellin me pas dhe rendesen administrative të pozicionit të administrates perballe gjyqesorit.

Përsa më lart vendimarrja është e argumentuar dhe e mbështetur në ligj, është në diskrecionin e autoritetit vendimarrës të përcaktojë llojin e masës së sanksioneve lidhur me kundërvajtjen administrative të konstatuar. Në përfundim, Rezulton se vendimet e Degës së Doganës Tirane janë nxjerrë mbi bazën e procesverbaleve të shkëlqeve doganore, si rrjedhojë e aplikimit të saktë të dispozitave ligjore që i përgjigjen shkëlqes doganore të kryer të konstatuara nga Struktura doganore respektive, pra referenca ligjore është e saktë dhe për pasojë sanksionet e vendosura janë korrekte.

Me anë të shkresës nr. 4557/1 prot., datë 18.03.2021 (Nr.2852 Prot., DDT date 23.03.2022), Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka informuar lidhur me përgjigjen e autoriteteve doganore të Spanjës nëpërmjet shkresës Nr.27520/22 date 17.02.2022 (Nr.4557 Prot. DPD date 03.03.2022) sipas të cilave: “Certifikata EUR I A 1084988 T është lëshuar nga Zyra Doganore si dhe nënshkrimi, ashtu edhe vula janë autentike, megjithatë është konstatuar se pas kryerjes së verifikimeve të duhura është konstatuar se mallrat e mbuluara nga certifikata EUR I e lartpërmendur nuk janë në përputhje me rregullat e origjinës preferenciale. Si rezultat, mallrat e përshkruara në këtë provë origjine nuk kualifikohen për trajtim preferencial.” Në vijimësi nga ana e Zyrës Aposteriori është mbajtur Procesverbali me Nr. Serial 0022850 (nr. 3547 prot., datë 11.04.2022) “Për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, përmes së cilit pasqyrohet vlera e detyrimit të munguar për praktikën doganore IM4 R 33004 datë 20.05.2020, i cili rezulton të jetë në masën 179,751 lekë.

Në respektim të kuadrit ligjor në fuqi i cili mirërregullon procedurën e komunikimit të cdo akti të autoriteti doganor Operatoreve Ekonomik (Ligji Nr.102/2014 neni 273 e në vijim), u njoftua edhe subjekti, nëpërmjet shkresës nr. 3547/1 prot., datë 21.04.2022.) Nga ana e Operatorit Ekonomik është proceduar me depozitimin e observacionit pranë Degës së Doganës Tirane, shkresa Nr.4691 Prot., date 17.05.2022. Ankim ky ndaj “Procesverbalit të Konstatimit të kundërvajtjes Administrative”. Nga ana e shoqërisë në Observacionin e depozituar është pretenduar ndër të tjera se: ...ky dokument nuk përpilohet nga shoqëria Jonë, por nga autoritet doganore spanjolle, nëse eksportuese plotëson kushet e kërkuara nga Eur.I, ndërkohë që vetë autoriteti doganor spanjoll e ka firmosur e vulosur këtë dokument, cka do të thotë që përgjegjësia e plote i takon këtij autoriteti. Në momentin e ardhjes së mallit në kemi dorëzuar cdo dokumentacion të dërguar nga eksportuesi ynë, i cili është vlerësuar i rregullt dhe nga autoritet doganore shqiptare, për këtë arsye bazuar në rregullat ligjore të pranuar ndërkombëtarisht, dokumentacioni i mesipërm, duke përfshirë dhe ato të lëshuara nga autoriteti doganor shqiptar, janë plotësisht të mjaftueshëm për të vërtetuar autenticitetin e mallit. Në vijimësi, pas konstatimit të fakteve reale dhe atyre të paraqitura në mënyrë Dokumentare nga strukturat doganore por dhe nga Operatori Ekonomik, Vlerësoj si më poshtë vijon: Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedures Administrative ne Republikën e Shqipërisë” në tërësinë e frymës ligjore që ndjek, përcakton sundimin e ligjit si parimin bazë më të rëndësishëm për kryerjen e procedurave administrative. Ai bën të qartë se jo vetëm duhet të respektohet legjisllacioni i zbatueshëm i Republikës së Shqipërisë, por dhe faktin se organet publike duhet të respektojnë edhe aktet e tjera normative që kanë fuqi juridike. Neni 14 Parimi i objektivitetit; neni 16 Parimi i marrjes së vendimeve, Neni 77 Parimi i hetimit kryesisht. Në frymën dhe dispozitat e këtij ligji, mbështetur në parimet e hetimit

administrativ ku në kuadër të ushtrimit të pushtetit administrativ, është detyra e organit publik të hetojë me përgjegjësi të plotë faktet dhe rrethanat domethënëse për një çështje administrative, të vlerësojë dhe të cmojë çdo provë në hollësi, të realizojë një hetim gjithpërfshirës, të sigurojë vendime të drejta ligjore dhe në vecanti vendime të verteta administrative. Në tërësinë e rrethanave dhe fakteve të paraqitura, kuadri ligjor administrativ shprehimisht përcakton parimet administrative të ekzistencës së shkeljes e cila në mirë përcaktimin e saj kërkon vërtetimin dhe lidhjen e drejtpërdrejtë midis qëllimit dhe fajit. Edhe Ligji specifik, Ligji Nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, shkeljet në fushën doganore i referon në ekzistencën e të gjithë elementeve shkak-pasojë që përbëjnë kundërvajtjen administrative.

Në rastin objekt vendimarrje kemi të bëjmë me faktin se Certifikata EUR 1 A 1084988 T është lëshuar nga Zyra Doganore si dhe nënshkrimi, ashtu edhe vula janë autentike, megjithatë është konstatuar se mallrat e mbuluara nga certifikata EUR 1 e lartpërmendur nuk janë në përputhje me rregullat e origjinës preferenciale, pra me fakte kundërshtuese të cilat pasjellin lindjen e detyrimit doganor por për sa kohë nuk lidhen në bashkëveprim kumulativ një serë faktorësh të cilët të vërtetojnë se ekziston një provë faktike që të vërtetojë qëllimin për fshehjen e vërtetësisë së dokumentacionit që lidhet me origjinën e artikujve të deklaruar. Por e kundërta nga ana e Operatorit Ekonomik janë marrë masat dhe është vepruar në transparencë për dekalrimin përpara autoritetetve doganore.

Sa me lart, të ndodhur përpara një praktike doganore, ku trajtimi tarifor preferencial ngelet apo kryhet mbi baza dyshimi në kuadër të një gabimi elektronik (pohuar kjo dhe në materialin konstatues) çka do të thotë se në zbatim të parimeve të “Sigurisë Juridike”, duke pasur në vëmendje faktin se në jo pak raste, Gjykata ka argumentuar se: Në rastet e ballafaqimit të nenit të kundërvajtjeve administrative me shkelje të tilla, rezulton se subjekti nuk ka kryer asnjë shkelje me faj të ndonjë dispozite ligjore apo nënligjore, gjyqësori gjithashtu vijon në argumentimin e vet kur citon se: Do të ishim para një kundërvajtje doganore për të cilën shoqëria duhet të mbante përgjegjësi nëse porvohet elementi subjektiv i kundërvajtjes administrative dhe në rastin konkret detyrimi i shmangur ashtu sikurse dhe Manuali i shkeljeve doganore orienton për rastet e trajtimit me origjinë doganore është ajo cka pasjell pasojen finnciare dhe duhet kontabilizuar.

Duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme nga e cila duhet të udhëhiqet administrata në kryerjen e funksioneve të saj si “Parimi i ligjshmërisë; Parimi i mbrojtjes së interesit publik por pa cënuar të drejtat e personave privat; Parimi i drejtësisë dhe paanësisë; Parimi i përgjegjshmërisë; parimi i kontrollit gjyqësor, etj”, parime këto të sanksionuara në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, shprehemi se nga ana jonë është vepruar në përputhje të plotë me ligjin. Për sa më lart : Duke Ju falenderuar për vëmendjen dhe mirëkuptimin Tuaj, shpresoj që argumentat e trajtuara do të merren në konsideratë nga ana Juaj dhe do të pranohen.

Oëndrimi i grupit të auditimit : Observacioni i paraqitur nga juristët e degës doganore nuk ka fakte e prova të reja, theksohet fakti se vendimet janë marrë mbi bazën e procesverbaleve të verifikimit të kundërvajtjeve të strukturave doganore, por nuk theksohet fakte se organi vendimarrës në rastet ku baza ligjore e vendimit është e ndryshme nga procesverbalet e verifikimit të kundërvajtjeve administrative, ka për detyrë: që të hetojë me përgjegjësi të plotë faktet dhe rrethanat domethënëse për një çështje administrative, të vlerësojë dhe të cmojë çdo provë në hollësi, të realizojë një hetim gjithpërfshirës, të sigurojë vendime të drejta ligjore dhe në vecanti vendime të verteta administrative (si thuhet dhe në observimet e paraqitura). Observimet nuk argumentojnë dhe shpjegojnë:

I. Mungesën e arsytimit të këtyre vendimeve të marra mbi baza ligjore të ndryshme nga proces verbalet e konstatimit të kundërvajtjes administrative , - mungesën e shpjegimit të

situatës faktike mbi të cilën është marrë akti, -mungesë të shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe vlerësimin të provave dhe mungesën e një shpjegimi pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këto raste, në kundërshtim me nenin 100 të KPrA-së, me nenet 251, 252, 253, 259, 276 të Kodit Doganor.

2. Janë në kundërshtim me nenin 259 të kodit Doganor, nuk kanë arsyetuar përse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këto raste, pse duhet zbatuar neni 259 i Kodit Doganor dhe përse jemi në raste të tjera nga ato të përcaktuara në mënyrë specifike në nenet 251 deri në 254 të këtij kodi, kur në nenin 252/c të tij përcaktohet qartë klasifikimi kundërvajtjes administrative : mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

3. Në këto observacione nuk shpjegohet fakti se këto vendime nuk janë të argumentuara dhe arsyetuara, se këto vendime nuk i shoqërojnë me dokumenta të cilat lidhen me shkëljen e verifikuar dhe që provojnë dhe argumentojnë kundërvajtjen si dhe qëllimin e shkëljesit, argumenta dhe arsyetime të detyrueshme për klasifikim korrekt të shkëljes dhe sanksionit të vendosur. Auditimi është bazuar mbi legjislacionin doganor në fuqi në, në periudhën kohore prill, maj qershor të vitit 2022 dhe observacionet nuk merren në konsideratë.

Observacioni nuk ka fakte e prova të reja, nuk mbështetet në ligj, në të nuk përmendet fakti se vendimi i degës doganore është marrë në kundërshtim me proces verbalin e verifikimit të kundërvajtjes administrative nga Zyra e Kontrollit Aposterior në bashkëpunim me Zyrën e Analizës së Riskut të kesaj dege doganore ku është argumentura se: megjithëse mallrat e mbuluara nga certifikata lëvizëse Euro1 nr. A-1084988T dt.30.04.2020, lëshuar nga zyra doganore, nënshkrimi dhe vula janë autentike, ato nuk përfitojnë trajtim preferencial. Subjekti të paguajë detyrimin doganor dhe sipas nenit 256 të KD të sanksionohet me 1-fishin e detyrimit. Observacioni nuk merret në konsideratë.

2.5.2. Auditimi i dokumentacionit administrativ të vendimeve administrative me përzgjedhje i dosjeve të administruara nga Dega Doganore Tiranë per periudhen nen auditim viti 2022 (periudha 01.07.2022 deri 31.12.2022).

Nga auditimi dhe te dhënat e administruara nga Dega Doganore Tiranë u vendosen ne dispozicion te grupit auditues te dhenat elektronike te mbajtura ne lidhje me procesin e administrimit te vendimeve te nxjerra nga Autoriteti Doganor Tiranë per periudhen 01.07.2022 deri me date 31.12.2022 sipas formatit te miratuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave me te dhena te detajuara te subjektit objekt detyrimi, shumen e detyrimit, penalitetin respektiv, statusin arketuar ose jo, nr e Vendimit, daten e nxjerre, si dhe llojin e shkëljes doganore. Per kete periudhe rezultojne

477 Vendime administrative te nxjerra per shkëlje doganore te konsumuara per vepra dhe shkëlje doganore qe lidhen me diferenca ne peshe, klasifikime tarifore me efekte detyrimi doganor dhe pa efekte ne detyrim doganor, shkëlje te natyres kontrabande, parregullsi dokumentare, rivlersime doganore, si dhe shkëlje te afatit te rregjimit RLP dhe RPA. Konkretisht nga auditimi me perzgjedhje i vendimeve administrative për periudhen 01.07.2022 deri 31.12.2022 u konstatua sa me poshte vijon :

1-Në lidhje me Vendimin administrativ nr 1104 datë 25.10.2022 nxjerrë ne ngarkim të subjektit “K. B.” me nipt L.....H eshte vendose ne perfundim pagimi i detyrimit doganor në shumën 216,000 leke dhe penalizimi ne shumën 216,000 leke per shkëljen doganore të kryer për diferenca peshe malli te padeklaruar ne sasine 800 kg te shmangur dhe te padeklaruar gjate procesit te deklarimit doganor. Vendimi doganor eshte nxjerre mbi bazen e shqyrtimit te Proces-Verbalit te Shkëljes Doganore ne lidhje me parregullsite e deklaruar gjate kontrollit te deklarates doganore nr. R 109527 date 21.10.2022 me

deklarues subjektin “K.B” me nipt L.....H. Konstatohet se subjekti deklarues ka kryer kundërvajtje administrative duke fshehur sasinë prej 800 kg mall të përbërë nga mallrat e ndryshme. Referuar përcaktimeve të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
Shkeljet në fushën doganore, Neni 250

Klasifikimi i shkeljeve

1. Shkelje doganore janë: a) kundërvajtjet administrative; b) kontrabanda.
2. Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ.
4. Paguesa e gjobës që zbatohet për shkeljen doganore, në asnjë rast, nuk është shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes.

Neni 252 sipas ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” përcakton se :

Kundërvajtje të kryera në neglizhencë pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: Pika D
Sa më sipër konstatohet se këto struktura kanë ndjekur standard të dyfishtë në klasifikimin e shkeljes doganore dhe për pasojë evidentimin e penaliteteve në proporcion. Sa më sipër për subjektin 'Xh. O' evidentohen detyrime shtëse penaliteti të munguara **në vlerën 93,136 lekë**.

Vendimi nr.812 datë 13.09.2023 për caktimin e detyrimit 18,829 lekë për subjektin 'D.A.M' dhe penalitetit 1 fish 18,829 lekë për diferencë në sasinë e mallit deklaruar në deklaratën doganore me R94550, sipas nenit 256/1/a të KD, konstatuar nga struktura e Antikontrabandës. Bashkëngjitur vendimit gjendet procesverbali verifikimit të shkeljes nr.0002743 datë 11.09.2023 me detyrim 18,829 lekë dhe penalitet 18,829 lekë mbajtur nga Z. A. H. , Z. V. R., Z.R. H., Z.M. G., Z.F. L., dhe Z .E Sh, si dhe akt kontrolli nr.0008396 datë 12.09.2023, evidenca e kontrollit fizik nr.0000072.

Në proces verbalet e verifikimit të shkeljeve nr.0010835 datë 01.04.2023, nr.0005612 datë 10.11.2023, nr.0005587 datë 18.09.2023, nr.813 datë 18.09.2023 mbajtur po nga këto struktura me të njëjtin dokumentacion dhe konstatim evidentohen të jenë caktuar penalitete në masën 3 fish të detyrimit si kundërvajtje bazuar në parashikimet e nenit 258/1/a, mbi të cilat kanë dalë vendimet nr.468 datë 03.04.2023, nr.813 datë 18.09.2023, 817 datë 18.09.2023 dhe 911 datë 10.11.2023.

Sa më sipër konstatohet se këto struktura kanë ndjekur standard të dyfishtë në klasifikimin e shkeljes doganore dhe për pasojë evidentimin e penaliteteve në proporcion. Sa më sipër për subjektin 'D.A.M' evidentohen detyrime shtëse penaliteti të munguara **në vlerën 37,658 lekë**. Sa më sipër Dega Doganore nuk ka arsytuar në mënyrë shteruese klasifikimin e kundërvajtjeve mbi të cilat ka marrë vendim si dhe nuk disponon nga struktura konstatuese e verifikimit të shkeljes detaje në arsyetimin dhe argumentimin e klasifikimit të kundërvajtjes dhe për rrjedhojë edhe identifikimin e detyrimeve të subjektit. **(Mbajtur ne terren Akt Konstatimi nr 3 date 31.05.2024)**

Sqarim Observacione

Lidhur me problematikat e trajtuara më sipër është paraqitur observacioni nr. 10738/26 datë 30.08.2024 nga DDT me të njëjtën përmbajtje dhe dokumentacion me atë të trajtuar në projekt raportin e auditimit dhe për rrjedhojë observacioni nuk merret ne konsideratë.

Efekt i financiar i përlllogarit në rastet e vendimeve doganore të trajtuar per periudhen 2022 dhe 2023 të trajtuara në tabelën anekse nr. 5.1 deri nr 5.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit në shumën 6,709,782 lekë (gjobe dhe vlere malli riblerje) lekë do te konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

2.6 Auditimi i veprimtarisë doganore për procedurat doganore të ndjekura sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për "Akcizat në RSH" për periudhën nën auditim.

Për periudhën 2022-2023 struktura përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 ka funksionuar sipas dy VKM-ve të ndryshme, e para VKM nr.02 datë 08.01.2018, e cila sipas intervistave me stafin ka funksionuar deri në muajin gusht 2023 dhe e dyta VKM nr.355 datë 26.05.2022, në të cilën zyra e akcizës evidentohet si një strukturë më vete e ndarë nga ajo e mbikqyrjes. Sikurse evidentohet edhe në tabelën e mëposhtme gjatë vitit 2023 kjo zyrë ka funksionuar me 2 pozicione doganier akcize

vacant, vakanca këto që sikurse evidentohet në vijim kanë cënuar mbarëvajtjen dhe mire funksionimin në përmbushjen e detyrave të zyrës së akcizës, si pasojë e ngarkesës dhe numrit të madh të subjekteve nën mbikqyrje të Degës Doganore.

Tabela: Struktura stafit për akcizën 2022-2023

Sektori Mbikqyrjes Doganore				Zyra e Akcizës Doganore			
Pozicionet	VKM nr.02 datë 08.01.2018	Fakt	Vakanca	Pozicionet	VKM nr.355 datë 26.05.2022	Fakt	Vakanca
Përgjegjës sektori	1	1	-	Përgjegjës zyre	1	1	0
Specialist Doganier	22	16	6	Doganier Akcize	8	6	2
Total	25	19	6		9	7	2

Burimi: Përpunuar KLSH.

Të ardhurat nga akciza në Degën Doganore Tiranë për vitin 2022 dhe 2023 në total kanë qënë në total në vlerën 17,274 milion lekëve dhe 18,795 milion lekëve sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga zyra e financës. Sipas raportit të sistemit vendosur në dispozicion nga zyra e akcizës është paguar me DSHA akcizë në vlerën 12,047 milion lekë për vitin 2022 pra pothuaj 70% e totalit dhe 13,172 milion lekë për vitin 2023, përsëri pothuaj 70% e totalit. Për sa i përket llojit të produkteve sikurse evidentohet në tabelën e mëposhtme kontributi kryesor i takon produkteve të duhanit me vlerë reth 11,438 milion lekë në 2022, pra 95 % e totalit të akcizës paguar me DSHA dhe 12,604 milion lekë në 2023 ose reth 96% ndaj totalit. Më pas vijojnë produktet alkolike me reth 4% ndaj totalit 2022 dhe 3% për 2023.

Tabela: Akciza paguar me DSHA sipas produkteve (lekë)

Kategoria Produktit	2022	Përqindje ndaj totalit	2023	Përqindje ndaj totalit
Alkol	475,206,897	4%	423,826,466	3%
Duhan	11,438,803,950	95%	12,604,629,990	96%
Kafe	120,639,847	1%	124,273,318	1%
Graso	1,383,949	0%	2,026,960	0%
Vajra	11,833,652	0%	17,904,833	0%
Total	12,047,868,296	100%	13,172,661,569	100%

Burimi: Përpunuar KLSH

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion evidenca me vendimet e kontabilizuara të borxhit me shkelje në fushën e akcizës, në të cilën janë evidentuar 3 vendime për kundërvajtje për vitet 2022 dhe 2023, dhe në total deri në 31.12.2023 vlera totale e borxhit të akcizës është në vlerën e 12,994,882,044 lekë, prej të cilave akoma pa u paguar 12,960 milion lekë.

Garancitë e magazinave fiskale

Grupi auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion informacioni me garancitë e magazinave fiskale të mbikqyrëra nga Dega Doganore Tiranë.

Tabela: Vlefshmëria e garancive të magazinave fiskale

Subjekti	Nipti	Shuma e llogaritur 2022-2023	Vlefshmeria e garancisë nga 2022	Vlefshmeria e garancisë deri 2023	Vlefshmeria e garancisë nga 2023	Vlefshmeria e garancisë deri 2024	Shuma e llogaritur 2023-2024	Masa garancisë
B. T.	J.....F	-	-	-	28.09.2023	01.10.2024	-	100%
T. B. H.	L.....C	-	-	-	-	28.02.2024	50.000	15%
E. H.	K.....T	-	-	-	12.02.2024	05.02.2024	1,900,000.0	15%
K.	K.....W	-	-	-	pezulluar	pezulluar	-	
CH. SHPK	L.....C	-	-	-	pezulluar	pezulluar	-	
S. H.	K.....T	170,000	12.12.2022	05.12.2023	-	-	-	

L.	L.....F		24.09.2021	21.09.2023	-	-	170,000.0	15%
I. F.	K.....Q	-	-	-	21.09.2023	03.09.2024		100%
E. B		-	-	-	-	-	500,000	100%
A.		15,000,000	-	-	-	-	15,000,000	100%
K. P	K.....U	531,000	-	-	24.11.2023	21.11.2024	536,336	15%
I. A.C.	L.....M	-	-	-	revokuar	revokuar	-	-
S. O. SHA	L.....T	-	-	-	pezulluar	pezulluar	-	-
A. O.	K.....F	-	-	-	19.12.2023	04.12.2024	280,000.0	15%
N.	L.....T	1,627,908	07.12.2022	15.11.2023	-	-	-	100%

Burimi: Zyra akcizës DDT, përpunuar KLSH.

Sikurse evidentohet dhe në tabelën e mësipërme subjektet B.T, K., Ch. shpk, I., K. P., I. A. C, S. O. sha dhe A. O. nuk kanë rinovuar garancitë gjatë vitit 2022. Subjektet S. H, L. dhe N. nuk kanë rinovuar garancitë gjatë vitit 2023. Subjektet T. B. H., E. H., E. dhe A. nuk kanë rinovuar garancitë gjatë vitit 2022 dhe 2023. **Sa më sipër është konstatuar se për subjektet e evidentuara nuk janë marrë masa administrative në monitorimin e vlefshmërisë së garancive të magazinave fiskale dhe nisjen e procedurave të revokimit sipas rastit, si nga Dega Doganore mbikqyrëse ashtu edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.** Sipas nenit 20 të ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Magazinat fiskale janë objekt mbikqyrjes dhe kontrollit doganor”. Ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, në nenin 20, pika 4, 5 dhe pika 6 përcakton se “4.Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni sjell si pasojë revokimin e autorizimit; 6.Autoritetet doganore mund të revokojnë një autorizim për depozituesin e miratuar nëse:a) depozituesi i miratuar nuk plotëson më kushtet e vendosura në autorizimin e depozituesit të miratuar ose nuk siguron sistemin e duhur për monitorimin e stoqeve, ose kur nuk plotëson listat e stoqeve brenda afateve kohore të përcaktuara në autorizimin e depozituesit të miratuar;b) ai nuk depoziton garancinë e llojit të duhur për pagesën e akcizës ose nuk depoziton një garanci në shumën e nevojshme për të paguar akcizën;c) nuk ekzistojnë më kushtet për dhënien e një autorizimi për depozitues të miratuar;”

Gjithashtu VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, në nenin 60 “Pushimi i vlefshmërisë së autorizimit për magazinë fiskale në rastin e revokimit nga autoritetet doganore” përcakton në mënyrë të detajuar edhe procedurën që duhet ndjekur nga autoritetet doganore ku konkretisht “3. Me konstatimin e njërit prej rasteve të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ë”, të pikës 6, të nenit 20, të ligjit, dhe në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 6, të nenit 20, të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr vendim për pezullimin e autorizimit, për një afat deri në 30 ditë. Ky vendim paraqet arsyet e këtij pezullimi dhe u njoftohet operatorit ekonomik dhe zyrës doganore mbikqyrëse, e cila merr të gjitha masat e duhura për të siguruar që gjatë këtij afati kohor operatori ekonomik të mos kryejë asnjë aktivitet tregtar në magazinën fiskale. 4. Kur operatori ekonomik nuk ka mundur të rregullojë situatën brenda 30 ditëve, por siguron që kushtet mund të përmbushen nëse afati i pezullimit zgjatet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të shtyjë afatin e pezullimit edhe për 30 ditë të tjera.5. Nëse brenda afatit të pezullimit operatori ekonomik plotëson kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen sipas ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave anulon pezullimin dhe informon operatorin ekonomik dhe zyrën doganore mbikqyrëse lidhur me këtë vendim.6. Nëse brenda këtij afati kohor, të përcaktuar në pikat 3 dhe 4, operatori ekonomik nuk plotëson mangësitë që kanë çuar në pezullimin e autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr vendim për revokimin e autorizimit: a) duke njoftuar zyrën

doganore mbikëqyrëse dhe depozituesin e miratuar në lidhje me vendimin e revokimit; b) duke përcaktuar detyrat e zyrës doganore mbikëqyrëse për procedurat e mëtejshme sipas nenit 61, të këtij vendimi; c) duke përcaktuar detyrimet e depozituesit të miratuar për procedurat e mëtejshme sipas nenit 61, të këtij vendimi; ç) duke përcaktuar të drejtën e depozituesit të miratuar për t'u ankimuar dhe organin pranë të cilit ushtrohet ky ankimim.”

Procedura autorizimi (12)

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion evidencat e detajuara mbi autorizimet e lëshuara, refuzuara, revokuara, modifikuara dhe pezulluara, për magazinat fiskale gjatë viteve 2022-2023, përmbledhur në vijim. Sipas evidencës së vendosur në dispozicion janë dhënë 12 autorizime të reja, prej të cilave 6 për magazinë fiskale prodhimi, 2 për magazinë fiskale stokimi dhe 4 për pritës të regjistruar.

Tabela: Autorizime të reja për magazina fiskale

NR	Nipt	nr Autorizimi	Emri i operatorit	dt e lëshimit	Tipologjia
1	M.....C	AL3Q220009002	O. T.	08.02.2023	PRITES KAFEJE
2	L.....O	AL3Q220008007	L. ZH.	08.02.2023	PRITES KAFEJE
3	M.....E	AL2N220027001	P. M.	06.06.2022	PRODHUES BIRRE
4	L.....A	AL2Q220030008	I. G.	23.06.2022	PRODHUES KAFE
5	L.....G	AL1N220039001	G. D.	23.09.2022	STOKUES
6	L.....U	AL2N220047007	S. T.	14.11.2022	PRODHUES VERE
7	M.....N	AL3Q220045001	P. L.	20.10.2022	PRITES KAFE
8	L.....A	AL3Q230013001	E. A.	02.06.2023	PRITES KAFE
9	M.....R	AL2N230020002	D. T.	08.08.2023	PRODHUES NARGJILE
10	K.....L	AL1N230021004	C. R.	29.08.2023	STOKUES
11	M.....E	AL2N230028006	A. P.	15.11.2023	PRODHUES NARGJILE
12	K.....I	AL2N230029001	A. G.	11.12.2023	PRODHUES VERE

Nga sa evidentuar më sipër janë përzgjedhur për testim **8 dosje** si më poshtë trajtuar.

1. D. T.- Autorizim për magazinë fiskale prodhimi nr.AL03212300210. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues si në vijim, ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinionioni DD (Aneksi 5), karta teknologjike, llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

2. A. P. T. Autorizim për magazinë fiskale prodhimi nr.AL03212300295. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues si në vijim, ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinionioni DD (Aneksi 5), karta teknologjike, llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

3. C. R.- Autorizim për magazinë fiskale stokimi nr.AL03212300222. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues si në vijim, ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinionioni DD (Aneksi 5), karta teknologjike, llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

4. G. D. - Autorizim për magazinë fiskale stokimi nr.AL03212200416. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues si në

vijim, ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), karta teknologjike, llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

5. I. G. Autorizim për magazinë fiskale prodhimi nr.AL03212200327. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

6. A. G.- Autorizim për magazinë fiskale prodhimi nr.AL2N230029001. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues si në vijim, ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), karta teknologjike, llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

7. P. M.- Autorizim për magazinë fiskale prodhimi nr.Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

8.S. T.- Autorizim për magazinë fiskale prodhimi Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.

Modifikime autorizimi

1.Horanlliu- kërkesë për ndryshim adrese në autorizim. Nga auditimi u konstatua se në dosje gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5) dhe ekstrakti QKR, kontrata dhe foto të ambjentit.

2. IGLA- kërkesë për shtim kategorie T403 në autorizim, si efekt i ndryshimeve ligjore në kategori produkti me ligjin nr.114/2021 “Për akcizat në RSH”. Në dosje gjendet autorizimi magazinës, korrespondenca me operatorin, relacioni shpjegues i DTA për DP dhe ndryshimet në kode miratuar nga DP.

Sa i takon zbatimin të afateve procedurale në miratimin e autorizimeve për dosjet e audituara rezultojnë si në tabelën më poshtë.

Tabela: Afate miratimi të magazinave fiskale

<i>Operatori</i>	<i>Datë Aplikimi</i>	<i>Datë opinon DD për plotësim dokumentacioni</i>	<i>Datë miratimi</i>	<i>Diferenca (2)-(3)</i>
D. T.	16.06.2023	29.06.2023	25.08.2023	57
A. P. T.	06.10.2023	04.11.2023	06.12.2023	31
C. R.	07.07.2023	29.08.2023	29.08.2023	0
G. D.	13.09.2023	21.09.2023	26.09.2023	5
I. G.	13.06.2022	20.06.2022	01.07.2022	11
A. G.	07.09.2023	20.10.2023	11.12.2023	51
P. M.	10.05.2022	18.05.2022	10.06.2022	22

S. T.	25.10.2022	28.10.2022	21.11.2022	24
-------	------------	------------	------------	----

Burimi: Përpunuar KLSH.

Rimbursimet

Gjatë auditimit është kërkuar informacion mbi vendimet për rimbursim akcize gjatë vitit 2022 dhe 2023.

Nga dokumentacioni vendosur në dispozicion është konstatuar se gjatë vitit 2022 janë dërguar pranë DPD **6 shkresa** për miratim shume rimbursimi dhe çelje fondi me gjithësej **33 vendime** miratimi, prej të cilave 25 për subjektin 'P.' dhe 8 për 'A. R.'.

Tabela: Rimbursime akcize 2022

Shkresa		Vendimi		Subjekti	Vlera
Nr.	Datë	Nr.	Datë		
5934	23.06.2022	769	20.06.2022	A. R.	336,955
		770	20.06.2022	A. R.	1,026,660
		771	20.06.2022	A. R.	1,364,270
		772	20.06.2022	A. R.	896,266
		773	20.06.2022	A. R.	590,864
		774	20.06.2022	A. R.	926,874
Totali					5,141,889
7324	04.08.2022	874	27.07.2022	P.	147,903
		875	27.07.2022	P.	209,845
		876	27.07.2022	P.	467,828
		877	27.07.2022	P.	444,999
		878	27.07.2022	P.	341,158
Totali					1,611,733
11923	16.12.2022	P.			3,512,021.68
12004	20.12.2022	P.			772,523
12012	20.12.2022	A. R.			1,661,835
12196	29.12.2022	P.			1,263,767
Total miratuar 2022					13,963,768.68

Burimi: DD Tiranë

Nga dokumentacioni vendosur në dispozicion është konstatuar se gjatë vitit 2023 janë dërguar pranë DPD **2 shkresa** për miratim shume rimbursimi dhe çelje fondi me gjithësej **11 vendime** miratimi, të gjitha për subjektin 'P'.

Prej tyre janë përzgjedhur për testim 2 vendime për të cilët është konstatuar si më poshtë.
-Vendimi nr.771 datë 20.06.2022 për rimbursimin prej 1,364,270 lekë të subjektit 'A. R.' për akcizën e paguar për lëndën djegse (mazut) përdorur në prodhimin e produktit lingota alumini për periudhën tetor 2021, bazuar në kërkesën e subjektit nr.9479 datë 09.11.2021. Bashkëngjitur vendimit gjendet Raporti Zyrës së Mbikqyrjes nr. 9479/1 datë 16.06.2022 mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar, anekset dhe tabelat sipas ligjit dhe udhëzimit dhe faturat/dav, korrespondeca me DRTT dhe process verbali kontrollit fizik nr. 0013197 datë 01.11.2021.

Sa më sipër konstatohet se edhe pse është paraqitur nga operatori i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit për rimbursim akcize, vendimi për miratimin e kërkesës ka dalë pothuaj 6 muaj me vonesë, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 "Për akcizat në RSH", neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se 'vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur'. Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 'Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat', i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se 'Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrijë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i

paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

-Vendimi nr.770 datë 20.06.2022 për rimbursimin prej 1,026,660 lekë të subjektit ‘A. R’ për akcizën e paguar për lëndën djegse mazut/solar, përdorur në prodhimin e produktit lingotë alumini për periudhën shtator 2021, bazuar në kërkesën e subjektit nr.8595 datë 08.10.2021. Bashkëngjitur vendimit gjendet Raporti Zyrës së Mbikqyrjes nr.8595/1 datë 16.06.2022 mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar, anekset dhe tabelat sipas ligjit dhe udhëzimit dhe faturat/dav, korrespondecë me DRTT dhe process verbali kontrollit fizik nr.0013188 datë 01.10.2021.

Sa më sipër konstatohet se edhe pse është paraqitur nga operatori i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit për rimbursim akcize, vendimi për miratimin e kërkesës ka dalë pothuaj 7 muaj me vonesë , në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se ‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se ‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

Tabela: Rimbursime akcize 2023

Shkresa		Vendimi		Subjekti	Vlera
Nr.	Datë	Nr.	Datë		
7286	22.08.2023	716	26.07.2023	P.	213,319
		717	26.07.2023	P.	243,505
		718	26.07.2023	P.	174,440
		719	26.07.2023	P.	183,188
		720	26.07.2023	P.	366,127
		721	26.07.2023	P.	138,532
Totali					1,319,111
10673	18.12.2023	1012	18.12.2023	P.	347,490.5
		1013	18.12.2023	P.	277,102
		1014	18.12.2023	P.	271,937
		1015	18.12.2023	P.	195,106
		1016	18.12.2023	P.	291,851
Totali					1,383,486.5
Total miratuar 2023					2,702,597.5

Burimi: DD Tiranë

Prej tyre janë përzgjedhur për testim 2 vendime për të cilët është konstatuar si më poshtë.

-Vendimi nr.720 datë 26.07.2023 për rimbursimin prej 366,127 lekë të subjektit ‘P.’ për akcizën e paguar për lëndën djegse diesel, përdorur në prodhimin e produktit barna për periudhën mars 2023, bazuar në kërkesën e subjektit nr.3181 datë 07.04.2023. Bashkëngjitur vendimit gjendet Raporti Zyrës së Akcizës nr. 3181/2 datë 14.07.2023 mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar, anekset dhe tabelat sipas ligjit dhe

udhëzimit dhe faturat/dav, korrespondeca me DRTT dhe proces verbali kontrollit fizik nr.0010905 datë 03.04.2023.

Sa më sipër konstatohet se edhe pse është paraqitur nga operatori i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit për rimbursim akcize, vendimi për miratimin e kërkesës ka dalë pothuaj 2 muaj me vonesë , në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se ‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se ‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

-Vendimi nr.1012 datë 18.12.2023 për rimbursimin prej 347,490 lekë të subjektit ‘P.’ për akcizën e paguar për lëndën djegëse diesel, përdorur në prodhimin e produktit barna për periudhën **maj 2023**, bazuar në kërkesën e subjektit nr.5153 datë 09.06.2023. Bashkëngjitur vendimit gjendet Raporti Zyrës së Akcizës nr.6547/2 datë 14.12.2023 mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar, anekset dhe tabelat sipas ligjit dhe udhëzimit dhe faturat/dav, korrespondeca me DRTT, dhe proces verbali kontrollit fizik nr.0010972 datë 01.06.2023.

Sa më sipër konstatohet se edhe pse është paraqitur nga operatori i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit për rimbursim akcize vendimi për miratimin e kërkesës ka dalë pothuaj 5 muaj me vonesë , në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se ‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se ‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

Gjithashtu është kërkuar nga subjekti evidenca e kërkesave për rimbursim akcize por pa miratim, për të cilën janë vndosur ne dispozicion shkresat për 3 subjekte si më poshtë.

-Kërkesa e 'A. R.' sha nr.6092 datë 10.07.2023 dhe 'E' sha nr.5221 datë 12.06.2023 për periudhën korrik 2022-maj 2023 pas ndryshimeve ligjore, ku për të cilat janë hartuar raportet respektive nga zyra akcizës nr.6093/1 datë 03.05.2024 dhe nr.5221/4 datë 03.05.2024 drejtuar Kryetarit të DD, në të cilët nuk rekomandohet rimbursimi sipas edhe interpretimit të Drejtorisë Juridike.

- **T. E. C. sh.p.k.**

-Operatori T. E. C. shpk ka dorëzuar kërkesën për rimbursim nr.1289 datë 10.02.2022 për rimbursimin e akcizës në vlerën **104,104 lekë** për lëndën djegëse koks, përdorur për podhimin e produktit tullë termike për periudhën **janar 2022**. Në dosje gjendet shkresa nr.1289/1 datë 28.02.2022 dhe shkresa nr.2448 datë 27.03.2024 dërguar DPT për verifikim të dokumentacionit për produktin e shitur, përgjigjia e të cilave nuk ka ardhur nga DPT, si dhe anekset dhe tabelat sipas ligjit dhe udhëzimit, **por mungon Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar si dhe përgjigjia apo njoftimi me shkresë i subjektit për këtë kërkesë sikurse përcakton ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 "Për akcizat në RSH", neni 81, pika 1 dhe 2**, në të cilat citohet se *'vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur'*. Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 'Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat', i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se *'Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.*

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.'

-Operatori T. E. C. shpk ka dorëzuar kërkesën për rimbursim nr.2519 datë 11.03.2022 për rimbursimin e akcizës në vlerën **35,610 lekë** për lëndën djegëse koks, përdorur për podhimin e produktit tullë termike për periudhën **shkurt 2022**. Në dosje gjendet shkresa nr.2519/1 datë 04.04.2022 dërguar DPT për verifikim të dokumentacionit për produktin e shitur, dhe shkresa nr.9677/1 datë 02.06.2022 me përgjigjien e ardhur nga DPT, si dhe anekset dhe tabelat sipas ligjit dhe udhëzimit, **por mungon Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar si dhe përgjigjia dhe vendimi për këtë kërkesë të subjektit sikurse përcakton ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 "Për akcizat në RSH", neni 81, pika 1 dhe 2**, në të cilat citohet se *'vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur'*.

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 'Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat', i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se *'Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.*

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose

procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

-Operatori T. E. C. shpk ka dorëzuar kërkesën për rimbursim nr.3576 datë 11.04.2022 për rimbursimin e akcizës në vlerën **78,988 lekë** për lëndën djegëse koks, përdorur për podhimin e produktit tullë termike për periudhën **mars 2022**. Në dosje gjendet shkresa nr.3576/1 datë 28.04.2022 dërguar DPT për verifikim të dokumentacionit për produktin e shitur, dhe shkresa nr.5196 datë 02.06.2022 me përgjigjien e ardhur nga DPT, si dhe anekset dhe tabelat sipas ligjt dhe udhëzimit, **por mungon Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar si dhe përgjigjia dhe vendimi për këtë kërkesë të subjektit sikurse përcakton ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se ‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.**

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për Akcizat”, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se ‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

-Operatori T. E. C. shpk ka dorëzuar kërkesën për rimbursim nr.4497 datë 11.05.2022 për rimbursimin e akcizës në vlerën **88,401 lekë** për lëndën djegëse qymyr koks, përdorur për podhimin e produktit tullë termike për periudhën **prill 2022**. Në dosje gjendet shkresa nr.4497/1 datë 13.05.2022 dërguar DPT për verifikim të dokumentacionit për produktin e shitur, dhe shkresa nr.6731 datë 18.07.2022 me përgjigjien e ardhur nga DPT, si dhe anekset dhe tabelat sipas ligjt dhe udhëzimit, **por mungon Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar si dhe përgjigjia dhe vendimi për këtë kërkesë të subjektit sikurse përcakton ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se ‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.**

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se ‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

-Operatori T. E. C. Shpk ka dorëzuar kërkesën për rimbursim nr.5533 datë 10.06.2022 për rimbursimin e akcizës në vlerën **104,121 lekë** për lëndën djegëse qymyr koks, përdorur për podhimin e produktit tullë termike për periudhën **maj 2022**. Në dosje gjendet shkresa

5533/1 datë 12.07.2022 dhe nr.2445 datë 27.03.2024 dërguar DPT për verifikim të dokumentacionit për produktin e shitur, si dhe anekset dhe tabelat sipas ligjt dhe udhëzimit, **por mungon përgjigjia e DPT me verifikimet përkatëse dhe Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar, si dhe përgjigjia dhe vendimi për këtë kërkesë të subjektit sikurse përcakton ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012** “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se *‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’*.

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se *‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.*

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

-Operatori T. E. C. shpk ka dorëzuar kërkesën për rimbursim nr.6534 datë 12.07.2022 për rimbursimin e akcizës në vlerën **85,027 lekë** për lëndën djegëse qymyr koks, përdorur për podhimin e produktit tullë termike për periudhën **qershor 2022**. Në dosje gjendet shkresa nr.6535/1 datë 13.07.2022, nr.6534/2 datë 23.11.2022, nr.2446 datë 27.03.2024 dërguar DPT për verifikim të dokumentacionit për produktin e shitur, si dhe anekset dhe tabelat sipas ligjt dhe udhëzimit, **por mungon përgjigjia e DPT me verifikimet përkatëse dhe Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar si dhe përgjigjia dhe vendimi për këtë kërkesë të subjektit sikurse përcakton ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012** “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se *‘vendimi për një kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’*.

Edhe VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se *‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.*

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

Gjithashtu për periudhën korrik 2022 - dhjetor 2023 (gjithësej 18) operatori ka dorëzuar kërkesat muajore për rimbursim, përvec muajve qershor dhe korrik 2023. Në shkresën nr.2449 datë 27.03.2024 drejtuar Kryetarit të DD Zyra Akcizës, Zj. E. J. dhe Z. G. Y. informon se për këto kërkesa operatori nuk ka përmbyshur detyrimin për aplikim pasi nuk ka instaluar kalimatësin në tubacion dhe nuk është bërë verifikimi kartës teknologjike, si dhe se është njoftuar operatori me shkresën *‘kthim pa veprim’* nr.11380 datë 05.12.2022. kjo shkresë në përmbajtje të saj citon se *‘referuar kërkesave nr.6534/1 datë 12.07.2022,*

nr.7670 datë 12.08.2022, nr.8562 datë 12.09.2022, nr.9649 datë 12.10.2022, nr.10605 datë 10.11.2022 (5muaj) DD nuk do të marrë në shqyrtim kërkesat pasi duhet instaluar kalimatësi në tubaacione dhe paraqitur karta teknologjike’.

Sa më sipër konstatohet se kjo shkresë për secilën nga kërkesat nuk është bërë në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore. Gjithashtu lidhur me konstatimin se nuk është bërë verifikimi i kartës teknologjike në DPD, në dosje nuk ka evidencë të korrespondencës së Degës me DPD për adresimin e këtij problemi.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7 përcakton gjithashtu se ‘Autoriteti doganor nëse pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe bazuar në kriteret e analizës së riskut, gjykon të nevojshme të verifikojë situatën në vend dhe/ose të ushtrojë kontroll, atëherë kjo procedurë kryhet përpara miratimit të rimbursimit. Në këtë rast kjo procedurë nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave harton një udhëzim të përbashkët mbi elementët e riskut për këto raste.

Në rast të kundërt, brenda 10 (dhjetë) ditësh, miraton ose refuzon rimbursimin e kërkuar, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër dhe kontrolli në vend kryhet sipas planifikimit ose procedurave të autoritetit doganor edhe pas kryerjes së rimbursimit të akcizës.’

Kontrollet

Gjatë auditimit është kërkuar informacion mbi kontrollet e zhvilluara nga zyra akcizes gjatë vitit 2022 dhe 2023, ku është vendosur në dispozicion informacioni si më poshtë.

Tabela: Kontrolle 2022 dhe 2023

Lloji kontrollit	Subjektet 2022	Subjektet 2023	Totali
Asistim në markim	1	-	1
Asistim në riparim linje	1	1	2
Heqje/vendosje plumce	3	2	5
Denatyrim	-	1	1
Kontroll fizik	8	2	10
Kontroll lënda e parë (rrush)	21	3	24
Mbikqyrje në objekt	7	-	7
Ndryshim adrese	1	-	1
Pullosje	103	209	312
Shkatërrim pullash	3	3	6
Totali	148	221	369

Burimi: Zyra akcizës, përpunuar grupi auditimit KLSH.

Sikurse evidentohet në tabelë sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga zyra akcizës janë zhvilluar në total 148 kontrolle gjatë vitit 2022 dhe 221 gjatë vitit 2023, ku prej të cilave peshën kryesore e zënë ‘pullosjet’ 69.5% gjatë vitit 2022 dhe 94.5% gjatë vitit 2023. Kontrolli fizik zë vetëm një pjesë të vogël të punës koncretisht 5.4% gjatë 2022 dhe 0.9% gjatë vitit 2023 dhe sikurse evidentohet më poshtë ka pasur vetëm një program kontrolli gjatë muajit prill dhe një gjatë muajit shtator për 2023 dhe 10 muajt e tjerë të vitit kanë qënë të pambuluar me kontrolle fizike. Ndërsa gjatë vitit 2022 rezultojnë 7 muajt të pambuluar me kontrolle fizike.

Nga auditimi është konstatuar se mungon një analizë risku në nivel zyre apo dege për evidentimin e operatorëve me risk, si dhe dokumentimi i kësaj analize në përzgjedhjen e secilit operator për kontroll sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021, pika 6.3 "Ne perfundim te analizës së riskut, specialistet e sektorit së bashku me pergjegjesin e sektorit, identifikojne operatorët me risk te larte dhe i adresojne tek eproret direkt (Drejtor Drejtorie/Shef departamenti) dhe mbas shqyrtimit prej tyre percaktohen operatorët mbi te cilet do te kryhen kontrolle aposterior dhe /apo te akcizes".

Gjithashtu është konstatuar se nga 77 magazina fiskale në mbikqyrje të DDT janë realizuar kontrolle fizike vetëm për 10% të tyre gjatë vitit 2022 dhe 2.5% të tyre gjatë vitit 2023, duke rezultuar në një nivel risku shumë të lartë nga mos mbikqyrja dhe monitorimi i veprimtarisë së tyre nga dega përkatëse.

Kontrollet fizike sipas muajve të realizuar për 2022 dhe 2023 evidentohen në tabelën më poshtë.

Tabela: Kontrollet fizike sipas muajve

	Jana	Shkur	Mar	Pril	Ma	Qersho	Korri	Gush	Shtato	Teto	Nënto	Dhjet
2022	1	1	-	2	3	-	1	-	-	-	-	-
2023	-	-	-	1	-	-	-	-	1	-	-	-

Burimi: Zyra akcizës, përpunuar grupi auditimit KLSH.

Gjatë auditimit është kërkuar të vendoset në dispozicion informacion i plotë për 7 dosje kontrolli përzgjedhur për testim.

1. Valtelina (nr.720 datë 27.01.2022)

Në dosjen e vendosur në dispozicion për subjektin gjendet vetëm shkresa nr.720/1 datë 24.02.2022 drejtuar Kryetarit të DD me 'Raport mbi program kontrollin e operatorit ekonomik' nga doganierët Znj.J. K. dhe Znj.O. Z. dhe specialist i zyrës së Mbikqyrjes Doganore Z. G. Y. Në këtë raport informacion dërguar KDD rezulton situata si më poshtë evidentuar.

Tabela: Levizja produkteve sipas sistemit dhe kontrollit fundit (kg)

Kafe e papjekur				
Gjëndje 31.07.2019	Hyrje (Import + Blerje vendi)	Dalje për pjekje	Shitje me fature tatimore	Gjëndje kontabël 31.01.2022
99,025	1,165,645	1,243,000	529	21,141
Kafe e pjekur				
Gjëndje 31.07.2019	Hyrje nga pjekja	Dalje (konsum+export)		Gjëndje kontabël 31.01.2022
24,392	1,006,830	1,007,624		23,598

Burimi: Draft raporti kontrollit, Zyra Akcizës.

Në draft raport jepet gjithashtu: Total jeshile (kontabël)=21,141+29,133=50,274 kg

Dhe sipas draft raportit rakordimi mes gjëndjes fizike dhe kontabël për dy produktet rezulton si më poshtë.

Tabela: Rakordimi fizik/kontabël

Produkti	Gjëndje kontabël	Gjëndje fizike	Diferenca
Kafe papjekur	21,141	34,590	+13,449
Kafe pjekur	23,598	12,713	-10,885

Burimi: Draft raporti kontrollit, Zyra Akcizës.

Në draft raport jepet gjithashtu: Total në jeshile (fizik)=34,590+15,695=50,289 kg si dhe se 'diferenca në kode (jeshile dhe e pjekur) vjen pasi produktet ndodhen në magazinën e prodhimit'.

Sikurse evidentohet në material nuk pasqyrohen veprimet e bëra dhe shpjegimet përkatëse në konvertimin e kafes së pjekur gjëndje kontabël dhe fizike në të papjekur.

Total diferencë sipas draft raportit 50,284-50,274=10kg, pra total diferenca 10kg jeshile, nën 2% të firove të lejuara dhe është lënë detyrë rregullimi i situatës sipas kodeve. Sa më sipër llogaritë janë të paqarta dhe mungon gjurma auditimit.

Sa më sipër në dosje mungon program kontrolli, autorizimi, proces verbali kontrollit fizik, si dhe raporti i miratuar nga Kryetari DD.

Në dosje nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështëten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë

28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

2.A. E. (nr.1698 datë 21.02.2022)

Në dosjen e vendosur në dispozicion për subjektin gjendet:

-Program kontrolli nr.1698 datë 21.02.2022 për kontroll të plotë fizik dhe dokumentar, nga kontrolli fundit, inventarizimi i produkteve referuar dhe rakordimeve periodike mujore, miratuar nga KDD.

-Autorizimi nga KDD, i pa protokolluar dhe pa datë.

-Proces Verbali kontrollit të fundit fizik datë 21.06.2021 me gjëndje 146,904 kg kafe pa pjekur dhe 790 kg kafe pjekur.

-Draft raporti kontrollit të ushtruar pa protokolluar dhe pa datë drejtuar Kryetarit të DD nga doganierët Znj. O. Z. dhe Z. S. S dhe specialist i zyrës së Mbikqyrjes Doganore Z. G. Y. Në këtë draft raport pa diferenca të evidentuara nga rakordimi fizik/dokumentar dërguar KDD rezulton situata me lëvizje të malit si më poshtë evidentuar.

Tabela: Levizja produkteve sipas sistemit dhe kontrollit fundit (kg)

Kafe e papjekur			
Gjëndje 21.06.2021	Hyrje	Dalje për pjekje dhe shitje	Gjëndje kontabël 22.02.2022
146,904	108,043	45,333+131,463=176,796	78,151
Kafe e pjekur			
Gjëndje 21.06.2021	Hyrje nga pjekja	Dalje (konsum+export)	Gjëndje kontabël 22.02.2022
790	36,719	27,559+9,950=37,509	0

Burimi: Draft raporti kontrollit, Zyra Akcizës.

Dhe sipas draft raportit rakordimi mes gjëndjes fizike dhe kontabël për dy produktet rezulton si më poshtë.

Tabela: Rakordimi fizik/kontabël

Produkti	Gjëndje kontabël	Gjëndje fizike	Diferenca
Kafe papjekur	78,151	78,151	0
Kafe pjekur	0	0	0

Burimi: Draft raporti kontrollit, Zyra Akcizës.

Sikurse evidentohet në material nuk pasqyrohen veprimet e bëra dhe shpjegimet përkatëse në konvertimin e kafes së pjekur gjëndje kontabël dhe fizike në të papjekur.

Në dosje mungon proces verbali kontrollit fizik datë 21.02.2022, bazuar në të cilin janë bërë rakordimet, si dhe raporti i miratuar nga Kryetari DD.

Në dosje nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështëten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

3.F. U. (nr.9006 datë 26.09.2022) kontroll për lëndën e parë- PV nuk është vendosur dispozicion.

4.V. B. (nr.9006 datë 26.09.2022) kontroll për lëndën e parë.

Në dosjen e vendosur në dispozicion për subjektin gjendet vetëm fotokopje e proces verbalit të kontrollit fizik, në të cilin nuk lexohen qartë vlerat e produkteve të inventarizuar mbajtur nga Znj. O. Z., Z. S. S dhe Znj.E. J.

5.E. K. (nr.354 datë 12.01.2023) kontroll për lëndën e parë.

Në dosjen e vendosur në dispozicion për subjektin gjendet

-Program kontrolli nr.354 datë 12.01.2023 për kontroll të plotë fizik nga data 20.11.2020, inventarizim i produkteve referuar dhe rakordimeve mujore, miratuar nga KDD.

-Autorizimi nga KDD, i pa protokolluar dhe pa datë.

-Proces Verbali kontrollit fizik nr.0015463 datë 19.01.2023 në të cilin evidentohet gjëndje produkti kafe pjekur 2,515 kg vendosur në paketime, mbajtur nga Znj. O. Z. dhe Z. S. S 6.Kuba (nr.3147 datë 06.04.2023)

Në dosjen e vendosur në dispozicion për subjektin gjendet

-Proces verbali kontrollit fizik nr.0010952 datë 07.04.2023 mbajtur nga Z.S. S. dhe Znj.O. Z., në të cilin evidentohet gjëndje fizike kafe e pjekur 1,661 kg në qese e kuti dhe kafe jeshile 2,116kg vendosur në thaës, si dhe citohet se kontrolli i fundit i bërë në datë 15.04.2022 ka rezultuar me gjëndje kafe jeshile 1,606kg dhe e pjekur 2,103kg.

-Draft raporti kontrollit të ushtruar nr.3147/1 në prill 2023, drejtuar Kryetarit të DD nga doganierët Znj. O. Z. dhe Z. S. S., dhe specialist i zyrës së Mbikqyrjes Doganore Z. G. Y. Në këtë draft raport me diferenca të evidientuara vetëm 1 kg, nga rakordimi fizik/dokumentar dërguar KDD rezulton situata me lëvizje të malit si më poshtë evidencuar, ku kafja e pjekur është konvertuar në jeshile dhe konkretisht 1,661 kg kafe pjekur= 2050 kg kafe jeshile (total=2,116+2,050=4,166 kg)

Tabela: Levizja produkteve sipas sistemit dhe kontrollit fundit (kg)

Gjëndje 15.04.2022	Hyrje	Kafe e papjekur	
		Shitje e pjekur 27,743 kg konvertuar në jeshile	Gjëndje kontabël 07.04.2023
4,202.8	34,216	34,251	4,167

Burimi: Draft raporti kontrollit, Zyra Akcizës.

Dhe sipas draft raportit rakordimi mes gjëndjes fizike dhe kontabël rezulton si më poshtë.

Tabela: Rakordimi fizik/kontabël

Produkti	Gjëndje kontabël	Gjëndje fizike	Diferenca
Kafe papjekur	4,167	4,166	1

Burimi: Draft raporti kontrollit, Zyra Akcizës.

Sikurse evidentohet në material nuk pasqyrohen veprimet e bëra dhe shpjegimet përkatëse në konvertimin e kafes së pjekur gjëndje kontabël dhe fizike në të papjekur.

Në dosje mungon proces verbali kontrollit fizik datë 21.02.2022, bazuar në të cilin janë bërë rakordimet, si dhe raporti i miratuar nga Kryetari DD.

Në dosje nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështëten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

Sa më sipër në dosje mungon programi kontrollit, autorizimi, si dhe raporti i miratuar nga Kryetari DD për kontrollin.

7.F. I. (nr.3949/1 datë 15.05.2023) kontroll për lëndën e parë- PV nuk është vendosur dispozicion.

Në përfundim për sa trajtuar më sipër nga auditimi i kontroleve të realizuara nga Zyra Akcizës është konstatuar se në dosjet e dorëzuara nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështëten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

Në përfundim të veprimeve përgatitore nuk janë hapur dosje kontrolli për çdo operator sikurse përcakton Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 6.4.2.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim edhe me përcaktimet e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për ‘Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’, neni 4, pika 8 “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e

dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 ‘Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit’, pika 2 dhe 3 “2.Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3.Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.”

Sqarim Observacione

Lidhur me problematikat e trajtuara më sipër është paraqitur observacioni nr. 10738/26 datë 30.08.2024 nga DDT me të njëjtën përmbajtje dhe dokumentacion me atë të trajtuar në projekt raportin e auditimit dhe për rrjedhojë observacioni nuk trajtohet përsëri pasi është trajtuar dhe marrë pjesërisht në konsideratë në fazën e Raportit Përfundimtar te Auditimit.

2.7 Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.

Zyra e borxhit doganor në DDT funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022 ‘Për personelin e administratës doganore’, në të cilën evidentohen dy pozicione pune për specialist borxhi. Nga auditimi u konstatua se zyra ka funksionuar me vetëm një punonjës dhe një pozicion ka vijuar të mbetet vakant, **vakancë kjo e cila sikurse evidentohet ne vijim ka cënuar mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin në përmbushjen e detyrave të zyrës së borxhit, si pasojë e ngarkesës dhe numrit të madh të subjekteve nën mbikqyrje të Degës Doganore.**

Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në evidentimin e gjendjes së detyrimeve të subjekteve debitorë, krijimin e detyrimeve, gjëndjen në fillim dhe në fund, kontabilizimin e tyre, strukturën e detyrimeve, llojshmëria, pesha specifike në total, masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor etj.

Bazuar në evidencën e vendosur në dispozicion nga Zyra e Borxhit, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 01.01.2023 paraqitet me 1,982 raste, 1,407 subjekte debitorë në vlerën 18,368,661,021lekë, dhe gjendja e borxhit më datë 31.12.2023 paraqitet me 1,642 raste, 1,252 subjekte debitorë në vlerën 18,620,934,751 lekë. Pra gjatë vitit ushtrimor 2023, borxhi doganor është ulur në numër me 155 subjekte debitorë dhe 340 numër rastesh në krahasim me numrin në fillim të vitit, ndërsa në vlerë është shtuar me 252,273,730 lekë ose me 1.37%.

Tabela: Borxhi doganor

(lekë)

Gjendja debitore 01.01.2023			Debitorë të shtuar gjatë 2023 përfshirë kamatvonesat e llogaritura para 2023			Debitor të shlyer gjatë 2023			Gjendja debitore 31.12.2023		
Raste	Debit or	Vlerë	Raste	Debit or	Vlerë	Raste	Debit or	Vlerë	Raste	Debit or	Vlerë
1,982	1,407	18,368,661,021	995	497	430,085,528	1,335	652	177,811,798	1,642	1,252	18,620,934,751

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Sikurse evidentohet edhe në tabelë rezulton se borxhi doganor gjatë vitit 2023 është shtuar me 995 raste dhe 497 debitorë në vlerën 430,085,528 lekë, ndërsa është pakësuar me 1,335 raste dhe 652 debitorë në vlerën 177,811,798 lekë.

Për sa i përket përket përbërjes së borxhit sipas zërit, sikurse evidentohet edhe në tabelën e mëposhtme peshën kryesore e zë zëri penalite për të dy vitet 2022 dhe 2023 me 10,269 milion lekë dhe 10,276 milion lekë pra me pothuaj 55% të totalit.

Tabela: Borxhi sipas zërave

(lekë)

DD Tiranë	Raste	Detyrime	Penalitet	Kamatvonesa	Total

Borxhi31.12.2022	1,982	5,136,754,633	10,269,412,763	2,962,493,626	18,368,661,021
Borxhi31.12.2023	1,642	5,137,243,392	10,276,316,231	3,207,375,130	18,620,934,752

Burimi: Zyra borxhit, DDT.

Sa i takon strukturës konstatuese të borxhit doganor në total për DDT sikurse evidentohet edhe në tabelë rezulton se rreth 69% e totalit, në vlerën 12,847 milion lekë është konstatuar nga struktura tatimore dhe vijon më pas me 3,043 milion lekë ose 16% e totalit nga DOH dhe më pas Dega Doganore me rreth 1,890 milion lekë ose 10.15% të totalit.

Tabela: Borxhi doganor në total sipas strukturave konstatuese (lekë)

Borxhi sipas strukturës konstatuese			
Organi Konstatues	Numër Raste	Shuma e Borxhit	% Ndaj Totalit
DOH	246	3,043,866,076	16.35%
KLSH	190	151,969,778	0.82%
Dega Doganore	778	1,890,511,774	10.15%
D.Kontrollit pas Zhdoganim	109	331,544,014	1.78%
A/KONTRABANDA	30	31,402,690	0.17%
CROËN AGENTS	120	57,459,538	0.31%
TATIMET	4	12,847,560,363	69.00%
AUDIT	31	39,806,021	0.21%
SKAO	53	13,195,740	0.07%
Min. Financës	1	21,423,888	0.12%
Dep.Akcizës	72	178,172,833	0.96%
Origjina DPD	8	14,022,036	0.08%
Totali	1642	18,620,934,752	100.00%

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Ndërsa gjatë vitit 2022 struktura me vlerën më të lartë të borxhit të konstatuar është DOH me rreth 91 milion lekë ose pothuaj 34%, e ndjekur nga Dega Doganore me pothuaj 32% të totalit ose 85 milion lekë. **Tabela:** Borxhi doganor 2022 sipas strukturave konstatuese (lekë)

Borxhi sipas strukturës konstatuese 2022			
Organi Konstatues	Numer Raste	Shuma e Borxhit	% Ndaj Totalit
DOH	43	91,466,854	33.85%
KLSH	236	19,018,542	7.04%
Deget Doganore	627	85,249,567	31.54%
SVQ	126	58,222,705	21.54%
SKAO	170	16,293,323	6.03%
Totali	1202	270,250,991	100.00%

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Gjatë vitit 2023 struktura me vlerën më të lartë të borxhit doganor të konstatuar është vet Dega Doganore me një vlerë pothuaj 74 milion lekë ose 40%, e ndjekur nga SVQ me pothuaj 29% të totalit ose rreth 53 milion lekë.

Tabela: Borxhi doganor 2023 sipas strukturave konstatuese (lekë)

Borxhi sipas strukturës konstatuese 2023			
Organi Konstatues	Numer Raste	Shuma e Borxhit	% Ndaj Totalit
DOH	29	12,929,090	7.12%
KLSH	291	37,000,336	20.36%
Deget Doganore	486	73,628,669	40.52%
SVQ	158	52,816,659	29.07%
SKAO	8	1,563,803	0.86%
A/KONTRABANDA	18	3,765,151	2.07%
Totali	990	181,703,708	100.00%

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Referuar llojit të shkeljeve në total vlera e borxhit doganor përbëhet nga 69% tatime, 15% kundravajtje, 11% kondrbandë etj., sikurse evidentohet edhe në tabelë.

Tabela: Borxhi doganor në total sipas llojit (lekë)

Borxh Total 31.12.2023			
	Numer Raste	Vlerë	% Ndaj Totalit
TVSH e shtyrë	32	326,649,387	1.75%
Auto Veturë	122	51,070,014	0.27%
Akcize Dogana	139	290,649,762	1.56%
Akcize Tatime	4	12,847,560,363	69.00%
Rivlerësim	417	92,074,073	0.49%
Kontrabandë	230	2,126,424,610	11.42%
Kundërvajtje	698	2,886,506,542	15.50%
Totali	1,642	18,620,934,751	100.00%

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Referuar llojit të shkeljeve vlera e borxhit doganor krijuar gjatë 2022 përbëhet më së shumti nga rivlerësimet reth 43%, kundërvajtjet 21%, akciza dhe kontrabanda reth 17%.

Tabela: Borxhi doganor 2022 sipas lloji (lekë)

Borxh krijuar 2022			
	Numer Raste	Vlerë	% Ndaj Totalit
Auto Veturë	82	1,644,752	0.61%
Akcize Dogana	5	47,732,552	17.66%
Rivlerësim	787	115,715,682	42.82%
Kontrabandë	10	47,202,655	17.47%
Kundërvajtje	318	57,955,350	21.45%
Totali	1202	270,250,991	100.00%

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Referuar llojit të shkeljeve vlera e borxhit doganor krijuar gjatë 2023 përbëhet më së shumti nga rivlerësimet reth 55%, kundërvajtjet 40% dhe kontrabanda reth 4%.

Tabela: Borxhi doganor 2023 sipas llojit (lekë)

Borxh krijuar 2023			
	Numer Raste	Vlerë	% Ndaj Totalit
Auto Veturë	77	1,540,000	0.85%
Akcize Dogana	3	236,427	0.13%
Rivlerësim	656	100,240,302	55.17%
Kontrabandë	10	6,814,746	3.75%
Kundërvajtje	244	72,872,233	40.10%
Totali	990	181,703,708	100.00%

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Sa i takon vjetërsisë së borxhit doganor rezulton se reth 97% e tij, me një vlerë prej 18,129 milion lekësh ka një vjetërsi më të madhe se 5 vjet dhe vetëm 0.51% e tij është borxh i krijuar rishtaz në dy vitet e fundit.

Tabela: Vjetërsia e borxhit doganor në 31.12.2023

Vjetërsia borxhit doganor 31.12.2023				
Nr.	Emertimi	Raste	Vlerë (mijë lekë)	Në %
1	1 vit	173	59,975,220	0.32%
2	2 vjet	97	94,119,896	0.51%
3	3 vjet	59	10,525,750	0.06%
4	4 vjet	129	326,538,929	1.75%
5	Mbi 5vjet	1,184	18,129,774,956	97.36%
	Gjithsej	1,642	18,620,934,751	

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Gjatë auditimit është kërkuar informacon mbi masat e marra gjatë vitit 2022 dhe 2023 për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor, për të cilin është vendosur në dispozicion informacioni evidentuar si në tabelat më poshtë.

Tabela: Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor gjatë vitit 2022

Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor gjatë vitit 2022

DEGA	Detyrime totale me Urdhër Ekzekutimi 01.01.2022-31.12.2022		Detyrime totale pa Urdhër Ekzekutimi Borxhe deri më 31.12.2022			
			Në proces gjyqësor		Në procedurë	
	Raste	Shumë	Raste	Shumë	Raste	Shumë
Tiranë	452	4,114,341,621	313	13,659,899,145	1,217	594,420,255

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Sipas DD Tiranë deri në fund të vitit 2022 kanë dalë 452 urdhër ekzekutime për dëmshpërblim të vlerës 4,114 milion lekë, rezultojnë në proces gjyqësor 313 raste me një vlerë prej 13,659 milion lekësh dhe për 1,217 raste me vlerë 594 milion lekë procedura administrative vijon të mbetet në faza të ndryshme, por pa arritur në fazat e sipër cituara.

Tabela: Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor gjatë vitit 2023

Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor gjatë vitit 2023

DEGA	Detyrime totale me Urdhër Ekzekutimi 01.01.2023-31.12.2023		Detyrime totale pa Urdhër Ekzekutimi Borxhe deri më 31.12.2023			
			Në proces gjyqësor		Në procedurë	
	Raste	Shumë	Raste	Shumë	Raste	Shumë
Tiranë	492	4,193,995,542	217	13,860,700,854	933	566,238,355

Burimi: Zyra e borxhit, DDT.

Sipas DD Tiranë deri në fund të vitit 2023 kanë dalë 492 urdhër ekzekutime për dëmshpërblim të vlerës 4,193 milion lekë, rezultojnë në proces gjyqësor 217 raste me një vlerë prej 13,860 milion lekësh dhe për 933 raste me vlerë 566 milion lekë procedura administrative vijon të mbetet në faza të ndryshme, por pa arritur në fazat e sipër cituara.

Nga auditimi i evidencës së borxhit vendosur në dispozicion është konstatuar se për vendime shpallje debitor të nxjerra gjatë viteve 2021,2022 dhe 2023 nuk janë zbatuar përcaktimet e Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, evidentuar më hollësisht më poshtë.

1-Për 184 subjekte janë bërë njoftimet jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 24h/5ditë/10ditë, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, kap VI, pika 1,2,3,4,5,6,7. (Aneksi 1)

2-Për 34 subjekte me vlerë borxhi 812,086 lekë nuk janë nxjerrë vendimet për rikuperimin me forcë të borxhit dhe për 111 subjekte të tjera, këto vendime janë nxjerrë vendimet jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 10/30 ditësh, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, kap VII ‘Ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor’, pika 2 në të cilën citohet se ‘Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas KD ose LA...kalohet në ekzekutimin forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës’. (Aneksi 2)

3- Për 71 subjekte me vlerë borxhi **3,686,949 lekë** Dega Doganore nuk ka dërguar në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhër ekzekutimeve në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, kap VIII, pika 4 ku thuhet se ‘Dega Doganore është

përgjegjëse për dërgimin sipas ligjit të akteve të mësipërme në Gjykatë dhe nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit'. (Aneksi 3)

Për vitin 2023 diferenca e debitorëve midis zyrës së financës dhe zyrës së borxhit është në vlerën prej **31,432,465** lekësh (18,652,367,216 lekë gjendja e debitorëve në 31.12.2023 raportuar nga zyra e financës dhe 18,620,934,751 lekë raportuar gjendja nga zyra e borxhit). Kjo diferencë prej **31,432,465** lekësh është justifikuar sipas sqarimeve të më poshtme se “Në fund të vitit nga të ardhurat e arkëtuara nga gjocat, marrim konfirmim me shkresë nga Drejtoria Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Zyra Jurike pranë Degës së Doganës Tiranë nëse subjektet që kanë paguar për gjocat për vitin aktual raportues janë në procese ankimi apo jo. Në vijim të sa më sipër është bërë kalimi nga llogaria ekonomike 7115210 e gjobave, te llogaria ekonomike 4662100 e mjeteve në ruajtje. Kjo sepse në rast se çështjet që janë në ankim apo në procese gjyqësore humben nga Dega e Doganës Tiranë, jemi të detyruar t’i kthejmë shumën e paguar subjekteve përkatëse, dhe kjo mund të bëhet në vitet e mëpasshme vetëm nga llogaria e mjeteve në ruajtje 4662100, si e vetmja llogari që mbartet nga viti në vit. Zyra e Financës mban përnjëherësh dhe llogarinë 468 si e drejtë për të arkëtuar mjetet monetare (llogari aktivi) dhe llogarinë 4662100 si detyrim për t’i kthyer mjetet monetare subjekteve përkatëse nëq finalizimi i procesit gjyqësor është në favor të subjekteve (pra llogari detyrimi). Ndërkohë zyra e borxhit e heq si debitor në momentin që subjekti paguan, qoftë kjo në llogarinë ekonomike 7115210 (llogari gjobe), qoftë në llogarinë ekonomike 4662100 (llogari mjete në ruajtje).”

Dosje me përzgjedhje 10 copë

Gjatë auditimit u përzgjedhën për testim 10 dosje të borxhit doganor me vlerë totale **89 milion lekë ose reth 58% e totalit të borxhit** (154 milion lekë) të krijuar dhe mbetur, gjatë viteve 2022 dhe 2023.

1.Subjekti ‘B. G.’ sh.a. me NIPT M.....E me një vlerë detyrimi total prej 3,788,880 lekësh.

Pjesë e dosjes është dokumentacioni si më poshtë:

a.Vendimi DD Tiranë nr.879 datë 06.12.2021 me vlerë detyrimi doganor 1,262,960 lekë dhe penalitet 2fish 2,525,920 lekë.

b.Zarfi njoftimit nr.879 datë 28.12.2021, i kthyer.

c.Vendimi nr.67 datë 07.07.2022 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës.

d.Zarfi njoftimit VRFB nr.67 datë 16.07.2022, i kthyer.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.10016 datë 25.10.2022 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

f.Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit datë 14.11.2022.

g.Lajmërimi për ekzekutim vullnetar të urdhërit të ekzekutimit nr.11480/5 datë 09.12.2022.

h.Zarfi kthyer i njoftimit nr.180/5 datë 19.12.2022.

i.Kontrata e shërbimit datë 21.12.2022 me zyrën përmbarimore.

Sa më sipër nga auditimi u konstatua se në dosje mungon:

*Shkresa për njoftimin e strukturave përkatëse tatimore DPT/DRT sipas “Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355 datë 19.06.2018, mbi detyrimet shtesë tatimore të lindura si pasojë e detyrimeve shtesë të akcizës në vlerën 1,262,960 lekë, konkretisht detyrime shtesë TVSH (20%)*1,262,960 lekë,pra 252,592 lekë detyrime TVSH-je dhe gjoba 100% mbi të prej 252,592 lekë, në total 505,184 lekë detyrime tatimore të munguara.*

Gjithashtu sikurse evidentohet dhe më sipër gjatë gjithë procedurës **nuk janë zbatuar afatet** procedurale përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, duke rezultuar në një procedurë e cila ka zgjatur në total pothuaj 1 vit.

2.Shtetasi Z. H. M. me një vlerë detyrimi total prej 2,277,590 lekësh.

Pjesë e dosjes është dokumentacioni si më poshtë:

a.Vendimi DD Tiranë nr.177 datë 18.02.2022 me vlerë detyrimi doganor 753,467 lekë dhe penalitet 1,506,934 lekë.

b.Zarfi njoftimit nr.177 datë 03.03.2022, i kthyer.

c.Vendimi nr.38 datë 29.06.2022 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës.

d.Zarfi njoftimit VRFB nr.38/R datë 04.07.2022, i kthyer.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.10124 datë 28.10.2022 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

f.Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit datë 01.12.2022 .

g.Shkresa nr.1456 datë 17.02.2023 për tërheqjen e Urdhër Ekzekutimit nga gjykata.

h.Lajmërimi për ekzekutim vullnetar të urdhërit të ekzekutimit nr.1456/1 datë 17.02.2023.

l.Kërkesa nr.1868 datë 02.03.2023 për ekzekutim të urdhërit drejtuar shoqërisë përmbarimore.

j.Kontrata e shërbimit datë 07.03.2023 me zyrën përmbarimore.

Sikurse evidentohet dhe më sipër gjatë gjithë procedurës nuk janë zbatuar afatet proceduriale përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, duke rezultuar në një procedurë e cila ka zgjatur në total pothuaj 1 vit.

3. Shtetasi ‘I. Sh. ’me ID J..... H me një vlerë detyrimi total prej 6,054,511 lekësh.

Pjesë e dosjes është dokumentacioni si më poshtë:

a.Vendimi DD Tiranë nr.176 datë 18.02.2022 me vlerë detyrimi doganor 1,515,859 lekë dhe penalitet 4,538,652 lekë.

b.Zarfi njoftimit nr.176 datë 03.03.2022, i kthyer.

c.Vendimi nr.37 datë 29.06.2022 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës.

d.Zarfi njoftimit VRFB nr.37/R datë 04.07.2022, i kthyer.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.10123 datë 28.10.2022 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Sa më sipër nga auditimi u konstatua se në dosje mungon:

- **Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe në vijim procedura.**

-Gjithashtu sikurse evidentohet dhe më sipër **gjatë gjithë procedurës nuk janë zbatuar afatet proceduriale** përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, duke rezultuar në një procedurë e cila ka zgjatur në total pothuaj 8 muaj.

4. Subjekti ‘G. G.’ shpk me NIPT L.....F me një vlerë detyrimi total prej 14,839,236 lekësh.

Pjesë e dosjes është dokumentacioni si më poshtë:

a.Vendimi DD Tiranë nr.155 datë 02.03.2022 me vlerë detyrimi doganor 7,419,618 lekë dhe penalitet 7,419,618 lekë.

b.Zarfi njoftimit nr.155 datë 08.03.2023, i kthyer.

c.Vendimi nr.91 datë 19.06.2023 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës.

d.Zarfi njoftimit VRFB nr.91/R datë 27.06.2023, i kthyer.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.7327 datë 23.08.2023 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Sa më sipër nga auditimi u konstatua se në dosje mungon:

- **Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe në vijim procedura.**

-Gjithashtu sikurse evidentohet dhe më sipër gjatë gjithë **procedurës nuk janë zbatuar afatet proceduriale** përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, duke rezultuar në një procedurë deri në këtë fazë të zgjatur në total për pothuaj 18 muaj, ku

konkretisht vetëm vendimi për rikuperimin e forcë të borxhit ka dalë 1 vit e 3 muaj pas vendimit të shpalljes debitor të subjektit.

5.Subjekti 'I. 'me NIPT M.....H me një vlerë detyrimi total prej 9,708,816 lekësh.

Pjesë e dosjes është dokumentacioni si më poshtë:

a.Vendimet DD Tiranë nr.695 dhe nr.696 datë 20.07.2023 dhe nr.698 dhe nr.699 datë 21.07.2023 me vlerë detyrimi doganor 3,236,272 lekë dhe penalitet 6,472,544 lekë.

b.Zarfi njoftimitit nr.695 datë 31.07.2023, i kthyer.

c.Vendimi nr.115 datë 03.10.2023 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës.

d.Zarfi njoftimitit VRFB nr.115/R datë 09.10.2023, i kthyer.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.859 datë 31.01.2024 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Sa më sipër nga auditimi u konstatua se në dosje mungon:

- **Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe në vijim procedura.**

-Gjithashtu sikurse evidentohet dhe më sipër gjatë gjithë **procedurës nuk janë zbatuar afatet proceduriale** përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 '*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*', duke rezultuar në një procedurë deri në këtë fazë të zgjatur në total për pothuaj 6 muaj dhe sikurse është konstatuar dhe në auditimin e vendimeve, vet vendimet e mësipërme kanë dalë në tejkalim të afateve ligjore me 85 ditë vonesë ose reth 160 ditë pas mbajtjes së process verbaleve të verifikimeve të shkeljeve.

6.Subjekti 'P. W. me NIPT M.....S me një vlerë detyrimi total prej 3,300,090 lekësh.

Pjesë e dosjes është dokumentacioni si më poshtë:

a.Vendimi DD Tiranë nr.410 datë 29.03.2023 me vlerë detyrimi doganor 1,650,045 lekë dhe penalitet 1,650,045 lekë.

b.Zarfi njoftimitit nr.410 datë 07.04.2023, i dorëzuar.

c.Vendimi nr.96 datë 19.02.2023 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës.

d.Zarfi njoftimitit VRFB nr.96/R datë 27.06.2023, i dorëzuar.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.7330 datë 23.08.2023 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

f.Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit datë 08.09.2023, marrë datë 02.10.2023.

e.Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.3736 datë 28.04.2023 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

f.Shkresa e gjykatës nr.4486 datë 23.05.2023 për depozitimimin e vërtetimit nga gjykata se akti administrative nuk është objekt i shqyrtimit gjyqësor.

g.Shkresa nr.4486/1 datë 23.05.2023 e DDT drejtuar gjykatës për informacion nëse subjekti është ankuar pranë saj lidhur me vendimin nr.608 dhe 609 datë 19.04.2022.

Sa më sipër nga auditimi u konstatua se në dosje mungon:

- **Vendimi Gjykatës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe në vijim procedura.**

-Gjithashtu sikurse evidentohet dhe më sipër gjatë **procedurës nuk janë zbatuar afatet proceduriale** përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 '*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*', duke rezultuar në një procedurë deri në këtë fazë të zgjatur në total për pothuaj 1 vit, ku vetem kërkesa për lëshimin e urdhër ekzekutimit drejtuar gjykatës është bërë pothuaj 1 vit nga njoftimi i marrë.

Trajtim Observacione

Lidhur me problematikat e trajtuara më sipër është paraqitur observacioni nr. 10738/26 datë 30.08.2024 nga DDT me të njëjtën përmbajtje dhe dokumentacion me atë të trajtuar

në projekt raportin e auditimit dhe për rrjedhojë observacioni nuk trajtohet përsëri pasi është trajtuar dhe marrë pjesërisht në konsideratë në fazën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se artikujt “*Tub Plastik një përdorim për përdorim venoz*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim në trajte përdorimi përfundimtar ambalazh*” janë ambalazhe plastike dhe kanë si përdorim në destinacion përfundimtar ambalazhimin e solucionit mjekësor dhe se nga pikëpamja e pikës 3 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, këto shërbejnë për mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim ose përdorim. Konstatohet se ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, vendos kufizime duke mos u shtrire efektin e tij në të gjithë mallrat e deklaruara në Nomenklaturën e Mallrave në RSH, dhe artikujt e mësipërm nuk përfshihen në listën e artikujve plastike ambalazhues njëpërdorimshëm që duhet të paguajnë taksë ambalazhi plastik në RSH.

1-Konstatohet se artikujt “*Tub Plastik një përdorim për përdorim venoz*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim në trajte përdorimi përfundimtar ambalazh*” kanë si përdorim në destinacion përfundimtar ambalazhimin e solucionit mjekësor si në trajtën e përdorimit të artikullit “*Shiringe plastike*” dhe në trajtën e përdorimit të artikullit “*Tub plastik për lëng venoz*” dhe janë 100% material plastik dhe në përdorim përfundimtar shërbejnë totalisht si ambalazh që ambalazhojnë solucione mjekësore. Konstatohet se në VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 për miratimin e rregullores “*Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore*” në VKM Nr. 418, datë 27.05.2020 “*Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020–2035*” dhe Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore përcaktohen rregulla të qarta për mënyrën e trajtimit të pajisjeve mjekësore të përdorura në njësi spitalore përfshirë edhe mallrat *Tub Plastik një përdorim*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim*” ndërsa për pajisjet mjekësore të natyrës së mësipërme që nuk trajtohen në njësi spitalore por vetëm në farmaci publike dhe depo farmaceutike në shitje të lirë për publikun nuk ka asnjë rregullim ligjor. Konstatohet gjatë auditimit se nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka patur korrespondencë dhe bashkëpunim me Ministrinë e Financave për këtë problematikë.

2-Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk rezultojnë të kryera kontrole doganore me qëllim ekzaminimin e mallrave, vërtetësinë e dokumentacionit dhe destinacionit të mallrave bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” me qëllim verifikimin e vërtetësisë së pagesës së detyrimeve doganore për mallrat “*Tub Plastik një përdorim*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim*” kur shiten në destinacion përfundimtar jo për “*Njësi spitalore*” por për farmaci ose depo farmaceutike pra shitje e lire publike trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit të cilat do të kishin sjelle efekte pozitive në shumën 18,689,857 lekë në të ardhurat doganore nëse do të ishin trajtuar me shkallë takse kombëtare në nivelin 35 lek/kg.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.4 në faqen nr. 89 deri 151 dhe aneksin nr. 4,61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet sektorit të Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Pas Zhdoganimit në Departamentin e Analizave Riskut dhe Aposteriorit në vijim të ndërtojë Programe Kontrolli Specifike Verifikuese për deklarimet e praktikave doganore që janë përpunuar sipas tabelës trajtuar për këtë çështje bashkëlidhur anekseve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të mësipërme si dhe të tjera praktika me qëllim verifikimin e vërtetësisë së pagesës detyrimeve doganore për mallrat e trajtuar sa më sipër në funksion të verifikimit të mallit “*Tub Plastik një përdorim*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim*, me destinacion përfundimtar Mbetje në Njësi Spitalore apo Shitje në Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike.

Rekomandimi 1.2: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përfundim të procedurave të kontrollit të gjykoje problematiken e trajtuar sa më sipër duke bashkërenduar menjëherë me Ministrinë e Financave me qëllim kryerjen e ndryshimeve ligjore për përfshirjen e artikujve “*Tub Plastik një përdorim për përdorim venoz*” dhe “*Shiringa plastike një përdorim në trajte përdorimi përfundimtar ambalazh*” me destinacion përfundimtar ambalazhimin e solucionëve që shiten në Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike në listën e artikujve plastike ambalazhues një përdorimshëm që paguajnë takse kombëtare TAM në nivelin 35 lek/kg dhe përfshirjen e këtyre mallrave për pagesë të taksës së ambalazhit në anekset e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare*” Në përfundim të procedurës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të informohet Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi rezultatet e kontrollit dhe mbi vërtetësinë e veprimeve të kryera për propozim për pagesë takse të ambalazhit plastik për praktika të gjeneruar të trajtuara në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vijim

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se në magazinën e mallrave të sekuestruara evidentohen 497 kode mallrash të artikujve të ndryshëm të sekuestruar në vlerën 11,892,923 lekë për vitin 2022 dhe 2023 dhe është rritur numri i artikujve të sekuestruar dhe vlera totale e artikujve për gjithë periudhat paraqitet në shumën 24,340,919 lekë. Këto mallra nga zyra e financës regjistrohen në bazë të procesverbalit shoqërues të mbajtur nga struktura që i ka bllokuar. Shumica e artikujve të bërë hyrje në vitet 2022 dhe 2023 janë mallra që dyshohet se cenohet e drejta e pronësisë intelektuale, për të cilat nga ana e Drejtorisë për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, pranë DPD-së kryen verifikimet për cenueshmerinë e pronësisë intelektuale në bashkëpunim me avokatin ligjor për mbrojtjen e markave dhe patentave. Për këto mallra të bllokuara me dyshimin e cënimit të pronësisë intelektuale, sipas subjektit Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale e ka informacionin rast pas rasti, por rezulton se jo në të gjitha rastet ka vendimmarrje për vazhdim procedurash. Gjithashtu nga strukturat verifikuese (*Spektori i Verifikimit Fizik, Antikontrabanda*, etj.) nuk është mbajtur procesverbal verifikimi apo sekuestrimi për të gjitha rastet siç parashikon neni 274 “*Forma e procesverbalit të verifikimit e të sekuestrimit*” i ligjit nr. 102/2014 “*Kodi Doganor në RSH*”, por vetëm procesverbal bllokimi. Në mungesë të procesverbaleve të sekuestrimit, nga ana e sektorit juridik nuk janë përgatitur vendime për vijimin e procedurës së konfiskimit, si rrjedhojë nga Dega e Doganës Tiranë nuk ka vendimmarrje për mallrat e sekuestruara me procesverbalet përkatës. Ky element procedural nuk është trajtuar edhe pse mallrat gjendje në magazinë sipas informacionit të zyrës së financës datojnë prej vitit 2018. Referuar mallrave me natyrë akcize të destinuara për shkatërrim nga Kryetari i Degës është hartuar urdhri nr. 09 datë 05.07.2023 “*Për ngritje komisioni për inventarizim të mallrave të konfiskuara me destinacionit shkatërrimin*”. Me shkresën nr. 5619/3 prot., datë

15.08.2023. Kryetari i Degës i ka dërguar relacion përmbledhës drejtorit të përgjithshëm mbi gjendjen e mallrave, por procedura nuk ka vijuar me ngritjen e grupit të shkatërrimit. Këto mallra janë gjendje në magazinën e DDT-së.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.1 në faqen nr. 23-30 të Raportit Përfundimtar te Auditimit)

Rekomandimi 1.1: Nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa që të ketë vendimmarrje për të gjitha rastet e mallrave të sekuestruara pas kryerjes së verifikimeve për cenueshmerinë e pronësisë intelektuale.

Rekomandimi 1.2: Nga strukturat përkatëse verifikuese (*Spektori i Verifikimit Fizik, Antikontrabanda etj.*) të merren masa që krahas procesverbalit të bllokimit, të mbahet dhe procesverbal sekuestrimi për mallrat, në mënyrë që sektori juridik të vijojë me vendimmarrjet sipas rastit.

Rekomandimi 1.3: Nga Drejtoria i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për ngritjen e grupeve të shkatërrimit për mallrat e akcizës të destinuara për shkatërrim që ndodhen në magazinat e Degës së Doganës Tiranë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave doganore të magazinimit të përkohshëm janë evidentuar mangësi në sistemin elektronik, ku problematike është qëndrimi në deklarin elektronik të mallrave në Magazinimin e Përkohshëm (DEMP) me ngjyrë të bardhë në sistem, pavarësisht se janë të mbyllura në rastet kur ka transit të brendshëm/transit ndërkombëtar/mospërputhje të tjera. Për rastet e evidentuara për vitin 2022 dhe 2023 konstatojmë se në praktikë në këtë procedurë të programuar ka mangësi pasi shumë DEMP kanë ngjyrë të bardhë ose gri pavarësisht faktit se ato janë në statusin “e shkarkuar” dhe duhet të kishin ngjyrë të kuqe gjë që tregon mospërputhshmërinë e treguesve të DEMP-it (ngjyrës) në lidhje në sistem në lidhje me statusin doganor të mallrave duke cenuar saktësinë e të dhënave që gjeneron ky sistem dhe veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 31.12.2018, Manuali për “Për deklarin elektronik të mallrave në Magazinimin e Përkohshëm-DEMP”,

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.2 në faqen nr. 30-54 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandimi 2.1: Nga ana e përgjegjës të Zyrës së Magazinimit të Përkohshëm të përcillet problematika e sistemit në strukturat përkatëse në mënyrë që të dhënat e këtij sistemi të jenë të sakta dhe koherente. Nga strukturat përkatëse lidhur me sistemin të merren masa për reflektim dhe zgjidhje të problematikave të hasura.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm (ZMP) për mallrat e vendosura në magazinim të përkohshëm të cilave u ka kaluar afati i qëndrimit prej 90 ditësh, doganierët mbikëqyrës të zyrës së magazinimit të përkohshëm nuk kanë marrë masat e nevojshme për të rregulluar situatën sipas legjislacionit doganor. Konkretisht duke nisur me njoftimin për subjektet dhe lënien e një afati kohor të arsyeshëm për të depozituar dokumentet dhe vendosjen e tyre në një regjim doganor të caktuar apo çlirimin e tyre sipas neneve 27 “Vendimet e favorshme që merren mbi baza aplikimi”, neni 178 “Shkatërrimi i mallrave”, neni 179 “Masat që duhet të merren nga autoritetet doganore”, neni 180 “Braktisja e mallrave (Heqja dorë nga posedimi ose pronësia)” të Kodit Doganor dhe neni 360 “Mallrat e pa çliruara”, neni 361 “Shkatërrimi i mallrave”, neni 362 “Braktisja e mallrave”, neni 363 “Shitja e mallrave dhe masa të tjera të marra nga autoritetet doganore” të DZKD.

-Nga auditimi për kontrollet e kryera gjatë vitit 2022 dhe 2023 ndaj subjekteve të autorizuara që deklarata e magazinimit të përkohshëm të jetë në formën e një manifesti

doganor ose dokument tjetër transporti sipas nenit 135 të Kodit Doganor, konstatojmë se kontrollet e kryera nga doganierët mbikëqyrës të kësaj zyre ndaj këtyre subjekteve nuk shoqërohen me dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm. Janë konstatuar mallra gjendje jashtë afatit kohor të qëndrimit në magazinim të përkohshëm, pa identifikuar dhe verifikuar saktë artikujt, vlerën, sasinë e cilësinë e tyre, si dhe pa verifikuar saktë në të gjitha rastet kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në këto ambiente. Gjithashtu evidentohen dhe mallra të abandonuara por të pa evidentuara nga kontrolli me sasi, përshkrim, vlerë, datë hyrje, subjekt etj.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.2 në faqen nr. 30-54 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandimi 3.1: Nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm për mallrat e vendosura në magazinim të përkohshëm të evidentuara se u ka kaluar afati i qëndrimit prej 90 ditë, të merren të gjitha masat e nevojshme për rregullim situatë konform parashikimeve të legjislacionit doganor. Gjithashtu të merren masa që kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve të autorizuar të shoqërohen me dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm duke identifikuar dhe verifikuar saktë artikujt, vlerën, sasinë, cilësinë e tyre si dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në këto ambiente.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në lidhje me koeficientet e shfrytëzimit të materialeve të hyra në regjime doganore ekonomike të tipit RPA, mbështetur në Kartën Teknologjike, në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 “Për Regjimin RPA”, u konstatua se ky proces nuk është kryer për të gjitha rastet me iniciativa të personelit mbikëqyrës doganor, por vetëm duke u mbështetur në deklarinë e operatorëve ekonomikë sipas kartës teknologjike apo deklarimet e vetë subjektit. Gjithashtu, konstatohet se jo për të gjitha produktet e përpunuara nga ana e subjekteve janë dorëzuar kartat teknologjike përkatëse. Në mbyllje të regjimit sipas aneksit 8, në disa raste koeficienti i shfrytëzimit është përcaktuar një koeficient për shumë artikuj duke i grupuar por dhe duke vendosur koeficient shfrytëzimi në një interval me diferencë të lartë midis minimumit dhe maksimumit. Për rrjedhojë, koeficienti i deklaruar nga subjekti në momentin e raportimit të mbetjeve që do të asgjësohet është marrë i mirëqenë në mbylljen e regjimit duke mbartur një risk të shtuar në lidhje dhe me procedurat e asgjësimit pasi prezenca doganore ka qenë e kufizuar vetëm në rastet e përzgjedhjes të deklarimit në kanal të kuq.

Gjatë auditimit u konstatua se në dokumentet e mbylljes së regjimeve rezultojnë koeficiente shfrytëzimi në një interval prej disa numrash dhe jo një numër i caktuar; në krahasimin e koeficientit të shfrytëzimit nga një regjim paraardhës në atë pasardhës kishte ndryshime, të cilat pavarësisht se objekti i veprimtarisë së regjimit të përpunimit aktiv nuk ka pësuar ndryshime *(dhe karta teknologjike është e njëjta e dorëzuar nga operatori në fillim të pajisjes me një regjim për herë të parë)*, prodhimi i mallrave mund të ketë qenë i ndryshëm në varësi të porosive nga eksportuesi, gjë që automatikisht ndikon në koeficientin e shfrytëzimit. Nisur nga situata e mësipërme nuk është kryer një verifikim specifik për të parë zbatimin konkret të koeficientëve të shfrytëzimit dhe për t’i krahasuar me sasinë e mallrave për të cilat është dhënë destinacioni IM9 “Asgjësimit i produkteve të dala nga proceset e përpunimit të mallrave nën regjim dhe humbje dhe firo të dala gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura nën regjim”. bazuar në përcaktimet e neni 15 “Detyrimet e Doganierit Mbikëqyrës” sipas Udhëzimit nr.4 datë 28.03.2019 “Mbi Zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” të cilat mbartin risk të lartë dhe mund sjellin pasoja me lindje detyrimesh doganore të cilat nuk kontabilizohen dhe nuk arkëtohen në Buxhetin e Shtetit.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.3 në faqen nr. 54-89 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandimi 4.1: Kryetari i Degës Doganore Tiranë, Sektori i Mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike doganore, të marrin masa të menjëhershme për verifikimin e koeficientëve të shfrytëzimit për të gjithë operatorët ekonomikë që kanë përfituar autorizime të tipit RPA, të cilët rezultojnë me mbyllje të regjimit të RPA me procedurë IM9 “*Asgjësim i produkteve të dala nga proceset e përpunimit të mallrave nën regjim dhe humbje dhe firo të dala gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura nën regjim*” me qëllim eliminimin e pasojave dhe efekteve negative që mund të lindin në të ardhurat doganore që raportohen në Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimeve të DD Tiranë për vitin 2023 janë evidentuar 5 vendime të hartuar në tejkallim të afatit 60 ditor që përcakton neni 276 të Ligjit nr.102/2014 datë 22.08.2014 ‘*Kodi Doganor i RSH*’ ku thuhet se: ‘*vendimi i autoriteteve doganore kompetente merret: a) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes është mbajtur nga vetë autoriteti doganor kompetent, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur shkelësit i përfundon afati për paraqitjen e pretendimeve për procesverbalin, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 273*’ dhe konkretisht vendimi nr.698 datë 21.07.2023 për 85 ditë me vonesë, vendimi nr.696 datë 20.07.2023 për 84 ditë me vonesë, vendimi nr.695 datë 20.07.2023 për 84 ditë me vonesë, vendimi nr. 699 datë 21.07.2023 për 85 ditë me vonesë dhe vendimi nr. 863 datë 06.10.2023 për 25 muaj me vonesë.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.5 në faqen nr. 151-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandim 5.1: Drejtoria/Sektori Juridik në Degën e Doganës Tiranë të marrë masa për hartimin dhe miratimin brenda afateve procedurale të parashikuara të vendimeve të Degës Doganore dhe dokumentimin e gjurmëve të auditimit për pengesat dhe arsyet e vonesave nga momenti i mbajtjes së proces verbaleve të konstatimit të shkeljeve administrative.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimeve të Degës Doganore Tiranë për vitin 2023 janë evidentuar 2 vendime, nr. 852 datë 29.09.2023 dhe nr.880 datë 20.10.2023 për operatorin ‘U. E’, në të cilët gjoha e aplikuar tejkalon limitin e parashikimit ligjor mbi të cilin është klasifikuar shkelja me 20,000 lekë, neni 256/1/b i Kodit Doganor në të cilin përcaktohet se ‘*b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë*’, si dhe vlerën e propozuar në proces verbale prej 50,000 lekësh.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.5 në faqen nr. 151-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandim 6.1: Dega Doganore të marrë masa për zbatimin e parashikimeve të Kodit Doganor mbi klasifikimin e shkeljes, aplikimin e penalitetëve dhe saktësimin e parregullsive të evidentuara në vlerën 40,000 lekë.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2023 zyra e akcizës në DDT ka funksionuar me 2 pozicione doganier akcizë vakant nga 6 që janë në strukturën e miratuar, vakanca këto që sikurse është konstatuar edhe nga auditimi, së bashku edhe me frekuencën e lartë të transferimeve të përkohshme apo delegimeve kanë cenuar mbarëvajtjen dhe mire funksionimin në përmbushjen e detyrave të zyrës së akcizës, si pasojë e ngarkesës dhe numrit të madh të subjekteve nën mbikëqyrje të Degës Doganore, në kundërshtim me

VKM nr.355 datë 26.05.2022,

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.6 në faqen nr. 177-192 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandim 7.1: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masat për plotësimin e pozicioneve vakante me doganier akcize sipas kërkesave specifike të pozicionit.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlefshmërisë së garancive të autorizimeve të magazinave fiskale për 77 operator akcize është konstatuar se:- Subjektet B. T., K., Ch. ShPK, I., K. P., I. A C, S. O. sha dhe A. O. nuk kanë rinovuar garancitë gjatë vitit 2022; - Subjektet S. H, L. dhe N. nuk kanë rinovuar garancitë gjatë vitit 2023; -Subjektet T. B. H., E. H., E. dhe A. nuk kanë rinovuar garancitë gjatë vitit 2022 dhe 2023. Për pasojë për subjektet e evidentuara nuk janë marrë masat administrative në monitorimin e vlefshmërisë së garancive të magazinave fiskale dhe nisjen e procedurave të revokimit sipas rastit, si nga Dega Doganore mbikëqyrëse ashtu edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 dhe VKM nr. nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 60,

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.6 në faqen nr.177-192 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandim 8.1: Dega Doganore Tiranë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në çështjen e autorizimeve të magazinave fiskale të cilat rezultojnë të pa mbuluara me garanci sipas legjislacionit doganor e për të cilat nuk kanë nisur ende procedurat e revokimit të autorizimit të magazinës fiskale, si dhe të marrë masa për monitorimin të vazhdueshëm të veprimtarisë së operatorëve lidhur me vlefshmërinë në kohë të kushteve ligjore të autorizimeve.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i informacionit vendosur në dispozicion për rimbursimin e akcizës është konstatuar se:

- Në 4 vendime rimbursim akcize të përzgjedhura për testim edhe pse është paraqitur nga operatorët ‘P.’ dhe ‘A. R.’ i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit për rimbursim akcize, vendimet për miratimin e kërkesës nga Dega Doganore kanë dalë 2, 5, 6 dhe 7 muaj me vonesë, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, si dhe përcaktimet e VKM nr.612 datë 05.09.2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat’, i ndryshuar në nenin 43, pika 7.

- Për periudhën janar-qershor 2022, për operatorin “T. E. C.” ShPK, me një vlerë totale prej 496,251 lekë (kërkesat e rimbursimit të akcizës), Dega Doganore ende nuk ka dalë me një vendim për miratimin apo refuzimin e tyre edhe pse i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit nga operatori është vendosur në dispozicion, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2. Si dhe nuk është hartuar Raporti i Zyrës së Akcizës mbi analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikuar

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.6 në faqen nr. 177-192 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandim 9.1: Dega Doganore dhe Zyra e Akcizës të marrë masa për përgatitjen brenda afateve ligjore të dokumentacionit përkatës në zbatim të procedurës së rimbursimit të akcizës për të gjithë kërkesat e operatorëve, si dhe të dalë me vendim për

kërkesat e pa trajtuara ende 2 vjet me vonesë të operatorit “T. E. C.” ShPK.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se mungon një analizë risku në nivel zyre apo dege për evidentimin e operatorëve me risk, si dhe dokumentimi i kësaj analize në përzgjedhjen e secilit operator për kontroll sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr. 02 date 28.01.2021 ‘Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës’, pika 6.3.

Nga 77 magazina fiskale në mbikëqyrje të DDT janë realizuar kontrole fizike vetëm për 10% të tyre (8 kontrole) gjatë vitit 2022 dhe 2.5% të tyre (2 kontrole) gjatë vitit 2023, duke rezultuar në një nivel risku shumë të lartë nga mos mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarisë së tyre nga Dega Doganore.

Gjithashtu nga auditimi i kontroleve të realizuara nga Zyra Akcizës është konstatuar se në dosjet e kontrollit nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, ku rezultatet e kontrollit nuk janë pasqyruar në raport sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021 ‘Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës’ kapitulli 8,2 ‘Përmbajtja e raportit përfundimtar të kontrollit’, pika 5.

Në përfundim të veprimeve përgatitore nuk janë hapur dosje kontrolli për çdo operator, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’ dhe pika 6.4.2, duke shkaktuar një dokumentim jo të plotë të gjurmëve të auditimit për këto procedura.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.6 në faqen nr. 177-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandim 10.1: Zyra e Akcizës të marrë masa për intensifikimin e kontroleve fizike me qëllim rritjen e përqindjes së mbulimit me kontroll për të minimizuar riskun e mos mbikëqyrjes dhe monitorimit. Gjithashtu të realizojë përzgjedhjen e operatorëve për kontroll bazuar në një analizë risku periodike të dokumentuar, si dhe dokumentojë kontrollet dhe rezultatet e tij, dhe më tej të hartojë raportet e kontrollit, në përputhje me përcaktimet e manualit të metodologjisë së kontrollit të akcizës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2023 zyra e borxhit në DDT ka funksionuar me 1 pozicion specialist borxhi vakant nga 2 që janë në strukturën e miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022, vakante kjo që sikurse është konstatuar edhe nga auditimi, ka cenuar mbarëvajtjen dhe mire funksionimin në përmbushjen e detyrave të zyrës së borxhit, si pasojë e ngarkesës dhe numrit të lartë të subjekteve nën mbikëqyrje të Degës Doganore, ku evidenca e borxhit në 31.12.2023 paraqitet me 1,642 raste me 1,252 debitor, ku vetëm gjatë vitit 2023 borxhi doganor është shtuar me 497 debitor për 995 raste dhe ulur me 652 debitor për 1,335 raste

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.7 në faqen nr.192-200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandim: 11.1: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrin masat për plotësimin e pozicionit vakant me specialist borxhi sipas kërkesave specifike të pozicionit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni mbi menaxhimin e borxhit doganor për periudhën 2022 – 2023, rezulton se:

- Në total detyrimi për borxhin doganorë më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 18,620 milionë lekë, kjo për 1252 subjekte, me një shtesë nga viti 2022 për 497 subjekte me vlerën 430 milionë lekë dhe pakësuar për 652 debitorë me vlerë 177 milionë lekë;
- Për periudhën e viteve 2021, 2022 dhe 2023, konstatohet se vendimet për shpallje debitorë nuk janë në zbatim të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës;
- Për 184 subjekte janë bërë njoftimet jashtë afatit të përcaktuar në ligj prej 24h/5ditë/10ditë, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, kap VI, pika 1,2,3,4,5,6,7;
- Për 34 subjekte me vlerë borxhi 812,086 lekë, nuk janë nxjerrë vendimet për rikuperimin me forcë të borxhit dhe për 111 subjekte të tjera, këto vendime janë nxjerrë jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 10/30 ditësh, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, kap.VII ‘Ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor’, pika 2;
- Për 71 subjekte me vlerë borxhi 3,686,949 lekë, Dega Doganore nuk ka dërguar në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhër ekzekutimeve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, kap VIII, pika 4 ;
- Në 10 raste të përzgjedhura për auditim, nuk janë zbatuar afatet procedurale të përcaktuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 ‘Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës’, duke rezultuar në procedura të zgjatura në total nga 6 muaj deri në 15 muaj, nga vendimi te njoftimi, vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit dhe njoftimi tij, kërkesa për lëshimin e urdhr të ekzekutimit, vendimi për lëshimin e urdhr, lajmërimi për ekzekutim vullnetar dhe kontrata shërbimit përmbarimor.
- Në 6 raste mungon vendimi gjykatës për lëshimin e urdhr të ekzekutimit dhe në 1 dosje atë të ‘Best Gaz’ sha. mungon shkresa për njoftimin e strukturave përkatëse tatimore DPT/DRT sipas “Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355 datë 19.06.2018, mbi detyrimet shtesë tatimore të lindura si pasojë e detyrimeve shtesë të akcizës

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.7 në faqen nr.192-200 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandim 12.1: Dega Doganore Tiranë (Zyra e Borxhit dhe Sektori JURIDIK), të marrë masa për zbatimin me rigorozitet të të gjitha fazave për rikuperimin e borxhit doganor të përcaktuara në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, për të gjithë operatorët e evidentuar në anekse dhe ndjekjen e procedurave në afat me qëllim uljen e nivelit të borxhit doganor me vlerë 18,620 milionë lekë.

Rekomandim: 12.2: Zyra e Borxhit të marrë masa për realizimin në afat të procedurave të evidentimit dhe rikuperimit të detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës, si dhe të njoftojë strukturën përkatëse tatimore DPT/DRT sipas “Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355 datë 19.06.2018, mbi detyrimet shtesë tatimore të lindura si pasojë e detyrimeve shtesë të akcizës për operatorin ‘B. G.’ sha.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Zyra e Mbikëqyrjes Doganore për mbikëqyrjen e Regjimit të Lejimit të Përkohshëm (RLP), në disa raste nuk ka mbajtur regjistra për regjistrimin e të gjithë operatorëve dhe operacioneve për të gjitha llojet e mjeteve dhe mallrave që lëvizin në këtë regjim doganor dhe nuk ka kryer kontrole fizike gjatë kësaj periudhe për të bërë identifikimin e mallrave të vendosura nën këtë regjim, duke marrë në konsideratë statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre sipas nenit 194 të Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.3 në faqen nr. 54-89 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandimi 13.1: Zyra e Mbikëqyrjes Doganore për mbikëqyrjen e Regjimit të Lejimit të Përkohshëm (RLP) të mbajë regjistra për regjistrimin e të gjithë operatoreve dhe operacioneve për të gjitha llojet e mjeteve dhe mallrave që lëvizin në këtë regjim doganor dhe të kryejë kontrole fizike gjatë kësaj periudhe për të bërë identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e mallrave brenda afateve autorizuese

Menjëherë

C. TË ARDHUARA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje në bazë risku i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore, rezultoi se janë konstatuar deklarime mallrash për të cilat vlerat e artikujve të importuar dhe të deklaruar janë trajtuar me transaksion, edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për t'u trajtuar si i tillë; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë; për mallra të importuar nga vende ma marrëveshje dhe me origjine NEU trajtimi i tyre është bërë me transaksion në momentin e hedhjes për qarkullim të lirë, trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë, rillogaritje të detyrimeve doganore si pasojë e rivlerësimit të shpenzimeve të transportit të mallrave deklaruar jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, rillogaritje të detyrimeve doganore që duhen paguar për taksën TAM të ambalazhit plastik sipas Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, rillogaritje të detyrimeve doganore për taksën kombëtare të hirrës, kemit të qumështit, qumështit pluhur sipas ligjit nr. 112/2021 date 25.11.2021 për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar, rillogaritje të detyrimeve doganore si pasojë e klasifikimeve të gabuara tarifore, rillogaritje të detyrimeve doganore si pasojë e mos pagesës së taksave kombëtare të akcizës, duke reflektuar të ardhura doganore të munguara në Buxhetin e Shtetit të rillogaritur në vlerën 417,679,279 (nga të cilat shuma prej 233,900,296 lekë viti 2022 dhe shuma prej 183,778,882 lekë për vitin 2023) për periudhën e audituar 01.01.2022-31.12.2023.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.4 në faqen nr. 89-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandimi 1.1: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritura në **shumën 417,679,279 lekë**.

Brenda muajit shkurt 2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjekte të ndryshëm që operojnë në fushën e regjimeve doganore ekonomike të tipit RPA kanë kryer sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “Tallash druri” dhe “copa mbetje druri” të deklaruar në kapitullin *44* “mbetje letre” dhe “mbetje kartoni” të deklaruar në kapitullin 48 dhe “mbetje plastike” të deklaruar në kapitullin 39 të NM në RSH dhe se vlera e mallrave dhe vlera e shpenzimeve të transportit të deklaruar është e ulët dhe nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*, përcaktimeve

dhe kërkesave të Sesionit të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” të cilat janë llogaritur rivlerësime të detyrimeve doganore për vlerën e mallit dhe të shpenzimeve të transportit me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 25,718,397 lekë.

Në lidhje me autorizimin e dhënë për operatorin ekonomik me nipt. J.....V i cili ka afat deri në periudhën Maj 2025 konstatohet se nuk rezultoi i kryer dhe i zbatuar detyrimi ligjor sipas pikës 4 dhe 5 “Mbikëqyrja e Regjimit dhe kontrolli” të Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin Praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” që lidhet raportin dhe kontrollin për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit të alkoolit puro. Gjate kontrollit të kryer sipas programit nr. 15640 date 31.08.2022 si dhe në Raport Përfundimtar të Kontrollit është verifikuar një diferencë 6314 litra alkool puro e pajustificuar që i përket fazës së përpunimit të alkoolit dhe nuk ka lidhje me fazën e operacioneve të transportit dhe fazën e qëndrimit të pijeve alkoolike në fuçi druri dhe nga ana e grupit auditues për sasinë prej 6314 litra alkool puro është llogaritur një detyrim doganor sipas nivelit të taksimit 45.000 lekë an hidër/450 lek/litër në shumën 2,841,300 lekë e cila rezulton e papaguar nga operatori ekonomik autorizues dhe rekomanduar pagimi i një gjobe doganore sa një fish i detyrimeve doganore në trajte gjobe në shumën 2,841,300 lekë dhe mosrespektim të Pikës 4 të VKM nr. 434 date 20.05.2015 “Për përcaktimin e normave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjate prodhimit, magazinimit, transportimit të njohura për qëllime fiskale” pasi karta teknologjike nuk rezulton e akredituar nga një Institucion/Laborator /Përgjegjës i Akredituar në RSH

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.3 në faqen nr. 54-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandimi 2.1: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulëta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruara sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “Tallash druri” dhe “copa mbetje druri” në kapitullin *44* “mbetje letre” dhe “mbetje kartoni” të në kapitullin 48 dhe “mbetje plastike” në kapitullin 39 të NM në RSH, dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale **31,400,097 lekë**.

Brenda muajt shkurt 2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të nxjerra për shkeljet në fushën doganore për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2023, rezultuan vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Konkretisht janë konstatuar raste marrje vendimi për diferencë sasiore të konstatuara në sasi malli rezultuar më tepër dhe të padeklaruara në deklaratat doganore respektive nga operatorët ekonomikë, për të cilat nga Autoriteti Doganor Tiranë nuk është aplikuar një gjobë doganore sa 2 (dy) fish i detyrimeve doganore të papaguara dhe shkelja doganore nuk është trajtuar si “Kundërvajtje doganore të kryera në neglizhencë” në shumën 300,824 lekë dhe vendime administrative që lidhen me shkeljen e afatit kohor të regjimit të lejimit të përkohshëm (RLP) pa efekte financiare për të cilat nuk është nxjerrë pike në vendim për kryerje procedure eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacionit malli për përfitim statusi shqiptar si dhe u konstatuan marrje të vendimeve në mosrespektim të afatit kohor për paraqitjen e pretendimeve nga shkelësi, mangësi në arsytetime dhe argumentimin si dhe vendime që nuk shoqërohen me dokumente të cilat lidhen me shkeljen e verifikuar që provojnë dhe argumentojnë kundërvajtjen si dhe qëllimin e shkelësit, veprime në

kundërshtim me nenet 273- 276 të Kodit Doganor dhe nenet 98-100 të Kodit të Procedurës Administrative të RSh në shumën totale 1,420,575 lekë.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.5 në faqen nr. 151-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandimi 3.1: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa të menjëhershme me qëllim shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritur në shumën **1,420,575** lekë , si dhe të kërkojë procedure eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacionit malli për përfitim statusi shqiptar në një rast vendimi administrative që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të regjimit RLP për mallra të natyrës auto vetura të nxjerra për vitin 2022.

Brenda muajit shkurt 2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimeve të DD Tiranë për vitin 2023 janë evidentuar 3 vendime me problematika në regjimin e lejimit të përkohshëm me një vlerë të vlerësuar të ardhurave të munguara për 180,000 lekë dhe konkretisht:

- Nga auditimi praktikës bashkëngjitur vendimit dhe përmbajtja e vendimit nr.51 datë 17.01.2023 për subjektin ‘M. A. U.’ është konstatuar se subjekti ka zotëruar 3 regjime lejimi të përkohshëm, konkretisht autorizimet nr.17089/1, nr.15425/1 dhe nr.16518/1, të cilët janë penalizuar sipas proces verbaleve përkatëse nr.10827 nr.10828 nr.10829 datë 15.11.2022 me nga 50,000 lekë, për secilin regjim dhe DDT ka dalë me vendim penaliteti vetëm për një nga proces verbalet e thyerjes së regjimeve dhe jo për të tre; -

- Nga auditimi praktikës bashkëngjitur vendimit nr.53 datë 24.01.2023 për subjektin ‘B.I. T. B. I.’, është konstatuar se subjekti ka zotëruar 2 regjime lejimi të përkohshëm, konkretisht autorizimet nr.11100/1 dhe nr.29508/1, ku për tejkalimin e afatit të këtij të fundit nuk është mbajtur proces verbal kundërvajtje nga doganierët e regjimit, dhe vendimi për thyerje regjimi ka dalë vetëm për 1 prej autorizimeve; -

- Nga auditimi praktikës bashkëngjitur dhe vendimit nr.567 datë 29.05.2023 për caktimin e gjobës me vlerë 20.000 lekë për subjektin ‘E. & G.’, për shkelje të afatit të regjimit të lejimit të përkohshëm nr.3050/1, bazuar në procesverbalin nr.471 datë 18.05.2023, në të cilin propozohet sanksion 50.000 lekë bazuar në nenin 257/1/c, nuk evidentohet dokumentacion shtesë dhe argumentim nga juristi mbi ndryshimin e cilësimit të shkeljes dhe sanksionit në ulje për vlerën 30.000 lekë..

- Nga auditimi i vendimeve janë evidentuar 2 vendime për përfitim të padrejtë të origjinës preferenciale dhe për rrjedhojë shmangie të detyrimeve doganore bazuar në nenet 250, 251/1/2/b, 256/1/b, 262 të Kodit Doganor, duke mos e penalizuar subjektin në masën 1 fish të detyrimit siç përcakton neni 256/1/a i KD për këtë shkelje ku citohet se ‘a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 1-fish të detyrimit të munguar;’, duke rezultuar me një vlerë të vlerësuar të të ardhurave të munguara në total për **1,106,980 lekë**, prej të cilave 99,706 lekë në vendimin nr.882 datë 20.10.2023 për operatorin ‘S.-A.’ dhe 1,007,274 lekë në vendimin nr.156 datë 03.03.2023 për operatorin ‘E.’.

- Nga auditimi i vendimeve të DDT për vitin 2023 janë evidentuar 4 vendime për kontrollet e rezultuara me sasi tepër nga struktura e antikontrabandës në të cilat është aplikuar penalitet 1 fish i detyrimit bazuar në klasifikimin e pa argumentuar të strukturës dhe DD në nenin 256/1/a të KD, duke rezultuar në një vlerë të vlerësuar totale të ardhurash të munguara prej **423,972 lekësh** si në vijim: vendimi nr.808 datë 11.09.2023 ndej operatorit ‘Dh. P’ për vlerën e munguar 138,410 lekë, procesverbali verifikimit të shkeljes nr.0013357 datë 08.09.2023; vendimi nr.158 datë 03.03.2023 ndaj operatorit ‘Shkëlqim

Tahiri' për vlerën e munguar 154,768 lekë, procesverbali verifikimit të shkeljes nr.0005582 datë 17.02.2023 ; vendimi nr.100 datë 16.02.2023 ndaj operatorit 'Xh. O.' për vlerën e munguar 93,136 lekë, procesverbali verifikimit të shkeljes nr.0022201 datë 20.01.2023; vendimi nr.812 datë 13.09.2023 ndaj operatorit 'D.A.M' për vlerën e munguar 37,658 lekë, procesverbali verifikimit të shkeljes nr.0002743 datë 11.09.2023 për te cilat DDT nuk ka arsytuar në mënyrë shteruese klasifikimin e kundërvajtjeve mbi të cilat ka marrë vendim, si dhe nuk disponon nga struktura konstatuese e verifikimit të shkeljes detaje në arsyetimin dhe argumentimin e klasifikimit të kundërvajtjes dhe për rrjedhojë edhe identifikimin e detyrimeve të subjektit.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.5 në faqen nr. 151-177 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandim 4.1: Dega Doganore Tiranë, të marrë masa për shqyrtimin e rasteve të evidentuara dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore në **vlerën 1,710,952 lekë**.

Brenda muajit shkurt 2025

5. Gjetje nga auditimi: Përgjatë auditimit janë evidentuar 19 raste me diferencën më të lartë në peshë ndërmjet sasisë së gjendjes faktike të mallit në transit (fletë peshës) dhe deklarimit. Për këto raste rezulton se nuk ka procesverbale mbi parregullsitë e konstatuara që realizohen nga zyra operacionale në rastet bazuar të pikës 3.4 të Udhëzimit nr. 17/2018 kur ka ndryshime ndërmjet të dhënave në deklarim dhe kur sasia faktike e ngarkesës ka qenë më e madhe se ajo e deklaruar, si dhe nuk është kryer ri kanalizim në kanal të kuq. Rezulton se nuk janë zbatuar në të gjitha rastet procedurat në rastet e parregullive për mbylljen e DEMP; nuk janë pasqyruar masat e marra në "aktin e kontrollit" në DAV. Këto kontrole nuk janë shoqëruar me procesverbal mbi parregullsitë e konstatuara, bazuar në nenet 250 deri 281 të KD dhe për këtë arsye operatorët ekonomik, mbajtës të regjimit të transimit kanë kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 259 "Sanksione për raste të tjera kundërvajtjesh", pika 1, për kundërvajtje të tjera nga ato të përcaktuara në mënyrë specifike në nenet 251 deri në 254 zbatohen sanksionet e mëposhtme në masë të cilat kanë sjellë pasoja financiare për buxhetin e shtetit në vlerën 380,000 lekë në formën e gjobave në Buxhetin e Shtetit.

Gjithashtu në 3 raste transiti janë bërë ndryshime në peshën në DAV, sipas dokumenteve shoqëruese (faturë, CMR ose parking listë) dhe ky saktësim nuk është shoqëruar me procesverbal kontrolli dhe sanksionim. Në këto raste agjenti doganor përkatës ka kryer kundërvajtje administrative sipas nenit 251, pika 2, gërma a dhe nuk është sanksionuar sipas nenit 256, pika 1, gërma b në vlerën 60,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.2 në faqen nr. 30-54 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandimi 5.1 : Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa që për të gjitha rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse, të kryhen verifikimet përkatëse, të ndiqen procedurat e parashikuara në manual, të mbahen procesverbale apo dokumentacion për të faktuar nëse diferencat sjellin ose jo pasoja financiare.

Rekomandimi 5.1 : Zyra Operacionale dhe Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën 440,000 lekë në formën e gjobës.

Brenda muajit shkurt 2025

6 Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatuan mangësi në procedurat e ndjekura nga Zyra e Regjimeve për mbikëqyrjen e Regjimit të Magazinimit Doganor konkretisht: Dosjet nuk janë të inventarizuara në kundërshtim me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të mbajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve, nuk japin të dhëna të qarta të gjurmës së kontrolleve të ushtruara, administrimin në to jo vetëm të dokumentacionit të sjellë nga subjektet por edhe dokumentacionin vërtetues të gjithë punës së kryer nga doganierët mbikëqyrës të regjimit të magazinimit doganor si dhe konstatojmë mosrespektimin e kryerjes së kontrolleve të paktën një herë në tre muaj. Këto veprime janë veprime në kundërshtim me detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierëve mbikëqyrës të regjimeve sipas përcaktimeve të: Kreu 8, Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve, nenet 44-46 të Urdhrit nr.146, datë 07.05.2018 të DPD-së dhe përcaktimet e pikës VII-Detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierit mbikëqyrës të Udhëzimit nr.07, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Magazinimit Doganor” të DPD-së; Zyra e mbikëqyrjes doganore të regjimit të magazinimit doganor nuk ka kryer mbikëqyrjen e Autorizimeve për përdorimin e Regjimit të Magazinimit Doganor duke kryer veprime në kundërshtim me detyrimet dhe përgjegjësitë e doganierëve mbikëqyrës të regjimeve sipas pikës V “Mbikëqyrja e Autorizimit” të Udhëzimit nr. 07, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Magazinimit Doganor” të DPD-së dhe me nenet 27 dhe 28, 30 deri 32, 191 deri 199 dhe 210 deri 215 të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” në shumën 100,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.3 në faqen nr. 54-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandim 6.1: Zyra e mbikëqyrjes doganore të regjimit të magazinimit doganor në zbatim të procedurave funksionale të kryejë inventarizimin e dosjeve, në dosje të jepen të dhëna të qarta të gjurmës së kontrolleve të ushtruara, administrimin në to jo vetëm të dokumentacionit të sjellë nga subjektet por edhe dokumentacionin vërtetues të të gjithë punës së kryer nga doganierët mbikëqyrës të regjimit të magazinimit doganor si dhe të kryejnë kontrolle të paktën një herë në tre muaj.

Të kryejë mbikëqyrjen e Autorizimeve për përdorimin e Regjimit të Magazinimit Doganor për të parë nëse përmbushen detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim.

Rekomandim 6.1: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në shumën **100,000 lekë**.

Brenda muajit shkurt 2025

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE DOGANORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan deklarime jo korrekte mallrash në kode tarifore për të cilat nevojitet dokumentimi përfundimtar i mostrave, mallrave etj nga struktura operuese pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me qëllim kryerjen e një procesi të plotë ligjor në lidhje me shkeljet doganore të trajtuara për rastet e mëposhtëm

a-Për artikullin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire” deklaruar nga operatori ekonomik me nipt K.....L në kodin 04049083 të NM në RSH dhe specifikisht në kreun tarifor “0404” importuar nga Kina u konstatua se ky artikull deklarohet sipas Certifikatës Veterinare si “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsirë”, me origjinë nga Kina vend NEU (me të cilin nuk ka marrëveshje bashkëpunimi midis Administratave Doganore). Referuar përcaktimeve ligjore të shkresës nr. 66 prot të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave datë 05.01.2022 përcaktohet se importi dhe prodhimi i kemit të qumështit, të përfshirë në kreun 0402 të NM në RSH duhet të paguaje taksën kombëtare në nivelin 150lek/kg. Referuar shënimeve dhe përcaktimeve të NM në RSH, kreu 0402

përfshin mallrat “*Qumësht dhe krem, i koncentruar apo qe përmban sheqer shtese apo lende te tjera ëmbëltuese*” te cilat klasifikohen tek kodi tarifor “04029910”. Malli deklarohet i ambalazhuar ne ambalazh plastik “plastik cup”, për te cilat nuk rezultojnë të jetë paguar taksë kombëtare e ambalazhit TAM. Nuk rezultojnë verifikime laboratorike nga Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor për klasifikimin tarifor te mallit “*qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsirë*”, te deklaruar paraprakisht ne kodin tarifor 04049083 te NM për te cilin nuk rezultojnë te jete paguar Takse Kombëtare QPL ne nivelin 150 lek/kg. Rezultojnë deklarime identike te mallit “*qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsirë*”, te deklaruar ne kodin tarifor “040229910” për te cilat është paguar Taksa Kombëtare QPL ne nivelin 150 lek/kg për këtë artikull shoqëruar edhe me deklaratat e faturave te mallit ku është përcaktuar kodi tarifor nga eksportuesit e mallit. Ndërsa ne kreun 0404 klasifikohen : “*Hirre, nëse është apo jo e koncentruar apo qe përmban sheqer shtese apo lende te tjera ëmbëltuese; produktet qe përbehen nga përbërës te qumështit natyral, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtese apo lende te tjera ëmbëltuese, te pa përfshira apo te pa specifik*” dhe konkretisht kodi tarifor 04049083 përcakton: “*Të tjera qe nuk përmban sheqer apo materiale te tjera ëmbëltuese shtese, me përmbajtje yndyre, ndaj peshës: Me tepër se 1,5 % por jo me tepër se 27 %*”. Gjithashtu nuk rezultojnë te administruara ne sistemin Asycuda Word të dhëna për karakteristikat teknike te mallit “*qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsirë*”, për mallin e importuar nga shoqëria “*I./T. & D.*” me nipt K.....L ne lidhje me elementet “*sheqer dhe llojin e materialeve ëmbëltuese shtese*” dhe “*nivelin e % te yndyrës ne volumin e produktit*” për të dhënë një gjykim përfundimtar ne lidhje me klasifikimin përfundimtar të mallit për të cilat nga ana e grupit auditues janë llogaritur efekte ne **shumen 81,962,208** lekë nëse artikulli “*qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsirë*”, do të rezultojë me klasifikim tarifor te gabuar pas verifikimeve që do të ushtrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe që do të rezultojnë me pagesë të detyrimit të taksës QPL në nivelin 150 lek/kg,

b-Për artikullin “*Hudhër*” konstatohet se në asnjë rast në praktikat doganore trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar te Auditimit nuk është kryer asnjë mos trim laboratorik për këtë artikull me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të këtij artikulli artikullit ndonëse disa praktika doganore kanë qenë të kanalizuar në profil risku. Në shënimet e Kapitullit 7 pika 3 përcaktohet se në “*kreun 0712 përfshihen të gjitha zarzavatet e thara të llojeve që futen në krerët 0701 deri 0711 përfshirë këtu dhe artikullin hudhër*”. Në pikën 3 të Rregullave të Përgjithshme për Interpretim të Nomenklaturës së Mallrave përcaktohet qartë se “*kur mallrat janë në pamje të parë të klasifikueshme në dy apo më shumë krerë klasifikimi do të kryhet në kreun numerik i cili ndodhet i fundit*”. Kreu numerik i cili ndodhet ne fund është kreu *07129090* me tarifë bazë 10%. Konstatohet se artikulli hudhër për nga karakteristikat e konstatuara duhet të ishte klasifikuar në kodin tarifor *07129090* me tarifë bazë 10% ndërkohë që është klasifikuar në kodin tarifor *07032000* me tarifë doganore 2% duke shmangur pagesën e detyrimeve doganore nëpërmjet deklarimit në një kod tarifor më tarifë doganore më të ulët se ai që duhej deklaruar sipas Rregullave të Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave sipas ligjit specifik për “*Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore*” i ndryshuar. Nga ana e grupit auditues janë llogaritur efekte ne **shumen 714,111** lekë nëse artikulli “*hudhër e ftohte*”, do të rezultojë me klasifikim tarifor te gabuar pas verifikimeve që do të ushtrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe që do të rezultojnë me pagesë të tarifë doganore bazë 15%

c-Për artikullin “*qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe*” nga Hungaria trajtuar me tarife doganore 0% sipas kushtit MSABE u konstatua se këto mallra janë deklaruar ne kreun *19019099* të NM në RSH, ndërsa deklarime te tjera te artikullit qumësht UHT me yndyre rezultojnë te deklaruar ne kapitullin 4 te NM ne RSH dhe trajtuar me tarife doganore 10% edhe ne kushtet e mallrave me origjine MSABE. Gjate auditimit konstatohet

se në kapitullin 4 të NM ne RSH përfshihen “*Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjalti natyral; produkte te ngrënshme me origjine prej kafshëve, te pa përfshira apo te paspecifikuara diku tjetër*”. Shënimi nr. 5. i Kapitullit nr. 4 përcakton se ne këtë kapitull nuk klasifikohen pra përjashtohen “(c) *Produkte te përftuara nga qumështi duke zëvendësuar një apo me shume prej përbërësve te tij natyral (për shembull, yndyra butirike) nga një substance tjetër (për shembull, yndyra oleike) (kreu 1901 ose 2106)*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk dokumentohet ne certifikata analize veterinarë dhe fito sanitarë heqja ose mos prania e yndyrës shtazore dhe zëvendësimi i saj me yndyre buti rike ose oleike. Nga shqyrtimi i Dokumentit të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ne pikat kufitare hyrëse administrohet fakti që nga ky autoritet është lëshuar dokumenti për “*Leje Importi dhe Transitimi për produkte me origjine Shtazore*”. Për periudhën ne juridiksion auditimi nuk rezultojnë mostrime laboratorike të kryera për produktin “*qumësht UHT*” me 3.6 yndyrë te deklaruar ne kreun *19019099* të NM në RSH, ndërsa deklarime te tjera te artikullit qumësht UHT me yndyre rezultojnë te deklaruar ne kapitullin 4 te NM ne RSH dhe trajtuar me tarife doganore 10% edhe ne kushtet e mallrave me origjine MSABE. Gjithashtu nga e Drejtorisë së Monitorimit dhe Analizës se Riskut nuk rezultojnë të vendosura ne profil risku deklarimet e artikullit “*qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe*” me qellim verifikimin e sakte te deklarimit tarifor te mallit me risk te larte klasifikimi ne kapitullin 4 te NM te RSH ku trajtimi tarifor është 10% edhe ne kushtet e origjinës preferenciale MSABE. Nga ana e grupit auditues janë llogaritur efekte ne **shumen 44,895,184** lekë nëse artikulli “*qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe*” do te rezultojë pas verifikimeve që do te ushtrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si mall me keq klasifikim tarifor i cili duhet të paguajë tarifë doganore bazë 15%

d. Për artikullin “*Spraj (vajra te lehte), Praimer, dhe Solvent*” dhe “*Vaj Lubrifikant sintetik pa përmbajete nafte*” te klasifikuar ne kapitullin *27* dhe kreun *2710* dhe “34” qe klasifikohen ne kreun “2710” dhe *34* nuk është paguar detyrimi i taksës kombëtare te akcizës ne nivelin 5 lek/kg, 37 lek/litri, dhe 40 lekë/kg. Konstatohet se nuk ka prova administrative dhe fakte konkrete ne lidhje me përdorimin dhe destinacionin final të këtyre produkteve sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve të pikës *d* te nenit 50 te nr. ligjit nr. 61/2012 “*Për Akcizat në RSH*”. Për periudhën ne juridiksion auditimi nuk rezultojnë mostrime laboratorike të kryera për këtë produkt energjetik me qellim verifikimin ose jo te mundësisë se pagesës se akcizës sipas ligjit nr 61/2012 “*Për Akcizat në RSH*”. Nuk rezultojnë kontrole te kryera nga Drejtoria e Kontrolleve Pas Zhdoganimit pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Doganave në bazë të nenit 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” për periudhën 01.01.2022-31.12.2023 të për praktikat doganore që janë përpunuar sipas tabelës së bashkëlidhur Projekt Raportit te Auditimit.

Gjithashtu nga e Drejtorisë së Monitorimit dhe Analizës se Riskut nuk rezultojnë të vendosura ne profil risku deklarimet e artikullit “*Spraj (vajra te lehte), Praimer, dhe Solvent*” dhe “*Vaj Lubrifikant*” me qellim verifikimin e sakte te cilësisë se mallit për efekte se pagesës se akcizës sipas ligjit nr. 61/2012 “*Për Akcizat në RSH*”. Ne dokumentacionin tregtar bashkëlidhur praktikave doganore te trajtuara nuk pasqyrohet sakte dhe ne mënyrë te qarte destinacioni i përdorimit te kësaj sasive malli dhe se materiali shoqërues i praktikave doganore te trajtuara sa me poshtë nuk ka prova të plota ligjore për klasifikimin e sakte tarifor te mallrave te poshtë cituar ne kode tarifore te kapitullit 27 te cilat nuk përfitojnë pagese akcize ne shkallen 37 lek/litër shkalle akcize dhe 50 lek/litër. Referuar Shtojcës se Ligjit te Akcizës nr. 61/2012 “*Për Akcizat në RSH*” për vitin 2022 dhe 2023 konstatohet se produktet me kode E 410, E 420, L000 taksohen me nivel akcize 37 lek/litër dhe 50 lek/litër. Nga ana e grupit auditues janë llogaritur efekte ne **shumen 9,705,294** lekë nëse artikujt “*Spraj (vajra te lehte), Praimer, dhe Solvent*” dhe “*Vaj Lubrifikant sintetik pa përmbajete*

nafte “do te rezultojë pas verifikimeve dhe kontrolleve që do te ushtrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si mallra me pagese takse akcize

e. Për artikullin “*Doreza Kirurgjikale*” te deklaruar ne kapitullin 40 te NM ne RSH ne kodin tarifor “40151200” trajtuar me tarife doganore baze 2%, dhe “te tjera doreza jo kirurgjikale” ne kodin tarifor “40159000” trajtuar me tarife baze 15% u konstatua se në përmbushje te verifikimit te plote te natyrës se mallit doreza ne përmbushje edhe te shpjegimeve dhe përcaktimeve te shkresës Nr. 29352 prot DPD date 15.12.2016 te nxjerrë nga Departamenti Teknik pranë DPD u konstatuan mospërputhje ligjore midis shpjegimeve dhe përcaktimeve te shkresës me lende “*Tërheqje vëmendje në lidhje me klasifikimin tarifor të dorezave ekzaminuese njëpërdorimshëm*” dhe dokumentacionit faktik te administruar ne sistemin Asi çuda Word për praktika te trajtuara sa me poshtë vijon.

1-Shoqëritë importuese te mallit “doreza kirurgjikale” nuk ishin te pajisura me “*certifikate regjistrimi*” nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore bazuar në zbatim nenit 13 te këtij te ligjit nr. 89/2014 “*Për pajisjet mjekësore*” te ndryshuar.

2-Dokumentacioni tregtar bashkëlidhur praktikave doganore nuk kishte bashkëlidhur Certifikatën e Konformitetit te detyruar sipas pikës 2 te shkresës nr. 29352 prot DPD date 15.12.2016 te Departamentit Teknik

3-Dokumentacioni tregtar bashkëlidhur praktikave doganore nuk kishte bashkëlidhur Testin e bere nga Ente dhe Laboratorë te njohur te Autorizuar ne përmbushje te kushtit te njohur EN455-1, EN 455-2 (*mbështetur ne Medical Device Directive 93/42 EEC*) i cili mund te jete ose jo i stampuar ne etiketën e paketimit, por duhet te jete i konfirmuar nga dokumentacioni shoqërues i mallrave qe vërtetojnë plotësimin e këtyre standardeve etj. te detyruar sipas pikës 2 te shkresës .

4-Pika 3 e shkresës nr. 29352 prot DPD date 15.12.2016 te Departamentit Teknik saktëson se kur nga ana e operatoreve ekonomike deklarohet se dorezat e ekzaminimit qe përmbajnë markimin CE dhe njëkohësisht përmbushin ndonjë standard tjetër te ndryshëm nga EN455-1, EN 455-2 te përputhshëm ose ekuivalent me to duhet qe dokumentet shoqëruese te lëshuara nga Prodhuesi (*certifikatë analize dhe certifikatë konformiteti*) te vërtetojnë nga ana dokumentare plotësimin e këtyre standardeve ose ekuivalencën ose përputhshmërinë me këto standarde

5-Për disa praktika doganore te trajtuara në anekset bashkëlidhur këtij Projekt Raporti Auditimi konkretisht u konstatua se dokumentacioni shoqërues nuk përmban : Certifikatën e konformitetit, Certificate regjistrimi nga agjencia e barnave., mungon testi (Analize) nga një Laborator i Akredituar

6- Për disa praktika doganore te trajtuara në anekset bashkëlidhur këtij Projekt Raporti Auditimi konkretisht u konstatua se dokumentacioni shoqërues përmban Test/Analize por nuk përmban, Certifikatën e konformitetit dhe Certificate regjistrimi nga Agjencia e Barnave.

7-Për rastet e praktikave doganore që kane rezultuar me kontroll fizik nga ana e personelit doganor janë hedhur foto në trajtë prove në sistemin Asicuda Word qe përmbajnë markimin CE dhe njëkohësisht standardin EN455-1, EN 455-2 te

8-Nuk është i mundur dhe i provuar dokumentimi i destinacionit te shitjes dhe përdorimit final në tregun e lire në territorin doganor shqiptar të mallrave doreza kirurgjikale në momentin e auditimit

Nga ana e grupit auditues janë llogaritur efekte ne **shumen 36,207,869** lekë nëse artikulli “*Doreza Kirurgjikale*” te deklaruar në kodin tarifor “40151200” trajtuar me tarife doganore baze 2%, do te rezultojë klasifikim të gabuar tarifor pas verifikimeve që do te ushtrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ne kodin tarifor “40159000” për të cilin paguhet me tarife baze 15%.

f-Konstatohet se nga Dega Doganore Tiranë nuk disponohen kapacitetet njerëzore për kryerjen e një analize të plotë për verifikimin e problematikave të trajtuara sa më sipër për të verifikuar saktësinë dhe llojshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratat doganore trajtuar për rastet e mallrave “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire”, “Spraj (vajra te lehte), Pramer, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”, “qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe” dhe “Hudhër e ftohte” dhe “Doreza kirurgjikale” për problematikat e trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit bazuar dhe në ndryshimet strukturore sipas VKM-së nr. 2 datë 08.01.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 921 datë 29.12.2018” dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 05. datë 26.01.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë si dhe faktit që për dhënien e një opinioni të plotë ligjor dhe profesional nevojiten struktura më të specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor dhe Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit të cilat monitorojnë deklarime doganore në **Plan Kombëtar** në territorin doganor në RSH. (Më hollësisht trajtuar pikën 2.4 në faqen nr. 89-151 dhe anekse nr. 4.62, 4.73, 4.74, 4.78, 4.79, dhe 4.80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandimi 1.1: Dega Doganore Tiranë të përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për ndjekje problematikën e konstatimeve të mësipërme në **shumën 173,484,666 lekë** (detyrim) për shqyrtime të thelluara dhe të detajuara dhe kontrole të mëtejshme për periudha të mëparshme përfshirë edhe periudhën 3 vjeçare (2021 deri 2024), që lidhen me:

- Rillogaritjen e detyrimeve për klasifikimin tarifor përfundimtar të artikujve “qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe”, “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohte” dhe “Qumësht UHT me 3.6% yndyre dhe Qumësht për kafe”
- Rillogaritjen e detyrimeve doganore për mallin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire” për pagesën e taksës QPL;
- Rillogaritjen e detyrimeve doganore për mallin “Spraj (vajra te lehte), Pramer, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”;
- Pagesën e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të akcizës dhe ndjekje të procedurave të mëtejshme doganore nga struktura të specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-se (si Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria së Riskut, dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës), duke marrë në konsideratë metodat dhe radhën e procesit ligjor të verifikimit doganor dhe përputhshmërinë me përcaktimet e legjislacionit doganor në fuqi. Në përfundim Dega Doganore Tiranë të informojë Institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për veprimet e kryera për këtë rekomandim.

Rekomandimi 1.2: Drejtoria e Përgjithshme të Doganave nëpërmjet strukturave të specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-se (Drejtorja e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria së Riskut, dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës si dhe Drejtoria e Laboratorit Kimik), të ndërtojë menjëherë Programe Kontrolli për artikujt “qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe” “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohte”, për rillogaritje detyrime doganore për mallin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire” për pagesën e taksës QPL dhe për rillogaritje detyrime doganore për mallin “Spraj (vajra te lehte), Pramer, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”, për pagesën e detyrimeve doganore dhe të akcizës dhe të kryejë menjëherë veprime konkrete verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe të regjistrave të kontabilitetit financiar të subjekteve me qëllim ndjekjen e kontabilizimit të të ardhurave doganore të munguara të llogaritura në **shumën 173,484,666 lekë** (nga te cilat shuma prej 83,272,639 lekë për vitin 2023 dhe shuma prej 90,212,026 per vitin 2022), si dhe llogaritjen e gjobave si pasoje e keq deklarimit dhe shmangies se pagesës se detyrimeve doganor nga deklaruesit e drejtpërdrejtë apo te tërthorte agjencitë doganore respektive bazuar në kërkesat e nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD.

E. TË TJERA

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të procedurave të ndjekura nga zyra e pikës së hyrje-daljes (*afati kohor dhe mbyllja e transiteve*), u konstatuan mangësi lidhur me mos evidentimin dhe mos dokumentimin e vonesave të justifikuara apo incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore, në kundërshtim me nenin 128 të Kodit Doganor, si dhe mos penalizimin e subjekteve për mos respektimin e afatit kohor të mbërritjes në doganën e destinacionit, në kundërshtim me nenin 126 të Kodit Doganor. Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë **13045** raste me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacion të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë. Nga personeli i pikës së hyrjes nuk janë bërë shënimet përkatëse në kutinë 56-I të deklaratës “*Kontrolli nga zyra e destinacionit: Data e ardhjes, kontrolli i plumbçeve, shënime*”. Është plotësuar data e ardhjes dhe kontrolli i plumbçeve, por nuk është plotësuar fusha shënime për vonesa të konstatuara. Nuk është vepruar në përmbushje të detyrave funksionale në përputhje me kërkesat e nenit 273.3 të KD, pasi nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, ku të aplikohet edhe sanksioni për kundërvajtjen sipas përcaktimeve të nenit 256.1/b të KD në 13045 raste në shumën **260,900,000 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.2 në faqen nr.30-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Rekomandimi 1.1: Dega Doganore Tiranë të marrë masa që për rastet e tranziteve të evidentuara si të mbërritur me vonesë, të reflektojë shënimet përkatëse në dokumentin e tranzitit, si dhe të procedojë me penalizimin e subjekteve për mosrespektim të afatit kohor të mbërritjes në doganën e destinacionit.

Rekomandimi 1.2: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të hartojnë udhëzim të ri për ndryshimin e tabelës së afateve të transitit të përcaktuar në udhëzimin nr. 04 datë 30.09.2011 “*Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit*”, duke marrë parasysh zhvillimet e reja infrastrukturore, trafikun apo arsye të tjera. Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit të evidentuara në 13,045 raste transiti (shkelje afati) në **shumën 260,900,000 lekë** në formën e gjobës doganore.

Brenda muajit shkurt 2025

2. Gjetje nga Auditimi: Gjate auditimit të praktikave doganore të artikujve ushqimorë kryesisht kapitujt 1, 2 3 dhe 4, 7, 8 ,9, 10, 11, 12, deri 24 të NM ne RSH rezultoi se ne disa raste dokumentacioni i detyrueshëm ligjori i lëshuar nga Agjencia e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (*dokumentit të Akt Kontrollit të përpiluar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në pikat kufitare hyrëse*), nuk kishte bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues respektive të hedhur ne sistemin Asycuda Word megjithëse është shënuar qe ky dokument ekziston duke nënvizuar ne Akt Kontroll edhe kredencialet përkatëse te këtyre dokumenteve.

Nga auditimi rezultoi se për deklaratime doganore të produkteve shtazore deklaruar në kapitujt 1, 2 3 dhe 4, nuk rezultonte e bashkëlidhur dokumenti “*Certifikatë Veterinare*” kjo në 46 raste, ndërsa ne 5 raste nuk rezultonin të trajtuara në dokumentin e Akt Kontrollit të AKU si dhe për dokumentin “*Certifikata Origjine*”, ne 54 raste nuk rezultonte si ne Dokumentin AKU ashtu edhe në sistemin Asycuda Word. Gjithashtu rezultoi se për mallrat ushqimore të gatshëm deklaruar në kapitujt 7, 8 ,9, 10, 11, 12, deri 22 nuk rezultonte e bashkëlidhur dokumenti “*Raport Analize*” në 33 raste si ne sistemin Asycuda Word ashtu edhe në dokumentin e Akt Kontrollit të përpiluar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në pikat

kufitare hyrëse, ndërsa në 41 raste nuk ka bashkëlidhur ne sistemin Asycuda Word dokument analize ndonëse është shënuar se është në dokumentin AKU.

Nuk rezultoi Certifikata origjine si ne dokumentin e Akt Kontrollit të AKU, ashtu edhe në sistemin Asycuda Word, ndërsa në 20 raste ka dokument Certifikata Origjine sipas akt kontrollit të AKU por nuk gjenden bashkëlidhur dokumentacionit Asycuda Word duke kryer veprime në kundërshtim me nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr. 9863 date 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, pasi mallrat “Produkte Shtazore” duhet te kishin dokumentacion ligjor te tipit “Certifikate Veterinare” dhe “Certifikata Origjine” dhe “Mallra Ushqimore te Gatshëm” duhet të kishin “Raport Analize”, “Certifikate Fito sanitare” “Certifikate Shëndeti”, dhe “Certifikate Origjine” .

(Më hollësisht trajtuar pikën 2.4 në faqen nr. 89-151 të Raportit Përfundimtar te Auditimit.)

Rekomandimi 2.1: Dega Doganore Tiranë, për 125 raste te deklarimeve të mallrave ku janë konstatuar deklarime mallrash te natyrës “Produkte Shtazore” dhe “Mallra Ushqimore te Gatshëm” te cilat nuk kanë bashkëlidhur në sistemin Asi çuda Word dokumentacion ligjor te tipit “Certifikate Veterinare “ për produktet shtazore te importuara, dhe dokumenti shoqërues i tipit “Raport Analize”, “Certifikate Fito sanitare” “Certifikate Shëndeti”, “Certifikate Origjine” për produkte ushqimore te gatshme, të aplikojë gjobë ne masën 20,000 lekë për çdo rast kundërvajtje administrative doganore, për vlerën totale 2,500,000 lekë.

Brenda muajt shkurt 2025

F. MASA DISIPLINORE

F I. Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në nenin 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore përkatëse, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

F. I (a) Niveli i masës “Vërejtje” për punonjësit e kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1-Për **Znj. A. M.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë

2-Për **Znj. S. P.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë

3-Për **Znj. T. L.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë

4-Për **Znj. S. C.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë

5-Për **Znj. S. S.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë

-Për problematika te evidentuara gjatë procedurave doganore të mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv për të cilat nuk janë kryer kontrole periodike me iniciativë të drejtpërdrejte për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit sipas përcaktimeve ligjore të nenit 15 të Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin Praktik te Regjimit te Përpunimit Aktiv”.

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 15 pika 4 “kompetencat e doganierit te mbikëqyrjes”

F. I (b). Niveli i masës *“Mbajtja në masën e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”* për punonjësit kategorisë **C1** dhe **C2** (përgjegjës sektori ose doganier vlerësimi te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

- 1- Për **Znj. M. H.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 2- Për **Znj. T. Sh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ.
- 3- Për **Znj. E. Xh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ.
- 4- Për **Z. R. M.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 5- Për **Z. R. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 6- Për **Znj. L. D.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
- 7- Për **Znj. K. Xh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
- 8- Për **Z. E. M.**, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
- 9- Për **Znj. A. B.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
- 10- Për **Z. E. H.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 11- Për **Z. P. R.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
- 12- Për **Znj. G. G.**, me detyrë doganiere e klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
- 13- Për **Z. A. H.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
- 14- Për **Z. E. N.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
- 15- Për **Znj. B. K.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
- 16- Për **Z. J. S.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
- 17- Për **Z. I. R.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ
- 18- Për **Z. J. H.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ
- 19- Per **Z. B. D.**, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
- 20- Per **Znj. E. G.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ

- Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 *“Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”*, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri ne 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.12, Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV “Procedurat që ndiqen nga SKAO” nga 1.1 deri 1.9, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, ndërkohë që duhet të ishin trajtuar me ndërhyrje në vlerën e mallit dhe jo në përputhje me kërkesat e neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave , duke kryer vlerësime jo të bazuara sipas kriterëve të pikës 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të Dhënat e Disponueshme në RSH, pikës 5 *“Rregullimet”*, pikës 6 *“Dokumentacioni*

shoqërues që lidhet me vlerën doganore”, pikës 6/b/c/d, pikës 7 “*Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor*”, pikës 8 “*Dokumentacioni Shtesë*”, pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f, pikës 11 “*Përdorimi i Data basit të Vlerësimit*” bazuar në pikën 10/c që lidhen me rilogaritje të detyrimeve doganore në import si dhe jo në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*”

-Për problematika që lidhen me procedurat e përpunimit të deklarave doganore me klasifikime tarifore të cilat nuk deklaruar janë në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mos rilogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, veprime jo në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779 prot, të DPD datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 date 25.11.20121 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr .9863 date 28.01.2008 “*Për Ushqimin*” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “*Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “*kompetencat e doganierit*” dhe neni 12 pika 5 “*kompetencat e përgjegjësit te zyrës operacion ale te kontrollit doganor*” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “*Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO*”.

F. I (c) .Niveli i masës “Mbajtja në masën e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” për punonjësit kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

- 1- Për Z.A. K.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.
- 2- Për Z. B. C.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane
- 3- Për Z. U. M.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane

-Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr. 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “*Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ*”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“*Pika I (nga pika 1 deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri ne 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe*

kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika që lidhen me mos kryerjen e plotë të procedurave të kontrollit doganor të përpunimit të deklarave doganore të kanalizuar në kanal te kuq (risk lartë) të cilat rezultojnë me klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, duke shkaktuar pasoja në mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 date 25.11.20121 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “për taksat kombëtare”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr. 9863 date 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (d) .Niveli i masës “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil” për punonjësit kategorisë C1 dhe C2 (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1-Për Z. J. H., me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.

2-Për Z. G. I., me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.

3-Për Z. E. C. me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.

-Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri ne 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika të evidentuara në praktikat doganore ku u konstatua se pas kryerjes se procedurës se kontrollit fizik nga personeli përpunues doganor për praktikat doganore në detyrim dhe juridiksion kontrolli në aktin e kontrollit është shënuar se deklarimi përputhej me gjendjen fizike të mallrave ndërkohe që pas procedurave të ri kontrollit është konstatuar mall i padeklaruar me diferenca në sasi, natyrë dhe vlerë për mjetet e çliuara nga zona doganore Tirane të rikthyera më pas për procedura ri kontrolli nga struktura e Drejtorisë së Antikontrabandes pranë Departamentit Operativ Hetimor. Pasi janë kryer procedurat e ri kontrollit nga struktura e Drejtorisë së Antikontrabandes pranë Departamentit Operativ Hetimor kanë rezultuar diferenca të mallrave të ndryshëm në sasi me efekte dhe pasoja në detyrime doganore për të cilat me pas Dega Doganore Tirane ka nxjerrë vendime administrative me efekte negative në Buxhetin e Shtetit të cilat janë kontabilizuar në formën e borxhit doganor. Në përfundim se konstatohet se nga personeli përpunues doganor i kontrollit fizik pranë Degës Doganore Tirane nuk janë kryer procedura të rregullta kontrolli gjatë kryerjes së detyrave funksionale me pasojë lindjen e efekteve negative në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

-Për problematika që lidhen me mos kryerjen e plotë të procedurave të kontrollit doganor të përpunimit të deklaratave doganore të kanalizuar në kanal të kuq (risk lartë) të cilat rezultojnë me klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, duke shkaktuar pasojë në mos rrillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 të ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime të cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit” dhe neni 12 pika 5 “kompetencat e përgjegjës të zyrës operacionale të kontrollit doganor” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (e). Niveli i masës “**Vërejtje**” për punonjësit e kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

- 1-Për **Znj. R. K.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 2-Për **Znj. E. B.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 3-Për **Z. L. Xh.** me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 4-Për **Znj. A. C.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 5-Për **Z. A. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
- 6-Për **Z. K. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
- 7-Për **Z. J. C.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ

- Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr. 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “*Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ*”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“*Pika I (nga pika 1 deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri ne 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.12, Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV “ Procedurat që ndiqen nga Skao” nga 1.1 deri 1.9, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.*

-Për problematika në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, ndërkohë që duhet të ishin trajtuar me ndërhyrje në vlerën e mallit dhe jo në përputhje me kërkesat e neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave , duke kryer vlerësime jo të bazuara sipas kriterëve të pikës 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të Dhënat e Disponueshme në RSH, pikës 5 “*Rregullimet*”, pikës 6 “*Dokumentacioni shoqëruar që lidhet me vlerën doganore*”, pikës 6/b/c/d, pikës 7 “*Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor*” ,pikës 8 “*Dokumentacioni Shtesë*”, pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f , pikës 11 “*Përdorimi i Databasit të Vlerësimit*” bazuar në pikën 10/c që lidhen me rilogaritje të detyrimeve doganore në import si dhe jo në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*”

-Për problematika që lidhen me procedurat e përpunimit të deklaratave doganore me klasifikime tarifore të cilat nuk deklaruar janë në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mos rilogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, veprime jo në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779 prot, të DPD datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 date 25.11.20121 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr .9863 date 28.01.2008 “*Për Ushqimin*” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “*Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së*

Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (f). Niveli i masës “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil*” për punonjësin e kategorisë C1 si më poshtë vijon.

1. Për Z. A. N. me detyrë përgjegjës i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane.

-Për problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e transiteve me destinacionit Degën e Doganës Tiranë pranë zyrës së pikës së hyrje-daljes (*afati kohor dhe mbyllja e transiteve*) dhe konkretisht: Nga ana e doganierëve të pikës së hyrjes nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuara/incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 126 dhe 128 të Kodit Doganor si dhe në referim tabelës së afateve të transitit nxjerrë sipas Udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “*Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit*”. si dhe referuar Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “*Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 13 pika 3 “kompetencat e përgjegjësit të sektorit të peshore pike/kontroli”

-Nuk janë dokumentuar shënimet për vonesën po ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklarates transit në sistemin Asçuda dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

-Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë 13045 raste me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacionit të cilat rezultojnë të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë për të cilat duhet të ishte mbajtur proces verbal për llojin e shkeljes kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë (çdo rast).

F II. Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe nenit 12 ‘*Masat Disiplinore*’ të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Tiranë në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë vijon :

F. II (a). Niveli i masës “*Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*” sipas nenit 12 pika 2 (b) të kontratës së punës individuale për punonjësit e mëposhtëm të kategorisë C3.

1- Për Z. Y. V. me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane.

2- Për Z. E. D. me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

3- Për Z. G. H. me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

4- Për Z. E. M. me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

5- Për Z. E. B. me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

6- Për Z. E. M. me detyrë ishdoganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

7- Për Z. K. B. me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

-Për problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e transiteve me destinacionit Degën e Doganës Tiranë pranë zyrës së pikës së hyrje-daljes (afati kohor dhe mbyllja e transiteve) ku nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuar/incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 126 dhe 128 të Kodit Doganor si dhe në referim tabelës së afateve të transitit nxjerrë sipas Udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit” si dhe referuar Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 11 ‘kompetencat e doganierit te peshore pike/kontrolli’.

-Nuk janë dokumentuar shënimet për vonesën po ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklaratës transit në sistemin Asicuda dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

-Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë 13045 raste me tejkallim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacionit të cilat rezultojnë të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë për të cilat duhet të ishte mbajtur proces verbal për llojin e shkeljes kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë (çdo rast).

Shënim: Për nëpunësit e përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit znj. L. B., E.H., z. G.P., J. P., E. Th., A. V., L.A., A. Sh., E. Nezaj, A. D., H. M., E. D., E. K., O. H., O. V., J. T., R. M., K. H., M. K., V. Y., E. P., E. K., E. K., E. Gj., K. B., R. M., S. L., K. H., A. Gj., L. D., K. E., J. M., S. T., E. Sh., , N. H., G. Y., O. Z., E. J., S. S., E.T., J. M., grupi auditues ka vlerësuar që nisur nga materialiteti i gjetjeve për numrin e praktikave të kryera dhe të përpunuara, niveli dhe frekuenca e shkeljeve të konstatuara, përgjegjësia e drejtpërdrejte ose indirekte në veprimet e kryera në mos përmbushje të detyrave funksionale sipas legjislacionit në fuqi, të mos rekomandohet masë disiplinore. Në vijim nga strukturat eprorë përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degën Doganore Tiranë si eprorë direkte dhe te drejtpërdrejtë të gjykohet dhe vlerësohet nisja ose jo e procedurave disiplinore për çdo rast ku janë të përfshirë dhe të përmendur këta persona në materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit pavarësisht faktit se për këta nëpunës zyrtarë nuk është rekomanduar masë e drejtpërdrejtë disiplinore në këtë material.

G. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre. Nga ana jonë nuk rekomandohet masë disiplinore për punonjësit e mëposhtëm

1-Për Z. R. D., me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ dalë në pension pleqërie.

2-Për Z. I. Xh., me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO dalë në pension pleqërie.

3-Për Znj. E. Sh., me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO dalë në pension pleqërie.

4-Per Z. K. V., me detyrë ish përgjegjës i klasifikim/vlerësim në SVQ në marrëdhënie pune mbushur moshën e pensionit të pleqërisë.

5-Për **Z. T. M.**, me detyrë ish doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane dalë në pension pleqërie.

H. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, ***të ndërmarrë veprimet si më poshtë:***

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT